

SEJJID KUTUB

ILUSTRIMI ARTISTIK NË KUR'AN

Logos-A



Sejjid Kutub

Ilustrimi artistik në Kur'an

Përktheu:
Ymer Musa

Copyright© by Logos-A 1996

Autor:
Sejjid Kutub

Titulli:
Ilustrimi artistik në Kur'an

Përkthyes:
Ymer Musa

Redaktor profesional:
Husamedin Abazi

Redaktor gjuhësor - korrektor:
Fatmire Ajdini - Hoxha

Biblioteka:
Mendimi islam

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Narodna i univerzitetska biblioteka
"Kliment Ohridski", Skopje

297.18:892.7-1.0

892.7-1.0:297.18

KUTUB, Sejjid

Ilustrimi artistik në Kur'an / Sejjid Kutub. - Shkup : Logos-A,
1996. - [i.e] 1416. 254 str. ; 20 sm. - (Biblioteka Mendimi islam)
ISBN 9989-601-29-1

a) Kuran - Poetika

Fjala e përkthyesit

S'do mend se ky libër, “Ilustrimi artistik në Kur'an”, i penës së mirënjohur Sejjid Kutub në kapitalin e librave të përkthyer shqip për dhe rreth Kur'anit, është i pari i këtij lloji. Libri në fjalë me tematikën që e shtjellon është arkë e pazbuluar shekuj me radhë në hapësirat e bukurisë artistike dhe vlerave të saj brenda Rreshtave hyjnore, jo vetëm tek ne por edhe në mbarë kufijtë islamë.

Në fillim do të theksoj se gjatë përkthimit të ajeteve të Kur'anit diku-diku kam përdorur vetëm përkthimin e H. Sherif Ahmetit, në shumë raste jam mbështetur edhe në dy përkthimet tjera të Kur'anit, atë të Hasan ef. Nahit dhe të dr. Fetë Mehdiut. Në disa raste jam detyruar të dal jashtë kornizave të përkthimit të tyre dhe të ndërhyj me shprehje tjera të shqipes duke u përpjekur që ajeti i përkthyer të përputhet me thurjen e ajetit në origjinal, domethënien e tij ilustrative si dhe qasjen e autorit për ta zbuluar bukurinë artistike në të.

Duke e pasur parasysh se autori objekt shpalosjeje të kësaj bukurie artistike ka fjalën e Allahut ashtu siç zbriti, kurse ne duhet ta përkthejmë edhe fjalën hyjnore edhe ilustrimin artistik të cilin na e ndriçon ky libër, jam më se i vetëdijshëm për vështirësitë në të cilat kam hasur gjatë përkthimit tim të këtij libri. Ne mund ta përkthejmë kuptimin e ngushtë të fjalës brenda fjalisë me fjalën shqipe, por jo edhe domethëniet e saj që i përmban në origjinal. Nga ky konstatim mund të përfundoj se vepra në shqip nuk e ka peshën e veprës në origjinal, por dëshira e botuesit dhe respekti që kam ndaj tyre bëri që t'i rrekem kësaj pune që opinionit intelektual shqiptar t'i prezentojmë një vepër artistike-letrare me kolorit islam të mbështetur në burimin e tij - Kur'anin.

Kam shpresë se kjo pikëpamje kur'anore ekskluzivisht artistike atyre që merren me art e krijimtari letrare do t'ua ngacmojë reflekset e brendshme intuitive, do t'ua shtojë oreksin artistik me anën e këtij ngacmimi emocional dhe do t'ua ushqejë imagjinatën me bukurinë artistike të Kur'anit që Autori i tij është Autor i tërë kësaj bukurie natyrore rreth nesh dhe në kozmos. Nëse kjo shpresë realizohet, do të ishte prej sukseseve më të mëdha për mua si përkthyes dhe një borxh i larë ndaj dëshmorit dhe mendimtarit të pakthyesëm, Sejjid Kutubit.

1 janar 1996

Ymer Musa

Shkup

Përkushtim

Ty, oj Nëna ime, këtë libër ta kushtoj!

Sa herë që përmes radios në fshat i dëgjoje kurratë (lexuesit e Kur'anit) duke lexuar Kur'an, dhe atë gjatë tërë muajit të Ramazanit e unë pranë teje dëshiroja të lozë si gjithë fëmijët, gishti yt i vënë në gojë, si vërejtje e fortë më pushtonte përnjëherë. Pranë teje edhe unë i përkulesha tertilit (leximit të Kur'anit) dhe prej atëherë shpirti im shijoi muzikalitetin e tij edhe pse ende nuk ia kuptoja domethëniet.

U rrita dhe u edukova në duart tua, e pastaj më dërgove edhe në shkollën fillore të fshatit. Më e madhja shpresë ytja ishte, që Allahu të më ndihmojë e të mësoj Kur'anin përmendsh, dhe të më dhurojë atë zë të dhembshëm që të ta lexoj e këndoj në çdo çast. Pastaj, në fund, ma tjetërsove atë rrugë në këtë rrugë të re të cilën jam duke e ndjekur tash, dhe atë pasi që u realizua një pjesë e dëshirës tënde me nxënien time të Kur'anit përmendsh.

Ti u ndave prej nesh, oj Nëna ime, e në kujtimin tim figura yte e fundit mbeti, ulja yte në dhomë pranë radios duke dëgjuar tertilin e bukur. Në fytyrën tënde fisnike shihej se ti me zemrën tënde të madhe dhe ndjenjën e zgjuar arrije t'i kuptosh caqet e tij dhe sekretet. Ky libër, oj Nënë, është fryt i udhëzimit tënd të pandërprerë që ia ke bërë fëmijës tënd të vogël dhe djalit tënd të madh. Edhe pse birit tënd i mungoi bukuria e tertilit, ndoshta nuk do t'i mungojë bukuria e te'vilit (komentimit).

Allahu të pastë në kujdesin e Tij përherë dhe e pastë birin tënd!

Biri yt, Sejjiidi.

Kur'anin e kam gjetur

Ky libër në mua ka një tregim. Këtë tregim kisha të drejtë ta mbaj në vete, përderisa ky libër ende pëshpërit dhe ngacmon ndërgjegjen time. Por, ky mori rrugën për në shtyp, andaj edhe tregimi i tij nuk është më pronë imja e as që pata të drejtë në atë.

Kur'anin e kam lexuar qysh kur isha i vogël. Atëherë kur aftësitë e mia nuk arrinin kupën e domethëniesve të tij e as kuptimi im nuk përshkonte madhësinë e synimeve të tij. Por, në shpirtin tim diçka prej tij kam gjetur.

Imagjinata ime e vogël dhe naive përmes shprehjeve kur'anore formësonte disa figura. Edhe pse ato figura ishin primitive dhe naive, ato ma mallëngjenin shpirtin dhe ma këndellnin ndjenjën, sa që një kohë mjaft të gjatë mbetesha në përjetim me to. Mbresat e tyre më gëzonin fuqishëm.

Nga ato figura primitive të cilat formësoheshin në imagjinatën time atëbotë, ishte ajo figurë e cila më shfaqej sa herë që e lexoja këtë ajet:

“Ka nga njerëzit që e adhurojnë Allahun me mëdyshje (hamendje), nëse i godet ndonjë e mirë ata qetësohen me te, por nëse i godet ndonjë e keqe, ata kthehen në fytyrën e vërtetë (të mëparshme), Ata e kanë humbur këtë dhe botën tjetër, e ky është dështim i qartë.” (Haxh, 11).

Nuk dëshiroj të qeshet askush kur do ta nxjerr në shesh këtë figurë të imagjinatës sime. Në kujtesën time shfaqej një njeri i cili qëndronte buzë një maje të lartë shkëmbore (atëherë jetoja në fshat) ose në maje të një kodre të ngushtë (që me kodrën tjetër i

ndante një luginë). Aty ai falej por nuk mund ta mbante qëndrimin. Në çdo lëvizje luhatej andej-këtej dhe e merrte rrëzimi. Unë përballë tij, me ëndje dhe mall të papërshkrueshëm përcillja çdo lëvizje të tij.

Prej figurave të tilla primitive, edhe kjo figurë, që më shfaqej sa herë që e lexoja këtë ajet:

“Dhe lexoju atyre tregimin e atij që ia patëm dhënë dituritë Tona, ndërsa ai u zhvesh prej tyre dhe atëherë atë e shoqëroi djalli, kështu që ai u bë prej të humburve. E sikur të donim, Ne do ta ngrenim lartë me atë (dituri), por ai nuk iu largua tokës (dunjasë) dhe shkoi pas epshit të vet. Shembulli i tij është si ai i qenit, të cilin nëse e përze, ai e nxjerr gjuhën, por edhe nëse nuk e përze, ai përsëri e nxjerr gjuhën.” (A’raf, 175-176).

Asgjë nuk kam kuptuar nga domethëniet e këtij ajeti e as nga synimet e tij. Por, në përfytyrimin tim shfaqej një figurë. Figura e një njeriu gojëhapur dhe gjuhëzgjatur i cili përjargej e përjargej panda, kurse unë i rrija përballë dhe nuk i hiqja sytë prej tij. Nuk e kuptoja pse e nxjerr gjuhën dhe përjarget por as nuk matesha t’i afrohem!

Në imagjinatën time të vogël personifikoheshin shumë figura të tilla. Me ëndje të madhe zhytesha në to, saqë mallëngjehesha ta lexoj Kur’anin për hir të tyre, dhe i kërkoja ato nëpër rreshtat e tij sa herë që lexoja.

* * *

Ato ishin kohë... Kaluan me përkujtimet e ëmbla dhe imagjinatat naive. Pastaj erdhën kohë tjera. Hyra nëpër institucione shkencore, i lexoja komentimet e Kur’anit në librat e tefsirit

(shkenca e komentimit), dhe e dëgjoja komentimin e tij nga profesorët. Por, unë gjatë leximit apo dëgjimit nuk e kam hasur atë Kur'an të lezetshëm dhe të bukur që e pata hasur gjatë fëmijërisë dhe djalërisë sime.

Obobo! Më janë zhdukur të gjitha pamjet e bukurisë së tij dhe më është zhveshur mendja nga shija dhe malli për të. Si thua, a nuk janë dy Kur'anë?! Kur'ani i fëmijërisë, i lehtë, i ëmbël dhe i përmallshëm dhe Kur'ani i rinisë, i vështirë, i ndërlikuar dhe i plasaritur! Apo vallë mos është ky mëkati i rrugës së ndjekur në tefsir?

Sërish iu ktheva leximit të Kur'anit, por jo në librat e tefsirit por në mus'haf. Përsëri e gjeta atë Kur'an të bukur dhe të dashur. I gjeta edhe figurat e mia të përmallshme e të dashura. Ato tani nuk janë të thjeshta siç ishin më parë. Edhe qëndrimi im ndaj tyre ka ndryshuar. Tani kthehem e i gjej synimet dhe qëllimet e tij, dhe e kuptoj se ato janë shembuj që shërbejnë e jo ngjarje që ndodhin.

Megjithatë, mahnitja nga ai ende është e pranishme kurse impresionimi nga ai panda vazhdon.

Falënderoj Allahun, Kur'anin e kam gjetur.

* * *

Prej figurave të cilat i kam hasur në Kur'an më lindi ideja që masës t'ia paraqes disa shembuj nga ata. Ashtu edhe veprova. Një studim të tillë e publikova në revistën "El-Muktetif" qysh në vitin 1939 me titull: Ilustrimi artistik në Kur'an. Në këtë artikull kam përfshirë disa figura në të cilat i konfirmova dhe zbulova të gjitha aspektet e bukurisë artistike. E vura në spikamë atë fuqi absolute e cila krijon pikturë thjeshtë vetëm me fjalë, që një gjë të tillë nuk

mund ta bëjë as brusha shumëngjyrëshe e as objektivi fotografues, andaj edhe përfundova: ky studim meriton të jetë temë për disertacion universitar.

* * *

Kaluan shumë vite. Gjatë gjithë asaj kohe Kur'ani më pikturonte një vizion në të cilin reflektoheshin gjurmët e mrekullisë artistike. Sa herë që më kujtohej dhe i kthehesha atij, më trimëronte që t'i hyjë këtij studimi, ta plotësoj dhe të zgjerohem në te. Kohë pas kohë mbetësja i vetmuar me Kur'anin duke i soditur pikturat e tij specifike, të cilat edhe më tepër ma shtonin dhe përforconin idenë e këtij studimi në qenien time. Megjithatë, çështjet tjera që më preokuponin e shndërronin idenë time shpresë në ndërgjegje dhe dëshirë në ndjenjë.

Kështu vazhdoi derisa ma mundësoi Allahu që pas pesë vjetëve të publikimit të këtij punimi në revistën “El-Muktetif”, t'i rrekem kësaj pune.

* * *

Studimin e fillova duke e pas Mus'hafin burim kryesor, që t'i përmbledhë figuracionet artistike të Kur'anit, t'i ekspozoj ato, ta sqaroj metodologjinë e ilustrimit në te dhe mënyrën se si realizohet harmonizimi artistik; ngase i tërë preokupimi im në atë kohë ishte i orientuar vetëm në këndin artistik pa mos ndërhyrë në lëmenjtë tjerë të shumtë të Kur'anit.

Por, çfarë të re kam sjellur?

Në të vërtetë, më është zbuluar një realitet i ri. Pa dyshim figuracionet në Kur'an nuk janë komponentë e tij që dallohen nga

komponentet tjera. Ilustrimi është bazë e të shprehurit dhe interpretimit në këtë libër të bukur. Bazë themelore e cila ndiqet në të gjitha qëllimet - pos qëllimit legjislativ, - andaj edhe nuk mund të thuhet se këtu bëhet fjalë për një studim të figuracioneve të cilat tubohen dhe renditen, por për një bazë e cila zbulohet dhe dallohet. Ky është një sukses dhe një zbulim që nuk e kam vërejtur më parë, pos pasi që iu rreka këtij studimi, arrita ta shoh atë!

Mbi këtë bazë edhe u ngrit ky studim. E gjithë ajo që gjendet në te, në të vërtetë është shfaqje e kësaj baze, shkoqitje e fenomeneve të saj dhe zbulim i kësaj veçorie origjinale të shprehjes kur'anore.

* * *

Kur e përfundova përgatitjen e këtij punimi, ndjeja se si në vete dëshmoja lindjen e sërishme të Kur'anit. Atë isha duke e përjetuar sikur kurrë më parë. Po, pa dyshim Kur'ani në qenien time ishte i bukur, mirëpo bukuria e tij ishte e përpjesëtuar dhe e ndarë, kurse sot ai është tog i pandarë dhe unik i cili ngrihet mbi një bazë të veçantë, mbi një bazë e cila ngërthen harmonizim të çuditshëm të cilin as që e kam ëndërruar më parë e as që kujtoj se dikush ka mund ta përfytyrojë.

Nëse kam arritur sukses që ta inskenoj këtë figuracion ashtu siç e ka parë shpirti im dhe t'ua prezentoj njerëzve ashtu siç e ka përjetuar ndërgjegjja ime, atëherë pa dyshim ky do të jetë suksesi i plotë i këtij libri.

Kur'ani magjepsës

Kur'ani i magjepsi arabët që nga çasti i parë, pa marrë parasysh a ishin ata që Allahu ua zgjeroi gjokset për Islam apo ata që në zemrat e tyre vuri perde. Nëse e lëmë anash grupin e vogël në fillim të paraqitjes së kësaj feje, te të cilët shkak i besimit të tyre ishte vetë personaliteti i Muhammedit alejhisselam, si bashkëshortja e tij Hadixheja, shoku i tij Ebu Bekri, djali i axhës së tij Aliu, shërbëtori i tij Zejdi e të ngjashmit me ta, do të shohim se Kur'ani është faktori vendimtar ose njëri prej faktorëve vendimtarë për pranimin e besimit të atyre që besuan në ditët e para të da'ves (thirrjes islamike), në ato ditë kur Muhammedi nuk kishte krah as pozitë kurse Islami nuk kishte pushtet e as aleatë.

Rrëfimi për besimin e Umer bin Hattabit dhe rrëfimi për refuzimin e Velid bin Mugires, janë dy shembuj nga shumë rrëfime për besimin dhe refuzimin. Që të dy e shfaqin këtë magjepsje kur'anore e cila i përfshiu arabët që nga çasti i parë dhe dëshmojnë - përmes këtyre dy orientimeve të kundërta - për peshën e kësaj magjepsjeje të pakrahasueshme të cilën në mënyrë të barabartë e konfirmojnë besimtarët dhe jobesimtarët.

Sa i përket rrëfimit për besimin e Umerit ekzistojnë transmetime të shumta:

Njëri prej tyre është transmetimi i Ataut dhe Muxhahidit të cilin e përcollti Ibni Is'haku nga Abdull-llah ibni Ebi Nexhihi. Aty përmendet se Umeri radijAllahu anhu ka thënë: “Prej Islamit kam qenë shumë larg. Në xhahilijet isha adhures i alkoolit, e kam dashur dhe e kam pirë shumë. Atëkohë kishim një kuvend ku tuboheshin disa burra kurejshitë... Dola që t'i takoj kuvendarët e mi atje, por aty nuk gjeta asnjërin. Thashë në vete, do të shkoj te filan

alkoolisti! Ia mësyva dhe mbërrita te ai por megjithatë nuk e gjeta. Thashë në vete, do të shkoj në Qabe e ta bëjë tavaf shtatë po edhe shtatëdhjetë herë! E kur arrita te faltorja dhe dëshirova t'i sillem Qabes, kur ja, I dërguari i Allahut alejhisselam qëndronte duke u falur. Ai e kishte zakon që kur falej të drejtohet kah Shami ku Qabeja ndërmjetësonte mes tij dhe Shamit, kurse vendfaljen e tij e merrte mes dy këndeve, këndit të zi dhe këndit jemenas. Kur e pashë, thashë në vete: Vall-llahi, sonte do të ishte mirë sikur ta dëgjoja Muhammedin dhe të marr vesh se ç'thotë! Më shkoi mendja se në qoftë se i afrohem për ta dëgjuar do ta frikësoj, andaj edhe u ndala. Iu afrova prej anës së gurit dhe u futa nën mbulojën e Qabes, saqë mes meje dhe atij qëndronte vetëm mbuloja e Qabes. E kur fillova ta dëgjoj Kur'anin, zemra m'u ul e sytë më rridhnin rrëke. Kjo edhe më shtyu ta pranoj Islamin”.

Ndërsa në një transmetim tjetër të cilin do ta cekim shkurtimisht thuhet se Umeri doli nga shtëpia i shashtisur me shpatën e tij, duke ia mësyer Resulullahut dhe disa shokëve të tij të cilët ishin mbledhur në një shtëpi në Safa. Që të gjithë, burra e gra, ishin afër dyzet veta.

Gjatë rrugës e takoi Neim bin Abdull-llahu dhe e pyeti se për ku është nisur. Umeri ia tregoi qëllimin e tij kurse ai kërkoi që të ketë kujdes prej Beni Abdu Menafëve dhe e porositi t'u kthehet disave nga anëtarët e familjes së tij, dhëndrit të tij Seid bin Zejdit dhe motrës së tij Fatimesë, të shoqes së Seidit. Ata që të dy ishin larguar nga feja e tyre e mëparshme. Atëherë Umeri e ndërroi kafen dhe ua mësyu atyre të dyve. Atje e dëgjoji Habbabin duke u lexuar Kur'an. Derën e përplasi përnjëherë, dhëndrit të tij ia dha një shuplakë kurse motrën e vet e përgjaku nga të rrahurit... Pas një marrëveshjeje ai mori në dorë fletushkën në të cilën ishte e shkruar sureja Tâhâ. Kur lexoi një pjesë të saj tha: “Sa fjalë e bukur dhe bujare qenka kjo!”. Më pas shkoi te Pejgamberi alejhisselam dhe e

shpalli Islamin e tij. Prej gëzimit të madh që e kaploi Pejgamberin, brohoriti me një tekbir aq sa zëri i tij arriti deri te shtëpitë e shokëve të tij dhe ata e kuptuan se Umeri e pranoi Islamin.¹

Ekzistojnë edhe transmetime tjera të cilat nuk ka nevojë t'i cekim, meqë të gjitha ato bëjnë me dije se Umeri dëgjoi apo lexoi diç nga Kur'ani, i cili ishte shkaktar i kthimit të tij në Islam. Do të ishte vërtet e tepërt sikur t'u hedhim një shikim faktorëve të tjerë shpirtërorë në historinë e Umerit, edhe pse këta faktorë nuk mund ta minimizojnë faktin se magjepsja nga Kur'ani ishte faktori vendimtar për ta pranuar Islamin.

Ky ishte rrëfimi për besimin e Umer bin Hattabit, ndërsa rrëfimi për refuzimin e Velid bin Mugires po ashtu ka shumë transmetime, të cilat shkurtimisht kanë këtë përmbajtje:

Velid bin Mugire dëgjoi diçka nga Kur'ani dhe sikur ajetet e tij ia zbutën zemrën. Atëherë kurejshitët thanë: Vallahi Velidi ndërroi fenë, tash do ta ndërrojnë fenë të gjithë kurejshitët. Ata Velidit ia dërguan Ebu Xhehlin që t'ia nxisë në shpirt madhështinë dhe krenarinë e prejardhjes së tij dhe pasurisë që kishte, e të kërkojë pastaj prej tij ta shpreh me fjalë urrejtjen ndaj Kur'anit. Velidi pyeti: “E ç’të them për te? Pasha Allahun, askush prej jush nuk ka njohuri më shumë se unë për poezinë dhe llojet e saj, po as për poezinë e xhinëve. Pasha Allahun, ajo të cilën ai e thotë, aspak nuk u përngjanë poezive. Pasha Allahun, fjala e tij ka ëmbëlsi, në të qëndron një mrekulli, s’ka bukuri mbi te, afër tij çdo fjalë shkrihet, andaj edhe s’ka fjalë më të lartë dhe asgjë nuk mund t’ia kalojë”. Atëherë Ebu Xhehli iu lut: “Populli nuk qetësohet derisa të thuash fjalë tjera”. Ai iu përgjigj: “Më le të qetë të kujtohem”. Kur u mendua mirë tha: “Kjo s’është gjë tjetër pos një magji trashëguese.

¹ Marrë nga libri Es-Sîretu e Ibni Hishamit.

A nuk keni parë se si e ndanë njeriun nga familja e tij dhe miqtë që i ka pasur?”²

Për këtë ndodhi Kur’ani i veçon këto ajete: “Ai ka paramenduar dhe ka kurdisur (fjalë kundër Kur’anit). Qoftë i shkatërruar, po si i ka kurdisur. Përsëri qoftë i shkatërruar, po si i ka kurdisur. Ai sërish u thellua në mendime. Pastaj u mrrol dhe u vrazhdësua. E më pas ktheu shpinën (refuzoi) dhe u kapërdis. Ai tha: Ky (Kur’ani) nuk është gjë tjetër pos një magji trashëguese.” (Muddeth-thir, 18-24).

Magji trashëguese e cila e ndanë njeriun nga familja, fëmijët dhe miqtë... Kjo është fjalë e njeriut i cili ngurron nga Islami, kryelartësohet e përmbahet që mos t’i dorëzohet Muhammedit dhe mburret me prejardhjen, pasurinë dhe fëmijët që ka. Ndonëse kjo nuk është fjalë e një njeriu besimtar, prapëseprapë, besimin e tij e li-dhë me magjinë e cila nuk mposhtet! Ky është edhe argumenti më i fortë për “magjepsjen e Kur’anit” te arabët, më shumë se edhe çdo fjalë e besimtarëve që e thonin, ngase ai nuk mund të lexohet o të dëgjohet, e që lexuesi apo dëgjuesi të gjejë mënyrë ta asgjësojë ose të zvarritet nga pranimi i tij!

Që këtu takohet rrëfimi për kufrin me rrëfimin për imanin kur që të dy miratojnë magjepsjen nga Kur’ani! Përmes këtij miratimi takohen dy personalitete të forta ndërmjet të cilëve ekziston një distancë e kundërshtisë aq sa mund të paramendohet mes Umer bin Hattabit dhe Velid bin Mugires. Kjo, sepse sinjeriteti ia hapë zemrën Umerit për Islam kurse arroganca e pengon Velidin t’i përkulet të vërtetës, ashtu që ata vazhdojnë rrugën e tyre të ndarë pasi që ishin të bashkuar në një pikëtakim, pikëtakimi i miratimit për magjepsjen nga Kur’ani.

² Po aty dhe nga Tefsiri i Ibni Kethirit.

Të njëjtën peshë të këtyre dy rrëfimeve për faktin e kësaj magjepsjeje kanë thëniet e disa jobesimtarëve të cilat Kur'ani i paraqet kur thotë: “Ata që nuk besuan thanë: Mos e dëgjoni këtë Kur'an dhe (kur të lexohet ai) bëni zhurmë ashtu që ta pengoni!” (Fussilet, 26). Ky citat vetëm e argumenton llahtarinë e cila i pat topitur shpirtrat e tyre nga ndikimi i Kur'anit në ta dhe në ithtarët e tyre. Ata i shihnin ithtarët e tyre se si magjepseshin mëngjes e mbrëmje nga ndikimi i një apo dy ajeteve, një apo dy sureve të cilat i lexonte Muhammedi ose njëri prej pasuesve të tij të parë. Kështu shpirtrat e tyre i përkuleshin, zemrat e tyre impresionoheshin kurse të sinkertit rrëqetheshin.

Këto fjalë nuk ua thanë krerët e kurejshëve, ithtarëve e tifozëve të tyre ngaqë ata i kishin shpëtuar magjepsjes nga Kur'ani. Sikur të mos ndienin në brendinë e tyre një fërgëllimë që ua dridhte zemrat nuk do t'i urdhëronin ithtarët e tyre me këtë urdhër e as që do ta përhapnin vërejtjen e tyre në popull që është fakt më i fortë se çdo fjalë për atë ndikim të madh e të fuqishëm!

Ata reagueshan ndaj Kur'anit me një mohim të vardisur. Kur'ani për këtë thotë: “(Ajetet e Kur'anit) janë legjenda të të parëve, që ai (Muhammedi) kërkoi t'i kopjohen e i lexohen ato mëngjes e mbrëmje.” (Furkân, 5).

Ata gjithashtu thanë: “Kemi dëgjuar (këso fjalë) edhe sikur të donim edhe ne do të thonim diçka të ngjashme me këtë. Këto nuk janë pos legjenda të të parëve.” (Enfâl, 31).

Pastaj thanë: “(Për Kur'anin) Ëndrra të përziera, jo, por ai (Muhammedi) vetë i trilloi, jo jo, ai është poet.” (Enbija, 5).

Atëherë Kur'ani u shpalli konkurrencë disa herë duke u thënë: “Sillni dhjetë sure të ngjashme (si të Kur'anit) ashtu të trilluara (siç thoni ju).” (Hūdë, 13). Nëse nuk mundeni: “Sillni pra ju një sure të ngjashme me këto, madje thirrni kë të doni në ndihmë, pos Allahut.” (Jûnus, 38). Por ata nuk sollën dhjetë sure, madje as një të vetme! Në të vërtetë, ata as që e bënë këtë përpjekje pos asaj që është thënë për përpjekjet e disa të vetëquajturve të dërguar pas Muhammedit. Madje as kjo nuk është aspak e sigurt dhe as që lejohet të bëhet llogari në këtë aspekt. Ndërsa men-dimi i thënë se ata e braktisën përpjekjen, nuk ka peshë që mban!

* * *

Ndoshta si përkryerje e fjalës në këtë kapitull do të ishte theksimi i disa figuracioneve të cilat janë cekur në Kur'an për shkak të ndikimit të tij në qeniet e disave që u është dhënë dituria (librat qiellorë) para ardhjes së tij dhe disave, zemrat e të cilëve tërhiqeshin nga ai.

Në kontekst të fjalës për hebrenjtë dhe të krishterët zbriti ky ajet:

“Gjithsesi do të vëresh se hebrenjtë dhe ata që i përshkruan Zotit shok, janë njerëzit me armiqtësi më të fortë kundër besimtarëve (muslimanëve). Ndërsa do të vëresh se miq më të afërt për besimtarët janë ata që thanë: Ne jemi të krishterë (nesârâ). Kjo ngase prej tyre ka dijetarë dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneçë. Kur e dëgjojnë atë që i është zbritur Të dërguarit, prej syve të tyre rrjedhin lotë, ngaqë e kanë kuptuar të vërtetën dhe thonë: Zoti ynë, ne kemi besuar, pra na regjistron ndër ata që dëshmojnë (pejgamberllëkun e Muhammedit).” (Mâide, 82-83).

Ky është shembull prej shembujve të ndikimit intuitiv gjatë dëgjimit të Kur'anit, andaj sytë e tyre mbushen me lotë prej të vërtetës që e kuptuan. Pa dyshim, metodologjia e cila përdoret për ta prezentuar këtë të vërtetë, zotëron impresionim të fuqishëm. Një fakt të tillë e proklamoi rasti që ceket në këtë tekst:

“Atyre që u është dhënë dijeni (nga librat e parë) para tij, kur u lexohet atyre, ata hidhen me fytyra (për dhe) duke i bërë sexhde. Dhe thonë: I lartësuar është Zoti ynë, premtimi i Zotit tonë është i realizuar. Dhe duke qarë bien me fytyra (kur dëgjojnë Kur'anin) dhe ai ua shton edhe më shumë përluljen (ndaj Allahut).” (Isra, 107-109).

Gjithashtu edhe ky figuracion për “ata që frikohen prej Zotit të tyre”:

“Allahu e ka shpallur fjalën më të bukur, librin të ngjashëm me mrekulli, të përsëritur herë pas here (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij rrëqethen lëkurët e atyre që i kanë dronë Zotit të tyre, e pastaj me përkujtim ndaj Allahut u qetësohen lëkurët dhe zemrat e tyre.” (Zumer, 23).

Kështu pra “rrëqethen lëkurët e atyre që kanë dronë Zotit të tyre” “Dhe duke qarë hidhen me fytyra (kur dëgjojnë Kur'anin) dhe ai ua shton edhe më shumë përluljen (ndaj Allahut)” “Prej syve të tyre rrjedhin lotët”... Ky pra është ndikimi i cili ngacmon intuitën, aktivizon ndjenjat dhe i shpërthen lotët. E dëgjojnë ata që janë të gatshëm për ta pranuar besimin, ndaj edhe shpejtojnë nga Ai sikur të ishin nën ndikimin e ndonjë magjie, e dëgjojnë edhe ata të cilët madhështohen e nuk e pranojnë, andaj edhe thonë: “Kjo nuk është tjetër vetëm se magji e hapur.” (Hūdë, 7), ose thonë: “Mos e dëgjoni këtë Kur'an dhe kur të lexohet ai, ju bëni zhurmë (bërtitni) ashtu që ta pengoni.” (Fussilet, 26). Në këtë mënyrë ata

vetëm miratojnë mrekullinë e pamposhtur dhe triumfuese me apo pa vetëdije!

Burimi i magjepsjes nga Kur'ani

Si dominoi Kur'ani mbi arabët me këtë magjepsim? Pse ishin unanimitë besimtarët dhe jobesimtarët kur ishte në pyetje miratimi i magjepsjes nga ai?

Disa studiues të veçorive të Kur'anit shikojnë në te në formë të përgjithshme e pastaj vijnë në konstatim. Disa të tjerë cekin disa shkaqe tjera jashtë harmonizimit artistik, të cilat i deduktojnë nga tematika e tij; meqë është kompletuar si legjislacion i përpiktë i përshtatshëm për çdo kohë dhe çdo vend, si lajmëtar i gajbit (të panjohurës) i cili realizohet pas disa vjetësh, dhe si libër që përmban njohuri për gjithësinë dhe njeriun.

Studimi nga ky kënd vetëm konfirmon një veçori të Kur'anit si tërësi. Megjithatë, çka do të thoshim për suret e shkurta të cilat nuk kanë as legjislacion, as gajb, as dituri shkencash. Nga kjo del se nuk janë përfshirë të gjitha veçoritë e nduarnduarta të Kur'anit. Në të vërtetë, këto sure të shkurta i magjepsën arabët që nga çasti i parë, në atë kohë kur ndjenjat e tyre nuk i zgjoi e as që do t'i mahniste legjislacioni i përpiktë ose qëllimet tjera kolosale të Kur'anit.

Domosdo pra, këto sure të shkurta në vete të kenë zotëruar elementin i cili magjepste dëgjuesit dhe dominonte mbi arsyet e besimtarëve dhe jobesimtarëve. Nëse kihet parasysh ndikimi kur'anor në besimin (Islamin) e muslimanëve, këto sure të para kanë luajtur rolin më të madh sado që të jetë i vogël numri i muslimanëve në atë kohë. Kjo, ngase në të shumtën e rasteve, ata u frymëzuan vetëm nga Kur'ani dhe i besuan. Mirëpo pjesa dërrmuese e atyre të cilët e pranuan Islamin pasi që u forcuan

muslimanët dhe dominoi feja islame, ata krahas Kur'anit kishin edhe faktorë tjerë të cilët ndikuan te ata që besuan, çdonjëri sipas mënyrës së vet dhe çdonjëri sipas përshtypjeve të tij. Andaj, Kur'ani nuk ishte i vetmi faktor vendimtar në Islamin e tyre siç ishte rasti në vigjilje të da'ves islamike.

Disa besuan ngaqë u la përshtypje morali i Pejgamberit alejhisselam dhe i shokëve të tij, kënaqësia e Allahut qoftë mbi ta.

Disa besuan kur i panë muslimanët se si i duronin maltretime, mundimet dhe torturat, se si ata e linin pasurinë, familjen dhe shoqërinë që të shpëtojnë ata dhe feja e tyre, e të strehohen atje ku i udhëzon Zoti i tyre.

Disa besuan ngase panë se si Muhammedin me një pakicë besimtarësh nuk mund t'i mposhte askush dhe panë se Allahu u ndihmon dhe i ruan nga kurthet e kurthngrehësve.

Disa besuan meqë filloi të zbatohet sheriatu islam, kur panë se aty ka drejtësi e tolerancë të cilat nuk mund të haseshin në sistemet tjera të mëparshme.

Disa të tjerë besuan për shkaqe tjera, ka mund të jetë magjepsimi kur'anor prej faktorëve të besimit, por jo si faktor vendimtar siç ishte në vigjilje të kësaj thirrjeje.

* * *

Pra, ne detyrohemi t'i qasemi "burimit të magjepsjes nga Kur'ani" para se t'i qasemi legjislacionit të përkryer, lajmeve sekrete, njohurive hapsinore dhe para se të bëhet Kur'ani tërësi e plotësuar e t'i përfshijë të gjitha këto aspekte. Pjesa e vogël e Kur'anit e cila ka ekzistuar në ditët e para të da'ves ishte e

zhveshur nga të gjitha këto tipare të cilat paraqiten më vonë. Përkundër këtyre tipareve, atë përsëri e përshkonte ai burim origjinal të cilin e shijuan arabët dhe thanë: “Kjo nuk është asgjë tjetër pos një magji trashëguese”.

Rrëfimi për refuzimin e Velid bin Mugires është i theksuar në suren Muddeththir e cila sipas rendit të zbritjes kur'anore duhet të jetë sureja e tretë pas sures Alek dhe Muzzemmil, ose përgjithësisht ajo është prej sureve të para në Kur'an.³

Të hedhim një shikim në këto sure, sa për të marrë shembull e të shohim se çfarë magjie e tronditi Velidin aq shumë.

Kur i lexojmë ajetet mekkase të këtyre sureve nuk do të hasim në legjislacion të përkryer e as në njohuri kozmike - pos një indikacioni të përciptë në suren e parë kur flitet për krijimin e njeriut nga embrioni - e as lajmërim për diç sekrete që do të ndodhë pas disa vjetësh siç është cekur rasti i tillë në suren Rrûm, që sipas rendit të zbritjes është sureja e tetëdhjetë e katërt.

Ku qëndron pra ajo magji për të cilën flet Velid bin Mugire pas gjithë atij studimi dhe vlerësimi?

Doemos, ajo magji e cila e lëndoi ate është fshehur në një fizionomi tjetër, jo sipas asaj të legjislacionit, të sekreteve apo njohurive kozmike. Domosdo të jetë fshehur në brendinë e vetë thurjes së vargjeve kur'anore (simetrisë kur'anore), e jo në tematikën për të cilën flet, ndonëse ne nuk mund ta injorojmë fuqinë dhe tërheq-shmërinë që e posedon natyra e besimit islam.

³ Radhitja e sureve sipas zbritjes së tyre nuk është çështje ujdie, përpos disa sureve të cilat për bazë kanë disa transmetime.

Këto veçori ndriçohen përmes shprehjes së bukur impresionuese, artikulluese dhe ilustruese.

Le ta shohim tani suren e parë sipas zbritjes: Alek. Ajo përmbanë pesëmbëdhjetë nëndarje (fâsile, durakë) me fjali të shkurta të cilat në shikim të parë ndoshta u gjasojnë “prozave të rimuara klerikale” (sexh’ul kihân) ose “fjalëve të urta të rimuara” (hikmetus sexha), të cilat ishin të njohura ndër arabët në atë kohë!

Megjithatë, dallimi mes tyre dhe prozave të rimuara është se fjalitë i kanë të shthurura dhe nuk kanë lidhshmëri dhe simetri mes vete. Andaj shtrojmë pyetjen, a thua të njëjtën pozitë e ka edhe sureja Alek?

Përgjigja do të ishte: assesi. Ajetet e saj janë të thurura simetrikisht dhe në mënyrë të harmonizuar nëndarjet e saj i lidhë një harmoni subtile e brendshme.

Kjo është sureja e parë e Kur’anit. Ajo meriton të fillohet me lexim dhe emër të Allahut. Leximi duhet t’i bëhet Kur’anit, kurse me emër të Allahut sepse Ai po thërret në emër të tij në fe. Allahu është rabb (Zot), kurse leximi bëhet për Terbijje⁴ (edukim) dhe mësim, andaj edhe thuhet: “Lexo me emrin e Zotit tënd”.

Kjo sure është pikëfillim i kësaj thirrjeje, andaj zgjedh nga cilësitë e Zotit cilësinë e cila ka kuptimin e fillimit të jetës. Pastaj vazhdon: “I cili krijoi”. Nga krijimi si atribut e afirmon periudhën e parë të krijimit: “Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur”. Fill i vogël dhe i gërditshëm, por Zoti krijues, është bujar dhe shumë bujar ngase e shndërroi atë copë gjaku në njeri të plotë i cili pranon mësimin dhe mësohet: “Lexo, se Zoti yt është më bujari! Ai që e

⁴ Fjalët *rabb* dhe *terbijje* kanë një gjenezë në gjuhën arabe (sh.p.)

mësoi (njeriun) të shkruajë me penë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte”.

Vërtet, ky është transformim i madh mes kësaj zanafille dhe këtij formimi. Sureja këtë rast e ilustron befasisht pa hyrë në etapa. I hedh pas shpine të gjitha etapat të cilat vijojnë pas fillimit të krijimit deri te formimi i tij i plotë, në mënyrë që ta ngacmojë fuqishëm ndërgjegjen njerëzore në sferën e thirrjes fetare dhe në sferën e meditimeve intuitive.

Do të ishte e arsyeshme që njeriu ta mirënjohë këtë vlerë të madhe dhe ta çmojë në mënyrë sensible këtë transformim imponant, megjithatë: “Kursesi! Njeriu vërtet i kalon kufijtë, për shkak se e ndien veten të pavarur”. Këtu pra u shfaq figura e njeriut kapërcyes i cili harron zanafillën e tij dhe e tërbon jovarshmëria. Epilogu kërcënues dhe i menjëhershëm për zbulimin real të kësaj figure është: “Po, kthimi është vetëm te Zoti yt”.

Nëse çështja i kthehet realitetit të saj kështu shpejt, nuk është çudi pse menjëherë kalohet dhe flitet për kapërcyeshmërinë njerëzore dhe vazhdohet në plotësimin e sures. Ky njeri i cili i kapërcen kufijtë me veprimin e tij, vetvetiu kalon në dëmtimin e të tjerëve!

“Çka mendon ti për atë që pengon një rob kur ai falet?”. “Çka mendon?” - kjo është fjalë e madhe! Ajo do të ishte edhe më e madhe nëse ky rob do të ishte i udhëzuar ose do të preferonte devotshmërinë: “Çka mendon kur ai është në rrugë të drejtë? Ose ai urdhëron për singëritet”. Ç’u bë me këtë krijesë njerëzore e cila harroi çdo gjë mu ashtu siç harroi zanafillën dhe formimin e saj?! “Çka mendon nëse ai përgënjeshtrohet dhe sprapset (nga besimi), a nuk e di ai se Allahu sheh?”. Këtu kërcënim i vjen mu në kohën e vet: “Kursesi! Nëse nuk tërhiqet, vërtet do ta kapim për flokët e

ballit". Pra, fjala "do ta kapim", është shprehje e ashpër ilustruese e cila e tingëllon kuptimin e vet. Kjo shprehje "le nesfeannehu" (në tekstin origjinal sh.p.) është më impresionuese dhe më ilustruese se sinonimi i saj "le ne'hudhennehu bi shiddeh" (në përkthim: do ta kapim fuqishëm), sepse shprehja e parë është ilustrim sensual (ndijor) i kapjes së shpejtë dhe të fuqishme në pjesën më të lartë, që u krekos me te kapërcyesi mendjemadh, e ajo është pjesa e parme e kokës së kreshpëruar. Ajo kokë meriton të kapet fuqishëm: "Flokë i ballit rrenacak dhe mëkatar". Në këtë moment të tërheqjes për flokët e ballit dhe hedhjes së mëkatarit, të tillit do t'i shkojë ndërmend t'i thërrasë ata me të cilët krenohej qofshin nga familja apo shoqëria: "Le t'i thërret ata të vetët (në ndihmë)" dhe ata që janë aty. Kurse ne, "Ne do t'i thërrasim zebanitë (rojat e xhehennemit)". Që këtu, kontesti i fjalëve ia përfytyron dëgjuesit disa pasqyrime betejash mes atyre që thirren, mes zebanive dhe të vetëve të tij. Kjo është një betejë psikologjike dhe e imagjinuar e cila ngacmon ndjenjën dhe imagjinatën, por kjo sipas këtyre rrjedhave është me epilog të ditur! Ta lëmë pra këtë betejë le të përfundojë me epilogun e saj të njohur. Le të vazhdojë ithtari i këtij misioni në misionin e tij dhe le të mos preket nga kapërcimet e zullumqarit dhe përgënje-shtrimet e tij: "Kurrresi! Mos iu përul atij, por bëni sexhde dhe afroju (Zotit me të)." (Ale, 1-19).

Kjo pra është nismë e fuqishme që nga momenti i parë i thirrjes islame. Të gjitha këto nëndarje (durakë) që në shikim të rëndomtë duken se nuk kanë lidhshmëri mes vete, ato kështu - prej përbrenda, intimisht - janë të harmonizuara simetrikisht. Kjo është një simetri kur'anore në suren e parë e cila nga jashtë u përngjanë prozave të rimuara klerikale ose fjalëve të urta të rimuara.

Le të shikojmë edhe suren e dytë e cila, sipas të gjitha gjasave, duhet të jetë sureja Muzzemmil të cilës, me sa duket, i kanë prirë

ajetet e para të sures Kalem. Siç duket, kjo është ajo sure të cilën e dëgjoi Velid bin Mugire dhe e tha fjalën e tij të njohur!

“Atë ditë kur toka dhe kodrat do të dridhen e do të bëhen si grumbuj të shkapërderdhur të rërës. Ne me të vërtetë te ju dërguam një Pejgamber që dëshmon kundër jush, ashtu siç patëm dërguar edhe te faraoni Pejgamber. E faraoni e kundërshtoi Pejgamberin, andaj ne i dhamë atij një dënim të rëndë. Nëse ju mohoni, si do të mbroheni një ditë kur fëmijët do të bëhen të thinjur (prej tmerrit të madh)?! Atë ditë qielli do të çahet dhe premtimi i tij do të realizohet.” (Muzzemmil, 14-18).

Ja pra, ky është një pasqyrim për terrin, i cili nga njeriu dhe shpirti i tij kalon në tërë atë që i themi natyrë, kurse dihet se njeriu është pjesë përbërëse e saj: “Atë ditë kur toka dhe malet do të dridhen e do të bëhen si grumbuj të shkapërderdhur të rërës”. Le ta mbërthejë imagjinata nëse mundet skenën e atij tmerrit të cilit do t’i dridhen trishtueshëm toka dhe kodrat si sinonime më të mëdha të natyrës. Ne (thotë Allahu), nuk do t’ua paraqesim këtë ditë vetëm pasi që t’u dërgojmë Pejgamber i cili përpiket t’ju udhëzojë dhe të dëshmojë (nëse nuk udhëzoheni) kundër jush: “Ne me të vërtetë, te ju dërguam një Pejgamber që dëshmon kundër jush, ashtu siç patëm dërguar edhe te faraoni Pejgamber”. Ju po e shfaqni fuqinë tuaj, po ku është fuqia juaj krahas fuqisë së faraonit?! “E faraoni e kundërshtoi Pejgamberin, andaj Ne i dhamë atij një dënim të rëndë”. A doni edhe ju të mblidhni forca ashtu siç mblodhi faraoni? E kur të përfundojë kjo botë: “Nëse ju mohoni, si do të mbroheni një ditë kur fëmijët do të bëhen të thinjur (prej tmerrit të madh)?! Atë ditë qielli do të çahet”. Pranë tmerrit këtu çahet qielli, e pak më parë u dridhën trishtueshëm toka dhe kodrat. Kjo pamje do t’i bëjë të thinjur fëmijët. Ky është një tmerr që pamjet e tij do të vizatohen në natyrë të vdekur e në njerëzimin e gjallë, ndërsa imagjinata duhet t’i përjetojë këto piktura të

ekspozuara. Ajo, pa dyshim do t'i përjetojë ashtu që edhe intuita do të trazohet e shqetësohet kur Ai (Allahu) bindshëm do ta vërtetojë: "Dhe premtimi i Tij do të realizohet". S'ka dyshim në të por as ikje prej tij. Kjo vërejtje alarmante nuk bëhet për asgjë, vetëm për përkujtim: "Këto janë një përkujtim qortues, e kush do, ai e zgjedh rrugën për te Zoti i vet." (Muzzemmil, 19). Rruga që shpie kah Allahu është më e qetë dhe më e lehtë se rruga që shpie drejt këtij tmërri lemeritës!

* * *

Sa i përket rrëfimit për imanin (pranimin e besimit) e Umerit, shumica e transmetimeve cekin se ai lexoi një pjesë nga sureja Tâhâ, e dyzet e pesta me radhë, dhe e cila vjen pas këtyre sureve: Alek, Muzzemmil, Muddeth-thir, Kalem, Fâtiha, Mesed, Tekvîr, Aë'la, El-Lejl, Fexhr, Duha, Inshirâh, Asr, Adijât, Kevther, Tekâthur, Maûn, Kâfirûn, Fîl, Felek, En-Nâs, Ihlâs, Nexhëm, Abese, El-Kadr, Shems. Burûxh, Tînë, Kurejsh, Kariah, Kijâme, Humeze, Murselât, Kâf, Beled, Târik, Kamer, Sâd, A'râfë, Xhinn, Jâsînë, Furkân, Fâtir dhe e dyzet e katërta me radhë sipas zbritjes sureja Merjem, që të gjitha janë sure mekkase pos disa ajeteve medinase që janë pjesë e sureve mekkase.

Le t'i shikojmë këto sure në formë të përgjithësuar - sepse vështrimi në formë detajore sipas parimit që e kemi ndjekur në rrëfimin e refuzimit të Velidit është i pamundshëm - e të shohim se çfarë magjepsje posedojnë ato, nga të cilat u impresionuan të parët e hershëm të cilët ndoqën Muhammedin, bile edhe para se të forcohet Islami me Umerin dhe para se të thërret Pejgamberi haptazi meqë thirrte fshehurazi dhe në mënyrë sekrete.

Nëse i vërejmë të gjitha këto sure, nuk do të gjejmë në to përveç në një masë shumë të vogël ato synime të cilat një pjesë e madhe e dijetarëve i trajtojnë si tipare më relevante të Kur'anit.

Ne në këto sure gjejmë - siç gjejmë në suret tjera mekkase në formë të veçantë - bukuri gjatë ekspozimit, fuqi gjatë interpretimit, impresionim gjatë të shprehurit, gjallëri gjatë ilustrimit, të gjitha këto sipas një stili specifik.

Çështjen e besimit, që ekspozimin e saj e merr përsipër Kur'ani, e gjejmë të shfaqur përmes skenave të gjithësisë dhe ndjenjave të shpirtit të cilat ngacmojnë ndërgjegjen dhe e ngjallin imagjinatën.

Ky libër nuk ka për qëllim që ta shtjellojë tematikën e da'ves kur'anore nga aspekti fetar. Ne do të përpiqemi - pas shtjellimit studioz të fjalës vetëm në frymën e të shprehurit - t'i tejkalojmë kufijtë kohorë dhe hapsinorë dhe t'i kapërcejmë moshat dhe periudhat që ta gjejmë bukurinë e çiltër të artit si element i mëvetësishëm në thelbin e tij, i përhershëm në Kur'an me qenien e tij. Ky libër do ta përjetojë këtë art kur'anor pa kurrfarë ndërhyrjesh, të ndarë nga të gjitha mveshjet dhe qëllimet tjera.

Nëse kjo bukuri artistike përjetohet në veçanti do të mjaftonte, e nëse shikohet nga këndi i simetrizimit të saj me qëllimet e thirrjes islamike, vlera e saj edhe më shumë do të shtohet.

Të shohim pra tani se si njerëzit e kuptuan dhe e ndjenë këtë bukuri gjatë periudhave të ndryshme.

Si është kuptuar Kur'an

Në shtjellimet e arabëve bashkëkohorë nuk mund të gjejmë ndonjë figuracion të kësaj bukurie artistike të Kur'anit, të cilën të parët e tyre herë e quajtën poezi e herë magji, ndonëse mund të vërejmë ndonjë figurë që u ka lënë përshtypje.

Arabët e parë Kur'anin e pranuan të magjepsur, qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Njëra palë magjepsesh dhe besonte kurse pala tjetër magjepsesh dhe ikte. Mandej që të dy palët tregojnë se çka i ka ngacmuar dhe impresionuar. Rrëfimet e tyre janë të mjegulluara, nuk të japin të kuptosh më tepër se figurën e të magjepsurit të shtangur i cili i hutuar nuk ia di strofllën magjisë nga ajo thurje e çuditshme kur e dëgjon, edhe pse në brendinë e tij e ndien këtë ndikim të pazakonshëm.

Umer bin Hattabi në një transmetim thotë: “E kur fillova ta dëgjoj Kur'anin, zemra m'u ul e sytë më rridhnin rrëke. Kjo edhe më shtyu ta pranoj Islamin”. Ndërsa sipas një transmetimi tjetër thuhet se ka thënë: “Sa fjalë e bukur dhe bujare qenka kjo”.

Por, ja, edhe Velid bin Mugire, mohues i Muhammedit dhe i Kur'anit detyrohet ta shfaqë dashurinë e tij ose besnikërinë: “Pasha Allahun fjala e tij ka ëmbëlsi, në të qëndron një mrekulli, s'ka bukuri mbi të, afër tij çdo fjalë shkrihet, andaj edhe s'ka fjalë më të lartë dhe asgjë nuk mund t'ia kalojë”. E më pas thotë: “Kjo nuk është gjë tjetër pos një magji trashëguese. A nuk e keni parë se si e ndanë njeriun nga familja e tij dhe miqtë që i ka pasur?”.

Ky Kur'an përshkruan përshtypjen që e lë në shpirtat e atyre që i besojnë dhe në shpirtat e atyre që u erdhi dituria më parë (Libri i shenjtë) dhe se atyre: “Prej (dëgjimit të) tij rrëqethen

lëkurët e atyre që i kanë dronë Zotit të tyre, e pastaj me përkujtim të Allahut u qetësohen lëkurët dhe zemrat e tyre.”(Zumer, 23). “Kur u lexohet atyre, ata hedhen me fytyra (për dhe) duke i bërë sexhde. Dhe thonë: I lartësuar qoftë Zoti ynë, premtimi i Zotit tonë është i realizuar. Dhe duke qarë bien me fytyra (kur dëgjojnë Kur’anin) dhe ai ua shton edhe më tepër përluljen (ndaj Allahut).” (Isra, 107-109).

Ja se si mohuesit kurejshitë flasin me një mohim të vardisur: “(Ajetet e Kur’anit) Janë legjenda të të parëve, që ai (Muhammedi) kërkoi të kopjohen ato, e i lexohen ato mëngjes e mbrëmje.” (Furkân, 5). Më pas, njëri prej tyre, fjala është për Nadir bin Harithin, ia behu të trillojë legjenda nga tregimet e të parëve: “Tregimet e Isfendarjarit dhe Rustemit” të cilat janë me origjinë persiane, dhe t’ua lexojë njerëzve në xhami kur Muhammedi ua lexonte Kur’anin, që t’i largojë njerëzit nga Muhammedi dhe Kur’ani. Megjithatë, ata nuk largoheshin. Dhe ja, mu ata mohuesit nga kurejshitet pas të gjitha këtyre orvatjeve nuk mund të gjejnë rrugëdalje pos që të thonë: “Mos e dëgjoni këtë Kur’an, dhe (kur të lexohet ai) bëni zhurmë ashtu që ta pengoni.” (Fussilet, 26).

E gjithë kjo thuhet dhe e gjithë kjo ndodh, por assesi të gesh një pasqyrim të qartë për bukurinë artistike në Kur’an. Ky popull ishte i preokupuar me atë që e përjetonte në qeniet e veta dhe atë që e ndiente në ndjenjat e veta. Atyre nuk u shkonte mendja ta sqarojnë këtë përshkrim ngase ishin të hutuar e të shqetësuar ose të dorëzuar e të nënshtruar.

Kjo pra ishte periudha e shijimit natyror në mënyrë direkte.

* * *

Nëse e kalojmë periudhën e zbritjes së Kur'anit, do të shohim se disa as'habë (shokë të Muhammedit) shërbeheshin me komente të vogla të Kur'anit duke u mbështetur në ato transmetime të pakta nga Pejgamberi alejhisselam. Disa prej tyre bënë përpjekje të interpretojnë disa ajete por me një masë të madhe të kujdesit dhe drojës. Disa të tjerë tërhiqeshin krejtësisht duke pas frikë se mos bëjnë mëkat fetar.

Transmetohet nga Seid bin Musejjib se kur ai pyetej për ndonjë çështje të Kur'anit përgjigjej: "Unë nuk them gjë për Kur'anin". Ibni Sirini thotë: "E kam pyetur Ubejden për një çështje të Kur'anit e ai ma ktheu: 'Ki frikë Allahun dhe tërhiqu. Ata që dinin për çfarë u zbrit Kur'ani kanë shkuar'". Edhe nga Hisham ibni Urve bin Zubejri përcillen këto fjalë: "Babain tim asnjëherë se kam dëgjuar duke e interpretuar së paku një ajet nga Libri i Allahut".⁵

E gjithë kjo nëse vërteton diç, vërteton ndikimin e magjepsjes, madhështinë e shkreptëmitës dhe gjurmët e befasisë me këtë thurje të mrekullueshme deri në masë të mahnitjes dhe dorëzimit.

Gjatë kohës së Tabiünëve (pasardhësve) tefsiri u zhvillua në mënyrë të vazhdueshme, megjithatë ata kufizoheshin vetëm në komentimin e ajetit duke e bërë sqarimin e domethënies gjuhësore të cilën e kuptuan nga ajeti dhe ate me fjalë shumë të shkurta. Për shembull, komenti i tyre në ajetin: "gajru mutexhanifin li ithm" (në përkthim: "nuk ka mëkat") komentohej me këtë domethënie: "Nuk i ekspozohet mëkatit". Pastaj komenti i tyre në ajetin: "ve enn testaksimu bil ezlam" (në përkthim: "dhe të të kërkuarit e fatit me fall"). Ithtarët e xhahilijetit e kishin zakon që kur dikush merrte rrugën për udhëtim merrte një shigjetë dhe thoshte: "Kjo jep leje për udhëtim". Nëse i dilte shorti, kjo do të thoshte se gjatë

⁵ Marrë nga libri Fexhrul islam i Ahmed Eminit.

udhëtimit të tij do ta përcillte e mira. Pastaj merrte shigjetën tjetër dhe thoshte: “Kjo nuk jep leje për udhëtim”. Nëse e kapte shorti i saj, kjo do të thoshte se do ta përcillte e keqja. Zgjedhja bëhej sipas shortit mes dy shigjetave. Allahu e ndaloi këtë veprim. I gjithë komenti që ata e bënëin përkufizohej në shkaqet e zbritjes së ajetit, e më vonë, ata që erdhën pas tyre u zgjeruan në komentime duke i përdorur edhe lajmet (shënimet) e çifutëve dhe të krishterëve.⁶

Që nga fundi i shekullit të dytë hixhrij tefsiri filloi të zhvillohet dhe të zgjerohet. Por, në vend që këta dijetarë të merren me gjurmimin e bukurisë artistike në Kur'an dhe përputhshmërinë e saj me bukurinë tematike me të cilën arrihet kulmi i përsosurisë, ata u morën me gjurmime juridike (të fikhut) dhe debatike; sintaksore dhe morfologjike; historike dhe mitologjike! Me këtë hap që e bënë ata, humbën shansin i cili ishte në disponim për komentuesit që të ilustronjë një pikturë të qartë për bukurinë artistike në Kur'an duke e sintetizuar atë me përsosurinë tematike e cila është shumë e theksueshme në Kur'an.

Ai i cili arriti që herë pas here të korr sukses në zbulimin e disa aspekteve të bukurisë artistike në Kur'an, është njëri prej dijetarëve deri diku i vonshëm i njohur me emrin Zemahsheri. Shembull, komenti i tij në ajetin: “Dhe kur Musait i kaloi zemërimi”. Thotë: “Sikur Musain zemërimi ta ngashnjente t'i bëjë ato gjeste dhe sikur t'i kishte thënë zemërimi: “Thuaj popullit tënd kështu, hedhi pllakat, kape vëllain për koke”. Ky harmonizim siç shihet është majft i kufizuar, i mungon kristalizimi i domethënieve dhe qartësia. Gjëja më e bukur në këtë shkoqitje është “personifikimi” i zemërimit, po si të ishte njeri, flet dhe hesht, ngashnjen dhe nda-lë. Ky “personifikim” kësaj shprehjeje i dha një bukuri të veçantë të cilën edhe e zbuloi Zemahsheri. Megjithatë, ai nuk i ndriçoi të

⁶ Po aty.

gjitha bukuritë por filloi të merret me sqarime tjera, me gjuhën e bashkëkohanikëve të vet që edhe nuk mund t’ia zëmë për të madhe. Po ashtu edhe komentë i tij në suren Fatiha kur thotë: “Kur robi fillon (leximin apo namazin), e falënderon Zotin e vet i cili meriton falënderim, me zemër të zgjuar dhe shpirt të përkujtueshëm, kur ai veç është duke e përjetuar me fjalët: Falënderimi i takon vetëm Allahut. Kjo thënie vërteton veçorinë e Tij për falënderim dhe se Ai e meriton atë. Në ato çaste pa dyshim njeriu gjen në vete motiv për t’iu drejtuar Atij. Meqë pas këtij fillimi lexuesi transferohet në pjesën e dytë të ajetit: “Zotit të botëve” i cili konfirmon se Ai është zotërues i botëve, nuk mund t’i shmanget as qenia e tij zotërimit dhe nënshtimit të Tij. Andaj edhe më tepër e aktivizon atë fuqi të brendshme. Pastaj transferohet në fjalën e Tij: “Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit”, e cila konfirmon se Ai është begatidhënës i të gjitha dhuntive, atyre që shihen dhe që nuk shihen. Tani edhe më tepër e aktivizon atë fuqi të brendshme. E pastaj kur kalon në epilog të këtyretributeve të mëdha me fjalën: “Sunduesit në Ditën e gjykimit”, konfirmon se Ai është Zotërues i gjithë kësaj çështjeje në Ditën e gjykimit. Këtu ajo fuqi e brendshme e arrin kulmin dhe i nënshtrohet Krijuesit të saj plotësisht. Në ato çaste qenia njerëzore i drejtohet veçanërisht Atij me një nënshtim të plotë dhe lutje për çdo nevojë: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”...

Ky koment është një lloj përputhshmërie në ilustrimin e harmonizimit shpirtëror në shesh të ndjenjave të njëpasnjëshme të motivuara me përcjelljen e ajeteve. Kjo pra është ngjyrë prej ngjyrave të harmonizimit nismëtar në Kur’an.

Disa prej komentuesve kanë bërë përpjekje që të zbulojnë disa aspekte të këtij harmonizimi. Ata nuk arritën më tepër pos që të bëjnë lidhshmërinë kuptimore në disa vende të ajeteve por jo edhe

në të gjitha, dhe duke mos arritur të konceptojnë një rregull të përgjithshëm. Madje në shumë raste ata edhe vetë e ndërlëkonin harmonizimin në masë të madhe.

* * *

Ekzistojnë edhe studiuesit e belagës (retorikës) dhe i'xhazit (elokuencës) kur'anore. Ndonëse ata me studimet e tyre që i bënë u larguan shumë nga sfera e studimit artistik, pritej që ata të shkojnë në vijën e të arriturave në këtë sferë atje ku nuk mundën të arrijnë mufessirinët (komentuesit). Mirëpo ata e preokupuan veten me gjurmime shterpe rreth “fjalës dhe domethënies” dhe se në cilat prej atyre dyjave (fjalës dhe domethënies) fshehet retorika. Disave u ka lënë përshtypje esenca e rregullave të retorikës. Ata në këtë mënyrë e zhdukën bukurinë e harmonizimit të tërësishëm ose kaluan në degëzimin dhe krerëzimin e sureve, saqë në disa raste arritën deri në masë të shkallmimit që nuk durohet.

Shikoni këtë shprehje të bukur: “E sikur t'i shihje mëkatarët se si ulin kokat e veta pranë Zotit të tyre”. (Sexhde, 12). Kjo shprehje e cila na ilustron një skicë të gjallë për nënçmimin në Ditën e kijametit dhe i pasqyron ata mëkatarë si trupa të gjallë të cilët imagjinata i përfytyron dhe pothuajse syri i sheh nga qartësia e asaj pamjeje dhe inskenimi të formës së saj “se si ulin kokat e veta”, e pranë kujt? “Pranë Zotit të tyre”. Kështu dëgjuesit i bëhet se ajo është e pranishme e jo e imagjinuar. Ky pasqyrim i tmerit për studiuesit e retorikës nuk ka vlerë më të madhe sesa këto fjalë: “Sipas rregullës së referimit duhet që atij që i referohet të përcaktohet, por ndonjëherë lihet edhe i papërcaktuar, si fjala kur thua: Filani është keqbërës, nëse e nderon të tradhton, nëse i bën mirë ta kthen me të keq. Këtu fjalia nuk ka për qëllim personin e caktuar por ka për qëllim të tregojë se si nderi dhe e mira kthehen me të keq. Për ta treguar një veprim të tillë nxirret në formë të

referimit që t'i përgjithësojë të gjithë të tillët. Pra, sjellja e keqe nuk përkufizohet në këtë person, e as në atë tjetrin. Këso rastesh në Kur'an kemi shumë. Për shembull, fjala e Allahut: "E, sikur t'i shihje mëkatarët se si i ulin kokat e veta pranë Zotit të tyre". Sipas strukturës ajo ka formë të referimit (pra i drejtohet dikujt) por me qëllim të përgjithshëm dhe me tendencë për ta treguar atë situatë tmerruese, dhe se ajo aq shumë u qartësua sa që nuk mbeti gjë e pazbuluar. Ajo nuk e veçon dikë për ta parë por i përfshinë të gjithë ata që shohin dhe e pranojnë këtë referim!"

Në këtë mënyrë mjegullohet ky ilustrim i gjallë artistik dhe përfundon ashtu siç ata shprehen në një situatë tmerruese e cila shihet qartë sa nuk mbeti asgjë e pazbuluar.

Shiko edhe shprehjet tjera ilustruese: "Dhe i fryhet Sûrit dhe bie e vdekur çka në qiej dhe çka në tokë, përveç atyre që do Allahu (të mos vdesin), pastaj i fryhet atij herën tjetër, kur ja, të gjithë ata të ngritur shikojnë (çka do të ndodhë)". (Zumer, 68). "(Përkujto) Ditën kur Ne i shkullim kodrat dhe tokën e sheh të sheshtë (të zbuluar), dhe Ne i tubojmë ata e nuk na mbetet asnjë prej tyre pa e tubuar." (Kehf, 47). "Banorët e zjarrit i thërrasin (lusin) ata të xhennetit: Na jepni pak nga uji apo nga ajo që ju ka furnizuar Allahu (se mbaruam nga etja)! Ata (të xhennetit) thonë: Allahu i ka ndaluar që të dyja këto për jobesimtarët!" (A'rafë, 50).

Pa dyshim këto figuracione të inskenuara, të mbushura me aksion dhe gjallëri, sa që mund t'i përcjellin sytë, veshët dhe imagjinata, pra, të gjitha këto figuracione nuk merituan nga studiuesi i belagës (retorikës) pos që të thotë: "Mënyra e të shprehurit për kohën e ardhshme me fjalinë e kohës së kaluar është sinjal dhe indi-kacion për pamëdyshjen e të ngjarit të tij, dhe se çdo gjë që i nënshtrohet të ngjarit është sikur të kishte ngjarë!"

E gjithë ajo që ua tërhoqi vëmendjen në këto ajete janë fjalët: “Fe saika” (në përkthim: “bie e vdekur”), “Fe hashernahum” (në përkthim: “dhe Ne i tubojmë ata”), “Ve nâdâ” (në përkthim: “i thërrasin”), të cilat në përbërje foljore kanë ardhur në kohën e kaluar, ndërsa sipas kuptimit duhej të vinin në kohën e ardhshme, por nuk ka ardhur si sinjal për pamëdyshjen dhe vërtetësinë e të ngjarit të tij!.

Vetëm një person nga studiuesit e belagës (retorikës) dhe i’xhazit (elokuencës) që jetoj para Zemahsheriut të cilin edhe e cekëm më parë, arriti të bëjë përafërsisht një harmonizim të plotë dhe të qëlluar në aspektin artistik, e ky është Abdul Kâhir El Xhurxhanî. Ai në librin e tij Delâilul i’xhaz (Gjurmët e elokuencës) ishte shumë afër që ta arrijë qëllimin e kërkuar sikur mos ta preokuponte çështja e “fjalëve dhe domethënive” që nga fillimi i librit e deri në fund të tij. Kjo çështje në shumë raste e largoi nga (ilustrimi artistik) që ishte shumë afër ta realizojë. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, ai përsëri ishte më i inspiruari nga të gjithë ata që shkruan në këtë lëmi në përgjithësi, bile edhe nga ata të kohës së sotshme!.

Këtu do të përmendim një shembull të suksesit të tij që ishte buzë arritjes në diç vendimtare. Lexuesi duhet t’i bëjë durim stilit të tij. Mënyra e tillë e të shprehurit ishte aktuale në kohën e tij. Ishte stil i logjikës dhe apologetikës i cili u fut edhe në stilin e letërsisë së asaj kohe.

“Ekzistojnë disa veçori të metaforës të cilat nuk mund të shpjegohen përveç nëse u studiohet struktura dhe u ndriçohet realiteti. Sa është kjo precize dhe misterioze mund ta ilustrojmë me atë se dijetarët kur përmendin fjalën e Allahut: “Më është zbardhur koka nga thinjat.” (Merjem, 4) nuk shtojnë asgjë përpos se thonë se është metaforë, se bukuria e këtij ajeti (simbolika e tij) qëndron

vetëm aty, dhe se tjetër koment përveç këtij nuk ka”. Vetëm kështu mund ta vrojtojmë ajetin sipas fjalëve të tyre, megjithatë e vërteta nuk është ashtu, as vetëm ajo bukuri artistike nuk vigjilon, as ky koment tërheqës, po as ky shkëlqim i cili ndriçon shpirtat me rastin e këtij komenti që e shpjegon thjeshtë vetëm si metaforë. Qëllimi është që në një fjali folja duhet të ketë lidhshmëri me subjektin i cili është veprues, ndërsa fjala ku bie veprimi gjegjësisht objekti, të vie pas tyre. Aty mund të kuptohet se lidhmëria dhe varshmëria mes objektit dhe foljes është për shkak të subjektit që i lidhë fjalët në fjali. Për shembull: “Tabe Zejdun nefsen” (në përkthim: “Zejd është person i mirë”) dhe “Karre Amrun ajnen” (në përkthim: “Amri është person i qetë”) e shembuj të tjerë të ngjashëm, ku veprimi transferohet nga vepruesi në objektin ku bie veprimi për shkak të tij. Kjo, ngase ne e dimë se termi “ishteale” (në përkthim: “është zbardhur”) ka lidhshmëri kuptimore me qimen e thinjur edhe pse në fjali përdoret për kokën, mu ashtu si termi “tabe” (i mirë) që është cilësor për shpirtin (personin) dhe termi “karre” (i qetë) që është cilësor për syrin (personin) edhe pse në fjali përdoret për subjektin.

Kështu pra, bëhet e qartë se bukuria artistike shfaqet mu pse përdoret kjo mënyrë e të shprehurit dhe zgjedhet kjo mënyrë e prezentimit. Po sikur të ishte përdorur mënyra tjetër ku do të thuhej: “Ishteale shejbur re’si” (në përkthim: “Është zbardhur thinja e kokës”), e thinja vërtet qëndron në kokë, por ne nuk do të mund ta shohim atë bukuri e as ta përjetojmë atë madhësi. Nëse shtrojmë pyetjen: Cila është arsyeja se nëse fjala “është zbardhur” metaforizohet për qimen e thinjur, në këtë konstruksion do të ketë përparësi e mënyra tjetër do të ishte e zbehur? Përgjigjja do të ishte: Arsyeja qëndron në atë se shkëlqimi i kokës nga thinjat nënkupton përfshirjen e saj, se është përhapur në çdo pjesë të kokës dhe se është vendosur (zbardhja e qimeve) saqë nuk mbetet qime e zezë ose nuk kanë mbetur prej të zezave pos atyre që është

e natyrshme të mbeten. Ky kuptim nuk do të mund të arrihej sikur të thuhej: “Është zbardhur thinja e kokës” ose “Është zbardhur qimja në kokë”. Madje as që jep të kuptosh se të zbardhurit ka përfshirë shumë qime të flokëve. Sa për krahasim mund ta japim këtë shembull: “Është ndezur shtëpia zjarr”, që jep të kuptojmë se zjarri e ka kapluar tërësisht shtëpinë dhe se e ka përshkuar nga të gjitha anët. E nëse themi: “Është ndezur zjarri në shtëpi”, atëherë nuk mund ta ketë të njëjtin kuptim, por merret vesh se e ka kapluar zjarri por jo edhe tërë shtëpinë por një pjesë të saj. Pra, sipas këtij konstrukti s’mund të kuptohet se a e ka përfshirë zjarri tërë shtëpinë.

Shembull të ngjashëm në Kur’an kemi fjalën: “Dhe Ne tokën e shpërthyem në burime uji.” (Kamer, 12). Në këtë rast shpërthimi si term ka lidhshmëri kuptimore me burimin, megjithatë është shumë më ndikues nëse përdoret si term për tokën ashtu siç zbardhja (e qimeve) iu mvesh kokës. Në këtë mënyrë këtu u arrit përfshirja e domethënies ashtu siç u arrit edhe më parë. Kjo ngase në këtë mënyrë nënkuptohet se toka ishte shndërruar e tëra në burime dhe se uji shpërthente nga çdo vend. Sikur fjala të përdorej si rëndom dhe të thuhej: “Dhe i shpërthyem burimet e tokës” ose “Dhe i shpërthyem burimet në tokë”, nuk do ta kryente atë funksion e as që do ta nënkuptonte atë qëllim. Kuptimi do të ishte sipas versionit të rëndomtë, se uji ka shpërthyer nga burime të ndryshme të tokës dhe i përfshiu vetëm ato vende”.

Allahu e mëshiroftë Abdulkahirin, burimin (komentin e vërtetë) e pati shumë afër por nuk e hasi atë. Bukuria artistike në komponentën e ajetit: “Më është zbardhur koka nga thinjat” dhe në komponentën e ajetit: “Dhe Ne tokën e shpërthyem në burime uji” qëndron në aspektin konstruktiv siç tha ai, por edhe në diç tjetër jashtë tij. Ajo është kjo energji e shpejtë imagjinative të cilën e ilustron shprehja, fuqia e të zbardhurit e cila përshkon kokën në

çast dhe lëvizja e të shpërthyerit e cila mbulon tokën sa hap e mbyll sytë. Kjo lëvizje ilustrative prek ndjenjën, impresionon imagjinatën dhe ua shoqëron shqisave dhe kujtesës shijimin e kësaj bukurie. E ajo bukuri në ajetin: “Më është zbardhur koka nga thinjat” shfaqet shumë më e qartë dhe më e fuqishme, sepse lëvizja e të zbardhurit (në përkthim të fjalëpërfjalshëm: të ndezurit sh.p.), në këtë rast është lëvizje metaforike për thinjën, e nuk mund të jetë e tillë edhe në thënien: “është ndezur shtëpia zjarr”. Kjo shprehje as që mund të afrohet e as të krahasohet me thënien kur’anore: “më është zbardhur koka nga thinjat”. Në shprehjen e të zbardhurit për thinjën kemi bukuri artistike kurse mvëshja e saj kokës është edhe një bukuri tjetër. Ato që të dyja plotësojnë njëra-tjetrën! E ja, mu këtë nuk arriti ta shpjegojë Abdulkahiri, edhe pse duket se ai një bukuri të tillë e ndiente në ndërgjegjen e tij, megjithatë nuk arriti ta inskenojë plotësisht në të shprehurit e tij. Sidoqoftë, ne nuk është mirë të kërkojmë prej tij të shprehet me gjuhën e shekullit tonë, Allahu e mëshiroftë!

Sado që të ishin të mëdha ato përpjekje të cilat u dhanë në tefsir dhe në lëmin e retorikës dhe elokuencës, të gjitha u ndalën në kufijtë e kriterëve logjike të kritikës letraro-arabe të vjetër. Fjala është për atë logjike të pjesërishme e cila shqyrtonte çdo frazë në veçanti duke analizuar dhe duke ia zbuluar bukurinë artistike - deri në atë masë që kanë pasë mundësi - pa mos kaluar në njohjen e tipareve të përgjithshme të aspektit artistik si tërësi.

Kjo dukuri është shfaqur gjatë studimit të retorikës në Kur’an. Megjithatë, askush nuk u përpoq ta kalojë një frazë të vetme, e të flasë rreth tipareve të përgjithshme artistike, pos asaj që është shkruar për harmonizimin e konstruksioneve dhe frazave kur’anore ose për plotësimin e rregullave gramatikore dhe stilistike. Por të gjitha këto tipare, siç thotë Abdu Kahiri, në realitet nuk

mund të trajtohen në lëmin e elokuencës derisa atë mund ta bëjë edhe çdo poet dhe prozator i ri.

Me ndaljen e studiuesve të retorikës kur'anore në tiparet e frazave të mëvetësishme dhe moskalimin e studiuesve në studimin e tipareve të përgjithshme, ata arritën në fazën e dytë të studimit të gjurmëve artistike. Kjo është faza e njohjes së sferave të bukurisë artistike në fraza të ndryshme dhe shkoqitje e çdo fraze në veçanti, duke pas parasysh atë që thamë më parë se këto të arritura ishin të mangëta dhe primitive.

Faza e tretë është faza e njohjes së tipareve të përgjithshme, të cilat nuk arritën të studiohen as në lëmin e letërsisë e as në Kur'an. Që këtu pohojmë se tiparet më të rëndësishme të artit kur'anor mbetën arkë e pazbuluar. Kjo situatë shtrën domosdonë e studimit të stilit dhe shprehjes së këtij libri i cili është pa konkurrencë dhe dominant, me një metodologji të re mbi bazat e përgjithshme të bukurisë artistike që ngërthehet në te. Ajo do të mund të arrihej me shtjellimin e tipareve të vazhdueshme të cilat bëjnë dallimin e kësaj bukurie nga çdo thesar që e posedonin arabët prej të arriturave të tyre njerëzore dhe duke e shtjelluar këtë mrekulli artistike me një shtjellim që ka për bazë konturat specifike të Kur'anit fisnik.

Ky libër madhështor zotëron tipare shumëdimensionale me metodologji unike në të shprehurit e të gjitha qëllimeve, pavarësisht a ka të bëjë qëllimi me përgëzim apo qortim; rrëfim që ka ndodhur apo ngjarje që do të ndodhë; argument për bindje apo thirrje në besim; përshkrim i jetës së kësaj bote apo të ahiretit; ilustrim i gjërave që ndihen apo preken; zbulim i gjërave konkrete apo abstrakte; proklamim i asaj që ndërmendet në ndërgjegje apo i një skene që shfaqet.

Kjo metodologji unike dhe ky bazament kolosal ishin shkas për ta shkruar këtë libër, këtë “ilustrim artistik”!

Ilustrimi artistik

Ilustrimi është element favorizues në metodikën e Kur'anit. Ai shpreh një domethënie mendore dhe një gjendje shpirtërore përmes pamjes sensibile dhe imaginative. Ai shpreh edhe ngjarjen reale, skenën spektakulare, shembullin human dhe natyrën njerëzore. Pastaj me anë të pikturës të cilën e vizaton arrinë t'i dhurojë një jetë karakteristike ose një lëvizje përtërirëse. Kështu domethënia mendore shndërrohet në qenie apo lëvizje, gjendje shpirtërore, në pllakë pikturë apo skenë, shembulli human në karakter të gjallë, natyra njerëzore në gjendje trupore të shikueshme, kurse ngjarjet, skenat, rastet dhe pamjet, të gjitha i shndërron në objekte të pranishme në të cilat ka jetë dhe lëvizje. E kur ilustrimit i bashkangjitet edhe dialogu, plotësohen të gjitha elementet e aktrimit. Në momentin kur fillon shfaqja, të gjithë dëgjuesit i shndërron në shikues. Ata i shpie përnjëherë në aktet e para të dramës në të cilat filloi ngjarja apo do të fillojë. Aty aktet do të pasojnë njëri pas tjetrit kurse aksionet do të përtërihen. Dëgjuesi do të harrojë se këto janë vetëm fjalë që lexohen dhe shembuj që sillen. Do të kujtojë se është spektakël që shfaqet dhe ngjarje që ndodh. Në skenë do të jenë personazhet e dramës të cilët paraqiten dhe shkojnë. Të gjitha këto janë simptome të skenës mallëngjyese tok me emocionet që ngjallen prej rastit të cilat u bashkangjiten ngjarjeve. Ato janë fjalë me të cilat lëvizin gjuhët dhe i zbulojnë ndjenjat e brendshme. Aty vërtet është vetë jeta e jo rrëfimi për jetën.

Meqë theksuam se elementet të cilat pasqyrojnë domethënien mendore ose gjendjen shpirtërore, apo të cilat e karakterizojnë shembullin human ose ndodhinë reale, ato në të vërtetë janë fjalë të thjeshta e jo edhe ngjyra që ilustrojnë e as personazhe që

interpretojnë, me të cilat kemi arritur t'i kuptojmë disa sekrete të i'xhazit (elokuencës) në shprehjen kur'anore.

Shembull për këtë që e themi është i tërë Kur'ani dhe ate kudo që trajton një qëllim prej qëllimeve që i cekëm më parë. Kudo që dëshiron të shpreh një domethënie reale, gjendje shpirtërore, shembull human, ngjarje të ndodhur, rrëfim të kaluar, skenë prej skenave të kijametit ose përjetim të lumturisë apo të dënimit. Ose kudo që dëshiron të sjell një shembull për diskutim ose ndonjë nevojë, apo kudo që dëshiron ta pasqyrojë vetëm diskutimin duke u mbështetur në situatën reale dhe perceptimin shqisor.

- Këtë edhe e kishim për qëllim kur thamë: Ilustrimi është element favorizues në metodikën e Kur'anit. Ilustrimi nuk është stoli e një metodike apo rastësi e cila vjen kudo që përputhet me te. Ilustrimi është doktrinë e konfirmuar, projekt i unjësuar, tipar i përgjithësuar, metodologji e caktuar e cila shërbehet me metoda të nduarnduarta në pozita të ndryshme. Megjithatë, ajo në fund kthehet në atë bazë të madhe, bazën e ilustrimit.

Është obligim yni që ta shtjellojmë domethënien e ilustrimit me qëllim që t'i arrijmë hapësirat e ilustrimit artistik në Kur'an. Ai është ilustrim ngjyrash, ilustrim lëvizjesh dhe ilustrim ndodhish. Shpeshherë i bashkangjitet përshkrimi, dialogu, tingulli i fjalëve, melodia e shprehjeve, muzikaliteti i vargjeve për ta zbuluar një figurë prej figurave të cilën e përjetojnë me ëndje syri dhe veshi, ndjenja dhe imagjinata, intelekti dhe intuïta.

Ky ilustrim është i gjallë ndonëse është i shkëputur nga bota e të gjallëve. Ai nuk përmban ngjyra të zbehta as vija të thjeshta. Është ilustrim në të cilin maten largësitë dhe hapësirat përmes ndjenjave dhe emocioneve. Domethëniet vizatojnë

mallëngjyeshëm në brendinë e gjallë njerëzore ose në pamjet e natyrës të cilës i është zhveshur jeta.

Tani do t'u rrekemi shembujve:

Domethëniet mendore të cilat shfaqen në figurat konkrete

1- Kur'ani dëshiron të bëjë me dije se ata të cilët nuk kanë besuar (që kanë mohuar), nuk do të mund të pranohen te Allahu dhe kurrësi nuk do të hynë në xhennet. Pranimi dhe hyrja janë gjëra të paarritshme për ta. Kjo është ajo mënyrë logjike për të shprehurit e atyre domethënieve modeste. Stili i ilustrimit paraqitet në këtë ajet:

“Nuk ka dyshim se ata që përgënjeshtroan argumentet tona dhe nga mendjemadhësia u larguan prej tyre, atyre nuk u hapen dyert e qiellit dhe nuk do të hyjnë në xhennet derisa të përbirohet deveja nëpër vrimën e gjilpërës.” (A'rafë, 40).

Kështu Kur'ani të lë që me imagjinatën tënde të pasqyrosh një pikturë në të cilën hapen dyert e qiellit dhe një tjetër në të cilën litar i trashë (në përkthim shqip është përdorur: “deveja”)⁷ përbirohet nëpër vrimën e gjilpërës. Nga sinonimet e litarit zgjedh termin xhemel i cili përshtatet për këtë vend. Ndjenjën e lë të impresionohet përmes imagjinatës në këto dy piktura që të zënë vend në thellësi të shpirtit domethëniet e pranimit dhe të pamundësisë. Ato kanë hyrë në shpirt përmes syrit dhe ndjenjës - në mënyrë imagjorative - dhe përmes shumë vrimave, qetë dhe

⁷ Autori fjalën xhemel e kupton si litar i trashë që është formuar nga disa litarë, që është edhe njëra prej domethënieve të kësaj fjale. Mirëpo shumica e dijetarëve këtë fjalë e kuptojnë sipas domethënies dominante. Ibni Mes'udi është pyetur për fjalën xhemel e ai është përgjigjur “Burri i “Nânës” (deves femër)”. Ky ajet edhe sipas këtij kuptimi e ka bukurinë artistike. Termi “deveja” ka lidhshmëri me termin “dyer”, ngase deve i duhet derë e madhe për të hyrë. Gjilpëra është përdorur si krahasim metaforik me vrimën (krahaso: derën) e mohuesve në xhennet. Vërejtje e përkthyesit.

dashurueshëm, e jo vetëm përmes vrimës së mendjes me shpejtësinë e saj abstrakte.

2 - Ai dëshiron t'ua bëjë të qartë se Allahu do t'i humb veprat e atyre që mohuan si të mos kishin qenë më parë. Ato do të humben në pakthim dhe kurrë nuk do të mund t'i marrin. Këtë domethënie e paraqet në mënyrë ilustrative në fjalën e Tij:

“E Ne i kthehem ndonjë veprë që e bënë ata dhe e bëjmë atë pluhur të shpërndarë.” (Furkân, 23).

Ajeti të mundëson të imagjinosh pamjen e pluhurit të shpërndarë me qëllim që të japë një kuptim më të qartë dhe më të fortë për humbjen e vërtetë dhe të sigurt.

3 - Për të njëjtin kuptim por në një formë pak më të zgjeruar, Kur'ani e vizaton edhe këtë pikturë:

“Shembulli i veprave të atyre që nuk besuan është si hiri, të cilin me puhi e shkapërderdh era në ndonjë ditë të stuhishme, e ata nuk mund të realizojnë asgjë nga veprat që kanë bërë”. (Ibrahim, 18).

Këtu pikturës i shtohen lëvizja dhe gjallërimi, me lëvizjen e erës në një ditë të stuhishme ku erërat e bartin hirin dhe e shkapërderdhnin në atë masë që më kurrë të mos mund të tubohet.

4 - Ai dëshiron t'ua bëjë të qartë njerëzve se sadakaja (lëmosha) e cila këmbëhet mes njerëzve është hipokrizi (syfaqësi), e ajo e cila përcillet me reklamacion dhe ofendim nuk jep rezultat dhe nuk jeton. Këtë domethënie të rëndomtë, Kur'ani e paraqet me fjalë konkrete dhe perceptuese, dhe atë në këtë mënyrë:

“O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar dhe ofendim siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa për sy e faqe e nuk e beson Allahun as botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar që mbi të ka pak dhe, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq).” (Bekare, 264).

Kur’ani i lë ata ta përjetojnë formën e gurit të lëmuar e të shtrirë të cilin e mbulon një shtresë e hollë prej dheu e cila i ngjan një toke pjellore. E kur e kaplon një rrebesh shiu, në vend se ta ngjallë atë tokë dhe ta bëjë të plleshme - e dihet se shiu është simbol i gjallërimit të tokës që ia dhuron qielli - e lë ashtu siç përshkruhet, të zhveshur, dhe i zhduket ajo shtresë e hollë e cila e mbulonte dhe me të cilën paramendohej bereqeti e pjellshmëria.

Pastaj ai vazhdon ilustrimin për ta shfaqur domethënien e kundërt nga domethënia e “syefaqësisë” dhe domethënia e humbjes së sadakasë nëse i përshkon krenaria dhe ofendimi i njerëzve.

“E shembulli i atyre që pasurinë e vet e japin nga bindja e tyre dhe duke kërkuar kënaqësinë e Allahut, i përngjanë një kopshti në një rrafshnaltë që i bie shi i madh, e ai jep fryt të dyfishtë. Po edhe nëse nuk i bie shi i madh, i bie një rigë (që i mjafton).” (Bekare, 265).

Këtu shfaqet ana tjetër e pikturës dhe faqja tjetër përballë të parës. Ja pra, sadakatë të cilat jepen duke kërkuar kënaqësinë e Allahut kësaj here janë si kopsht e jo si një grusht dheu. Nëse ai grusht dheu atje ishte i shtrirë mbi një gurë të madh, këtu kopshti shtrihet mbi një rrafshnaltë kurse shiu i shoqëron të dy. Në rastin e parë shiu fshinë dhe zhdukë e në rastin e dytë gjallëron dhe zhvillon. Në rastin e parë bie mbi një gurë të mbuluar me një shtresë dhe ashtu që t’ia zbulojë fytyrën e vrenjtur dhe të keqe,

kurse në rastin e dytë bie mbi një kopsht ku përzihet me dheun dhe nxjerr “frytin”, edhe nëse ndonjëherë ky rrebesh i shiut nuk bie, ai forcohet dhe gjallërohet edhe me pak shi ngase në te ka pjellshmëri dhe fuqi për mbirje “Po edhe nëse nuk bie shi i madh, bie një rigë (që i mjafton)”.

Këtu nuk dëshiroj ta paraqes këtë harmoni të çuditshme në ambientin e kësaj pikturë e as krahasimin e komponenteve të saj dhe të shpërndarjes së këtyre komponenteve në pergament, si mbulimi i gurit të madh me një shtresë të hollë dheu ngjashëm me shpirtin dashakeq që e mbulon sadakaja e i cili në të vërtetë këtë e bën sa për sy e faqe. (Syfaqësia është një tis i hollë dhe i tejdukshëm që don ta fshehë zemrën e vrazhdë). Po ashtu edhe si qenia e kopshtit mbi një rrafshnaltë përballë një grusht dheu mbi gurin e madh...

Kësaj ndarjeje e shpërndarjeje dhe këtij krahasimi e harmonizimi i është lënë një kapitulli tëveçantë i cili gjendet brenda kapitujve të këtij libri.

5 - Kur’ani i kthehet po asaj domethënieje edhe një herë dhe thotë:

“Shembulli i asaj që ata e japin në këtë jetë (për t’u lavdëruar e për t’u përmendur) është si i një stuhie me breshër që godet dhe shkatërron të mbjellat e një populli që e ka lëshuar rrugën në dëm të vetes.” (Âli Imrân. 117).

Ai e pasqyron pamjen e arës të cilën e merr stuhia me breshër dhe i godet të mbjellat e të lashtat dhe i shkatërron, ashtu që pronari i arës nuk arrin të marrë nga ajo atë që ka shpresuar pas gjithë mundit që e ka dhënë. Kështu është edhe me mohuesin

(káfirin) i cili jep lëmoshë nga pasuria e tij dhe shpreson bereqetin për atë që e ka dhënë, por kufri ia merr atë që shpresonte.

Nuk do të lëmë të na ik edhe tingëllima e termit sir-run (breshër, akull) e as ilustrimi i domethënies së tij. Ato sikur të ishin bomba të vogla të cilat bien mbi arë dhe e shkatërrojnë. Edhe kjo është ngjyrë e këtij harmonizimi dhe kësaj simetrie të cilën gjithashtu do ta paraqesim në një kapitull të veçantë.

6 - Kur'ani dëshiron ta vë në dukje domethënien se Allahu i përgjigjet vetëm atij që i lutet dhe ia jep atë që e shpreson. Kurse zotat që i lusin krahas Allahut nuk zotërojnë asgjë e as që ua sjellin të mirat dhe bereqetin edhe nëse janë afër tyre. Për ta ekspozuar këtë domethënie Kur'ani prezanton këtë pikturë mahnitëse:

“Lutje e vërtetë është vetëm ajo drejtuar Atij, e ata që u luten të tjerëve pos Tij, ata nuk u përgjigjen atyre me kurrëgjë, ashtu sikur ai që i zgjat dy duart (prej së largu) nga uji, për t'i ardhur te goja; por, uji, kurrsesi nuk i vjen (sepse uji është gjë e vdekur e nuk kupton për etjen e tij). E lutja e mohuesve (drejtuar të tjerëve pos Zotit), nuk është tjetër vetëm se dështim (kotësi).” (Ra'd, 14).

Ky është një figuracion i cili ngacmon ndjenjën dhe intuitën dhe e tërheq fuqishëm vërtetimin. Atij nuk mund t'ia kthejë shpinën pos me mundim dhe vështirësi. Ky figuracion është njëri prej të tillëve të cilët nuk mund t'i përshkruajnë fjalët. Person i gjallë, i përshkrueshëm i cili i shtrin duart kah uji. Ujin e ka afër dhe dëshiron t'i arrijë në gojën e tij. Por ai nuk i arrin dot. E sikur duart e tij t'i shtriheshin pak më tepër, ndoshta do ta arrinte ujin!.

7 - Ai shpjegon se zotat tjerë të cilët i adhurojnë pos Allahut as nuk dëgjojnë e as nuk përgjigjen, ngase ata nuk marrin vesh e as nuk kuptojnë. Lutja e robërve-adhuresve të tyre është e kotë dhe

prej asaj lutjeje nuk kanë kurrfarë dobie. Kur'ani zgjedh një pikturë e cila e bën të përafërt këtë domethënie dhe e bën të dukshme këtë gjendje. E ngacmon ndërgjegjen dhe shpirtin më fuqishëm se shprehjet e rëndomta kur i ngacmojnë domethëniet mendore.

“Shembulli i (thirrësit të) atyre që nuk besuan është sikurse i atij (bariut) që u lëshon britmë atyre (bagëtisë) që nuk dëgjojnë tjetër vetëm se britmë e zë (e nuk kuptojnë). Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë.” (Bekare, 171).

Kështu pra mohuesit u bërtasin atyre që s'dëgjojnë e i thërrasin ata që s'kuptojnë. Tek ata nuk arrijnë asnjë prej zërave të tyre pos një britmë çjerrëse dhe një thirrje e pakuptueshme. Këta zota nuk bëjnë dallim mes zërave dhe nuk e kuptojnë përmbajtjen e tyre. Ky përshkrim vërtet është shembull, por është edhe figuracion personifikues. Pikturë e një bashkësie njerëzish që u luten zotave që u besojnë, te të cilët arrijnë zërat e tyre të turbullt, megjithatë ata nuk kuptojnë çfarë domethënie kanë. Që këtu vërehet neglijenca e thirrësve dhe kotësia e thirrjeve të tyre krahas palogjikshmërisë së thirrurve dhe pamundësisë së përgjigjes së tyre!

8 - Kur'ani dëshiron ta figurojë ligësinë e atyre zotave ose të adhuruarve të tjerë pos Allahut dhe dobësinë e strehimores në të cilën strehohen adhuresit e tyre kur i dorëzohen mbrojtjes së tyre. Për gjithë këtë Kur'ani sjell një pikturë shumëgjyreshe:

“Shembulli i atyre që përpos Allahut morën mbrojtës (zota idhujsh), është si shembulli i merimangës që thur shtëpi, e sikur ta dinin ata, shtëpia më e dobët është shtëpia e merimangës.” (Ankebūt, 41).

Këtu ilustron rrjetin e dobët dhe i ligësht në të cilin gjejnë prehje ata që do t'i mbrojnë zotat apo të adhuruarit në një shtëpi si

shtëpia e merimangës e që nuk ka shtëpi më të dobët dhe më të ligshhtë. “Më e dobta shtëpi është shtëpia e merimangës, nëse e dinë”. Por ata nuk e dinë këtë të vërtetë aksiomatike dhe të dukshme!

9 - Ai dëshiron ta bëjë të qartë se ai i cili i përshkruan ortak (shok) Allahut, veprimi i tij nuk ka fryt e as rrënjë, nuk ka ekzistencë për të e as mbijetim. Këtë domethënie e ilustron në një figuracion ku hapat janë të shpejtë ndërsa lëvizjet janë të vrazhda dhe shumë të fuqishme:

“E kush i përshkruan shok Allahut, ai është sikur të bie nga qielli e ta rrëmbejë shpendi, ose si ai të cilin e fërfëllinë era e stuhishme në ndonjë vend të humbur.” (Haxh, 31).

Kështu, sa çel e mbyll sytë, bie nga qielli kah nuk mund ta dijë askush, e as që mund të mbijetojë në tokë asnjë çast, sepse shpendi do ta rrëmbejë ose era e stuhishme do ta fërfëllijë... do ta fërfëllijë në një vend të humbur të cilit gjithashtu askush nuk do t’ia dijë gjurmët. Ky pra edhe është qëllimi.

10 - Kur’ani dëshiron ta konfirmojë domethënien e ndalesës dhe nëpërkëmbjes në ahiret për ata që Allahu ua dha Librin para Islamit e të cilët e nëpërkëmbën, të cilët kur u kërkua të zotohen (të japin besë) për iman-besim u zotuan e pastaj tradhtuan për të arritur një leverdi të vogël materiale, mu si ai besa dhe fjala e të cilit nuk kanë respekt. Andaj për këtë nëpërkëmbje abstrakte jep një figurë konkrete:

“Ata që për një vlerë të vogël e shesin besën e dhënë Allahut dhe e ndryshojnë edhe zotimin e tyre, të tillët nuk kanë pjesë (mëshirë) në botën tjetër, dhe në Ditën e gjykimit Allahu nuk u flet

atyre, nuk i shikon ata dhe nuk i pastron (prej barrës së gabimeve), ata kanë një dënim të dhembshëm.” (Âli Imrân, 77).

Kështu Kur’ani e sqaron domethënien e nëpërkëmbjes jo me fjalë që dëshmojnë nëpërkëmbjen, por me anë të pikturimit të lëvizjeve të cilat e dëshmojnë atë, pa fjalë, pa shikim, pa pastrim por vetëm me anë të dënimit të dhembshëm.

* * *

Gjendja shpirtërore dhe psikologjike e shfaqur në figurat konkrete

1 - Kur'ani vë në pah topitjen që e godet atë që i përshkruan Allahut shok (ia rivalizon të tjerët) pasi që e njësoi (dëshmoi se është një, i vetmi), pra atë që e ka shpërndarë zemrën e tij mes një Zoti dhe shumë zotave, dhe atë që e ka përpjesëtuar zemrën e tij mes udhëzimit dhe lajthitjes. Kur'ani këtë pamje e pikturon në formë konkrete dhe perceptuese:

“Thuaj: A pos Allahut të adhurojmë çka nuk na sjell as dobi as dëm dhe të kthehemi prapa (në kufër) pasi që Allahu na nxori në rrugë të drejtë? Dhe atëherë të bëhemi sikur ai, të cilin e kanë trulluar (ngashënuar) djajtë në tokë e ai mbeti i hutuar, e ai ka shokë që thërrasin në rrugë të drejtë (në udhëzim): Eja te ne.” (En'am, 71).

Kur'ani pra, kështu e vë në spikamë figurën e kësaj krijese të rraskapitur të cilën e ngashënuan djajtë në tokë (termi “ngashënjim” është fjalë ilustruese e atij që është protagonist i saj). Ah sikur ndjekja e këtij ngashënjimi ta orientonte në atë drejtim të synuar që do ta qetësonte - edhe nëse e orienton në lajthitje: - por nga ana tjetër ka vëllezër (dashamirë) që e thërrasin në udhë të drejtë dhe e ftojnë: “Eja te ne”.

Mes këtij ngashënjimi dhe kësaj ftese ai mbetet i hutuar, me zemër të përpjesëtuar. Ai nuk di cilit grup t'i përgjigjet dhe cilës palë t'i bashkohet. Në vendin e tij mbetet i shtangur, ashtu në qendër të vëmendjes ai gjithmonë është i përshkrueshëm.

2 - Ai dëshiron ta shpalosë gjendjen e atyre të cilëve Allahu ua lehtësoi ta njohin të vërtetën, e ata e braktisën dhe ikën sikur të

mos u ishte lehtësuar kurrë. Pastaj ata jetojnë të nënçmuar. Shpirti dhe emocionet e tyre i trazojnë duke ua përkujtuar atë që e njohën dhe atë që e injoruan. Ashtu ata as që u rehatuan me pakujdesinë (neglijencën) e tyre e as që u rehatuan me njohurinë. Kur’ani këtë gjendje e ilustron në këtë mënyrë:

“Dhe lexoju atyre tregimin e atij që i patëm dhënë dituritë Tona, ndërsa ai u zhvesh prej tyre dhe atëherë atë e shoqëroi djalli dhe kështu ai u bë prej të humburve. E sikur të donim Ne, do ta ngrenim lartë me atë (dituri), por ai nuk iu largua tokës (dunjasë) dhe shkoi pas epshit të vet. Shembulli i tij është si ai i qenit, të cilin nëse e përze ai e nxjerr gjuhën, po edhe nëse nuk e përze, ai sërish e nxjerr gjuhën.” (A’rafë, 175-176).

Në këtë pasqyrim na shfaqet nënçmimi dhe poshtërimi - që njëherit e realizojnë qëllimin fetar - por në aspektin artistik ky është pasqyrim personifikues. Në te ka lëvizje të përhershme dhe të vazhdueshme. Ajo është figurë aksiomatike e cila vërteton qëllimin e domethënies, fortë dhe fuqishëm. Përmes kësaj rruge takohet qëllimi fetar me atë artistik siç është e zakonshme përherë në të gjitha pikturat që i vizaton Kur’ani.

3 - Kur’ani vë në spikamë gjendjen e luhatshmërisë së akidesë (besimit) kur njeriu nuk është stabil në bindje e as i durueshëm (i përballueshëm) ndaj sprovave me zemër të mbështetur në iman. Ai as që e strehon akidenë e tij në ndonjë vend të sigurt, ta ruajë nga mvëshjet e ndryshme në jetën e tij, ta mënjanojë larg peshojës së fitimit dhe humbjes. Këtë luhatje e përshkruan përmes një figure të molisur dhe të rraskapitur e cila është afër shembjes:

“Ka nga njerëzit që e adhurojnë Allahun me mëdyshje (luhatshmëri), nëse i godet ndonjë e mirë ata qetësohen, por nëse i godet ndonjë gjë e pakëndshme, kthehen në fytyrën e vërtetë (të

mëparshme), ata e kanë humbur këtë dhe botën tjetër.” (Haxhah, 11).

Tani imagjinata pothuajse e formësoi këtë “luhatje” me anë të së cilës adhurohet Allahu nga disa njerëz. Ajo pothuajse edhe e perceptoi shqetësimin shpirtëror kur ata sprovohen. Ata mbesin të hutuar mes qëndrimit dinjitoz dhe lajthitjes. Në të vërtetë, ky figuracion e përshkruan luhatjen në mënyrën më të qartë në të cilën mund të përshkruhet ajo, ngase luhatja përputhet me ndjenjën dhe përmes saj lidhet me shpirtin.

Tani më kujtohet ajo figurë e cila shfaqej në kujtesën time kur arrija në këtë ajet gjatë leximit të Kur’anit, kur isha nxënës në shkollën fillore. Si mendoni, a është tani perceptimi im shumë larg asaj figure primitive? - Nuk kujtoj! Ndryshimi i cili ndodh është vetëm perceptimi im sot, se ky ilustrim është bërë për një gjendje shpirtërore e jo edhe për një trup sensibil! Kjo pra është elokuenca e shprehjes që në perceptimin e saj mund të afrohen të gjitha mendjet, dhe në çdo rast arrijnë ta inskenojnë atë figuracion të gjallë edhe pse çdokush sipas imagjinatës së tij.

4 - Ekziston edhe një figuracion tjetër që shfaqet në po të njëjtën mënyrë por me një qëllim tjetër. Ai është ajo pikturë të cilën e vizatoi Kur’ani për muslimanët para se ta pranojnë Islamin, atëherë kur me kufrin e tyre i ishin ekspozuar xhehennemit. Kur’ani thotë:

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin e Allahut, e mos u përçani! Përkujtoni nimetin e Allahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni Fenë islame) ishit të armiqësuar e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij u bëtë vëllezër. Madje, ishit buzë greminës së xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij.” (Âli Imrân, 103).

Kështu pra “Ishit buzë greminës së xhehennemit” për pak e të binit në te, ngase këmbët tuaja dridheshin e pothuajse rrëshqitët. Këtu nuk kemi për qëllim ta tregojmë përpikërinë e krahasimit dhe realitetin e tij. Ne tani gjendemi para një pamjeje të trishtueshme dhe të trazueshme e cila është afër zhdukjes në imagjinatën tonë. Sikur të kishte mundësi brusha e piktorit ta pikturonte këtë lëvizje imagjinative me ngjyrat e saj në një pikturë të vdekur, në botën e artit do të konsiderohej si një risi marramendëse. Piktori ka brushën, pëlhurën dhe ngjyrat, kurse ne në këtë rast këtu kemi vetëm fjalët me të cilat pikturon Kur’ani.

Le të shikojmë në bukurinë e kësaj shprehjeje nga një pikëpamje tjetër. Kur’ani e pikturon këtë pamje dhe në pëlhurën e tij nxjerr këtë greminë prej zjarri kurse njerëzit i vë në zgrip të saj. Ai e lë në harresë gjithë jetën e kësaj bote që e dëshmojmë (ngase ajo paraqet kufirin mes tyre dhe zjarrit) dhe i bënë që ata të mbeten (derisa ata janë ende të gjallë dhe në këtë botë) buzë greminës prej zjarri, atëherë kur ishin mohues dhe mosbesimtarë!

5 - Ngjashëm me këtë figuracion kemi edhe një figuracion tjetër. Bëhet fjalë për atë që e ndërtoi fortesën e vet pa patur devotshmëri:

“A është më i mirë ai që ndërtesën e vet e themeloi në devotshmëri dhe në kënaqësi të Allahut, apo ai që ndërtesën e vet e themeloi buzë bregut të shembur e bashkë me të bie në zjarrin e xhehennemit?” (Tevbe, 109).

Pra këtu plotësohet lëvizja e fundit e cila pritej që në rastin e parë “e bashkë me të bie në zjarrin e xhehennemit”. Përmes kësaj mënyre Kur’ani jetën e kësaj bote plotësisht e lë në harresë duke mos përmendur as fjalën “thumme” (në përkthim: “pastaj”), por në vend të saj përdori lidhësen “fe” (në përkthim: “e”) kur tha “e

bashkë me të bie” sepse ky udhëtim i gjatë për ne, është shumë i shkurtë për Kur’anin saqë nuk ka vend as për këtë vonesë të vogël! Ky pra është arti i cili ekspozon bukurinë për të cilën do të jepen shpjegime më të gjerësishme në një kapitull të veçantë të po këtij libri.

Gjendja shpirtërore që konkretizohet me anë të “llojit” njerëzor

Sa për ilustrim të këtupërkëtushëm kemi ajetin: “Ka nga njerëzit që e adhurojnë Allahun me mëdyshje (luhatshëm)”. (Haxhxi, 11) Për këtë ajet kemi folur pak më parë, e tani do t’i japim edhe këta shembuj:

1 - Kur’ani dëshiron ta përshkruajë gjendjen e inatit (kryeneçësisë) të marrë dhe mendjemadhësisë së verbër që nuk zotërojnë argument e as dëshmi protagonistët e tyre. Një gjendje të tillë Kur’ani e shpalon me anë të një lloji njerëzor në saje të këtyre fjalëve:

“E sikur Ne t’u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në te (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata gjithqysh do të thonin: Neve na janë ndalë sytë (të pamurit). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur.” (Hixhr, 14-15).

Ose thotë:

“Edhe sikur të zbritnim ty një libër të shkruar në letër, e ta preknin atë me duart e tyre, ata që mohuan do të thonin: Kjo nuk është gjë tjetër përveç një magji e qartë.” (En’am, 7).

2 - Kur’ani vë në dukje se njeriu e njeh Zotin e vet vetëm në çastet e ngushtësisë dhe ate vetëm derisa të lirohet. Madje ai

harron edhe atë se Allahu është ai që e liroi. Megjithatë ai këtë nuk e shpreh përmes kësaj thurjeje psikike por vizaton një pikturë përplot lëvizje përtërirëse me akte të njëpasnjëshme. Brenda tij pikturon edhe një lloj njerëzor i cili gjithmonë është i pranishëm në gjininë e tyre.

“Ai (Allahu) ua bëri të mundshëm udhëtimin në tokë dhe në dete e edhe kur jeni në anije. Më të lundrojnë (udhëtarët) me anë të një ere të lehtë dhe janë të lumtur me te, kur (papritmas) ia behë një erë e fortë, e nga të gjitha anët rrethohen nga valët, binden (pas humbjes së shpresës) se janë të shkatërruar, (atëherë) e lusin Allahun me sinjeritet dhe Atij i dorëzohen (duke i thënë): Nëse na shpëton nga kjo (katastrofë), ne do të jemi gjithnjë falënderues! E kur Ai (Allahu) i shpëtoi ata, ja, ata veprojnë mbrapshtë në tokë, pa arsye. O ju njerëz! Kryeneçësia juaj është vetëm kundër vetes suaj.” (Jûnus, 22-23).

Kështu pra, ngjallet dhe lëviz piktura, lundron dhe e humb drejtpeshimin. Frymëmarrjet ngrihen dhe ulen me lëkundjen e anijes! Dhe më në fund, me anë të një stili të fuqishëm dhe të përsosur e shfaq atë domethënie të synuar.

3 - Ai gjithashtu shpalon gjendjen e një “lloji” të njerëzve të cilët pamja e tyre të entuziazmon kurse brendia e tyre të ofendon. Andaj edhe ua pikturon një pamje të tillë siç vijon:

“Ka nga njerëzit që fjala e tyre mahnit në këtë botë (ngase në botën tjetër gjykon Ai i cili i di të fshehtat) dhe e paraqesin Allahun dëshmues për atë (të mirë) që e kanë në zemër, e në realitet ata janë kundërshtarë më të rreptë. E posa të kthehen (prej jush), përpiqen në tokë të bëjnë ngatërresa, të asgjësojnë të korrat (të mbjellat) dhe gjallesat. E Allahu nuk e do çrregullimin (fesatin).” (Bekare, 204-205).

Ja pra, këtu Kur'ani përshkrimin e plotëson me anë të lëvizjes dhe angazhimit dhe e nxjerr në pah dallimin mes pamjes së jashtme dhe të brendshme përmes renditjes së disa figurave aktive në shpirt dhe imagjinatë.

4 - Një grup njerëzish janë të dobët në akide (besim), të dobët në vendosje, kurse duken në gjendje normale, ashtu që dobësia e tyre nuk vërehet në raste normale dhe të qeta. Por kur priset rehatia dhe rëndohet situata kjo dobësi shfaqet plotësisht. Kur'ani këta njerëz i ilustron me shembull të kthjellët përmes këtyre fjalëve:

“Ata që besuan po thonë: Përse të mos shpallet një sure (që na e obligon luftën?). E kur u shpall sureja e qartë dhe në te u përmend lufta, i sheh ata të cilët kanë zemra të sëmura (të dyshimta), që shikojnë me një shikim si të ishin në agoni të vdekjes.” (Muhammed, 20).

Pamja e atij që duket si të ishte në agoni të vdekjes është e njohur (e zakonshme). Shprehja kur'anore në këtë rast cek gjendjen e tillë me qëllim të shpalosjes së pamjes së tyre në ndërgjegjen tonë duke ia shoqëruar talljen dhe nënçmimin.

5 - Ndonjëherë ky lloj i njerëzve shfaqet në një ngjarje të rrëfyer e cila i tejkalon ngjarjet e rastit me qëllim që të mbetet lloj i përgjithshëm përgjithmonë:

“A nuk ke marrë vesh për parinë e bijve të Israilit pas Musait? Kur i patën thënë një të dërguari të tyre (Shem'unit): Cakto për ne një sundues e të luftojmë në rrugë të Allahut! Ai (Pejgamberi) tha: A mund të ndodhë që nëse lufta u bëhet obligim ju të mos luftoni! Ata thanë: E ç'kemi ne që të mos luftojmë në rrugë të Allahut, kur dihet se ne jemi dëbuar nga atdheu dhe bijtë tanë? E kur u

obliguan me luftë, përveç një pakice, ata u zbrapsën (u tërhoqën).” (Bekare, 246).

Këtu dobësisë i shtohet këmbëngulësia në ditët e paraluftës dhe shfaqja e trimërisë dhe sakrificës, e më pas ligështia dhe frika kur afrohet çasti i luftës!

Kjo nuk është një ngjarje që ndodh njëherë dhe shkon, por është një lloj i përsëritshëm në gjininë njerëzore i cili nuk kufizohet me kohë dhe vend.

* * *

Me kaq do t’i ndërprejmë shembujt për domethëniet mendore, gjendjen shpirtërore dhe llojet njerëzore të cilat shprehja kur’anore i nxjerr në figura të personifikuara dhe aktive duke u tërhequr nga të shprehurit abstrakt e duke kaluar në pasqyrim të ilustruar.

Tani do t’u rrekemi shembujve për ilustrimin personifikues, skenave të ngjarjeve të ndodhura, shembujve të dhënë dhe rrëfimeve të përcjellura. Mënyra e inskenimit të tyre është e njëjtë dhe e pandryshueshme kurse ngjashmëritë mes tyre janë të përafërta.

1 - Ja ky është Kur’ani i cili flet për “humbjen e luftës”. Asaj i përshkruan një skenë të plotë në të cilën vërehen lëvizjet e jashtme dhe reagimet e brendshme. Kështu në të takohen figurat ndijimore me ato shpirtërore (lexo: ato konkrete me ato abstrakte sh.p.), po sikur të ishte rasti i ekspozuar pa mos harruar asgjë të vogël apo të madhe:

“O ju që keni besuar, përkujtoni të mirën e Allahut ndaj jush kur juve u erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë

dhe ushtri që ju nuk e shihnit, e Allahu e shihte atë që ju e vepronit. Kur ata u erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshtmi, dhe kur shikimet (tuaja) u shtangën, e zemrat (tuaja) arritën në fyt, e ju sajoni mendime të llojlojta për Allahun. Atje në atë vend ishin sprovuar besimtarët, dhe ishin dridhur me një dridhje të fortë. Kur hipokritët dhe ata që në zemrat e tyre kishin sëmundje, thonin: “Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk na premtuan tjetër vetëm se mashtrim! Dhe kur një grup prej tyre thanë: O banorë të Jethribit nuk ka qëndresë për ju, ndaj kthehuni! E një grup prej tyre kërkonin lejen e Pejgamberit, duke thënë: Shtëpitë tona janë të pambrojtura, në realitet ata nuk donin tjetër por vetëm të iknin.” (Ahzâb, 9-13).

Cilat lëvizje shpirtërore dhe shqisore nga lëvizjet e humbjes së luftës dhe cilat skena të jashtme ose të brendshme nga skenat e këtij rasti nuk i zbuloi ky shirit preciz dhe i lëvizshëm, ku lëvizja e tij në mënyrë të tërësishme përputhet me tërë lëvizjen e rastit?!!

Ja aty paraqiten armiqtë e vërtetë të cilët u vijnë besimtarëve nga çdo kënd. Aty i kemi edhe shikimet (sytë) e palosura dhe shpirtrat e ngushtë. Aty i gjejmë edhe besimtarët të cilët dridhen si një tërmet i fortë dhe munafikët (hipokritët) të cilët ndjellin fitne (përçarje) dhe ligështi. Ata thonë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk na premtuan tjetër vetëm se mashtrim”, ndërsa medinasve u thonë: “Kthehuni në shtëpitë tuaja se atyre u kanoset rreziku”. E ata që ishin një grup me zemra të ligështa thanë: “Shtëpitë tona janë të pambrojtura” por në të vërtetë ato nuk janë ashtu, ngase: “në realitet ata nuk donin tjetër por vetëm të iknin”.

Mu kështu nuk mund t’i shpëtojë rastit një lëvizje apo një simptom e të mos jetë i regjistruar dhe i dukshëm por, pothuajse është i personifikuar dhe i pranishëm.

Ky është rast që ka ndodhur me të vërtetë, megjithatë figuracioni i tij pikturon “humbjen” si të veçantë pa kurrfarë përshtjellimesh. Aty nuk ka gjë tepër e as që mungon diç pos disa imtësirave të ngjarjes! Ndërsa piktura shpirtërore është e përhershme dhe përsëritet në çdo kohë, sa herë që të takohen dy palë dhe njëres palë i kanoset ligështia.

2 - Ngjashëm me këtë figuracion kemi edhe figuracionin tjetër i cili gjithashtu flet për humbjen. Edhe piktura e tij mbetet e përhershme e jo e rastit dhe e veçantë, dhe atë kur thotë:

“Allahu përmbushi premtimin e vet ndaj jush, ngase me vullnetin e Tij i korrët ata (me shpata) deri kur u dobësuar dhe u përçatë ndërmjet vete, në çështjen e vendit (që u pat caktuar Pejgamberi), dhe pasi që vërejtët atë që dëshironit (prenë e luftës), atëherë kundërshtuat (urdhrin e Pejgamberit). Pati prej jush që e deshën këtë jetë (ata që nxituan pas présë), e pati prej jush që e deshën botën tjetër. Pastaj për t’ju sprovuar ju zbrapsi juve nga ata. Por Allahu ju fali juve; Allahu është dhurues i madh ndaj besimtarëve. Dhe kur largoheshit dhe nuk e përfillshit njëri-tjetrin, ndërsa i Dërguari ju thërriste mbrapa. Atëherë ju goditi me dëshpërim për dëshpërimin (që ia shkaktuat Pejgamberit), ashtu që të mos pikëlloheni për atë që ju doli duarsh (fitorja dhe preja e luftës) e as për atë që ju goditi juve (humbja). Allahu është i njohur hollësisht me atë që veproni. Mandej pas asaj tronditjeje të rëndë, Ai u lëshoi sa për qetësim, një kotje (gjumë të lehtë) që e kaploi një grup prej jush, kurse një grup e kishte preokupuar vetëm çështja e vetvetes... Ata formuan bindje të padrejtë ndaj Allahut, bindje injorante (xhahilite), e thonin: Ne nuk kemi në dorë asgjë nga kjo çështje! Thuaj: E tërë çështja është vetëm në duart e Allahut! Ata fshehin në vetvete atë që ty nuk ta shprehin. Thonin: Sikur ne të kishim diçka në dorë në këtë çështje, ne nuk do të mbyteshim këtu! Thuaj: Edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, atyre që u është caktuar

mbytyja (vdekja), do të dilnin në vendin e flijimit të tyre!” (Âli Imrân, 152-154).

Më duket sikur unë jam dëshmitar i aktit të këtij rasti me të gjithë ata dhe ajo që është aty e pranishme!

* * *

Tani do të shkojmë në prezentimin e disa llojeve nga shembujt rrëfimorë të cilët trajtohen në Kur'an:

1 - Ja, ne jemi ata që gjendemi para pronarëve të xhennetit (kopshtit), xhennetit të dunjasë e jo të ahiretit. Ja, pronarët e tij kanë nda vend në te edhe për mikpritje. Nga frutat e këtij xhenneti kishin pjesë edhe të varfërit, por ja që pronarët pasardhës nuk dëshirojnë t'u ndajnë. Ata dëshirojnë ta përvetësojnë të tërën për vete e t'ua ndalojnë atyre të gjorëve nafakën e tyre. Le të shohim se si veprojnë:

“Ne i sprovuam ata (mekkasit), ashtu sikurse i kishim sprovuar pronarët e xhennetit (kopshtit). Kur u betuan se do ta vjelin herët në agim (para se të zgjohen lypsarët dhe fukarenjtë). Dhe nuk veçojnë për ta.” (Kalem, 17-18). Të gjithë u pajtuan që t'i vjelin frutat herët në agim me qëllim që të mos ndajnë asgjë për të ngratit (të vobektit). T'i lëmë ata ashtu siç vendosën e të shikojmë se ç'do të ndodhë po në këtë natë kur ata fshehen prapa perdeve dhe derisa skenës i mungojnë aktorët. Çka do të shikojë auditoriumi (publiku)? Aty do të ndodhë një befasi e përvjedhshme dhe një lëvizje e fshehtë si lëvizja e siluetave në errësirë! “Dhe atë (kopshtin) e përshkoi një fatkeqësi nga Zoti yt sa ishin ata duke fjetur. Dhe ai (kopshti) gdhiu si të ishte i vjelur.” (Kalem, 19-20). E ata, nuk ndjejnë asgjë!!

E tash, ja, ata zgjohen herët duke i lëshuar zë shoku-shokut pëshpëritshëm dhe duke mos ditur se çfarë i ngjau kopshtit të tyre në atë errësirë: “Ata në mëngjes thërritnin njëri-tjetrin. Ngrehuni herët te plantacionet (prodhimet) tuaja nëse doni t’i vilni! Dhe ata vajtën duke pëshpëritur në mes vete (të mos i dëgjojë kush). Të mos lejojnë të afrohet sot në të asnjë i varfër!” (Kalem, 21-24).

Le ta fshehë auditoriumi gjuhën dhe mos t’u tregojë pronarëve të kopshteve se çka u ka ngjarë kopshteve të tyre. Dhe le t’i fshehin gjithashtu përqeshjet tallëse të cilat pothuajse shpërthyen prej tyre derisa ata janë duke i përcjellë hapat e mashtruar të pronarëve të kopshteve. Ata i bëzanin njëri-tjetrit pëshpëritshëm duke pas frikë se vallë po u hyn ndonjë varfanjak! Le t’i fsheh edhe njëherë auditoriumi qeshjet e veta ironike! E nëse nuk mund të përmbahet, le të lirohet se tani do të pasojë tallja e madhe: “Dhe u nisën herët, të bindur se do të mund t’i pengojnë ata.” (Kalem, 25). Po, po! Ata vërtet tani do të mund të pengojnë dhe të privojnë, në mos dikë tjetër, do ta privojnë vetveten!

Ja, ata po befasohen. Publiku le të qeshet sa të dojë: “E kur e panë atë, thanë: S’ka dyshim, ne e kemi humbur (rrugën).” (Kalem, 26). Ky sigurisht nuk është kopshti ynë përplot fruta. Ne pa dyshim e paskemi humbur rrugën!... E dikush u thotë: “Binduni o shokë!... “Jo, (nuk e kemi humbur rrugën) por paskemi mbetur pa to.” (Kalem, 27). E ky, ky është lajmi i sigurt!

E tani, kur u prenë shpresat e tyre: “Ai më i maturi prej tyre tha: A nuk ju thashë unë se duhet ta kujtoni Allahun.” (Kalem, 28). Ju nuk e kujtuat Allahun dhe nuk ia kishit frikën Atij. Atëherë ata thanë: “I pafajshëm është Zoti ynë, ne ishim të padrejtë.” (Kalem, 29). Vetëm tani, pas kalimit të kohës!

Siç është e zakonshme që çdo ortak ta çfajësojë dhe ta arsyetojë veten prej ortakëve të tij kur epilogu mbaron keq dhe padëshirueshëm, duke i drejtuar akuzat te të tjerët, por ç'të bësh, edhe këta të tjerët përsëritën fjalët e njëjta: “Dhe u kthyen, e po e qortojnë njëri-tjetrin.” (Kalem, 30).

E më pastaj, i lanë qortimet dhe të gjithë e pranuan gabimin, mos vallë pranimi i tyre do ta sjell faljen e Zotit që t'ua kompensojë kopshtin e shkretëruar me ndonjë kopsht tjetër: “Thanë: Të mjerët ne, vërtet ne ishim jashtë rrugës! Shpresohet se Zoti ynë do të na e zëvendësojë me ndonjë edhe më të mirë se ai; ne vetëm tek Zoti ynë mbështesim shpresën!” (Kalem, 31-32).

2 - Tani kalojmë te një pronar i një kopshti tjetër, bile pronar i dy kopshteve, sipërfaqja e të cilëve ishte më e madhe se sipërfaqja e kopshteve të para. Ky pronar ka një rrëfim me një shok të tij i cili nuk ishte prej të djallëzuarve por prej të udhëzuarve me iman. Që të dy janë “shembull njerëzor” i një grupi të njerëzve: Pronari i dy kopshteve është shembull i njeriut pasanik që e ngazëllen pasuria, e tërbon dhe e dalldisë bollëku dhe e harron Fuqinë absolute e cila dominon mbi fatin (kaderin) e njerëzve dhe jetën e tyre. Ai llogaritë se ky bollëk është i përhershëm dhe se nuk zhduket dhe atë nuk mund ta ndalë fuqi e as gjueti. Shoku i tij është shembull i një njeriu besimtar që krenohet me imanin e tij dhe e kujton Zotin. Ai e konsideron bollëkun gjurmë e begati të Atij i cili jep me bollëk që të obligon ta falënderosh dhe përkujtosh e jo ta refuzosh e mohosh:

“E ti sillju atyre (që kërkuar t'u largohen të varfërit) si shembull dy njerëz: njërit prej tyre i dhamë dy kopshte (vreshta) nga rrushi dhe ato i rrethuan me hurma, e në mes të atyre dy kopshteve bimë të tjera. Të dy kopshtet jepnin frutat e veta pa

munguar asgjë, e në mesin e tyre bëmë të rrjedh një lumë. Ai kishte edhe pasuri tjetër.” (Kehf, 32-34).

Me anë të këtij pasqyrimi inskenohet plotësisht pamja e dy kopshteve të lulëzuara e të mrekullueshme. Kjo është skena e parë. Të shohim tani skenën e dytë:

“E ai, atij shokut të vet (që ishte besimtar) i tha: - duke iu lavdëruar atij - Unë kam pasuri më shumë se ti, e kam edhe krahë më të fortë!” (Kehf, 34). Me sa duket, ai këto fjalë ia thotë kur ata që të dy ishin duke shkuar te dy kopshtet ose pranë portës së tyre para hyrjes, ngase pas saj vijon:

“Dhe ai hyri në kopshtin e vet (e me besimtarin për dore) po duke qenë dëmtues i vetes (me mosbesim dhe krenari) tha: Unë nuk mendoj se kjo mund të zhduket kurrë! Dhe nuk besoj se do të ndodhë kijameti (Dita e gjykimit), por nëse bëhet të kthehem te Zoti im, pa dyshim do të gjej ardhmëri edhe më të mirë se kjo.” (Kehf, 35-36).

Ja, ai tani është në kulm të mendjemadhësisë, tërbimit, kryelartësisë dhe dalldisjes. Si ta merr mendja, çfarë pasoja do të lë e gjithë kjo në shpirtin e shokut të tij të varfër i cili nuk ka as kopsht e as pasuri, as përkrahës e as miq? Shoqëruesi i tij është besimtar i denjë. Atë nuk e ngacmojnë të gjitha këto dukuri për ta ndier veten të përbuzur dhe për ta ndier fuqinë e Zotit të tij borxhdhënës. Atë, ato as që e bëjnë që ta harrojë detyrën e tij të vërtetë për t’ia kthyer shoqëruesit të tij dalldisjen në rrugë të drejtë, edhe nëse kjo e shpie para një epilogu që ai ta refuzojë turpshëm dhe përbuzshëm. Pastaj t’ia përkujtojë zanafillën e tij të vogël prej dheut të cilës nuk i kushtohet rëndësi: “Atij ai shoku i vet (besimtari) i tha: - duke polemizuar me te - A e mohove Atë që të krijoi ty nga dheu e pastaj nga një pikë uji, pastaj të bëri njeri të

plotë? Por për mua, Ai (Allahu) është Zoti im, e Zotit tim nuk i bëj shok askël! E pse ti kur hyre në kopshtin tënd nuk the: Allahu çka do bëhet, s'ka fuqi pa ndihmën e Tij. Ti më sheh mua se unë kam më pak se ti edhe pasuri edhe fëmijë (krahë më të dobët). Po unë shpresoj se Zoti im do të më japë kopsht më të mirë se kopshti yt, e këtij tëndit t'i shkaktojë fatkeqësi nga qielli e të gdhijë tokë e lëmuar (e zhveshur). Ose të gdhijë uji i saj i shterur, e ti kurrsesi nuk mund ta kërkossh atel!" (Kehf, 37-41).

Mu këtu përfundon kjo skenë mes dy shokëve (bashkudhëtarëve); njëri i kreshpëruar si gjeli, i kapërditur nga lulëzimi i kopshtit të tij; tjetri i bindur në Allahun, krenar me imanin e tij, ia tërheq vërejtjen shokut të tij dhe e qorton. Ai ia çel sytë duke i treguar se si duhet të veprojë kur ta shohë kopshtin e tij të lulëzuar. Siç duket, kolegu i tij nuk ia vuri veshin - ky gjest është i natyrshëm për njerëzit e tillë - andaj edhe iu kërcënua siç kërcënohet Ai që hidhërohet për fenë e Tij. Ai bëri lutje për kopshtin e shokut të tij te Allahu që t'ia lëshojë rrufetë e ta shkretëtojë, t'i rrëshqasin dhe t'i fundosen këmbët në te, ose t'i humbet uji si të ishte i kredhur, e ai të mos dijë si ta kërkojë e aq më pak edhe si ta kthejë. Pas saj dy bashkudhëtarët ndahen që të dy të hidhëruar. Të shohim se ç'do të bëhet më tej:

"Dhe vërtet, u shkatërruan frutat e kopshtit, e ai filloi t'i rrahë shuplakët për atë që kishte shpenzuar në të, e pemët ishin rrënuar për dhé, dhe thoshte: O i mjeri unë, të mos i kisha bërë Zotit tim askë shok." (Kehf, 42). Allahu iu përgjigj lutjes së njeriut besimtar që kundërshtoi pa ndonjë interes. Le ta shohim protagonistin tonë të personifikuar se si i rrah shuplakët për atë që e investoi në kopshtin i cili tanimë ishte shkatërruar tërësisht. Ta lëmë le të pendohet: "O i mjeri unë, të mos i kisha bërë Zotit tim askë shok!". Mu në këtë çast lëshohen perdet mbi skenën shkretëruese dhe kërkimfalëse.

* * *

Tani do të ndajmë vend edhe për rrëfimet e vërteta pasi që i prezentuam rrëfimet që përmbanin shembuj.

1 - Pikësëpari do ta paraqesim një spektakël të rrëfimit për Ibrahimin gjatë ndërtimit të Qabes së bashku me birin e tij Ismailin. Pothuajse ne tani jemi dëshmitarë të ndërtimit të tyre dhe lutjeve që i bënë e jo dëshmitarë të para shumë kohëve dhe gjeneratave.

“Dhe (kujto atë kohë) kur Ibrahimimi dhe Ismaili vunë themelet e shtëpisë (Qabes, e u lutën): Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je ai që dëgjon dhe di! Zoti ynë, na bëj neve besimtarë të sigurtë ndaj Teje, dhe nga pasardhësit tanë njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tonë dhe falna neve, vërtet Ti je që fal shumë, je mëshirues! Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiu i tyre Të dërguar që t’ua lexojë atyre ajetet Tua, t’ua mësojë atyre Librin dhe urtësinë, e t’i pastrojë (prej ndytësisë së idhujtarisë). S’ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijshtëmi.” (Bekare, 127-129).

Përfundoi lutja, përfundoi edhe skena dhe u lëshua perdja.

Këtu kemi një lëvizje të çuditshme kur lajmi transferohet në dua (lutje). Ajo pra skenës i dha gjallëri dhe e bëri të pranishme. Lajmi është: “Dhe (kujto atë kohë) kur Ibrahimimi dhe Ismaili vunë themelet e shtëpisë”. Kjo sikur të ishte sinjal për ngritjen e perdes për t’u shfaqur skena; shtëpia, Ibrahimimi dhe Ismaili duke e bërë këtë lutje të gjatë.

Sa mrekulli e çiltër artistike është kur kalohet prej rrëfimit në lutje. Do të bëhej edhe më e çiltër sikur të paramendohej vazhdimi

i rrëfimit që të shohim se sa do të ishte ajo pamje e shëmtuar sikur të thuhej: Dhe (kujto atë kohë) kur Ibrahim dhe Ismaili vunë themelet e shtëpisë duke thënë... Kjo shfaqje me këtë spektakël do të ishte rrëfim, ndërsa në pikturën kur'anore ajo është jetë. Këtu pra edhe qëndron ai dallim i madh mes këtyre dy shprehjeve. Në të vërtetë jeta në “tekst” shtrihet e lëvizshme dhe gjithmonë e pranishme, ndërsa misteri i krejt kësaj lëvizjeje është në shmangien e një fjale... Mu aty pra është strukur elokuenca (i'xhazi).

2 - Tani do të japim një skenë nga tregimi për “tufanin”: “Ajo lundron me ta në valë si kodra”. Në këto çaste lemeritëse në shpirtin e Nuhit ngërthen dashuria atërore. Më tej ka mbetur një djalë i tij që nuk besoi. Ai e dinte se ai po fundosej me të fundosurit, por ja që valët e detit bëjnë shtypje në mënyrë që “njeriu” në shpirtin e Nuhit do të dominojë mbi “Pejgamberin” saqë e detyron që i shqetësuar dhe i përlurur t'i afrohet e ta thërrasë të birin e vet: “E Nuhi e thirri djalin e vet, që ishte në një vend të ndarë: O djali im, hip bashkë me ne e mos shko me mohuesit”. Megjithatë, kjo bijësi e ndarë nuk e pranon këtë thirrje të shqetësuar, kjo djalëri e ngrefosur dhe e kacagjeluar nuk sheh shpëtim pos në thërmijat (fuqitë) e tij personale: “(I biri) tha: Unë do të ngjitem në një kodër që do të më mbrojtë nga uji (vërshimi)!”. Dhe ja ai që posedon cilësinë e atërisë së shqetësuar ia bën thirrjen e fundit: “Tha: Nuk ka sot mbrojtës prej dënimit të Allahut, pos për atë që Ai e ka mëshiruar”. Për një çast ndërrohet situata. Ja, po vjen vala e kreshtuar e cila po kapërdinë çdo gjë para vete: “Vala në mes tyre i ndau, e ai (i biri), u bë prej të fundosurve.” (Hūd, 42-43).

Dëgjuesi i cili në këtë rast lirisht mund të trajtohet si shikues, mbetet pa frymë në këto çaste të shkurtra ngase: “Ajo (anija) lundron me ta nëpër valë si kodra”, kurse Nuhi, babai i shqetësuar dërgon thirrjen; e i biri i tij, djalë i krekosur, refuzon t'i përgjigjet

thirrjes; ndërsa vala e kreshtuar, si një dremmitje syri e shpejt dhe grabitçare, i jep fund kësaj drame... Këtu tmerri mund të matet vetëm me ndikimin e tij në shpirt të gjallë - mes babait dhe djalit - ashtu siç mund të matet në natyrë - vetëm kur vala përmbys gjallesat dhe kopshtet. Këto skena janë identike si në natyrë të vdekur ashtu edhe në shpirt të njeriut.

* * *

Tani po kalojmë në skenat e kijametit dhe në spektaklet e begative apo të ndëshkimit. Këto skena edhe marrin hisen më të madhe në ilustrimin artistik:

1 - “Ditën kur thirrësi (Israfil) i thërret në diç të tmerrshme. (Ata) me sy të përulur dalin nga varret, thuajse janë karkaleca të shpërndarë. Duke shpejtuar drejt Atij që i thërret, e jobesimtarët thonë: “Kjo është ditë e vështirë.” (Kamer, 6-8).

Kjo është njëra prej skenave të ringjalljes. Shiriti i saj është i shkurtë dhe i shpejtë, megjithatë i personifikueshëm dhe i lëvizshëm. Ajo është përplot tipare dhe aksione. Aty janë turmat që dalin prej varreve, po si të ishin karkaleca të shpërndarë. Ndërsa pasqyra e karkalecit të njohur ndihmon në incizimin e këtij spektakli të çuditshëm. Këto turma shpejtojnë në drejtim të thirrësit pa e ditur përse i thërret. E ai i thërret “në diç të tmerrshme” që ata nuk e dinë. “Me sy të përulur”. Ky pasus e plotëson tabllonë dhe ia jep tiparin e fundit. Gjatë këtij tubimi, shpejtimi dhe përuljeje “jobesimtarët thonë: Kjo është ditë e vështirë”. A thua a mbeti diç në skenë e që nuk u përshkrua pas këtyre frazave të shkurtra. Pa dyshim dëgjuesit janë duke e imagjinuar këtë ditë të tmerrshme. Aty gjejmë një varg pikturash. Në pikturat e tyre (e ata vërtet do të jenë prej të ringjallurve) shihet qartë ai trishtim përjetues i cili e prek shpirtin e çdo të gjalli!

2 - Tani do të shohim një skenë tjetër. Ajo është skena e vrapit dhe përuljes e cila e tmerron edhe më tepër shpirtin dhe e ngjyros edhe më fuqishëm pikturën.

“E ti kurrresi mos e mendo Allahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë zullumqarët! Ai vetëm ua shtyen (dënimin) deri në ditën kur sytë e tyre shtangen (mbesin të hapur). Të ngutur e me kokë të ngrehur nuk lëvizin sytë e tyre (e shikojnë me ngulm) e zemrat i kanë të zbrazëta (nga tmerr).” (Ibrahim, 42-43).

Këtu na shfaqen katër piktura të njëpasnjëshme e të varguara, ose katër skena të një akti të cilat përcillen njëra pas tjetrës në ekspozim. Me anë të gjithë kësaj arrihet edhe një pikturë e personifikuar në imagjinatë. Ajo është pikturë specifike për tmerrin, turpin, trishtimin dhe dorëzimin. Atë e mbulon një hije e pikëllueshme dhe serioze që i pushton frymëmarrjet. Ajo është pikturë e cila vigjilon mes një sheshi të gjallë. Aty kemi njerëz. Mes tyre dhe dëgjuesve ekziston lidhja e përbashkët gjinore dhe ndjenja e ngjashme. Ajo në shpirtrat e tyre vizatohet e gjallë. Përmes saj ndjenja arrinë prej personazheve në dëgjuesit me anë të lidhjes intuitive dhe imagjinatës konkrete, ashtu që kur e lexon lexuesi, dridhjet e trishtimit futen në brendinë e tij sikur t'i përjetonte.

3 - Pas saj vjen edhe skena e tmerrit më të madh që për të shprehurit e saj fjalët e Kur'anit nuk mungojnë. Le ta prezentojmë pra që të shprehet për veten:

“O ju njerëz, ruajuni dënimet nga Zoti juaj, sepse dridhja pranë katastrofës së kijametit është një llahtari e madhe. Atë ditë kur ta përjetoni atë, secila gjidhënese braktisë atë që ka për gjini dhe secila shtatzënë e hedh para kohe barrën e vet, ndërsa njerëzit duken të dehur, por ata nuk janë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër.” (Haxh, 2).

Këtu në këtë skenë janë përfshirë të gjitha gjidhënëset të cilat e braktisin foshnjën kur janë duke i dhënë gji. Njerëzit një situatë të tillë e shikojnë por nuk e shohin, lëvizin por nuk janë të vetëdijshëm për lëvizjet e tyre. Aty janë të përfshira edhe të gjitha gratë shtatzëne që e hedhin barrën përnjëherë nga tmerri i trishtueshëm që i godet. Aty i kemi edhe njerëzit e dehur që në të vërtetë nuk janë të dehur. Dehja është simbolikë e syve të tyre të hutuar dhe e këmbëve të lëshuara. Skenë përplot njerëz si tufa të valëzuara. Syri pothuajse i sheh kur imagjinata është duke i përjetuar. Tmerri i cili përshkoi çdo gjë, syrin e huton sa që nuk mund t'i shohë skajet e tij. Kjo është një lemeri e gjallë që nuk matet sipas peshës dhe madhësisë por sipas ndikimit të saj në shpirtrat njerëzorë. Gjidhënëset kanë braktisur atë që patën për gjini; shtatzënet kanë hedhur para kohe barrën e vet; të dehurit që në të vërtetë nuk janë të dehur (por ata duken ashtu ngase) “dënimi i Allahut është i ashpër”.

4 - Pos tre figuracioneve të mëparshme, nëse tmerrin e pasqyrojnë të qartë për sytë, kemi edhe figuracione të tjera të cilat nuk mund t'i perceptojë asgjë pos intuita:

“Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet.” (Abese, 37).

“Dhe asnjë mik nuk pyet për mikun.” (Meârixh, 10).

Nuk ka shprehje më koncize dhe më precize për ta ilustruar preokupimin e zemrës dhe mendjes me dertin e atypëratyshëm dhe dominues, aq sa që nuk ka vend për asgjë tjetër, as për ta vërejtur as për ta përcjellur.

5 - Tani gjendemi para një sheshi tjetër prej shesheve të ringjalljes. Ai është i ndarë në disa akte dhe i përbërë prej disa

skenave, ku mes secilës prej tyre ekziston një interval të cilin e plotëson imagjinata.

“Ata presin vetëm një britmë që do t’i rrëmbejë duke u grindur mes vete. E nuk do të mund të lënë as porosi (vasijet-testament), as të kthehen në familjet e tyre.” (Jâsîn, 49-50).

Kjo është britma e parë e cila i rrëmbeu kur ata ishin duke polemizuar dhe duke u grindur, nga e cila nuk patën mundësi as të lënë porosi, sepse britma i nxitoi për në varreza... e mandej:

“Dhe i fryhet “surit” kur ja duke nxituar prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre. E thonë: Të mjerët ne! Po kush na ngriti prej shtretërve tanë (varreve)? E kjo është ajo që premtoi Zoti dhe vërtetuan Të dërguarit.” (Jâsîn, 51-52).

Tani kjo është britma e dytë, dhe ja ata pej varrezave nxitojnë kah Zoti i tyre të frikuar e të hutuar. Pyesin njëri-tjetrin: “Kush na ngriti prej shtretërve tanë?”. Duke fërkuar sytë marrin përgjigjen “Kjo është ajo që e premtoi Zoti dhe e vërtetuan të dërguarit”.

“Ajo nuk është tjetër pos një britmë e fuqishme, e ata të gjithë para nesh janë të pranishëm. Sot pra, askujt nuk i bëhet e padrejtë diçka dhe nuk shpërbleheni me tjetër vetëm për atë që vepruat.” (Jâsîn, 53-54).

Ata vërtet ishin të pranishëm. Skena mori pamjen e saj. Ja, ata po e dëgjojnë kumtesën para syve dhe veshëve të atyre që tani janë duke e lexuar këtë Libër (Kur’anin)!: “Sot pra, askujt nuk i bëhet e padrejtë diçka, dhe nuk shpërbleheni me tjetër vetëm për atë që vepruat”.

6 - E kur të kryhet ringjallja e të fillojë paraqitja, do të jemi para skenës së një shoqërie e cila në dunja duhej e dashurohej e ajo sot (ditën e ringjalljes) injorohet dhe distancohet. Disa i nxitnin të tjerët në lajthitje e disa u krenoheshin besimtarëve dhe talleshin me ata që ftonin në lumturinë e ahiretit.

Ja, ata e dendësojnë zjarrin grumbull pas grumbulli. Aty është grumbulli i parë që po informohet për futjen e grumbullit të dytë: “Ky është një grumbull që bashkohet me ju”. E çfarë do të jetë përgjigjja? Ata u thonë: “Kurrë mos u çlirofshin. Ata këndellin zjarrin”. E, a është e mundur të heshtin të mallkuarit? Kurrsesi! Ja tash, edhe ata ua kthejnë: E kush? Populli parisë: “Jo, ju mos u çlirofshi kurrë. Ju na e përgatitët këtë! Sa vendqëndrim i keq është ky”. Kur ja, tani, bëjnë një lutje të përbashkët e thonë: “O Zoti ynë, atij që na e përgatiti këtë shtoja dyfish dënimin në zjarr!”. E ç’ka më pastaj? Pastaj ata i hulumtojnë besimtarët të cilëve u lavdëroheshin në dunja dhe i trajtonin si të këqij, kurse tani në ahiret nuk i shohin bashkë me ta dhe thonë: “Ç’është që nuk i shohim disa burra që ne i konsideronim prej të këqijve. E që i kemi pas marrë ata për tallje, a mos na është larguar shikimi prej tyre? Kjo grindje ndërmjet banorëve të zjarrit është e vërtetë.” (Sâd, 59-64).

Tani po e dëshmojmë këtë grindje sikur të ishte e pranishme para syve tanë! Çdo shpirt njerëzor ndien në brendinë e tij ndodhinë e kësaj skene dhe i frikohet. Ai kujdeset - nëse sjell dobi kujdesi - të mos bie në të!

* * *

Këto ishin skena të ringjalljes dhe rikthimit e të gjithë asaj që ndodh në te, diskutim mes partnerëve dhe injorim mes miqve.

Tani do të ekspozojmë disa skena të kënaqësisë dhe ndëshkimit (mjerimit) pas dialogut dhe kërcënimit:

1 - “E ata që nuk besuan sillen në grupe te xhehennemi, e kur arrijnë te ai, dyert e tij hapen e roja e tij u thotë atyre: A nuk ju erdhën juve Të dërguar nga mesi juaj t’ua lexojnë shpalljet e Zotit tuaj, t’ua tërheqin vërejtjen për ballafaqimin në këtë ditë? Po, (na kanë ardhur...) ata thonë; por fjala (vendimi) e dënimit domosdo është e meritueshme kundër jobesimtarëve. U thuhet: Hyni nëpër dyer të xhehennemit, aty do të jeni përgjithmonë, sa vend i shëmtuar është për kryeneçët!” (Zumer, 71-72).

“E ata që ishin të devotshëm ndaj Zotit të tyre, sillen në grupe te xhenneti, e kur arrijnë aty dyert e tij i gjejnë të hapura dhe roja e tij u thotë atyre: Selamun alejkum-qofshi të shpëtuar, ishit të pastër, andaj hyni në të, aty jeni përgjithmonë. E ata (të xhennetit) thonë: I falënderuar qoftë Allahu, i cili premtimin e vet e plotësoi për ne e na dha në trashëgim tokën (e xhennetit) që të vendosemi në xhennet si të duam! Sa shpërblim i mrekullueshem është për ata që vepruan drejt”.

Kurse plotësimi i skenës bëhet kur:

“Do t’i shohësh engjëjt të rreshtuar përreth Arshit, e madhërojnë me falënderim Zotin e vet! E në mes tyre kryhet gjykimi me drejtësi dhe thuhet: (prej të gjithëve): Falënderuar qoftë vetëm Allahu, Zoti i botëve!” (Zumer, 73-75).

Mendojmë se skena ishte e qartë dhe e dalluar, me hapa të simetrizuar dhe komponente të sintetizuara të cilat nuk kërkojnë prej nesh ndonjë sqarim apo shpjegim. Tani do t’i përcjellim hapat e dy palëve pas mureve!

2 - “Me të vërtetë pema e zekkumit (një lloj peme tepër e idhët), do të jetë ushqim i mëkatarit. Vlon si katrani (pezhgveja) në barqet (e tyre), ashtu si vlon uji i valë. (U thuhet engjëjve për mëkatarin): Rrëmbene e grahne në mes të xhehennemit. Dhe hedhni mbi kokën e tij ujin valë e shtojani mundimin. (I thuhet): Shijoje! Se ti je ai i forti, autoritativi. E ky është dënimi për të cilin dyshonit”.

“Vërtet, ata që i druajn (Allahut) janë në vend të qetë. Në kopshte (xhennete) e në burime që rrjedhin. Veshin petka nga mëndafshi e kadifeja, ulur ballë për ballë. Ja kështu, edhe i martojmë me bardhoshe symëdha (me hyri). Aty kërkojnë t’u sillen çdo lloj peme dhe aty janë të sigurt. Aty nuk do të përfetojnë vdekjen, përveç asaj të parës (në dunja). Ata i shpëtoi (Allahu) prej vuajtjeve të xhehennemit.” (Duhan, 43-55).

3 - Me këtë pikë po i përmbyllim skenat e kijametit dhe me anë të kësaj skene të ndarë në shumë spektakle, me akte të llojllojta, e cila është specifike në mënyrën e shfaqjes dhe dialogut:

“Ata të xhennetit i thërrasin (pyesin) banorët e zjarrit e u thonë: Ne e gjetëm të vërtetë atë që na e pat premtuar Zoti ynë, e ju (banorë të zjarrit) a e gjetët të vërtetën, atë që u pat premtuar Zoti i juaj? Ata (banorët e zjarrit) thonë: Po. Atëherë në mes tyre (mes dy grupeve) thërret një zë: Mallkimi i Allahut qoftë mbi zullumqarët! Ata që penguan nga rruga e Allahut dhe që kërkuan shtrembërimin e saj dhe ata që ishin mohues në botën tjetër”. “E mes atyre (dy grupeve) është një perde (mur), e mbi A’rafë (lart mbi mur) janë burrat që e njohin secilin (të xhennetit dhe të xhehennemit) me shenjat e tyre. Ata i thërrasin banorët e xhennetit: Paqja qoftë mbi ju! Ata (të A’rafit) nuk kanë hyrë në te, por shpresojnë. E kur u shkon shikimi nga ata të xhehennemit, thonë: Zoti ynë, mos na bë neve me mizorët!”. “Ata të A’rafit i

thërrasin disa burra që i njohin me shenjat e tyre dhe u thonë: Çka ju vlejti ai grumbullimi juaj (në pasuri dhe fëmijë) dhe ajo që mbaheshit kryelartë, (e tash jeni në xhehennem)? A këta janë ata (besimtarët) për të cilët betoheshit se nuk do t'i përfshijë mëshira e Allahut? (Në mënyrë ironike i përqeshin kafirët, mandej u thonë besimtarëve): Vazhdoni në xhennet, as nuk ka frikë për ju, as nuk keni për t'u brengosur!”. Banorët e zjarrit i thërrasin (lusin) ata në xhennet (duke u thënë): Na jepni pak nga uji apo nga ajo me të cilën ju ka furnizuar Allahu (se mbaruam nga etja)! Ata (në xhennet) thonë: Allahu i ka ndaluar që të dyja këto për jobesimtarët!” (A’rafë, 44-50).

Ja, ne jemi dëshmitarë të skenave të cilat pasojnë njëra-tjetrën.

Ja, ne jemi dëshmitarë të besimtarëve në xhennet dhe jobesimtarëve në xhehennem. Të parët i thërrasin të dytët: “Ne e gjetëm të vërtetën, atë që na e pat premtuar Zoti ynë, e ju a e gjetët atë që ua pat premtuar Zoti juaj?”. Kjo pyetje përmban qesëndi të idhët, e përgjigjja kthehet: “Po!”, ngase ska vend për mohim apo refuzim. Në atë çast dikush (prapa perdeve) thotë: “Mallkimi i Allahut qoftë mbi zullumqarët”!

Mandej ja, ne jemi edhe dëshmitarë të A’rafit - murit ndarës mes xhennetit dhe xhehennemit - ku në te qëndrojnë njerëz që i njohin këta dhe ata! U drejtohen banorëve të xhennetit duke u dëshiruar mirëseardhje dhe rehati, e u drejtohen banorëve të zjarrit duke i qortuar dhe fyer: “A këta janë ata (besimtarë) për të cilët betoheshi se nuk do t'i përfshijë mëshira e Allahut?”. Shikoni ku janë tash ata. Ata janë në xhennet duke e pranuar shpërblimin!

Së fundi, ja ku janë edhe banorët e zjarrit duke kërkuar ndihmë. Kërkojnë nga banorët e xhennetit t’ju lëshojnë pak ujë ose diç nga të mirat që ua ka dhënë Allahu. Ata nga çdo e mirë kanë

me bollëk, le t'u japin nga ato edhe të shkretëve. Megjithatë, përgjigjja kthehet me keqardhje dhe përkujtim: “Allahu i ka ndaluar që të dyja këto për jobesimtarët”.

Këto pra janë skena të kijametit, skena të dialogjeve, grindjeve dhe skena të kënaqësisë dhe ndëshkimit. A thua lexuesi gjatë paraqitjes të tyre e ka ndier se e gjithë kjo do të vie në ardhmërinë e largët, apo e ka ndier se ajo është duke ngjarë në moment dhe në praninë e tij?

E unë, unë e kam harruar veten. Kam harruar se jam duke i pasqyruar këto skena me kostumet e tyre. Më duket se jam duke i dëshmuar në realitet e jo në imagjinatë. Ky pra është ndikimi i i'xhazit (elokuencës) në ekspozim dhe përshkrim. Vlera e kësaj mrekullie shtohet ngase, siç kam thënë disa herë, ajo mbështetet ekskluzivisht në fjalë gjatë ilustrimit.

* * *

Më tej... Do të ishte reale për këtë kapitull gjer këtu të përfundoj. Megjithatë, ekziston një synim prej synimeve të Kur'anit i cili sipas natyrës duket se është larg metodologjisë ilustruese, sepse ai përmban logjikë, polemikë dhe thirrje në fe. Më tepër të dukej se metodologjia psikologjike është ajo që trasohej në ato raste. Përdorimi i metodologjisë ilustruese - bile edhe në këtë qëllim - zotëron tiparin e saj se ajo është element favorizues në metodologjinë kur'anore, kurse çështja të cilën e shtrojmë në këtë kapitull nuk është çudi se e përfshinë edhe këtë fenomen. Andaj, ne do të sjellim disa shembuj për polemikën ilustruese, edhe pse kjo polemikë do të përfshijë një kapitull të veçantë i cili do të vie nga fundi i këtij libri.

1 - Tani bëjmë fjalë për pikturën e parë: Skenë prej skenave të natyrës së vdekur dhe të amshuar. Shikimi tërhiqet kah ajo si dëshmi e fuqisë së Allahut: “Ai është që krijoi shtatë qiej palë-palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohish ndonjë kontrast. E ti, hedhe shikimin, a sheh ndonjë plasaritje? Mandej hedhe shikimin disa herë, por, do të kthehet i lodhur dhe i molisur.” (Mulk, 3-4).

Kjo është një pikturë natyrore dhe e thurur mirë, e cila tërheq shikimet, në mënyrë që syri të përcjell në shpirtin e tij atë që e sheh. Pastaj të futet ndikimi i natyrës në brendinë e shpirtit për t'i besuar fuqisë së Allahut “I cili krijoi shtatë qiej palë-palë” Ajo pikturë është e ekspozuar në çdo kohë, por kur lexohen këto ajete dhe hedhet shikimi në to, duket se ajo për herë të parë po ekspozohet në qiell. Kjo pra është metodologjia kur'anore e cila manifestohet sa herë që i drejton shikimet në dëshmitë e natyrës dhe dëshmitë e jetës në të gjitha rastet e përshtatshme.

2 - Këtu kemi edhe një pikturë prej skenave të natyrës së vdekur. Por, këtë herë ajo është e pasqyruar në tokë e jo në qiell.

“Në tokë ka disa lëvizje që janë fqinje të njëra-tjetrës, kopshtije të hardhisë, palma me një pip ose me shumë pipa, të cilat ujiten me të njëjtin ujë, e disa i avancojmë nga të tjerat sipas shijes (së frutave).” (Ra'd, 4).

Kjo është skenë e vjetër dhe e përsëritshme. Sytë dhe shpirtat kalojnë pranë saj duke mos i përfillur. Por ajo këtu shfaqet si të ishte e re. Do të mjaftonte sikur syri kur e sodit të krijonte në shpirt impresionim të veçantë intuitiv. Këto vise që gjenden në fqinjësi në sipërfaqe të tokës, janë të dalluara sipas bimëve. Por edhe prej të njëjtit lloj të bimës ekzistojnë forma të ndryshme. Disa janë çift e disa tek. E që të gjitha ato ujiten me të njëjtin ujë,

megjithatë në ngrënie shija u dallon. Pa i marrë parasysh këto karakteristika, synimi parësor kthehet në dëshminë e kësaj, piktura natyrore e cila impresionon çdo shikim për ta soditur me atë tipar të pazëvendësueshëm, që inspiron me atë shqisë të brendshme që shikon, dhe ate, pasi që ta sodisin sytë.

3 - Këtu kemi një spektakël prej spektakleve të natyrës aktive në ambient. Ate e ekspozon Kur'ani hap pas hapi, ashtu që në çdo hap do të kemi një skenë.

“Allahu është Ai që i lëshon erërat, e ato lëkundin retë dhe Ai i shtrin lartë si të dojë e i bën ato edhe të ndara në pjesë, dhe përmes tyre e sheh si bie shi, e kur ia lëshon kujt të dojë prej robërve të Vet, qe, ata gëzohen. Edhe pse para se t'u binte (shiu) atyre, ata para tij ishin të dëshpëruar. Shiko pra gjurmët e mëshirës së Allahut, se si e gjallëron tokën pas vdekjes së saj, e s'ka dyshim se Ai është që do t'i ngjallë të vdekurit, ngase Ai për çdo gjë është i plotfuqishëm.” (Rrûm, 48-50).

Kështu pra, pikturë pas pikturë, dërgimi i erërave, lëkundja e mjegullave, shtrirja e tyre në qiell, ndarja e tyre në pjesë, reshja e shiut përmes tyre, zbritja e shiut për gëzim (sihariq) për ata që ishin të dëshpëruar dhe ngjallja e tokës pas vdekjes së saj.

Nëpërmjet këtyre skenave të njëpasnjëshme që u ekspozohen syve dhe imagjinatës dhe lënies që ato të ndikojnë në shpirt në mënyrë graduale, me anë të tyre pra synohet që të dilet para këtij realiteti! “Ai është që do t'i ngjallë të vdekurit, sepse Ai për çdo gjë është i plotfuqishëm”. Kështu kjo konkluzë vjen në çastin më të volitshëm për këtë konkludim.

4 - Nëse skena e tretë ishte në ambient, skena e katërt do të jetë e shfaqur në tokë. Toka në këtë skenë do të prezentohet sipas një tipari të veçantë:

“A nuk e sheh se Allahu lëshon ujë nga qielli dhe atë e shpërndanë në tokë nëpër burime, mandej me të mbijnë bimë të ngjyrave (llojeve) të ndryshme, pastaj ajo thahet dhe e sheh të zverdhur e pastaj e bënë të llomitur. S’ka dyshim se në këtë ka argument për të zotët e mendjes.” (Zumer, 21).

Ja pra, kjo është skenë prej skenave të tokës e cila gjithashtu hapëron disa hapa. Ajo paraqitet ngadalë por e qartë. Çdo hap syrit i lë afat të mjaftueshëm për meditim, kurse shpirtit afat të mjaftueshëm për impresionim. Ja, ky është uji i cili bie nga qielli e pastaj shpërndahet në burime për ujitje. Mandej me të mbijnë bimë të llojeve të ndryshme, e pastaj thahet bima pasi që të piqet dhe e sheh të zverdhur, e më pas thahet krejtësisht dhe bëhet e llomitur. Termi “pastaj” çdo herë ia dhuron këtë “afat” syrit dhe shpirtit që ta sodisin skenën e paraqitur para ndërrimit të saj me paraqitjen e skenës vijuese. (Ky është një art i harmonizimit të shfaqjes për të cilin do të flitet gjerësisht në njërin prej kapitujve të ardhshëm).

5 - Në ambient kemi edhe skena tjera të gjalla, kemi shpendin i cili fluturon me krahë të hapur e me këmbë të mbledhura. Pastaj i mbledh flatrat e tij kur fillon të lëshohet në tokë:

“A nuk shikojnë shpezët mbi (kokat) e tyre (se si fluturojnë) krahëhapur dhe kur i palojnë, ato nuk i mban kush në ajër pos I Gjithëmëshirshmi.” (Mulk, 19).

Ky ajet ka një skenë me dy spektakle. Spektakli i shpendit krahëhapur dhe këmbëmbledhur dhe spektakli kur i palon krahët. Kjo është një pikturë e gjallë dhe aktive të cilën njerëzit e shohin

në çdo çast, por, pranë saj kalojnë me neglijencë. Kur'ani ua kthen shikimet kah Ai që ta shohin me shqisën e ndjenjës, dëshmi për fuqinë dhe mëshirën e Allahut.

6 - Në tokë ka edhe një skenë tjetër e përsëritshme, pranë së cilës njerëzit gjithashtu kalojnë me neglijencë. Meditimi dhe përcjellja e lëvizjes së saj të ngadalshme e cila pothuajse është formuar në imagjinatë - edhe pse është e shfaqur para syve - influenton shpirtin dhe impresionon instinktin. Ajo i jep rast soditjes me ngjyrëra të ndryshme në atë spektakël të cilin e pranuan trupat, ashtu që duket e shtangur kurse ajo lëvizë ngadalë dhe pavërejtshëm:

“A nuk e sheh se si Zoti yt e ka zgjatur hijen, e sikur të kishte dashur do ta linte të palëvizshme e diellin e kemi bërë tregues të saj. Pastaj Ne atë e tërheqim pak nga pak.” (Furkân, 45-46).

Në këtë skenë kemi bukuri natyrore e cila nxit imagjinatën të meditojë përreth dhe e mbush vullnetin plot etshuri. E sa skena të njohura e të përsëritura duken të reja! Ato të përhitën sikur syri t'i kishte parë për herë të parë kur ato i sodit me shqisën e ndjenjës së hapur dhe syrin e zgjuar që i dallon bukuritë.

7 - Toka ka edhe skena të tjera. Ndoshta prej atyre që më së shumti impresionojnë ndjenjën dhe shpirtin janë pikturat e vizatuara shpeshherë dhe sipërfaqet e shkreta (dhe të lashta). Ato ia imagjinojnë ndjenjës pikturat e jetës së lashtë dhe siluetat e kuarteve të rrethuara. Këto skena në mënyrë eksplicite i dedikohen syrit kurse në atë implicite (të ndërgjegjes) i dedikohen shpirtit. Andaj Kur'ani i orienton shikimet kah ato që pastaj imagjinatën ta kthejë në jetën e lashtë dhe në zanafillën e saj:

“A nuk udhëtuan nëpër tokë e të shohin se si ishte përfundimi i atyre që ishin para tyre!? Ata ishin edhe më të fortë se këta, ata e lëvruan tokën dhe e ndërtuan më shumë se sa këta që e rindërtuan, atyre u patën ardhur Të dërguarit e tyre me dëshmi të qarta. Pra, Allahu nuk dëshironte që t’u bëjë të padrejtë atyre, por ata vetvetes i bënë të padrejtë.” (Rrûm, 9).

* * *

Pra, ilustrimi është elementi favorizues në metodologjinë e Kur’anit. Ai është baza e parë e Kur’anit për sqarim dhe proklamim dhe është rruga me të cilën shqyrtohen të gjitha qëllimet. Ilustrimi është ajo rrugë e veçantë të cilën gjurmuesi nuk mund ta përfshijë në të gjitha aspektet e tij.

Ky kapitull është garanci dhe dokument i këtyre fjalëve.

Përftyryrimi konkret (ndijimor) dhe trupëzimi

Kur themi: Ilustrimi është elementi favorizues në metodologjinë e Kur'anit dhe bazamenti i parë për interpretim, nuk do të thotë se ne kemi përfunduar me shpjegimin e këtij fenomeni gjithëpërfshirës dhe universal. Pas gjithë kësaj kemi edhe një shtojcë e cila meriton t'ia kushtojmë këtë kapitull të veçantë.

Mbi cilën bazë ndërtohet ky ilustrim?

Ne në fillim të kapitullit të mëparshëm cekëm diç për këtë çështje kur thamë: “Ai shpreh domethënien mendore dhe gjendjen shpirtërore përmes pamjes sensible dhe imagjorative. Ai shpreh edhe ngjarjen reale, skenën spektakulare, shembullin human dhe natyrën njerëzore. Pastaj me anë të pikturës të cilën e vizaton, arrinë t'i dhurojë një jetë karakteristike ose një lëvizje përtërirëse. Kështu domethënia mendore shndërrohet në qenie apo lëvizje, gjendja shpirtërore në pllakë pikturë apo skenë, shembulli human në karakter të gjallë, natyra njerëzore në gjendje trupore të personifikueshme. Kurse ngjarjet, skenat, rrëfimet dhe spektaklet i shndërron në objekte të pranishme në të cilat ka jetë dhe lëvizje. E kur ilustrimit i bashkangjitet edhe teksti, atëherë plotësohen të gjitha elementet e aktrimit”.

Të gjithë shembujt të cilët u cekën në kreun e mëparshëm janë të përshtatshëm si fakte për këtë dukuri, ndonëse thurja e tyre në atë kapitull ishte e shpejtë vetëm sa për të vërtetuar se ilustrimi është element favorizues në metodologjinë e Kur'anit. Por, ne në këtë kapitull nuk do të ndalemi vetëm në prezentimin e këtyre shem-bujve, sepse Kur'ani i cili është para duarve tona është përplot shembuj të rinj. Këtu do t'i zgjedhim shembujt që kanë

dëshmi të posaçme për këtë dukuri të fiksuar: Dukurinë e përfytyrimit konkret dhe trupëzimit me anë të ilustrimit.

Ekzistojnë shumë pak figuracione të Kur'anit të cilat shfaqen mecece (të vdekura) dhe pasive. Shumica dërrmuese e tyre kanë lëvizje të brendshme ose të jashtme. Lëvizje e cila i ngrit të rrahurat e jetës dhe e rritë ngrohtësinë e saj. Kjo lëvizje nuk përkufizohet në skenat e rrëfimeve dhe ndodhive, në skenat e kijametit, në skenat e kënaqësisë dhe ndëshkimit ose në skenat e diskutimeve dhe polemizimeve. Por, ajo vërehet edhe në sferat tjera në të cilat nuk do të pritej të vërehet.

Ne medoemos duhet të kemi kujdes ndaj llojit të kësaj lëvizjeje. Ajo është lëvizje e gjallë nga e cila aktivizohet jeta eksplicite për të gjithë sytë ose jeta implicite në intuitë. Kjo lëvizje të cilën po e quajmë “përfytyrim konkret”, është ajo që përmes saj formohet ilustrimi në Kur'an për ta shpërndarë gjallërinë në të gjitha figuracionet e të gjitha formave dhe të gjitha ngjyrave.

Edhe një dukuri tjetër shfaqet në ilustrimin kur'anor. Ajo dukuri është “trupëzimi”. Fjala është për trupëzimin e domethënieve abstrakte duke i shfaqur si trupa ose gjëra konkrete tërësisht. Kur'ani përmes kësaj dukurie arrinë në atë distancë të largët sa që me të shprehet në raste të ndishme, tepër të ndishme, për të cilat Feja islame impulson për t'i abstraktizuar krejtësisht siç është rasti me Qenien Hyjnore dhe cilësitë e Tij. Për këtë kemi dëshmi të prera më shumë se çdo dëshmi tjetër, kjo ngase metoda e “trupëzimit” është metodë favorizuese në ilustrimin kur'anor, por duke bërë vërejtje dhe duke patur kujdes në rrezikun e “trupëzimit” në imagjinatë.

Tani shkojmë në prezentimin e shembujve.

1 - Ngjyrë prej ngjyrave të “përfytyrimit” të cilën mund ta quajmë “personifikim”, shëmbëllet në mveshjen e jetës materieve të ngurta, fenomeneve natyrore dhe reflekseve intuitive. Fjala është për atë jetë e cila ngrihet dhe bëhet jetë njerëzore, e cila përfshin materiet, fenomenet dhe reflekset që t’u japë të gjithave emocione dhe motive njerëzore. Ajo jetë i shoqëron njerëzit, merr nga ata dhe u jep atyre. Ajo i shoqëron në të gjitha rrethanat. I bënë ta ndiejnë jetën në çdo gjë që e sheh syri ose merr pjesë në të ndjenja. Ata ose janë të kënaqur me këtë ekzistencë ose e braktisin nga droja, ndjeshmëria dhe ndërlikueshmëria e saj.

Ja, ky është mëngjesi që merr frymë: “Pasha agimin kur merr frymë.” (Tekvir, 18). Kur’ani t’i përfytyron këto çaste të qeta nga të cilat lirohen fleksionet e mëngjesit duke marrë frymë - në ato çaste merr frymë edhe jeta - duke rrjedhë gjallërimi në çdo qenie të sipërfaqes së tokës dhe në qiell.

Ja edhe ku është nata, e cila nxiton duke kërkuar ditën, por ajo nuk mund ta arrijë: “Ai (me errësirën) e natës e mbulon ditën, e ajo e kërkon (ditën) ngashënjyeshëm.” (A’rafë, 54). Kështu kujtesa sillet me këtë sjellje të rrjedhshme e cila nuk ka fund e as fillim.

Tani ja edhe nata e cila ec: “Pasha natën kur ec”, (Fexhr, 4). Dhe e ndien ecjen e saj në këtë hapësirë të gjerë, ashtu që do të ngazëllesh me këtë ecës pushueshëm dhe dashurueshëm!

Në këtë hapësirë janë edhe toka edhe qielli të cilat qëndrojnë të varura. Kur’ani ua drejton atyre fjalimin e ato me të shpejtë i përgjigjen: “Mandej e mësyu qiellin (krijimin e tij) e ai ishte tym (mjegullinë, si materie e parë), e atij edhe tokës i tha: Ejani, o me përulje o me dhunë! Ato thanë: Të erdhëm të përulshëm!”

(Fussilet, 11). Në këtë rast imaginata personifikohet në tokë dhe qiell të cilat thirren dhe i përgjigjen thirrjes.

Ja, në këtë hapësirë është i pranishëm dielli, hëna, nata, dita, që të gjitha ato janë në garë të përhershme, megjithatë: “As dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata nuk mund ta kalojë ditën, por secila në hapësirë të caktuar lundron.” (Jâsîn, 40).

Vërtet kjo është një garë imponante e cila nuk përfundon me një natë apo një ditë.

Ja ku është edhe toka e cila herë është “e tharë” (e vdekur) e herë “e tharë” (e përlur). E kur i zbret “uji” gufon e gjallëron: “Ti e sheh tokën të tharë (të vdekur), e kur Ne ia lëshojmë ujin ajo gufon e gjallëron dhe nga të gjitha llojet mbijnë bimë të këndshme.” (Haxhixh, 4). “Nga argumentet (gjurmët) e Tij është edhe toka që ti e sheh të thatë (të përlur), e kur Ne ia lëshojmë ujin, ajo gufon e gjallëron.” (Fussilet, 39).

Kështu, në këtë mënyrë toka e thatë shndërrohet në qenie të gjallë, me anë të përkëdheljes brenda përbërjes së një fjalie.

Këtu është edhe xhehennemi grykës dhe i tërbuar, nga i cili nuk mund të ikë askush po as ta ngopë askushi. Xhehennemi i cili i thërret ata të cilët (në botën kalimtare) thirreshin në udhëzim kurse ata ia kthenin shpinën. Ata asaj thirrjeje përkundër thirrësve (në botën kalimtare) tash i përgjigjen: Xhehennemi i cili kur i sheh kriminelët nga larg tërbohët e “Ditën kur Ne xhehennemit i themi: A u mbushe? E ai thotë: A ka edhe më?” (Kâf, 30). “Kur t’i vërejtë ai (xhehennemi) prej një vendi të largët, ata do t’ia dëgjojnë vlimin dhe kërhamën.” (Furkân, 12). “Kur të hedhen në të do t’ia dëgjojnë ushëtimën nga ndezja e tij e këndellur.” (Mulk, 8). “Ajo është Ledh-dha (emër i flakës së xhehennemit). Heqëse e kapakëve

të kokës. Ajo thërret (e tërheq për koke) atë që ia ka kthyer shpinën dhe i është shmangur (besimit). Dhe që ka grumbulluar (pasuri) dhe e ka ruajtur (depozituar).” (Meârixh, 15).

Ja, kjo është hija te e cila strehohen kriminelët: “Dhe në hijen prej tymi të zi. As e freskët e as e këndshme!” (Vâkia, 43).

Po aty janë edhe erërat mbarësuese: “Ne i lëshojmë erërat mbarësuese.” (Hixhr, 22) të cilat mbarësojnë me anë të ujit që e bien. Këtë shprehje e madhështon mënyra e të shprehurit e cila ia dhuron një jetë gjallëruese që mbarëson e frytmon!

Ja, aty është edhe hidhërimi, frika apo myzhdeja. Aty shfaqen edhe nxitimi edhe matja, edhe ngutja edhe të ndalurit, edhe shkuarja edhe ardhja:

“E kur Musait i kaloi hidhërimi i mori pllakat.” (A’rafë, 154). “Pasi që Ibrahimit i kaloi frika dhe i erdhi myzhdeja, ai nisi dialog me Të dërguarit tanë rreth popullit të Lutit.” (Hûd, 74).

2 - Gjithashtu një ngjyrë prej ngjyrave të “përfytyrimit” shëmbëllen në ato figura të lëvizshme (aktive) me të cilat shprehet një gjendje prej gjendjeve ose domethënie prej domethënies. Figura e atij i cili adhuron me mëdyshje “Nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet me te, por nëse e godet ndonjë gjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vërtetë.” (Haxhixh, 11). Pastaj pamja e muslimanëve para se të bëhen muslimanë kur ata ishin: “Buzë greminës së xhehennemit.” (Âli Imrân, 103). Mandej figurën e atij i cili: “Ndërtesën e vet e themeloi buzë bregut të shembur e bashkë me të bie në zjarrin e xhehennemit.” (Tevbe, 109). Të gjitha këto janë figura të cilat i përfytyrohen ndjenjës si lëvizje e prituri për çdo çast. Kjo lëvizje plotësohet me figurën e fundit siç thamë edhe në kapitullin e “Ilustrimit artistik”.

Këtyre figuracioneve përfytyruese u ngjanë edhe përbirimi i litarit të trashë nëpër vrimë të gjilpërës. Momenti i shumëpritur i mosbesimtarëve për hyrjen e tyre në xhennet pas një jete të gjatë. Këtu përfytyrimi e vëzhgon shfaqjen e kësaj lëvizjeje të çuditshme e cila nuk përfundon po as nuk ndalet derisa atë e përcjell përfytyrimi!

Ndërsa pikturën të cilën e përfytyron ajeti: “Thuaj: Sikur deti të ishte ngjyrë (për të shkruar) fjalët e Zotit tim, do të shterej deti para se të mbarojnë fjalët e Zotit tim, e madje sikur të sillnim Ne si ndihmë edhe aq ngjyrë shkrimi.” (Kehf, 109).

Në këtë rast përfytyrimi mbetet duke e imagjinuar atë lëvizje: lëvizjen e ngjyrës prej ujit të detit për t’i shkruar fjalët e Allahut pa ndërprerje e pa fund. Vetëm atëherë kur përfundon deti duke u shterur!

Ngjashëm me këto figura është edhe ajo që ia përfytyron ndjenjës ky ajeti: “E kush shpëton prej zjarrit e futet në xhennet, ai ka arritur shpëtim.” (Âli Imrân, 185) dhe ajeti: “Po edhe sikur të jetojë aq, ajo (jetë e gjatë) nuk do ta shpëtojë prej dënimit”. (Bekare, 96). Vetë termi Zahzaha (në përkthim: shpëtim, shmangie) përmban në vete atë lëvizje të njohur, (kurse ky është art i veçantë për të cilin do të bëhet fjalë), e kjo lëvizje e përfytyron rastin buzë zjarrit të xhehennemit i ngërthyesëm për imagjinatën dhe shikimet!

3 - Ngjyrë prej ngjyrave të “përfytyrimit” shëmbëllet në lëvizjen përfytyruese të cilën e interpreton shpirti me disa shprehje, si për shembull: “E Ne i qasemi ndonjë veprë që e bënë ata dhe e bëjmë atë hi e pluhur.” (Furkân, 23). Në kapitullin e “Ilustrimit artistik” kemi bërë fjalë për pikturën e pluhurit të shpërndarë e cila është pikturë konkrete për shembjen e veprave. Kurse tani na

ngacmon fjala “fekadimna” (në përkthim: “ne i qasemi”) ngase ajo është e përfytyrueshme për ndjenjën. Fjala është për lëvizjen e qasjes e cila vjen para shpërndarjes së veprës si pluhur. Ky përfytyrim do të fshihej sikur të thuhej: “Ne e bëmë veprën e tyre pluhur të shpërndarë”, ngase do të veçohej lëvizja e shpërndarjes dhe piktura e pluhurit pa u shfaqur lëvizja e cila i përparëson: fjala pra është për lëvizjen e qasjes.

Ngjashëm me ajetin e parë e kemi edhe këtë ajet: “Thuaj: “A thua pos Allahut të adhurojmë çka nuk na sjell as dobi as dëm dhe të kthehemi prapa (në kufër).” (En’âm, 71). Komponentja “dhe të kthehemi prapa (në kufër)” përfytyron një lëvizje sensuale të renegimit në sferën e renegimit emocional e cila i jep pikturës një jetë konkrete (të ndishme).

Po në të njëjtin drejtim kemi edhe ajetin: “Mos shkoni hapave të djallit se ai është armik i hapët i juaji.” (Bekare, 168), në kontekstin: Mos iu nënshroni shejtanit, fjalët “tet-tebiu” dhe “hutuvat” (e para në përkthim ka kuptimin: “shkoni”, “ndjekni”, kurse e dyta “hapave”) përfytyrojnë një lëvizje të posaçme. Lëvizja e djallit duke hapëruar kurse njerëzit pas tij i ndjekin hapat e tij. Ky është një figuracion i cili kur të trupëzohet në këtë mënyrë, kur është fjala për njerëzit, duket shumë i çuditshëm sepse mes tyre dhe djallit të cilit i shkojnë pas, vigjilon ngjarja e cila e nxori babain e tyre (Ademin) nga xhenneti!

Gjithashtu kemi ajetin: “Dhe lexoju atyre tregimin e atij që i patëm dhënë dituritë Tona, ndërsa ai u zhvesh prej tyre dhe atë e shoqëroi djalli.” (A’rafë, 175), por me një ndryshim të vogël, sepse djalli këtë herë është ai që e ndjek këtë lajthitës dhe e shoqëron për t’ia humbur rrugën dhe bëhet “prej të humburve”.

Po të njëjtin jaz e trason edhe ajeti: “Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri.” (Isra, 36). Këtu lëvizja e qasjes i përshtatet intuitës dhe mund t’i shëmbëllejë përfytyrimi me trup e mësyerje, e jo thjesht vetëm me mend e me shpirt.

4 - Një ngjyrë prej ngjyrave të “përfytyrimit” shfaqet në ato lëvizje të shpejta dhe suksesive (të njëpasnjëshme) prej të cilave ekspozuam një shembull në kapitullin e mëparshëm. Fjalën e kemi pra për figuracionin e atij që i bën shirk (i përshkruan shok) Allahut: “Ai është sikur të bie nga qielli e ta rrëmbejë shpendi, ose si ai të cilin e gjuan era e stuhishme në ndonjë vend të humbur.” (Haxhah, 31).

Ngjashëm me te, sa i përket shpejtësisë dhe shumëllojshmërisë së spektakleve, është ajo lëvizje përfytyruese në fjalën e Të Madhërishmit: “Kush mendon se Allahu nuk do ta ndihmojë atë (Muhammedin) në këtë dhe në botën tjetër, ai le të ngjitet me ndonjë mjet në qiell e pastaj le ta këpusë, e le të shikojë se a po ia largon mjeshtria e tij atë që po e mllëfos.” (Haxhah, 15).

Ky vërtet është një pasqyrim i çuditshëm. Atij që bezdiset nga ndihma e Allahut që ia bën Pejgamberit të tij, i ngushtohet shpirti dhe i arrinë tërbimi në një pikë ku nuk mund të përmbahet, le të orvatet ta ndryshojë këtë gjendje sa të ketë fuqi, nëse nuk mund të bëjë durim dhe ta presë premtimin e Allahut për ndihmë. Le të ngjitet përmes një litari për të cilin kapet dhe ngjitet përpjetë për ta gjetur ndihmën, e nëse nuk e gjenë, atëherë le ta këpusë këtë litar të gjatë e pastaj le të shikojë: A e shpëtoi plani i tij për t’ia shuar mllëfin nëse ka mbetur diç nga ai, të shikojë pas këputjes së litarit të tij të gjatë dhe pas rrëzimit të cilin e vëzhgon përfytyrimi.

Në po të njëjtën vijë e kemi edhe një ajet, duke i përdorur dialogun dhe butësinë të cilat i përshtaten bashkëbiseduesit, e ai

është Pejgamberi alejhisselam i cili brengosej për refuzimet e mushrikëve (politeistëve) dhe shpresonte në mundësinë e udhëzimit të tyre në të vërtetën duke ua sjellur mrekullinë (muxhizen) të cilën e kërkonin: “Nëse refuzimi i tyre të është bërë brengë e madhe, ti kërko nëse ke mundësi ndonjë zgavër në tokë ose shkallë në qiell dhe sillju një mrekulli.” (En’am, 35).

5 - Edhe një ngjyrë e këtij “përfytyrimi” shfaqet në lëvizjen e përfituar e cila për nga struktura është pasive. Një ngjyrë të tillë e kemi në ajetin: “Dhe më është zbardhur koka nga thinjat.” (Merjem, 4).

Lëvizja e të zbardhurit këtu e përfytyron thinjën në kokë mu si lëvizja e ndezjes së zjarrit në bar të thatë, në të cilin ka gjallëri dhe art siç theksuam edhe më parë.

* * *

Gjithashtu edhe “trupëzimi” si element ilustrues; për të janë dhënë shembuj të shumtë në kapitullin e “Ilustrimit artistik”. Prej tyre, të gjitha ngjashmëritë që u sollën për t’i transformuar domethëniet dhe gjendjet në figura dhe forma. Si shembull do ta marrim ajetin: “Shembulli i veprave të atyre që nuk besuan është si hiri, të cilin me puih e shkapërderdh era në ndonjë ditë të stuhishme.” (Ibrahim, 18). Pastaj ajeti: “O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të kërkuar e me ofendim siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa për sy e faqe ndaj njerëzve, e nuk e beson Allahun dhe botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar që mbi te ka pak dhé.” (Bekare, 264). Edhe shembulli: “Shembulli i atyre që pasurinë e vet e japin nga bindja e tyre e duke kërkuar kënaqësinë e Allahut, i përngjanë një kopshti në një rrafshnaltë...” (Bekare, 265).

Po nga i njëjti lloj kemi edhe ajetin: “A nuk ke kuptuar se si Allahu bëri shembull; fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart (në qiell), e që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frutin e vet në çdo kohë. Allahu pra u parashtron njerëzve shembuj që ata të mendojnë. Dhe shembulli i fjalës së keqe si një pemë e keqe që është shkukur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar.” (Ibrahim, 24-26).

Ne me “trupëzimin” këtu nuk kemi për qëllim ngjashmërinë shqisore ngase ajo është e shpeshtë dhe e zakonshme, por kemi për qëllim një ngjyrë të re të tij - trupëzimin e sendeve jomateriale (pra atyre që janë abstrakte), dhe ate jo në mënyrë krahasuese dhe metaforike por në mënyrë transformuese dhe shndërruese.

1 - Kur’ani thotë: “Ditën kur çdo njeri e gjen të prezentuar atë që veproi mirë ose keq, e për atë të keqe që e bëri do të dëshirojë që ndërmjet tij dhe asaj të ekzistojë një distancë shumë e madhe.” (Âli Imrân, 30). “Dhe atë që e vepruan e gjejnë të pranishme.” (Kehf, 4). “Çfarëdo të mirë që e përgatitni për veten tuaj, atë e gjeni te Allahu.” (Bekare, 110). Kështu pra, Kur’ani këtë punë abstrakte e bën sikur të ishte materie konkrete. Ajo prezentohet në formë të trupëzuar ose në formë të personifikuar, apo gjendet te Allahu sikur të ishte amanet i cili dorëzohet këtu e pranohet atje.

Të ngjashme me këtë trupëzim janë edhe mëkatet që përshkruhen si barrë, (bartja në shpinë e konfirmon edhe më shumë trupëzimin): “E duke i bartur mëkatet e veta në shpinat e tyre.” (En’am, 31). “Askush nuk ngarkohet me barrën e tjetërkujt”. (En’am, 164).

Ekzistojnë edhe shembuj tjerë të trupëzimit të gjërave abstrakte:

“Përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria.” (Bekare, 197). Në këtë rast takvallëku (devotshmëria) përshkruhet si furnizim ose si ngjyrë e Allahut në ajetin: “Ngjyrë e Allahut, e kush ngjyros (me fe) më mirë se Allahu.” (Bekare, 138). Pra feja e Allahut është ngjyrë e dalluar (e shënuar). Ose ajeti: “O ju që besuat, hyni në shpëtim të gjithë.” (Bekare, 208). Këtu shpëtimi përshkruhet si send që mund të hyhet në te. Kurse në ajetin: “Lini të dukshmet e mëkateve dhe të brendshmet e tyre.” (En’am, 120). Mëkati përmban anën e tij të brendshme dhe të jashtme. Këto ishin disa por kemi edhe shumë ajete metaforike të këtij lloji.

2 - Kur’ani rrëfen edhe për një gjendje shpirtërore dhe sentimentale përmes figuracioneve të ngushtësisë, mërzisë dhe prekshmërisë të cilat i trupëzon si lëvizje fizike. “(Ai ua fali) edhe atyre të treve që patën munguar (në ushtri), kjo derisa toka u bë e ngushtë për ta përkundër gjerësisë së saj, kur u ngushtuan edhe shpirtrat e tyre saqë u bindën se nuk ka strehim prej Allahut (tjetërku) pos te Ai.” (Tevbe, 118). Toka u ngushtohet atyre, e në anën tjetër edhe shpirti u ngushtohet siç u ngushtohet toka. Është e pamundshme të ilustruhet ngushtësia e brendshme sentimentale, në këtë rast si ngushtësi konkrete më qartë dhe më bindshëm se ky ilustrim kur’anor, ose të trupëzohet gjendja e atyre që munguan në betejën me Pejgamberin. Ata e përjetuan këtë ngushtësi ngulfatëse dhe u penduan për mungesën e tyre me një pendim të rëndë dhe të prekshëm saqë nuk kishin shpresë për ndonjë strehim apo rrugëdalje e as që u qetësuan, pos atëherë kur Allahu e pranoi pendimin e tyre. [1]

I ngjashëm me këtë ajet është edhe ajeti: “Ti ua tërhiq atyre vërejtjen për Ditën e kijametit, kur zemrat do t’ju vijnë deri në fyt prej pikëllimit. Për zullumqarët nuk ka as mik e as ndërmjetës që i shkon fjala.” (Gâfir, 18). Këtu zemrat sikur ndahen nga vendi i tyre dhe me të vërtetë arrijnë deri në fyt nga pushtimi i madh.

Pastaj ajeti: “Përse pra, kur arrin shpirti në fyt. E ju në atë moment shikoni (se ç’po ngjet).” (Vâkia, 83-84). Këtu shpirti shfaqet si të jetë send i trupëzuar i cili arrinë në fyt përmes lëvizjes konkrete.

Pastaj ajeti: “Përpos atyre që strehohen te një popull me të cilin keni marrëveshje dhe përpos atyre që vijnë te ju, e u zihet gjoksi se a të luftojnë kundër jush ose kundër popullit të vet.” (Nisaë, 90). Gjokset e tyre u ngushtuan nga hutimi dhe tronditja mes asaj që t’i luftojnë muslimanët e t’i dalin në ndihmë popullit të vet, apo ta luftojnë popullin e vet e t’u dalin në ndihmë muslimanëve.

3 - Kur’ani e përshkruan gjendjen mentale ose shpirtërore. Fjala është për rastin e mosdobishmërisë nga fjalët të cilat i dëgjojnë disa njerëz kur u jepet udhëzimi. Ata bëhen sikur të mos kishin dëgjuar ose sikur nuk kanë kurrfarë lidhjeje me atë në të cilën udhëzohen. Ata Kur’ani i përshkruan sikur para vetes kanë barriera konkrete që i ndajnë ata me udhëzimin. Shembull: “Sepse ata janë të penguar edhe për të dëgjuar.” (Shuaraë, 212). “Po, Ne kemi krijuar mbulesë mbi zemrat e tyre që të mos e kuptojnë atë dhe në veshët e tyre sajuam shurdhim.” (En’am, 25). “Vallë a nuk duan ata ta studiojnë me vëmendje Kur’anin, apo zemrat e tyre kanë drynat e vet?!” (Muhammed, 24). “Ne u kemi varë në qafat e tyre pranga e ato u arrijnë deri në nofulla, andaj ata mbesin me kokat lart.” (Jâsîn, 8). “Ne kemi vënë edhe para tyre pendë edhe prapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin.” (Jâsîn, 9). “Allahu ua mbylli atyre zemrat, veshët dhe në të

pamurit e tyre ka perde.” (Bekare, 7). “Atyre që sytë i kishin të mbuluar me perde kundër këshillave të Mia.” (Kehf, 101).

Të gjitha këto ajete i trupëzojnë të gjitha këto barriera abstrakte dhe psikologjike dhe i shndërrojnë në barriera (pengesa) konkrete dhe materiale, ngase ato kështu të pikturuara në tablonë kur’anore janë më ndikuese, më impresionuese dhe më të qarta.

4 - Kur përshkrimi është konkret përnga natyra e tij, atëherë Kur’ani veçon nga përshkrimi një formë të cilën e trupëzon, siç është rasti me ajetin: “Ditën kur ata i kaplon dënimi mbi ta dhe nën këmbët e tyre.” (Ankebût, 55). Në një vend që do t’u vie dënimi nga çdo anë ose do t’i rrethojë. Kjo, sepse forma e kaplimit nga lart dhe nga poshtë në përshkrim, në ndjenjë trajtohet si rrethim. Ashtu e kemi edhe ajetin: “Kur ata ju erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshtmi.” (Ahzâb, 10). Gjithashtu ajetin: “Sikur ata ta zbatonin Tevratin, Inxhilin dhe atë që u është shpallur prej Zotit të tyre (Kur’anin), ata do të kishin furnizim me bollëk prej lart dhe prej nën këmbëve të tyre.” (Mâide, 66). Të po të njëjtit lloj e kemi edhe ajetin: “Fytyrat e tyre po sikur t’i kishte mbuluar ndonjë pjesë e errët e natës.” (Jûnus, 27). Kjo errësirë e cila i kaploi fytyrat e tyre nuk është kolorit e as ngjyrë por pjesë e natës së errët me të cilën u mbuluan fytyrat e tyre!

5 - Prej llojeve të “trupëzimit” e kemi edhe përshkrimin e abstraktes në mënyrë konkrete: Si përshkrimi i torturës (dënimit) me vrazhdësinë. “Dhe pas saj (vdekjes) ka dënim të vrazhdë”, (Ibrahim, 17). Pastaj përshkrimi i ditës, se ajo është e rëndë: “E, e lënë pas (e lënë asgjë) ditën e rëndë që i pret.” (Insân, 27).

Përmes këtij figuracioni tortura nga kuptimi i saj abstrakt shndërrohet në një send që është i vrazhtë e i ashpër, kurse dita

shndërrohet prej kohës e cila nuk kapet, në një send të rëndë dhe me peshë!

6 - Pastaj sjellja e shembujve të gjërave abstrakte me anë të atyre konkrete, siç është ajeti: “Allahu nuk krijoi dy zemra në gjoksin e asnjë njeriu.” (Ahzâb, 4). Këtë e thotë për ta bërë të qartë se zemra e njeriut nuk ka vend për dy orientime! Dhe si fjala e Zotit: “Mos u bëni (në thyerjen e kontratave) si ajo (grua) që e prish tjerin e saj pasi të jetë dredhur fort e të mbetet i shprishur.” (Nahl, 92). Këtë e thekson për ta proklamuar marrinë e prishjes së marrëveshjes pas kontratës. Pastaj ajeti: “Dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur.” (Huxhurât, 12). Këtë e citon për ta shpallur si mëkat të madh, sepse ai është sikur ta “hajë mishin e vëllait të vet të vdekur”.

7 - Meqë trupëzimi është plan i përgjithshëm i Kur’anit, llogarinë në ahiret e ilustron sikur të ishte peshojë e materializuar për të mirat dhe të këqijat: “Në Ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të sakta.” (Enbija, 47). “Ai që e ka të rëndë (veprën) në peshojë... E ai që e ka të lehtë (veprën) në peshojë.” (Kâria, 6-8). “Edhe nëse është (vepra) sa pesha e një kokrrë të melit Ne do ta sjellim atë.” (Enbija, 47). “Dhe nuk u bëhet padrejtësi asnjë fije.” (Nisaë, 49). “Dhe nuk u bëhet dëm asnjë thërrmi.” (Nisaë, 124). Të gjitha këto ajete shfaqen në pajtim me trupëzimin e peshojës.

* * *

Shpeshherë ndodh që “përfytyrimi” dhe “trupëzimi” të bashkohen në të njëjtin shembull të Kur’anit. Ai e ilustron shpirtëroren abstrakte si trup konkret. Atij trupi ia përfytyron një lëvizje ose ia përfytyron rreth tij përmes rrezeve të shprehjes. Ne edhe nga shembujt e kaluar kemi modele të tilla, por do ta shfaqim

këtë dukuri përmes shembujve të rinj. Ne kemi shembuj të mjaftueshëm në Kur'an për çdo pikëpamje artistike!

1 - Prej tyre: “Përkundrazi, Ne me të vërtetën (hakun) e hedhim gënjeshtren (batilin), dhe (e vërteta) e shkatërron atë ndërsa ajo (gënjeshtria) bëhet e zhdukur.” (Enbija, 18). “Dhe në zemrat e tyre hodhi frikën.” (Hashr, 2). “Ne ndërmjet tyre hodhëm armiqësi e urrejtje (që do të vazhdojë) deri në Ditën e kijametit.” (Mâide, 64). “Pastaj Allahu zbriti qetësinë e Vet në Të dërguarin e Tij dhe në besimtarët.” (Tevbe, 26). “Shtriju atyre (prindërve) krahun, përlulës të mëshirës.” (Isra, 24)...

Këtu haku përshkruhet sikur të ishte predhë djegëse e cila e qëllon batilin dhe e zhdukë. Pastaj llahtaria (frika) sikur të ishte predhë e shpejtë e cila përbirohet në zemër nga shpejtësia e saj, kurse armiqësia dhe urrejtja sikur të ishin materie e rëndë e cila hedhet mes tyre dhe mbetet deri në Ditën e kijametit. Ndërsa qetësia sikur të ishte materie përforcuese e cila i zbret Pejgamberit dhe besimtarëve. Pastaj përlulja sikur të kishte krahë që shtrihen nga mëshira që e ka njeriu ndaj prindërve.

Në të gjithë këta shembuj bashkohet trupëzimi - me shndërrimin e abstraktes në trup - me përfytyrimin, me anë të lëvizjes së detyrueshme të këtij trupi.

2 - Prej tyre gjithashtu: “Po, (do ta përfshijë zjarri) atë që bën keq dhe që e vërshojnë gabimet e tij.” (Bekare, 81). Pastaj ajeti: “Ja ata mu në sprovë kanë rënë.” (Tevbe, 49). Pasi të bëhet gabimi send material, fillon të aktivizohet dhe merr fuqinë e vërshimit. Dhe pasi që të bëhet sprova det i thellë, marrin hovin për të rënë në të.

3 - Prej tyre kemi edhe ajetet: “E mos e mvishni të vërtetën me të pavërtetë.” (Bekare, 42). “Shpërthe (lajmin, publiko) me atë për të cilën urdhërohesh.” (Hixhr, 94). Në shembullin e parë e vërteta dhe e pavërteta shndërrohen në dy matere që mbulohen njëra me tjetrën. Ndërsa në shembullin e dytë, ai (da’veti) për të cilin urdhërohet I dërguari shndërrohet në materie me të cilin mund të përbirohet dhe shpërthen si dëshmi për fuqi dhe zbatim.

4 - Po ashtu edhe ajetet: “Allahu është mbikëqyrës i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirës në dritë, e kujdestarë të atyre që nuk besuan janë djajtë që i nxjerrin ata prej drite e i hedhin në errësirë.” (Bekare, 257). “Ai që e mohon gënjeshtren dhe i beson Allahut, ai është i kapur për litarin më të fortë i cili nuk ka këputje.” (2 Bekare, 256). Në shembullin e parë shndërrohen udhëzimi dhe humbja në dritë dhe errësirë, pastaj fillon aksioni i nxjerrjes përfytyruese. Ndërsa në shembullin e dytë imani shndërrohet në litar. Pastaj fillon aksioni përfytyrues me kapjen e tij. Ky figuracion i trupëzuar dhe aktiv e sjell në shprehje kuptimin më të qartë dhe më të thukët për domethënien përfytyruese abstrakte.

* * *

Me anë të kësaj metodologjie favorizuese për shfaqjen e domethënies abstrakte përmes binarëve të saj u zhvillua metodika kur’anore, derisa edhe në çështjet më të ndieshme dhe më delikate të cilat kërkojnë zhveshje (abstraktizim) absolute dhe pastrim të plotë (nga çdo e metë), siç është rasti me ajetet: “Dora e Allahut është mbi duart e tyre.” (Fet’h, 10). “Arshi (froni) i Tij kishte qenë mbi ujë.” (Hûd, 7). “Kursija (vendqëndrimi) e Tij përfshin qiejt dhe tokën.” (Bekare, 255). “Pastaj qëndroi mbi Arshin.” (A’rafë, 54). “Pastaj ia mësyu qiellit (për ta krijuar) e ai ishte tym (gjendje mjegullire që ishte si materia e parë).” (Fussilet, 11). “Në Ditën e

kijametit e tërë toka është në grushtin e Tij, e qiejt të mbështjellë në të djathtën e Tij.” (Zumer, 67). “Ti nuk i gjuajte kur gjuajte, por Allahu i gjuajti.” (Enfâl, 17). “Allahu shtrëngon dhe çliron.” (Bekare, 245). “Dhe kur të vijë Zoti yt dhe engjëjt qëndrojnë radhë-radhë!” (Fexhr, 22). “Çifutët thonë: Dora e Allahut është e shtrënguar! Të shtrënguara janë duart e tyre, dhe janë mallkuar për atë që thanë. Jo, duart e Tij janë të lira.” (Mâide, 64). “O Isa, Unë po të marr ty dhe po të ngris tek Unë.” (Âli Imrân, 55).

Rreth këtyre fjalëve (ajeteve) u nxit dhe u ngjall një polemikë e rreptë, atëherë kur polemika u shndërrua në mjeshtri kurse fjala në mjet zbukurues të saj. Ato fjalë ishin rrjedhojë e një simetrie të shfaqur në shprehje e cila synon t’i sqarojë domethëniet abstrakte dhe t’i konfirmojë ato. Rrjedha e tyre shfaqet sipas një rregulle kontinuitive në të cilën nuk ka zbrazëtira e as devijime. Ky pra është parimi i përfytyrimit konkret dhe trupëzimit në çdo hapësirë prej hapësirave të ilustrimit.

Trasimi i vëmendshëm i këtij parimi, posaçërisht në këtë hapësirë, jep dëshmi të prera - siç edhe kemi thënë - se kjo metodologji në Kur’an është themelore për ilustrimin, ashtu siç edhe “ilustrimi është bazë kryesore në shprehjen kur’anore”.

Harmonizimi artistik

Kur themi: Ilustrimi është baza kryesore e shprehjes kur'anore ndërsa përfytyrimi dhe trupëzimi janë dy fenomene të dalluara të ilustrimit, nuk ia kemi arritur qëllimit për shpjegimin e veçorive kur'anore përgjithësisht, e as të veçorive të ilustrimit kur'anor veçanërisht, sepse pas gjithë kësaj ekzistojnë horizonte tjera në të cilat ka gjurmë simetria kur'anore, që përmes saj të bëhet orientimi i drejtë në aspektin e rolit artistik. Aty bëhet një harmonizim i cili arrinë piedestalin në ilustrimin e Kur'anit.

Harmonizimi këtu ka ngjyra dhe shkallë. Disa studiues të retorikës kur'anore kanë cekur disa nga këto ngjyra, e disa të tjera kanë mbetur të paprekura nga askush deri më sot.

1 - Nga ato që janë cekur, është harmonizimi i akordimit të shprehjeve përmes zgjedhjes së fjalëve. Pastaj renditja e tyre në një simetri të veçantë e cila sipas retorikës arrinë shkallën më të lartë. Këta studiues për këtë lloj kanë bërë fjalë shumë dhe e kanë arritur qëllimin final, bile e tejkaluan realitetin duke ia ngarkuar kësaj ngjyre edhe ato që nuk i përkasin asaj!

2 - Prej ngjyrave të tilla është edhe ritmi muzikor që formohet nga zgjedhja e fjalëve dhe renditja e tyre sipas një simetrie të veçantë. Edhe pse kjo dukuri është shumë e qartë në Kur'an dhe e struktur thellë në konstruksionin e tij artistik, diskutimi i tyre rreth saj nuk e kapërceu këtë ritëm të jashtëm, e as që u ngrit në atë shkallë që t'i arrijë shumëllojshmëritë e versioneve muzikore, pastaj harmonizimin e gjithë kësaj me ambientin që e dhuron ky muzikalitet dhe funksionin që e luan në çdo kontekst kur'anor.

3 - Prej ngjyrave të tilla gjithashtu janë ato fenomene retorike të cilat i vërejtën shumë dijetarë, siç është rasti me përputhshmërinë e fundit të ajetit me kontekstin e tij. Një shembull të tillë e kemi në këtë komponentë: “Dhe Ai (Allahu) është i plotfuqishëm për çdo gjë”, (Bekare, 20), pas fjalës e cila vërteton fuqinë e Tij. Pastaj komponentja: “Allahu e di shumë mirë se çka mbajnë zemrat e tyre.” (Ali Imrân, 119) pas fjalëve të cilat flasin për çështjet misterioze (të fshehta)... Ose të shprehet me përemrin lidhor që të jetë fjalia lidhore si dëshmi për shkakun e dënimit. Shembull: “Nuk ka dyshim se ata që i përgënjeshtroan argumentet Tona dhe nga mendjemadhësia u larguan prej tyre, atyre nuk u hapen dyert e qiellit dhe nuk do të hyjnë në xhennet derisa të përbirohet deveja nëpër vrimë të gjilpërës”. (A’râfë, 40)... Ose të shprehet me termin “rabb” (në përkthim: “Zot”) në sferat e “terbijes” (në përkthim: “edukatës”) dhe arsimimit. Si për shembull: “Lexo me emrin e Zotit tënd i cili krijoi. Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo se Zoti yt është më bujar! Ai që e mësoi njeriun të shkruajë me penë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte.” (Alek, 1-5). Kurse shprehet me termin “All-llah” në sferat e hyjnizimit dhe madhërimit. Shembull: “Ska dyshim se vetëm Allahu e di se kur do të ndodhë kijameti, Ai e di kur e lëshon shiun, Ai e di se ç’ka në mitra (të nënave).” (Lukmân, 34)... Ose e shfaq emrin e të Madhërishmit ose e sjell si përemër vetor për një synim që e kërkon lidhmëria e fjalisë. Si për shembull ta sjell para ose prapa, të jetë në lidhje ose e ndarë, ta shfaqë të plotë ose ta fsheh, ta sjell në formën pyetëse ose konfirmuese (përforcuese), e shumë e shumë sfera të studimit të njohur retorik. Disa prej tyre e konsiderojnë këtë dukuri si dukurinë më të lartë retorike në shprehjen kur’anore!

4 - Gjithashtu prej ngjyrave të tilla është edhe ai episodim intuitiv ndërmjet qëllimeve në kontekstin e ajeteve dhe përshtatshmëria e transferimit prej një qëllimi në qëllimin tjetër.

Disa të tjerë e ndërlikojnë këtë harmoni fjalësh me një ndërlikim të panevojshëm saqë kalojnë në artificializëm, shpjegime këto për të cilat Kur’ani aspak nuk ka nevojë.

5 - Sipas të gjitha gjasave, prej llojit më të lartë të harmonizimit që e kanë vërejtur, është harmonizimi shpirtëror mes hapave të shkallëzuar në disa tekste kur’anore dhe hapave shpirtërorë që e shoqërojnë atë siç është rasti me shembullin që e morëm nga Zemahsheri për suren Fâtiha në kapitullin “Si është kuptuar Kur’ani”.

Ndonëse veçoritë të cilat i cekën janë të vërteta dhe të çmueshme, megjithatë ato sapo ishin dukuritë e para të harmonizimit me të cilat ndeshet studiuesi në Kur’an. Pas tyre ka horizonte studimesh që fare nuk janë hulumtuar pos dukurisë së ritmit muzikor e cila është njëra prej këtyre sferave madhështore. Por ata, siç thashë edhe më parë, u ndalën vetëm në dukuritë e saj të jashtme.

Meqenëse ilustrimi në Kur’an është çështje të cilës aspak nuk iu rrekën studiuesit e tij me formën e tij si bazë e shprehjes kur’anore përgjithësisht, atëherë edhe harmonizimi artistik në këtë “ilustrim” natyrisht se mbeti larg sferave të hulumtimit të tyre.

Pra, qëllimi ynë me këtë libër është që t’i ekspozojmë këto hapësira të reja, e jo edhe t’i përsërisim pikëpamjet prej të cilave u inspiruan studiuesit e mëparshëm. Ne do t’i lëmë shqyrtimet e këtyre pikëpamjeve - edhe pse jemi të bindur se gjithçka që është shkruar në to mund të prezantohet në petk të ri - që të arrijmë hapa kolosalë pas hapit të fundit të cili stagnuan të parët.

Në këtë kontekst, ne do të mjaftojmë me vënien në spikamë të modelit të cilin e prezentuam kur bëmë fjalë për harmonizimin e

brendshëm mes domethënies dhe synimeve në suren Alek, si sure e parë në kapitullin “Burimi i magjepsjes në Kur’an”. Pra, ky model është pasqyrë mbi atë se si do të shtrihet ky studim i ri në këtë varg mendimesh dhe në këtë harmonizim shpirtëror e emocional mes konteksteve të Kur’anit.

Mandej do të sinjalizojmë sipërfaqësisht në harmonizimin intuitiv dhe shpirtëror mes rrëfimeve të cilat i shfaq Kur’ani, kontekstit në të cilin i shfaq ato dhe harmonizimin e paraqitjes së tyre në këtë kontekst krahas qëllimit fetar dhe fenomenit artistik në mënyrë paralele. (Shembulli për këtë ngjyrë të harmonizimit do të prezantohet në kapitullin: “Rrëfimi në Kur’an”). Shembulli i rrëfimeve të cilat vijnë në këtë ngjyrë të harmonizimit paraqitet në të gjitha shfaqjet e skenave të kijametit, spektakleve të kënaqësisë dhe ndëshkimit dhe atyre të cilat simetrizohen në shfaqje polemike. Ai shfaqet në përputhshmëri me mesin në të cilin paraqitet duke e ushtruar qëllimin intern të cilin e synon.

* * *

Megjithatë e gjithë kjo përfundon me harmonizimin e domethënies dhe qëllimeve, ndërsa studimi në këtë kontekst sado që të jetë preciz dhe kulminativ, ai përsëri mbetet i izoluar nga metoda më e bukur dhe më e ndriçuar e Kur’anit në të shprehur, e ai është ilustrimi.

Meqë kemi të bëjmë me një transferim mjaft distanciv, dhe nëse dëshirojmë që nga këto hapësira të shtrira të ngjitemi në ato maje të larta, ne do të zgjedhim mënyrën e arritjes në piedestale hap pas hapi derisa të ngjitemi në majën më të lartë.

1 - Aty kemi të bëjmë me pozita në të cilat shprehja harmonizohet me rastin e synuar për ilustrim, ashtu që ajo

ndihmon në plotësimin e tipareve karakteristike të pikturës konkrete apo abstrakte. Këtu bëhet fjalë për një hap të përbashkët mes shprehjes kur shpreh diçka dhe shprehjes kur ilustron diçka. Këtu pra edhe është dallimi i shtigjeve mes hapësirave të shtrira dhe majave të shkallëzuara.

Si shembull po e sjellim këtë ajet: “Krijesat (gjallesat) më të dëmshme te Allahu janë ato të shurdhëtat (që nuk dëgjojnë të vërtetën), memecet (që nuk e thonë të drejtën), të cilat nuk logjikojnë.”(Enfâl,22). Fjala “devâbb” (në përkthim: “gjallesat”, “sisorët”) zakonisht u referohet shtazëve - edhe pse në familjen e tyre bën pjesë edhe njeriu si gjallesë dykëmbëshe - por përfshirja e njeriut në këtë fjalë nuk e ka këtë qëllim, por atë që është e zakonshme gjatë përdorimit. Zgjedhja e fjalës “devâbb” këtu, pastaj trupëzimi i gjendjes e cila i pengon që të kenë dobi nga udhëzimi me përshkrimin e tyre “të shurdhët e memecë”, që të dyja e plothësojnë pikturën e pakujdesisë dhe shtazarisë të cilën dëshiron t’ua pikturojë Kur’ani atyre që nuk besojnë ngase “nuk logjikojnë”.

Po i të njëjtut drejtim është edhe ajeti: “Ata që nuk besuan përrjetojnë kënaqësi (në këtë botë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, vendbanim i tyre është zjarri.” (Muhammed, 12). Me anë të kësaj ngjashmërie ua ilustron atyre këtë pikturë subtile: Ata hanë dhe kënaqen të painteresuar ndaj qëllimit të ekzistencës njerëzore, të painteresuar ndaj ndëshkimit i cili i pret ata, mu ashtu si hanë kafshët dhe argëtohen të painteresuara ndaj thikës së mishtherësit ose të painteresuara ndaj çdo gjëje pos hajes dhe pijes.

Si shembull kemi edhe ajetin: “Gratë tuaja janë arat tuaja, afrohuni arave tuaja si të doni.” (Bekare, 224). Në këtë shprehje gjejmë disa ngjyra të harmonizimit të dukshëm dhe të padukshëm përmes bukurisë metonimike dhe përputhshmërive të përpikta.

Gjëja më e përpiktë në këtë rast është ngjashmëria mes relacionit të bujkut me arën e tij dhe relacionit të bashkëshortit me bashkëshorten e tij në këtë lëmi të posaçme dhe mes atij fryti që e nxjerr ara dhe atij fryti që e nxjerr bashkëshortja; dhe ajo që rezulton prej tyre me anë të shumimit, ndërtimit dhe përparimit. Të gjitha këto piktura, siç shihet, shtrihen nën këtë metaforë dhe atë me pak fjalë.

2 - Ndonjëherë veçohet një fjalë - e jo edhe një shprehje e tërë - duke vizatuar një pikturë personifikuese, por jo edhe vetëm duke i ndihmuar për t'i plotësuar vijat e një pikturë. Ky është një hap tjetër në harmonizimin e ilustrimit i cili shkon më larg se hapi i parë dhe është më afër majës së re në harmonizim. Këtij hapi i shtohet vlera ngase vetëm një fjalë përshkruan dhe vizaton tërë pikturën. Herë me tingullin e saj i cili tingëllon në vesh, herë me hijen e saj e cila bie në imagjinatë e herë me tonin dhe hijen së bashku. Veshi dëgjon fjalën: “Ith-thâkaltum” (në përkthim: “u rënduat si të ishit të gozhduar”) në ajetin: “O ju që besuat, ç’është me ju që kur u thuhet: “Dilni në (luftë) rrugën e Allahut, ju u rënduat në vend (si të ishit të gozhduar)?” (Tevbe, 38). Imagjinata e përfytyron këtë trup tepër të rënduar të cilin mundohen disa ta ngrejne dhe nga pesha e madhe e tij u bie prej duarve. Kjo fjalë përmban në vete peshë së paku prej “disa tonësh”! E sikur të thuhej: “tethâkaltum” (në përkthim: “u bëtë si të rënduar”) pesha do të dukej më e lehtë dhe do të humbte ndikimi i synuar nga ajo dhe do të fshihej ajo pikturë e kërkuar të cilën e vizatoi kjo fjalë dhe u dallua me vizatimin e saj.

Kur e lexojmë ajetin: “Me të vërtetë nga ju ka që zvarriten (nuk dalin në luftë).” (Nisaë, 72), vizatohet piktura e zvarritjes në tingullin e tërë shprehjes dhe në tingullin e fjalës: “lejubat-tien-ne” (në përkthim: “që zvarritet”) veçanërisht. Aty gjuha mund të

ngatërrohet nga zënia e saj në atë zvarritje derisa të arrijë ngadalë deri në fund të fjalës!

E kur e lexojmë rrëfimin e thënies së Hûdit: “Më thuani nëse unë jam i mbështetur në argument të qartë nga Zoti im dhe Ai më dha mëshirë nga ana e Tij, e juve u është verbuar ai (argumenti), a mund t’ua imponojmë atë, kur ju e urreni.” (Hûd, 28). Aty ndiejmë se fjala “e nulzimukumuha” (në përkthim: “a mund t’ua imponojmë atë”) përfytyron ambientin e imponimit përmes bashkimit të të gjithë këtyre përemrave vetorë (pronomenët) në një shprehje, (fjala është për tekstin në gjuhën arabe sh.p.), dhe afrimin e tyre njërin ndaj tjetrit ashtu siç ndeshen urrejtësit me atë që e urrejnë dhe tërhiqen nga ajo e ata mundohen t’i ikin!

Kështu, kjo ngjyrë e harmonizimit shfaqet më e fortë se retorika sipërfaqësore dhe më e lidhur se letrarishtja e fjalës ku (retorikën dhe letërsinë) disa studiues të Kur’anit në të kaluarën dhe tani i llogarisin si veçori më të mëdha të Kur’anit.

Ne e dëgjojmë edhe fjalën “jestarihûn” (në përkthim: “do të klithin”) në ajetin: “Po, për ata që nuk besuan është zjarri i xhehennemit. Ata as nuk gjykohen që të vdesin (të rehatohen) e as nuk u lehtësohet ndëshkimi. Kështu e ndëshkojmë secilin që është shumë i pabesim. Dhe ata do të klithin aty: “O Zoti ynë, nxirrna e të bëjmë vepra të mira e jo si ato që i bënim!” (Fâtir, 36-37). Këtu na përfytyrohet klithja e tyre e ashpër. Ashpërsia e klithjes së grithur dhe të përplasur në çdo anë e cila del nga fyta të ngjeshur me zëra të vrazhdë. Po ashtu ne do ta vërejmë hijen e pakujdesisë ndaj kësaj klithjeje për të cilën s’ka kush të interesohet dhe kush t’i përgjigjet. Prapa gjithë kësaj do ta perceptojmë skenën e atij ndëshkimi të ashpër të cilët të zhytur në të klithin.

Atëherë kur një fjalë veçohet me gjithë këto piktura, pa dyshim ky është art i një harmonizimi shumë të lartë.

Ngjashëm me te është edhe fjala: “utul-lin” (në përkthim: “shumë i vrazhdë”) e cila është në funksion të përfaqësimit të vrazhdësisë së thatë dhe ekstravagante: “Që është shumë i vrazhdë, më në fund edhe kopil (nuk i dihet babai).” (Kalem, 13).

E kur e dëgjon ajetin: “Por edhe sikur të jetojë aq, ai nuk do të jetë tundës prej dënimit.” (Bekare, 96). Fjala “bi muzahzihihi” (në përkthim: “tundës”) - e cila në këtë kontekst shfaqet si subjekt (në aspektin gramatikor sh.p.) për t’u veçuar - shfaqet që ta ilustrojë pikturën e tundjes së njohur, të plotë e të lëvizshme përmes kësaj fjale të vetme.

Gjithashtu thënia kur’anore në ajetin: “E ata (idhujt) dhe adhuresit e tyre, do të shemben në te. Dhe e gjithë ushtria e djallit.” (Shuarâe, 94-95). Fjala “kubkibu” (në përkthim: “do të shemben”) shfaq tingëllimën e saj përmes zërit me të cilin plotësohet lëvizja.

Pa dyshim pozita e këtyre dy fjalëve në aspektin gjuhësor ua dhuron këto dy piktura, që në realitet nuk janë të përdorura në mënyrë të posaçme në Kur’an, siç është rasti me termet e mëparshme të cilat i nxori për ndonjë qëllim të veçantë ose i përdorë në atë strukturë fjalësh për herë të parë. Megjithatë, zgjedhja e tyre dhe vendosja në ato pozita pa dyshim trajtohet si retorikë e shprehjes.

Prej sinonimeve të cilat i nxori Kur’ani për Ditën e ringjalljes janë edhe sinonimet: “Es-sâhha” dhe “Et-tâmme”. “Es-saahha” është një fjalë që sipas veprimi të saj mund edhe ta shkyejë kanalin e veshit nga fuqia e saj, vrazhdësia e tingëllimit të saj dhe ta çajë

dendësinë e ajrit ashtu që kur të arrijë në vesh arrin e krrokatur dhe e vardisur. Ndërsa “Et-taamme” është një fjalë e cila përmban oshëtimë dhe fringëllimë, të duket se gjithçka vërshon dhe përfshinë, mu si rrëmeti (tufani) i cili vërshon dhe përmbysë çdo gjë.

Vendosi këto fjalë pranë kësaj fjale të shkëlqyer dhe romantike “teneffes” në ajetin: “Pasha agimin kur frymon,” (Tekvîr, 18), do ta shohish mrekullinë e zgjedhjes së fjalëve në hapësirat e tyre dhe ngritjen e këtyre fjalëve me vizatimin e këtyre pikturave në shumëllojshmërinë e tyre.

Gjithashtu të shprehurit e gjumit përmes dremitjes dhe thellësisë së gjumit përmes kotjes: “Dhe kur Ai ju kaploi me një kotje (gjum) siguri prej Tij.” (Enfâl, 11). Aty do ta shohësh ambientin e kotjes së lehtë e të qetë sikur të ishte mbulesë e ndonjë pëlhure të tejdukshme e cila i mbulon lehtë dhe përkëdhelshëm shqisat: “Siguri prej Tij”. Këtu ambienti është përplot siguri, qetësi e rehati.

Edhe një lloj tjetër i ilustrimit të fjalëve me tonin e tyre shfaqet në suren En-nâs: “Thuaj: Mbrohem me Zotin e njerëzve! Sunduesin e njerëzve, të Adhuruarin e njerëzve, prej sherrit të atij që sjell vesvese dhe fshihet (tërhiqet kur përmendet emri i Zotit), i cili sjell vesvese në gjokset (mendjet) e njerëzve, qoftë ai nga xhinët apo nga njerëzit.” (En-Nâs, 1-6). Nëse e lexoni suren me kujdes dhe vëmendje, do ta ndieni se si zëri juaj do të dalë i vesvesur (i cytur) duke iu përshtatur ambientit të sures. Ambientin e vesveses së “atij që sjell vesvese dhe fshihet (tërhiqet kur përmendet emri i Zotit), i cili sjell vesvese në mendjet e njerëzve, qoftë ai nga xhinët apo nga njerëzit”.

Ngjashëm me këtë shembull por me disa ndryshime e kemi fjalën e Të Madhërishmit: “Sa e madhe është ajo fjalë që del nga goja e tyre e ata nuk thonë tjetër vetëm se gënjeshtër.” (Kehf, 5). Këtu kërkohet të kritikohet ashpër thënia e tyre - se Allahu ka marrë për Vete fëmijë - dhe të shpallet mëkat i madh kjo shpifje në çdo mënyrë, andaj edhe tha: “Keburet” (në përkthim: “sa e madhe është”). Subjektin (në tekstin origjinal sh.p.) e shndërroi në përemër vetor të pacekur, pastaj të njëjtën fjalë e bëri specifike në trajtë të pashquar që kjo mënyrë e moscekjes së përemrit vetor dhe ardhja në trajtë të pashquar të marrë kuptim të demantimit dhe kritikës së ashpër: “Sa e madhe është ajo fjalë”, pastaj e bën të dalë nga goja e tyre, një dalje që sikur të ishte shigjetë e gjuajtur pa shigjetar “që del nga goja e tyre”. Si vazhdimësi e kësaj atmosfere të demantimit dhe kritikës vjen edhe fjala “efvâhihim” (në përkthim: “goja e tyre”). Për ta shqiptuar këtë fjalë (të tekstit origjinal sh.p.) ne kemi nevojë ta hapim gojën për shkak të “vavit” me zgjatje dhe t’i shqiptojmë dy “heja” të njëpasnjëshme prej fytit, rëndë dhe me vështirësi para se t’i afrojmë buzët për ta shqiptuar “mimin” në fund të fjalës!

Në disa raste kemi një lloj fjalësh të cilat e përshkruajnë figurën e temës jo me tingullin e saj që e përçon në vesh por me hijen e saj që e përçon në imagjinatë. Edhe fjalët ashtu si edhe shprehjet e tëra, kanë hije të veçanta të cilat i ndien instinkti i fuqishëm kur ato ia tërheqin vëmendjen dhe kur paraqiten me një figuracion që e posedon karakterin sensibil.

Si shembull kemi ajetin: “Dhe lexoju atyre tregimin e atij që i patëm dhënë dituritë Tona, ndërsa ai u zhvesh prej tyre.” (A’rafë, 175). Hija të cilën e hedh fjala “insaleha” (në përkthim: “u zhvesh”) pasqyron një pikturë të fuqishme të rrjepjes përmes këtyre ajeteve, sepse zhveshja është një lëvizje e fuqishme sensible.

Pastaj ajeti: “Dhe (Musai) u zgjua i frikësuar në qytet e duke vëzhguar (se çka po i ndodhë).” (Kasas, 18). Fjala “jeterekkabu” (në përkthim: “duke vëzhguar”) përshkruan pozitën e vëzhguesit fort të kujdesshëm. (Të mos harrojmë në këtë rast, se ai është i frikësuar dhe duke vëzhguar në qytet, si rëndom qyteti është vend i sigurisë dhe qetësisë. Edhe pse kjo është sinonim për tërë shprehjen, po kjo shprehje e veçantë këtu zbulon rëndësinë e fjalës ilustrative për trembjen në vendin e sigurisë!)

Po të njëjtës rrugë shkojnë edhe shembujt të cilët i prezentuam në kapitullin “Përfytyrimi konkret dhe trupëzimi” për “përfytyrimin”. Hijet të cilat i hedhin shprehjet atje janë të të njëjtës formë.

Ndonjëherë në fjali inkuadrohen edhe tingulli edhe hija, si për shembull: “Ditën kur me rrëmbim shtyhen në zjarrin e xhehennemit.” (Tûr, 13). Fjala “de’a” (në përkthim: “shtyhen me rrëmbim”) në ilustrimin e saj përmban edhe tingullin edhe hijen. Këtu fjala “de’a” ka kuptimin e shtyrjes së fuqishme pas shpine. Kjo shtyrje në shumë raste e bën të shtyrin të nxjerrë një zë të paparamenduar përmes “ajnit” të pavokalizuar (ajnun sakine) në këtë mënyrë “aa”. E ky, sipas tingullit të tij, është shumë afër tingullit të fjalës “de’a”!

Gjithashtu e kemi edhe ajetin: “Rrëmbene e grahne në mes të xhehennemit.” (Duhân, 47). Termi “atlu” (në përkthim: “grahje”) posedon tingëllimë në vesh dhe hije në imagjinatë, të cilat e shpiejnë veprimin e tyre në sens dhe intuitë.

Këtij kapitulli mund t’i shtojmë edhe disa “fjalë” nga ato të cilat i cekëm më parë e të cilat kanë tingullin e tyre si fjala “nuas” (në përkthim: “dremetje”, “kotje”), “teneffes” (në përkthim: “frymon”) dhe “et-taamme” (në përkthim: “oshëtimë”),

“fringëllimë”). Edhe ato gjithashtu krahas tingullit posedojnë edhe hije. Të bësh dallim mes tyre në të vërtetë është shumë vështirë sepse dallimet janë shumë precize dhe të imta. Megjithatë të gjitha takohen në një pikë, në ilustrimin e fjalëve sipas veprimeve të tyre, por jo vetëm sipas veprimeve abstrakte por edhe sipas metodës ilustrative dhe imagjinative. Kjo në veçanti edhe e zgjoi interesimin tonë për te.

3 - Në Kur'an gjejmë edhe përballshmëri precize mes pikturave të cilat i vizatojnë shprehjet. Ndërsa përballshmëria është një metodë prej metodave të ilustrimit dhe të komponimit. Shprehja kur'anore i përdorë shumë shpesh ato duke i harmonizuar pikturat e saj përmes fjalëve të cilat i pasqyron në mënyrë subtile.

Nga ato kemi dy piktura të shpejta të shpërndarjes dhe bashkimit në fjalën e Të Madhërishmit: “Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe shpërndarja e gjallesave në të dyjat dhe Ai me fuqinë e Tij mund t'i bashkojë kurdo që të dojë.” (Shûrâ, 29).

Piktura e shpërndarjes së gjallesave dhe piktura e bashkimit të tyre takohen në një rresht, kurse imagjinata përfshinë një distancë më të gjatë kohore kur i përfytyron ato njëren pas tjetrës.

Prej tyre gjithashtu ato dy piktura të cilat i prezenton për vdekjen e të gjallëve dhe për ngjalljen e të vdekurve në thënien e Të Madhërishmit: “Vallë! A nuk u është e qartë atyre se sa nga popujt para tyre i shkatërruam, nëpër vendbanimet e të cilëve ecin? Me të vërtetë në ato (vende të shkretëruara) ka fakte, e si nuk janë duke dëgjuar me vëmendje. Vallë! A nuk shohin ata se Ne e sjellim ujin në tokën e thatë, e me të nxjerrim të lashtat me të cilat ushqehen kafshët e tyre, bile edhe ata vetë. E si nuk janë duke parë me vëmendje.” (Sexhde, 26-27).

Kështu sa çel e mbyll sytë Kur'ani i transferon lexuesit e tij prej fshatrave të shkatërruara e të shkretëruara pasi që ishin të gjalla e të ndërtuara në tokën e gjallë dhe pjellore, pas asaj që ishte e vdekur dhe e thatë. Në këtë rast përballshmëria ekziston mes dy situatave me dy situata tjera në realitet, e jo mes një situatë dhe një situatë tjetër.

Kjo përballshmëri pothuajse reflektohet në të gjitha pikturat e kënaqësisë dhe ndëshkimit në ahiret. Ato janë të shumta e ne do të ndalemi në cekjen e disa prej tyre me anë të këtyre shembujve:

Përmes pikturave të tij, Kur'ani e përshkruan sheshin e tmerrit vetëm me disa rreshta: “Jo, mosni ashtu! Kur të shembet toka njëpasnjëshëm! Dhe kur të vijë Zoti yt, e engjëjt qëndrojnë radhë-radhë! Dhe atë ditë sillet xhehennemi, e atëherë njeriut i bie në mend, por çdo t'i sjell dobi përkujtimi? E thotë: Ah i gjori unë, sikur të isha parapërgatitur për jetën time! Atë ditë askush nuk mund të dënojë si Ai. Dhe askush si Ai nuk mund të lidhë në pranga”.

Në mes të këtij vendi spektakular i cili transmeton paradë ushtarake, në të cilën merr pjesë edhe xhehennemi me muzikën e tij ushtarake të akorduar në mënyrë precize, të komponuar nga konstruksioni i fjalëve të ashpra e robëruese dhe në mes të ndëshkimit të veçantë, prangalidhës dhe të zingjiruar... e atij që besoi i thuhet bindshëm:

“O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i kënaqur kur edhe Ai është i kënaqur. Hyn në mesin e robërve të mi! Dhe hyn në xhennetin T'im.” (Fexhr, 21-30).

Kështu butësisht dhe dashurueshëm: “ja ej-jetuha” (në përkthim: “o ti”), pastaj shpirtërisht dhe nderueshëm: “en-nefsul

mutmein-neh” (në përkthim: “shpirt i bindur plotësisht”), pra, mu në këtë vend spektakular. “Irxhi’î ilâ rabbiki” (në përkthim: “kthehu te Zoti yt”) me të gjitha ato lidhje dhe dashuri që keni pas mes vete. “Râdijeten merdijeh” (në përkthim: “i kënaqur kur edhe Ai është i kënaqur”) me këtë thurje fjalësh e cila mbush ambientin tërësisht me kënaqësi dhe përkëdhelje. “Fed-hulî fî ibadî” (në përkthim: “hyn në mesin e robërve të mi”) i bashkuar dhe i dashur me ta. “Ved-hulî xhenneti” (në përkthim: “dhe hyn në xhennetin Tim”) që është përgatitur për robërit e mi. Muzika këtu rreth këtij sheshi është e qetë dhe e valëzuar. E butë përballë asaj muzike të fortë ushtarake.

Ky është shembulli i përballshmërisë emocionale mes mohuesve dhe besimtarëve. Tani do të shtojmë një shembull të ndëshkimit konkret (sensual) dhe lumturisë materiale të cilat qëndrojnë në përballshmëri gjithashtu:

“A të erdhi lajmi ty për fatkeqësinë e kaplueshme (të kijametit)?! Atë ditë do të ketë fytyra të dëshpëruara, të lodhura e të rraskapitura. Në zjarr të fortë do të digjen. U jepet të pijnë prej një kroi (me ujë) të valë. Ata ushqim tjetër nuk kanë pos një barishte me ferra helmuese që as nuk jep fuqi e as nuk largon uri. Atë ditë do të ketë (edhe) fytyra të ndriçuara. Për angazhimet e veta të kënaqura. Në xhennet të shkallës së lartë. Aty nuk dëgjojnë fjalë të pakëndshme. Aty rrjedh një krua i rrjedhshëm. Aty kanë shtretër të lartë dhe gastare të vëna pranë. Edhe jastëk të rënditur për mbështetje. Edhe qilima të shtruar.” (Gâshije, 1-16).

Këtu ekziston përballshmëria mes ambientit të ndëshkimit dhe ambientit të kënaqësisë dhe në të gjitha komponentet e ajeteve përshkruese aty dhe atje. Raste të tilla në Kur’an kemi shumë.

4 - Ekziston një lloj i përballshmërive, po jo mes dy pikturave të pranishme siç është rasti këtu - ato janë të pranishme në imagjinatë edhe pse janë piktura të ringjalljes në të ardhmen - por mes dy pikturave, njëra është tani e pranishme e tjetra e kaluar me kohë. Ajo përballshmëri vepron në imagjinatë për ta prezentuar këtë pikturë të fundit duke e vënë përballë pikturës së pranishme.

Shembull: “E krijoi njeriun nga një pikë (uji), kur qe, ai (bëhet) kundërshtar i hapët.” (Nahl, 4).

Piktura e cila është e pranishme këtu është piktura e njeriut “kundërshtar i hapët”, ndërsa piktura e qëkohshme është piktura e pikëzës së gërditshme. Mes këtyre dy pikturave ekziston një largësi mjaft e madhe e cila shpaloset për ta afirmuar këtë dallim të madh në sjelljen e njeriut. Kjo edhe është arsyeja pse i vuri këto dy piktura përballë njëra-tjetrës duke i injoruar të gjitha etapat mes tyre, ashtu që nëpërmjet këtij dallimi të madh ta shfaqë këtë qëllim të veçantë dhe atë me përballshmërinë imaginative mes një situate dhe një situate tjetër.

Kemi edhe ajetin: “Më le Mua me ata gënjeshtarë që jetojnë në luks dhe jepu atyre pak afat. Se me të vërtetë te Ne ka pranga dhe zjarr, edhe ushqim që nuk gëlltitet (e mbetet në fyt) dhe dënim të dhembshëm.” (Muzzemmil, 11-13).

Këtu përballshmëria ekziston mes pikturës së atyre “që jetojnë në luks” e cila është e pranishme dhe pikturës imaginative të “ushqimit që nuk gëlltitet”. Kjo ka vlerën e saj artistike krahas asaj fetare.

Gjithashtu ajeti: “Mjerë për çdo përqeshës e shpifës që ka grumbulluar pasuri dhe e numëron. E mendon se pasuria e tij e ka bërë të përjetshëm. Jo! Jo! Mashtrohet! Ai me të vërtetë dhe

mesiguri do të hedhet në Hutameh. E kush të tregon ty se ç'është Hutameh? Është zjarr i Allahut i ndezur fort që depërton deri në loçkë të zemrës. Ai (zjarri), do të jetë i mbyllur mbi ta (si saç). Në shtylla të gjata flakëruese.” (Humeze 1-9).

Figurës së përqeshësit-shpifësit i cili tallet me njerëzit dhe u bënë shpifje dhe figurës së këtij mendjemadhi tallës i qëndron përballë figura e “të hedhurit në Hutameh” [2], i cili dërrmon çdo gjë që bie në te. Aty dërrmohet mendjemadhësia, fuqia dhe kapitali i tij. Ai është zjarri i cili “depërton” në zemrën e tij prej të cilës burojnë përqeshja dhe shpifja dhe në të cilën fshehen arroganca dhe men-djemadhësia. Dhe si plotësim i figurës së të hedhurit, të dërrmuarit e të rrjepurit është: Ky Hutameh, i cili do ta mbyll në vete e nuk do të mund kush ta shpëtojë prej tij, po as që do t'i shkojë mendja kujt të pyesë për te.

Ngjashëm me te kemi edhe ajetin: “E të majtit, ç'është puna e të majtëve? Janë në vapë të zjarrit dhe në ujë të valë. Dhe në hije prej tymi të zi. As e freskët e as e këndshme. Ata, para kësaj (në dunja) kanë jetuar në luks.” (Vâkia, 41-45).

Vapa e zjarrit, uji valë dhe hija, e cila vetëm me emër i përket hijes sepse është prej tymit të zi “as e freskët e as e këndshme”, Të gjitha këto piktura qëndrojnë përballë pikturës së luksit “ata, para kësaj (në dunja) kanë jetuar në luks”.

Këtu kemi hapësirë për një meditim solid përmes këtij ilustrimi dhe atij që është përballë tij: Protagonistë të këtyre ajeteve janë ata që jetojnë në këtë botë të pranishme ndërsa përballë tyre qëndron figura e luksit e cila është e afërt dhe figura e vapës së zjarrit, ujit të valë dhe peripecive e cila është ajo e largëta. Me-gjithatë, në këtë hapësirë ilustrimi në sajë të gjallërisë së tij ia përfytyron lexuesit se kjo botë ka mbaruar dhe se protagonistët e saj janë atje, se pamja e

luksit ka mbaruar gjithashtu, ndërsa pamja e peripevice ka dalë në shesh. Protagonistëve të botës kalimtare tani në mes të vapës së zjarrit e ujit valë u kujtohet se ata “para kësaj (në dunja) kanë jetuar në luks!” Kjo pamje është prej përfytyrimeve më mahnitëse, e cila në shumicën e rasteve edhe është simetri që ndiqet në Kur’an. Ajo u përgjigjet ashikëve të artit dhe të fesë paralelisht: U përgjigjet ashikëve të artit me forcën e lëvizjes aktive dhe gjallëruese, ashtu që ata të harrojnë gjatë paraqitjes së skenave se ky është vetëm shembull që jepet por ta ndiejnë të pranishme atë që dëshmohet. Ajo u përgjigjet edhe ashikëve të fesë sepse përjetimi i të papranishmes si e pranishme është gjë që prek thellë dhe e gjallëron ndërgjegjen dhe e përgatitë atë për thirrjen e besimit të vërtetë.

Po të njëjtës vijë shkon edhe ajeti: (U thuhet engjëjve për mëkatarin) “Rrëmbene e grahne në mes të xhehennemit. Dhe hedhni mbi kokën e tij ujin e valë e shtojani mundimin. (I thuhet): Shijoje! Se ti je ai i forti, autoritativi.” (Duhân, 47-49).

Prej shembujve të përballshmërisë është edhe kjo pikturë: “Por kur të arrijë (shpirti) në gropë të fytit. Dhe thuhet (nga familja e të afërmit): Kush do të të shërojë? Dhe bindet se aty është ndarja. Dhe i puqet kofsha për kofshe. Atë ditë vetëm te Zoti yt shkohet. E ai as nuk e vërtetoi (besimin e tij me sadakë), as nuk u fal. Por përgënjeshtroi dhe ktheu shpinën. E pastaj shkonte te familja e tij me fodullëk.” (Kijâme, 27-33).

Edhe këtu Kur’ani ndjek të njëjtën simetri për të cilën folëm më parë. Piktura e dytë është ajo e cila është e kaluar dhe e mbaruar që bashkë me te mbaroi edhe bota. Piktura e parë është ajo e pranishmja të cilës i është rrekur dhe nuk mund të përfundojë me te. Aty do ta shohim atë të cilit i puqet kofsha për kofshe nga tmerri dhe lemeria ose thënë më drejt, nga sëmundjet dhe

dhimbjet. Shpirti i tij arrinë në gropë të fytit, kurse në ato çaste bën pyetje kush arrinë të bëjë pyetje: A nuk ka shërues për ta shëruar dhe për t'ia shmangur këtë gjendje - mu ashtu siç mundohen të shërohen të sëmurët nga sëmundja e epilepsisë dhe magjisë. Ai kujtoi se do të ndahet nga shokët dhe bashkëpunëtorët e tij, për të mos e parë më këtë figurë të tij, dhe të prezentojë figurën tjetër të tij, skenën kur ai përgënjeshtroi dhe ktheu shpinën dhe shkante te familja e tij me fodullëk. Ai do t'i paraqesë që të dy figurat (pikturat), por pas pak kohe, sepse: “Është puqur kofsha për kofshe” dhe nuk ka kohë në ato çaste ngase: “Atë ditë vetëm te Zoti yt shkohet”.

* * *

Më tej, ne mund t'i harrojmë të gjitha ato që i përmendëm më parë dhe ato që i përmendën të tjerët pos nesh sa u përket ngjyrave të harmonizimit në Kur'an dhe të kalojmë në ngjyrat tjera të harmonizimit artistik të cilat nuk i kemi prezentuar deri më tash. Këto ngjyra të harmonizimit sipas peshës së tyre do t'i mjaftonin këtij libri si tërësi!

1 - Kemi thënë se në Kur'an ka ritëm muzikor me tinguj të llojllojshëm, i cili harmonizohet me ambientin dhe e luan rolin kryesor në ndriçimin e synimeve.

Meqenëse ky muzikalitet kur'anor është rrezatim i thurjes (kontekstit) së veçantë në çdo rresht dhe përcjellës i separacioneve-nëndarjeve [4] të gjata e të shkurta, po ashtu është përcjellës i sintetizimit të shkronjave në fjalë të vetme dhe sintetizimit të fjalëve në një separacion. Mendoj se për këto dukuri është mirë të flasim për të gjitha bashkërisht.

Në Kur'anin fisnik kemi ajetin: “Ne as nuk ia mësuam atij (Muhammedit) poezinë, e as që i takon ajo atij, (atë që e sjell) nuk është tjetër vetëm se këshillë dhe Kur'an i qartë.” (Jâsîn, 69).

Aty përmendet edhe një tregim për mohuesit arabë: “Jo, ai e ka trilluar atë (Kur'anin); jo, ai është poet”.

Thënia e Kur'anit nuk mund të ketë dyshim se me të vërtetë këto vargje nuk janë poezi, por edhe arabët nuk ishin të marrë e as injorantë dhe të padijshëm për specifikat e poezisë, atëherë kur për këto vargje madhështore thanë se: “Kjo është poezi”.

Ajetet kur'anore i hutuan mendjet e tyre me atë ilustrim të shkëlqyeshëm që e zotëronin dhe i magjepsën emocionet e tyre me atë logjikë magjepsëse që e posedonin e ua pushtuan veshët me atë ritëm të bukur që e kishin. Këto edhe janë karakteristikat kryesore të poezisë nëse nuk i marrim parasysh kafijen (rimimin) dhe tefailin (kriterin e matjes së konstruksionit të fjalëve në fund të vargjeve në poezinë arabe. sh.p.)

Struktura e fjalisë kur'anore përfshinë karakteristikat e prozës dhe poezisë në formë të përgjithësuar mirëpo vargu kur'anor është i liruar nga rregullat e kafijes dhe tefailit. Në këtë mënyrë Kur'ani arriti lirinë e shprehjes së plotë e të lirë në të gjitha qëllimet e tij universale. Në të njëjtën kohë ai mori nga poezia muzikën e saj të brendshme dhe separacionet e përafërta me tefailin dhe kafijen ashtu që këtyre karakteristikave të cilat i cekëm iu bashkangjitën edhe këto të prozës dhe të të gjitha llojeve të tjera.

Kudo që njeriu e lexon Kur'anin e ndien ritmin e brendshëm emocional brenda rreshtave të tij. Ai ritëm shpaloset qartë sidomos në suret e shkurtra, separacionet e shpeshta, sferat e ilustrimit dhe përshkrimit përgjithësisht dhe deri diku vërehet edhe në suret e

gjata. Pa marrë parasysh, në çdo rast ritmi është gjithmonë i pranishëm në strukturën e simetrisë kur'anore.

Ja, ta marrim dhe ta lexojmë suren Nexhm:

“Pasha yllin kur perëndon. Shoku juaj (Muhammedi) as nuk e ka humbë as nuk e ka shmangë (rrugën e drejtë). Ai nuk flet sipas qejfit të vet. Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet. Atë ia mësoi ai (Xhibrili) me fuqi të madhe. Që ka mendje të mprehtë dhe që u paraqit në formën e vet. Dhe ai ishte në hapësirën më të lartë (qiellore). Pastaj u lëshua dhe iu afrua. Ishte afër sa dy harqe (kute) apo edhe më afër. E i shpalli robit të Tij atë që ia shpalli. Zemra nuk e përgënjeshtroi atë që e pa. A po e polemizoni atë për atë që e ka parë? Atë (Xhibrilin) e ka parë edhe herën tjetër. Tek Sidretul Munteha. Që pranë saj është Xhennetul Me’va (Kopshti i strehimit). Kur Sidrën e mbuloi ajo që e mbuloi, shikimi (i Muhammedit) nuk u shmang as nuk tejkaloi. Ai (Muhammedi) vërtet, pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet. E ju a e shihni Latin dhe Uzanë. Dhe atë të tretin e të fundit, Menatin (a kanë fuqi si Zoti i Muhammedit, e ju i konsideroni zota?!). A mendoni se meshkujt janë tuajt e të Atij femrat?! Kjo pra është një ndarje e padrejtë!” (Nexhm,1-22).

Këto separacione përafërsisht janë të barabarta në trajtë (por jo sipas rregullave të poezisë arabe) dhe unike në aspektin rimor (të kafijes). Këtu kemi të bëjmë me ritëm unik muzikor sipas rregullave të tefailit dhe kafijes dhe sipas një rregulle të mëvetësishme në të cilën nuk shfaqet tefaili dhe kafija por ngërthen prej për-puthshmërisë së shkronjave me fjalë dhe prej harmonizimit të fjalëve në fjali. Ajo ka bazë ndjenjën e brendshme intime dhe inspirimin muzikor i cili bën dallimin mes ritmit muzikor dhe atij që është i rëndomtë edhe nëse separacionet dhe trajtat e fjalëve të fundit janë unike në fjali.

Këtu ritmi muzikor shfaqet me kohë mesatare ngjashëm me distancën e fjalisë muzikore sipas gjatësisë dhe unik sipas unitetit të stilit muzikor. Ai i episodon rrëfimet pikërisht si stili i ndonjë drame e cila i ngjanë rrëfimit episodik. E gjithë kjo shihet dhe përjetohet. Megjithatë në disa separacione ajo shkrepëron, shembull: “E ju a e shihni Latin dhe Uzanë. Dhe atë të tretin dhe të fundit, Menatin?” E sikur të thuhej (në tekstin origjinal sh.p.) “E fe reejtumul lâte vel uzzâ ve menâtheth thâlithë” (pa shtesën “el uhrâ” sh.p.), do të humbte kafija dhe do të prishej ritmi muzikor. E sikur të thuhej: “E fe reejtumul lâte vel uzzâ vemenâtel uhrâ” (pa ndërmjetësimin e fjalës: “thâlithete” sh.p.), do të humbej barabarësia e fjalëve në varg. Gjithashtu në ajetin: “A mendoni se meshkujt janë tuajt e të Atij femrat?! Kjo pra është një ndarje e padrejtë”. E sikur të thuhej (në tekstin origjinal sh.p.) “E lekumudhdekeru ve lehul untha. Tilke kismetun dîzâ” do të humbej ritmi i rregullt pa fjalën “idhen”.

Kjo nuk do të thotë se fjalët “el uhrâ”, “eth thâlithë” dhe “idhen” janë shtesa vetëm për shkak të kafijes (rimimit) dhe veznit (barabarësisë së fjalëve në varg). Ato në të vërtetë janë të domosdoshme në strukturën e fjalive për shkak të disa fenomeneve të brendshme-intime e të posaçme. Kjo është edhe një veçori tjetër artistike e ajeteve kur’anore. Pra, ashtu që fjala të vjen në fjali me qëllim që ta japë domethënien e brendshme të saj por njëkohësisht edhe ta realizojë përshtatshmërinë në melos, pa mos ndikuar njëra në tjetrën e as t’u nënshtrohen rregullat rasteve të jashtëzakonshme.

Çështja e simetrisë ritmike nëpër ajete dhe separacione vërehet qartë në çdo vend ku shtrihen fjalët kur’anore ose afër kësaj përpikërie madhështore. Si argument kemi shndërrimin e shprehjes prej formave krahasuese të fjalës në formë të ndarë, ose të jetë i thurur vargu në atë mënyrë që nëse u ndërrohen vendet fjalëve

duke i vendosur para ose prapa apo të bëhet në atë kontekst çfarëdo ndryshimi, ato pa dyshim do ta humbnin atë bukuri.

Shembull për formën e parë kemi rrëfimin për Ibrahimin:

“Ai tha: A po shihni se ç’po adhuroni? Ju dhe prindërit tuaj të mëparshëm. Në të vërtetë ata (që i adhuroni ju), janë armiq të mi, përveç Zotit të botëve. Zoti që më krijoi, Ai më udhëzon mua. Dhe Ai që më ushqen dhe më jep të pijë. Dhe kur të sëmurem Ai më shëron. Ai më bën të vdekur e pastaj më ngjallë. Ai, tek i cili kam shpresë se do t’mi falë mëkatet në Ditën e gjykimit.” (Shuaraë, 75-82).

“Je-ja” e vetës së parë (në tekstin origjinal sh.p.) është hequr në fjalët “jehdînë”, “jeskînë”, “jeshfînë” dhe “juhjînë” për ta ruajtur rimimin (harful kafije) me mbaresat e fjalëve: “ta’budûn”, “akdemûn” dhe “ed-dîn”.

E ngjashme me te është edhe heqja e “je-së” trungore nga fjala. Për shembull: “Pasha agimin! Pasha dhjetë netët! Pasha çiftin dhe pasha tekun! Pasha natën që shkon (ec)! Vallë a nuk ka këtu betim për të mençurin?” (Fexhr, 1-5). “Je-ja” e fjalës “jesër” (në tekstin origjinal sh.p.) është anuluar krejtësisht me qëllim të ruajtjes së simetrisë me fjalët “el fexhr”, “ashër”, “vitër” dhe “hixhër”.

Gjithashtu ajeti: “Ditën kur thirrësi (Israfil) kumton një gjë të tmerrshme. Dalin prej varreve, e si karkaleca të shpërndarë e me shikim të përulur, duke shpejtuar drejt atij që i thërret, e jobesimtarët thonë: kjo është ditë e vështirë.” (Kamer, 6-8).

Sikur të mos ishte hequr “je-ja” nga fjala “ed-dââ” do të kishim thyerje të rimës si në vargjet e poezisë kur ndodh ndonjëherë.

Po ashtu ajeti: “Ai është (vendi) që ne po e kërkojmë! Dhe u kthyen që të dy rrugës së tyre prej nga kishin ardhur.” (Kehf, 64). Sikur të shfaqej “je-ja” e fjalës “nebgi” (në tekstin original sh.p.) ashtu si e kërkon rregulli, do të humbej “vezni” (barabarësia e fjalëve në varg) dhe do të mbetej e zhveshur prej asaj bukurie artistike.

Një gjë e tillë ndodh edhe kur shtohet “he-ja” e “sektes” (mbaresës në fjalë) në “je-në” trungore ose në “je-në” e vetës së parë. “Ndërsa atij që ka peshojën e lehtë të veprave të tij, vendi i tij do të jetë në Hâvijeh. E kush të tregon ty se ç’është ajo (Hâvijeh)? Është zjarr i vrullshëm.” (Karia, 8-11).

Pastaj ajeti: “Kujt i jepet libri i tij nga e djathta e tij, do t’u thotë (të tjerëve): Qe, lexoni librin tim. Unë kam qenë i bindur se do ta jap llogarinë time. Ndërsa ai atëherë është në një jetë të kënaqshme.” (Hâkka, 19-21). [6]

Ndërsa shembulli për situatën e dytë është të mos ketë ndryshim nga metoda krahasuese, por megjithatë vërehet muzikaliteti intim në atë përbërje e cila do të zbehej sikur t’i ndërrohej forma. Shembull: “Përkujtimi i mëshirës së Zotit tënd ndaj robit të Vet, Zekeriait. Kur ai iu lut Zotit të vet me një zë të ulët. Tha: Zoti im! Vërtet, mua më janë dobësuar eshtrat, më është zbardhur koka nga thinjat, e me lutjen time ndaj Teje, o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar.” (Merjem, 2-4). Nëse orvatesh t’ia ndërrosh vendin fjalës: “minni” dhe ta vësh para fjalës “el adhmu”, e cila do të dukej kështu: “Kale rabbi inni vehene minnil adhmu” (në tekstin original sh.p.), menjëherë do të vëresh një thyerje që i përngjan thyerjes së ritmit (veznit) në poezi, ngase ajo balancohet me fjalën “inni” të komponentës së parë në këtë mënyrë: “kale rabbi inni” “veheneel adhmu minni”.

Nuk ka dyshim se në ajetet kur'anore ekziston një lloj i muzikalitetit të brendshëm-intim i cili vërehet por nuk mund të shpjegohet siç edhe e pamë më parë. Ky muzikalitet është i struktur në kontekstin e fjalës së përveçme dhe në përbërjen e një fjalie të vetme. Ky muzikalitet perceptohet vetëm në ndjenjën e fshehur në brendi të zemrës dhe me dhuratë hyjnore.

Vetëm në këtë mënyrë mund të shfaqet ky muzikalitet intim në strukturën e shprehjes kur'anore, i matur me peshojën e ndjenjave jashtëzakonisht të vrullshme të cilat i përpëlité lëvizja më e vogël dhe dridhja më e butë, edhe pse nuk është poezi apo nuk përputhet me shumë rregulla të poezisë të cilat e kufizojnë lirinë e poetit gjatë të shprehurit sensual për qëllimin e kërkuar.

* * *

Sistemi i separacioneve dhe rimeve është i llojlojshëm mu ashtu siç janë të llojlojshme ngjyrat e ritmit muzikor. A thua kjo arrihet sipas rregullave të posaçme të cilat shpiejnë në synime të caktuara?

Le t'i hedhim pra një shikim kësaj hapësire të veçantë prej hapësirave të harmonizimit muzikor, meqë është vërtetuar ekzistimi i kësaj muzike.

Është vërtetuar se sistemi i separacioneve dhe rimeve pëson ndryshime në suret e nduarnduarta, e ndonjëherë pëson ndryshime edhe në suren e njëjtë.

Llojlojshmëria e tyre në sure ndryshon përballë separacioneve, sipas distancave të fjalëve prej të gjata, mesatare e të shkurtra. Ato i përngjajnë ndryshimit të metrikave të poezisë në një divan. Shkurt mund të themi: separacionet (nëndarjet, el fevâsil) shkurtohen në

suret e shkurta kurse janë mesatare apo zgjaten në suret e mesme dhe të gjata. Në krahasim me shkronjën rimuese (harful kafije) në suret e shkurta janë shumë të pranishme shëmbëllimi dhe ngjashmëria ndërsa më pak në suret e gjata. Rimat e “nun-it”, “mim-it” dhe para tyre “je-jës” ose “vav-it” dominojnë në të gjitha shkronjat rimuese në suret e Kur’anit dhe atë me shumëllojshmërinë e metodave muzikore edhe nëse janë të ngjashme rimat në suret e ndryshme. Stili muzikor në këtë rast përcjell separacionet e gjata dhe ato të shkurta, por edhe vendet e shprehjes së ritmit ashtu siç e përcjell mënyrën e konstruksionit të fjalive sipas përbërjes së tyre.

Sa i përket shumëllojshmërisë së këtij sistemi në një sure, në shumë raste kemi vërejtur se separacioni (el fâsile) dhe rimimi (el kafije) nuk ndryshojnë vetëm për shkak të shumëllojshmërisë. Neve na u zbulua fshehtësia e këtij ndryshimi në disa pasuse të ajeteve por mbeti misterioze në disa pasuse tjera. Ne nuk dëshirojmë t’ia mveshim edhe këtij sistemi faktin se ai është dukuri e përgjithshme siç ishte rasti me ilustrimin, përfytyrimin, trupëzimin dhe ritmin (melosin kur’anor).

Prej gjurmëve të cilat do të vërejmë se ndryshimi i sistemit të separacionit dhe rimimit ka qëllim të posaçëm, janë ato ajete të cilat erdhën në suren Merjem.

Sureja fillon me rrëfimin për Zekeraiin dhe Jahjanë e pastaj vijon rrëfimi për Merjemenë dhe Isain. Aty separacioni dhe rimimi shfaqen në këtë mënyrë:

“Përkujtimi i mëshirës së Zotit tënd ndaj robit të vet Zekeraiat. Kur ai iu lut Zotit të vet me një zë të ulët. Tha: Zoti im! Vërtet, mua më janë dobësuar eshtrat, më është zbardhur koka nga thinjat,

e me lutjen time ndaj Teje, o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar...” (Merjem, 2-4).

“E përmendju në këtë libër (tregimin për) Merjemen kur ajo u largua prej familjes së saj në një vend në Lindje. Ajo vuri një perde ndaj tyre, e Ne ia dërguam asaj Xhibrilin, e ai iu paraqit asaj si njeri në tërësi. Ajo tha: Unë i mbështetem Të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse je që i frikësohesh Atij...” (Merjem, 16-18).

Kështu përfundojnë të dy rrëfimet sipas një melosi. Por befasisht kjo simetri fjalësh ndryshon dhe merr formë tjetër pas pasusit të fundit në rrëfimin për Isain, dhe ate në këtë mënyrë:

“Ai (Isai) tha: “Unë jam rob i Allahut, mua ma ka dhënë (ka caktuar të ma japë) Librin dhe më ka bërë Pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (lutje) e zeqat përsa të jem gjallë! Më ka bërë të mirësjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë e as të padëgjueshëm! Selami (shpëtimi i Allahut) është me mua ditën kur të dal (prej varrit) i gjallë! Kjo është fjalë e vërtetë e Isait, birit të Merjemes për të cilën ata shkaktojnë dyshime. Nuk i takoi (nuk ka nevojë) Allahut të ketë fëmijë, i pastër është Ai, kur dëshiron një send Ai vetëm i thotë atij: Bëhu! Ai menjëherë bëhet. (Isai i tha popullit të vet) Dhe se Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, pra adhurone Atë, kjo është rrugë (fe) e drejtë. Por grupet u kundërshtuan mes vete (rreth Isait). Të mjerët ata që nuk besuan se çka kanë për të parë Ditën e madhe...” (Merjem, 30-37).

Në këtë mënyrë ndryshoi sistemi i separacionit duke marrë mbaresën e zgjatur. Gjithashtu ndryshon sistemi i rimimit i cili bëhet me shkronjën “nûn” ose “mîm” duke pas para “meddîn” (zgjatimin) e zgjatur. Sikur Kur’ani në fund të këtyre ajeteve nxjerr një konkluzë pas përfundimit të rrëfimit të mbështetur në këtë

rregull. Forma e vendimit (konkluzës) vjen me një metodë muzikale e jo sipas metodës kumtesore, dhe vjen me një ritëm të fortë e të ashpër përkundër ritmit të rrëfimit indolent e të shlrshëm. Sikur për këtë shkak të është bërë ndryshimi.

Ne e shohim të arsyeshme që në rastin e kësaj konkluze të vëmë në spikamë edhe një vërejtje tjetër. Fjala është se vetëm pas përfundimit të nxjerrjes së këtij akti dhe marrjes së këtij vendimi, iu kthye përsëri sistemit të parë sa i përket separacionit dhe rimimit ngase tani Kur'ani i kthehet një rrëfimi të ri në këtë mënyrë:

“Po, grupet u kundërshtuan mes vete (rreth Isait). Të mjerët ata që nuk besuan se çka kanë për të parë Ditën e madhe! Ditën kur ata do të na paraqiten Neve, sa mirë do të dëgjojnë dhe shohin, (ose njerëzit do të shohin se çka do t'i gjejë ata), por tash për tash (në këtë jetë) zullumqarët janë në humbje të qartë. Ti tërhiqju atyre vërejtjen për ditën e dëshpërimit, kur të marrë fund çështja (e përgjegjësisë e dikush në xhennet e dikush në zjarr), se ata (sot) janë të painformuar dhe nuk janë duke besuar. S'ka dyshim se Ne e trashëgojmë (na mbetet) tokën dhe çka ka në të, dhe te Ne do të jetë e ardhmja e tyre. Përkujtoju (idhujtarëve dhe të tjerëve) në libër (në Kur'an) Ibrahimin. Ai ishte vërtet shumë i drejtë dhe Pejgamber. Kur babait të vet i tha: “O babai im, pse adhuron atë që as nuk dëgjon as nuk sheh, e as nuk ke asgjë prej tij? O babai im, mua më është dhënë nga dituria çka ty nuk të është dhënë, andaj më dëgjo se unë të udhëzoj në rrugë të drejtë. O babai im, mos adhuro djallin, sepse djalli është kundërshtar i Mëshiruesit. O babai im, unë kam frikë se ty do të godet ndonjë dënim prej të Gjithëmëshirshmit, e do të bëhesh shok i djallit...!” (Merjem, 37-45).

Gjithashtu edhe sureja “Nebe’ë” fillon me rimën e “nûnit” dhe “mîimit”: “Për çka ata i bëjnë pyetje njëri-tjetrit? Për lajmin e madh

e tronditës, në të cilin ata janë në kundërshti. Jo, të mos pyesin, se ata do ta kuptojnë! Përsëri jo, se ata do ta kuptojnë!” (Nebe’ë, 1-5).

Meqë e kryen këtë kumtesë dhe fillon me përbërje të reja kuptimore - thurje debati e jo kundërshtimi - dhe në këtë mënyrë u ndërrua sistemi: “Përsëri jo, se ata do ta kuptojnë...! A nuk e bëmë Ne tokën e përshtatshme (për jetë) ndërsa kodrat shtylla? Dhe ne ju krijuam juve në çifte. Dhe gjumin tuaj ua bëmë për pushim. Dhe natën ua lamë mbulesë (si rrobat), ndërsa ditën e bëmë për gjallërim.” (Nebe’ë, 5-15).

Kurse në suren Âli Imrân sureja shkonte sipas një lloj ritmi deri para përfundimit, e kur filloi ta paraqesë lutjen e një grupi prej besimtarëve të cilët e përmendnin Allahun kur ishin në këmbë, ulur dhe shtrirë, separacioni ndryshoi në këtë mënyrë:

“Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit! Zoti ynë, atë që Ti e futë në zjarr, atë e ke poshtëruar; për mizorët nuk ka ndihmëtarë!...” (Âli Imrân, 191-192). Ne kemi hasur në këso raste në shumë komponenta tjera, megjithatë nuk mundëm t’u japim koment konsekuent në të gjitha sferat ku ato ndryshojnë, andaj edhe i dhamë përparësi qëndrimit që t’i vëmë në spikamë aq sa na u shfaqën fshehtësitë e tyre. Mendoj se ato që i shtruan si shembuj do të mjaftojnë.

Sa i përket shumëllojshmërisë së metodës muzikore dhe ritmit të saj përmes shumëllojshmërisë së valëve të cilat shfaqen në te, ne zotërojmë mbështetje të fortë se ajo shkon sipas një sistemi të veçantë dhe përshtatet me ambientin e përgjithshëm vazhdimisht pa përjashtime.

Për t’i regjistruar këto dallime dhe për t’i sqaruar ato, kemi nevojë për njohjen e disa rregullave të veçanta muzikore dhe të

disa terminologjive në muzikë të cilat nuk i zotëron secili lexues por as ne gjithashtu. Megjithatë, ne këtë çështje do ta lehtësonim sikur të zgjedhnim ngjyra të dallueshme dhe forma kontraste të nxjerrura nga ajo muzikë.

Në suren Naziât kemi dy forma muzikore dhe dy ritme që simetrizohen me dy valë plotësisht.

Forma e parë në këtë fragment shfaqet me një lëvizje të shpejtë me valë të shkurta dhe me strukturë të fortë e cila gërshetohet me një ambient të elektrizuar, me rrahje të shpejta dhe me dridhje të forta, në këtë stil:

“Pasha ata (engiëjt) që marrin shpirtin me rrëmbim (përmbytshëm)! Dhe ata që marrin shpirtrat me lehtësim! Dhe ata që notojnë me shpejtësi! Dhe nxitësit të cilët me shpejtësi në vendin e vet i çojnë! Dhe pasha ata që çdo çështje e rregullojnë! Ditën që vrullshëm bëhet dridhja. Që pas saj pason tjetra. Atë ditë zemrat janë të tronditura. Shikimet e tyre janë të poshtëruara (të frikësuara). Ata (idhujtarët në dunja) thonë: A thua do të bëhemi përsëri kështu si jemi? A edhe pasi të jemi bërë eshtra të kalbur? Ata thanë: Atëherë, ai kthim do të jetë dëshpërues për ne! Po, ajo (ringjallja) nuk do të jetë tjetër pos një thirrje (klithje). Dhe ja, ata mbi sipërfaqen e tokës.” (Naziât, 1-14).

Metoda e dytë në këtë fragment shfaqet me lëvizje të ngjyrosur me valë të buta, me gjatësi të mesme, e cila gërshetohet me ambientin rrëfimor i cili në këtë sure në mënyrë direkte kumton “kthimin dëshpërues”, “thirrjen e vetme” dhe çështjen e “sipërfaqes së tokës” në këtë mënyrë:

“A të ka ardhur ty rrëfimi i Musait? Kur Zoti i tij e pat thirrur në luginën e bekuar Tuva (rrëzë kodrës Tûri Sinâ). Shko te faraoni

se ai vërtet e ka tepruar, dhe thuaj: E ke ndërmend të pastrohesh? Unë do të udhëzoj te Zoti yt që t'ia kesh frikën Atij!” (Naziât, 15-19).

Mendoj se ne nuk kemi nevojë t'i njohim rregullat muzikore po as terminologjinë artistike që ta bëjmë dallimin mes dy stileve dhe dy ritmeve, ngase ato janë të qarta dhe nuk fshehen. Ato gjithashtu janë të sintetizuara në çdo hapësirë me ambientin në të cilin tingëllon muzika.

Kjo muzikë ka një detyrë parësore, e ajo është inkorporimi i saj në dy skenat e paraqitura në të dy herët, si në të parën ashtu edhe në të dytën.

Tani të flasim diç për llojin e tretë të muzikës kur'anore. Ajo është muzika e duasë (lutjes) së valëzuar, indolente, të gjatë e të përkulshme:

“Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit me zjarr! Zoti ynë, atë që Ti e futë në zjarr, atë e ke poshtëruar; për mizorët nuk ka ndihmëtarë!... Zoti ynë, jepna atë që nëpërmjet Të dërguarve Tu na e premtove dhe në Ditën e kijametit mos na turpëro; Ti je Ai që nuk e shkel premtimin!” (Âli Imrân, 192-194).

Ose një lutje tjetër:

“Zoti ynë, s'ka dyshim se Ti e di se çka fshehim dhe çka publikojmë, se Allahut nuk mund t'i fshehet asnjë send në tokë e as në qiell. Falënderimi i qoftë Allahut, i cili në pleqëri m'i fali mua Ismailin dhe Is'hakun! Vërtet, Zoti im dëgjon dhe i përgjigjet lutjes. O Zot, më bëj mua nga ata që falin namazin, edhe prej pasardhësve të mi dhe pranoje lutjen time, o Zoti ynë! Zoti ynë!

Më fal mua dhe prindërit e mi dhe të gjithë besimtarët ditën kur jepet llogaria.” (Ibrâhîm, 38-41).

Ne nuk kemi nevojë për rregulla dhe terminologji që të kuptojmë se ky stil dallon nga dy stilet e kaluara. Kjo formë akordohet me lutjen në mënyrë të plotë si përnga muzikaliteti, valëzimi dhe ritmi i ngadalshëm.

Tash ndalemi e kujtohemi që të sjellim një ngjyrë të muzikës së valëzuar me valë të gjata - por me një ngjyrë krejtësisht tjetër - e përkujtojmë dhe e sjellim këtu duke u mbështetur në ekzistimin e dallimit mes saj dhe ngjyrave të kaluara.

Përbërja muzikore e fjalisë këtu ia shton edhe më tepër valëzimit thellësinë dhe gjerësinë. Në te ka edhe lemeri edhe dëshpërim sepse ajo është muzika e tufanit: “Ajo lundron nëpër valë me ta si kodra, e Nuhi e thirri djalin e vet, që ishte në një vend të ndarë: O djali im, hip bashkë me ne, e mos u bë me mohuesit! Ai (djali) tha: Unë do të ngjitem në një kodër që do të më mbrojë nga uji (vërshimi). Tha: Nuk ka sot mbrojtës prej dënimit të Allahut, pos atë që Ai e ka mëshiruar! Vala hyri mes tyre të dyve, e ai (djali) u mbyt në ujë.” (Hûd, 42-43).

Përbërja muzikore e fjalisë si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht futet në thellësi dhe ngjitet në lartësi, për të marrë pjesë në tmerrin e gjerë dhe të thellë. Ndërsa zgjatjet (meddat) e njëpasnjëshme dhe të shumëllojshme në përbërjen e fjalisë ndihmojnë për ta plotësuar ritmin, për ta formësuar dhe për ta harmonizuar me ambientin e skenës fort të trishtueshme.

Tani të kujtohemi përsëri dhe ta prezantojmë ngjyrën e tretë të muzikës së valëzuar me valë dhe orientime të ndryshme: “O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i kënaqur kur edhe Ai

është i kënaqur. Hyn në mes të robërve të mi! Dhe hyn në xhennetin 'Tim!' (Fexhr, 27). Kur t'i lexojë (këndojë) lexuesi i Kur'anit këto ajete me ton të zëshëm, do ta përjetojë atë muzikalitet të qetë e të valëzuar. Ato i përngjajnë valës së ngadalshme kur ngrihet në majën e saj dhe lëshohet deri kur shtrihet qetë dhe sigurt. Ato përputhen me ambientin e sigurisë (bindjes së plotë) gjatë gjithë shfaqjes së skenës. Ndoshta barabarësia e zgjatimit (med-it në tekstin origjinal. sh.p.) përmbi me "elif" dhe ndër te me "je-në" në mënyrë të përhershme ka ndonjë fshehtësi në këtë valëzim por ajo nuk është fshehtësia e tërë ngase zgjatimi i shpjegon ruajtjet e thekseve në fjali e jo edhe akordimin e tyre. Ai shpjegon barabarësinë e jashtme të fjalëve në melodi e jo shpirtin e saj të brendshëm. Ky shpirt buron nga disa tipare të fshehura (misterioze) në tingujt e shkronjave dhe fjalëve të cilat mund t'i zbulojë ai që e lexon shprehjen kur'anore me ndjeshmëri dhe frymëzim të thellë. Ne do të mjaftojmë me këtë pasqyrim të mundshëm për të mos iu ekspozuar gëlltitjeve terminologjike.

* * *

Tani do të shtegtojmë në hapësirën e fundit prej hapësirave të harmonizimit artistik të ilustrimit kur'anor.

Kemi thënë se Kur'ani vizaton piktura dhe ekspozon skena, andaj edhe duhet ta kemi ndër dije se ato skena dhe ato piktura përmbajnë dukuritë më subtile të harmonizimit artistik në ngjyrën e pikturës dhe ambientin e skenës, ndarjes së komponenteve-detajeve dhe shpërndarjes së tyre në tablonë e ekspozuar.⁸

⁸ Piktori i mirënjohur prof. Dijaud-din Muhammed mori përsipër korrigjimin e këtij kapitulli të veçantë për harmonizimin artistik të ajeteve kur'anore.

Ne diç prej kësaj cekëm në kapitullin “Ilustrimi artistik” kur e prezentuan pikturën (figurën) e atij që shpërndante pasurinë e vet vetëm sa për sy e faqe dhe pikturën e gurit të madh të mbuluar me dhé krahas pikturës së atyre që e shpërndajnë pasurinë e vet duke kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe pikturës së kopshtit në një rrafshnaltë. Të gjitha këto piktura mes vete kanë një baraspeshë mes komponenteve të tyre dhe përballshmëri mes pozicioneve të tyre.

Ky lloj i harmonizimit është çelës i rrugës drejt harmonizimit të cilin në këtë rast në mënyrë ekskluzive e synojmë.

Si pika kryesore në këtë rast që na interesojnë janë:

Së pari: Ajo që quhet “universalitet vizatimor”. Për këtë universalitet dinë sadopak edhe fillestarët në rregullat e artit vizatimor, andaj mendojmë se nuk ka nevojë ta shpjegojmë atë. Rregullat parësore të vizatimit imponojnë që të ekzistojë një universalitet (përputhshmëri) mes detajeve të vizatimit sepse detajet e pikturës nuk mund të veçohen.

Së dyti: Distribuími (shpërndarja) i komponenteve të vizatimit - pas përshtatshmërisë së tyre - në pëlhurë me një masë të caktuar që të mos e ngushtojnë njëra-tjetrën dhe në të njëjtën kohë vizatimi të mos e humb harmonizimin në tërësinë e tij.

Së treti: Ngjyra me të cilën pikturon dhe shkallëzimi i hijeve në mënyrë që t'i përshtatet ambientit të përgjithshëm të harmonizuar me idenë dhe motivin.

Ilustrimi me ngjyra e shpalos këtë harmonizim ashtu siç “distribuími” e shpalos në skenat teatrale dhe kinematografike. Ilustrimi në Kur'an sendërtohet mbi themelet e tij edhe pse

element i tij i vetëm i pikturimit janë fjalët. Por kjo edhe më tepër pedestalizon i'xhazin (elokuencën) mbi të gjitha orvatjet tjera:

1 - Ta marrim një sure prej sureve të shkurta të cilat ndoshta ndokush i konsideron si proza të rimuara klerikale ose fjalë të urta të rimuara. Për shembull ta marrim suren Felek:

Cili ambient i caktuar do të shfaqet këtu? Ai është ambienti i kërkim-mbështetjes dhe kërkim-ruajtjes duke i pasur parasysh fshehtësitë, paqartësitë dhe turbullirat. Dëgjo se çka shkruan në Kur'an:

“Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit. Prej dëmit të çdo krijese që Ai e krijoi. Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja. Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron.” (Felek, 1-5).

Cili është ai agim (felek) me të cilin kërkon mbrojtje te Zoti i tij? Nga shumë sinonimet e fjalës “felek” do ta zgjedhim fjalën “fexhr” (mëngjes) ngase ky sinonim është më i përshtatshëm të kërkohet mbrojtje prej Tij nga një errësirë e cila mund t'i kaplojë nga ajo që e krijoi, nga ajo që ngryset plotësisht, nga fyerjet dhe zilia, dhe se në te ka pakuptueshmëri të veçantë të cilës do t'ia dimë fshehtësinë pas pak kohe.

Kërkon mbrojtje me Zotin e “fexhrit” (mëngjesit) “prej dëmit të çdo krijese”. Këtu Kur'ani në mënyrë mohuese dhe me “ma-në” (në tekstin original “ma halek” sh.p.) e cila është lidhëse me funksion gjithëpërfshirës. Në këtë mohim dhe përfshirje realizohet turbullia dhe errësira abstrakte në përgjithësi. “Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht”. Atëherë kur errësira e natës futet në çdo gjë, ajo shtrihet tmerrueshëm dhe frikësueshëm. “Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja”. Ambienti i lidhjes dhe

fryerjes në nyja që bëhet nga fallxhorët dhe klerikët në të cilin dominojnë trishtimi, misteri dhe errësira. Bile ata në të shumtën e rasteve fryejnë në nyja vetëm natën. “Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron”. Smira (zilia) është refleks i brendshëm emocional i strukur në errësirën e shpirtit, i errët por edhe i tmerrshëm.

Ambienti është përplot errësirë dhe tmerr, misteriozitet dhe enigmë. Njeriu kërkon mbrojtje te Allahu nga kjo errësirë, e Allahu është Zot i çdo gjëje. Tani shtrohet pyetja, e pse të veçohet si “Zot i agimit”? - Në mënyrë që të simetrizohet me ambientin e tërë pikturës dhe të marrë pjesë në te. Megjithëse do të dukej më e logjikshme sikur të kërkonte mbrojtje nga errësira te “Zoti i dritës”. Por këtu logjika nuk mund të jetë kriter gjykues. Kriter gjykues është ndjenja e ilustrimit të përpiktë dhe subtil. Drita (nuri) zbulon paqartësinë e tmerrueshme por nuk mund të gërshetohet me ambientin e ngrysjes, fryerjes në nyja, e as me ambientin e smirës. “Feleku” (agimi) realizon domethënien e dritës në aspektin logjik pastaj ndërthehet me ambientin e përgjithshëm në aspektin ilustrativ. Agimi është interval para shkëlqimit të dritës i cili e përfshinë dritën dhe errësirën. Ai zotëron edhe ambientin e errët magjepsues.

Shtrohet pyetja: Cilat janë detajet e pikturës këtu dhe cilat janë aktet e skenës?

Në pikëpamje të “agimit dhe errësirës” kemi dy skena prej skenave të peizazhit, ndërsa në pikëpamje “të lidhjes dhe fryerjes në nyja” dhe “smirëkeqit kur sipas smirës vepron”, kemi dy krijesa njerëzore.

Në pikëpamje të “agimit” dhe “errësirës së natës” kemi dy skena të përballshme kohësisht. Ndërsa në pikëpamje të “lidhësit

dhe fryerësit në nyja” dhe “smirëkeqit” kemi dy kategori të përballshme njerëzore.

Këto detaje janë të shpërndara në pllakë në formë të harmonizuar dhe të përballshme në pëlhurën e vizatimit me krahasim të përpiktë e cila në tërësi është e të njëjtës ngjyrë. Që të gjitha janë misterioze dhe të tmerrshme të mbështjellura në paqartësi dhe errësirë. Ambienti i përgjithshëm është formuar në bazë të këtij uniteti në ngjyra dhe detaje.

Me këto fakte nuk kemi bërë kurrfarë teprimesh. Është e pamundur që i gjithë ky precizitet të vijë pa synim të caktuar. Synimi i tillë nuk mund të jetë vetëm një stoli kalimtare. Kjo çështje nuk ka të bëjë me fjalë ose me përballshmëri psikike por me pëlhurë vizatimi, ambient, harmonizim dhe disa përballshmëri ilustrative të cilat numërohen si art i shkëlqyeshëm në ilustrim, që me një shprehje të thjeshtë tërheq vëmendjen kur ekzekutohet.

2 - Kur’ani tokën e karakterizoi para zbritjes së shiut dhe para gufimit të saj me bimë të ndryshme, njëherë si “të shkretë” e njëherë si “të përrulur”. Dikush këtë e kupton vetëm si ndryshim i shprehjeve e ne do të shikojmë se si janë paraqitur këto dy pamje.

Ato janë paraqitur në dy versione të cilët dallojnë nga njëri-tjetri dhe atë në këtë formë:

a) Është cekur “e shkretë” në këtë version: “O njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, (dine) se Ne ju krijuam prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej një gjaku të ngjizur, pastaj prej një (copëz) mishi, që është krijesë e formuluar ose e paformuluar që t’ua sqarojmë juve (fuqinë Tonë). Dhe Ne e mbajmë në mitër atë që duam deri në kohë të caktuar e mandej u nxjerrim foshnje e pastaj do të arrini pjekurinë tuaj. Disa prej jush vdesin e disa mbesin deri

në kufirin më të skajshëm të jetës, që mos të dijë asgjë nga ajo që ka ditur më parë. E ti e sheh tokën të shkretë, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet dhe gufon, dhe nga të gjitha çiftet (llojet) mbijnë bimë të mrekullueshme.” (Haxh, 5).

b) Dhe është cekur “e përulur” në këtë version:

“Nga faktet e madhësisë së Tij janë nata, dita, dielli e hëna. Mos i bëni sexhde (mos iu përulni) as diellit as hënës! Sexhde bëni vetëm Allahut, i cili i krijoi ato, nëse e adhuron vetëm Atë! E, nëse ata madhësohen, ata që janë te Zoti yt (engjëjt) e lavdërojnë Atë natën dhe ditën, e kurrë nuk mërzen. Nga faktet e madhësisë së Tij është edhe toka që ti e sheh të përulur (të thatë), e kur Ne ia lëshojmë asaj shiun gjallëron dhe gufon.” (Fussilet, 37-39).

Nëse këto dy versione sadopak i sodisim, do të dalë në dritë mënyra e harmonizimit në termin “e shkretë” dhe atë “të përulur”. Ambienti i versionit të parë është ambient i ringjalljes, gjallërimit dhe gufimit andaj edhe harmonizohet me te ilustrimi i tokës se ajo është “e shkretë” e pastaj gjallëron dhe gufon dhe nga çdo çift mbijnë bimë të mrekullueshme.

Kurse ambienti në kontekstin e dytë është ambient adhurimi, përulshmërie dhe i rënies në sexhde, ashtu që me te harmonizohet ilustrimi i tokës se ajo është “e përulur” e kur ia zbret shiun gufon dhe gjallëron. Pastaj këtu nuk ia bashkangjet gjallërimit dhe gufimit mbirjen dhe daljen siç ia bashkangjet atje, sepse ato dy fenomene nuk kanë hapësirë në ambient të adhurimit dhe rënies në sexhde. Në rastin e dytë nuk vijnë “gufimi dhe gjallërimi” për të njëjtin qëllim që erdhën në rastin e parë. Këto dy shprehje në këtë rast ia përfytyrojnë tokës lëvizjen pas përuljes së saj. Mu kjo lëvizje edhe synohet këtu, ngase çdo gjë në skenë lëvizë sipas lëvizjes së adhurimit, prandaj nuk do të ishte e përshtatshme vetëm toka të

mbetet e përulur dhe e palëvizshme. Ajo u gjallërua që t'u bashkangjitet adhuruesve që i bënë lëvizjet e tyre në skenë, dhe gjithashtu të mos mbetet një akt prej akteve të skenës, i palëvizshëm, kurse të gjitha aktet tjera të lëvizin përreth.

Edhe kjo pra është një prej ngjyrave të mprehtësisë së harmonizimit të lëvizjes imagjinative e cila kulmon mbi çdo vlerësim.

Është mirë të vërejmë se shkretësia dhe përulshmëria unjësohen në kuptimin e përgjithshëm. Përmes atyre dyjave në dy ajetet argumentohet fuqia e Krijuesit për ringjallje. Ato dy tipare përshkruhen të plogështa dhe imobile që pastaj të përcillen me lëvizje dhe gjallërim.

Sikur të ishte qëllimi vetëm vënia në pah e domethënies mendore, nuk do të kishte nevojë për këtë shumëllojshmëri. Shprehja kur'anore nuk synon vetëm ta shfaq domethënien mendore por sugjestionon gjithashtu edhe në ilustrim (pikturë). Në anën tjetër, ilustrimi pretendon në shumëllojshmërinë që të arrihet harmonizimi me detajet tjera të tablosë vizatimore ose skenës së ekspozuar.

Përfundimi i kësaj shumëllojshmërie është i prerë në atë se “ilustrimi” është element kryesor në metodologjinë kur'anore dhe se shprehja nuk përfundon në domethënien mendore por pulson sipas natyrës së saj me piktura të gjalla të domethënieve. Ato ndryshojnë me ndryshime të imta dhe të buta sipas ndryshimit të detajeve dhe ngjyrave.

Tani t'i hedhim një shikim “unjësimit vizatimor” në të dy pikturat dhe në vetë detajet e pikturës gjithashtu.

Unjësimi i pikturës së parë është kështu: Disa krijesa të gjalla që dalin nga vdekja; ose prezentimi i disa skenave të jetës. Detajet e kësaj pikturë janë: uji (sperma) i cili evoluon në etapat e tij të njohura dhe një bimë e cila me zhvillimin e saj bëhet çift (lloj) i mrekullueshëm. Ndërsa toka ishte dhé i vdekur nga i cili del kjo spermë dhe tokë e shkretë nga e cila del kjo bimë. Ambienti i përgjithshëm është ambient i të gjallëve të pikturuar nga këto detaje.

Kurse njësimi i vizatimit të dytë është në këtë formë: Krijesa natyrore adhuruese, ose skena natyrore. Detajet e saj janë: Nata dhe dita, dielli dhe hëna dhe toka e përlurur Allahut... Në të valëzojnë dhe me të lidhen dy grupe të gjallësh me gjini të ndryshme me pamje të njësuara: Grup prej njerëzve të cilët madhësohen e largohen nga ibadeti dhe grup prej engjëjve të cilët e adhurojnë Allahun natën dhe ditën. Ambienti i përgjithshëm është ambienti i adhurimit i pikturuar nga këto detaje.

Në këtë mënyrë harmonizohen detajet me ambientin e përgjithshëm dhe njësohen detajet e një pikturë duke e realizuar njësimin vizatimor dhe i shpërndanë detajet në pëlhurë me këtë sistem të mahnitshëm.

3 - Në hapësira të ndryshme Kur'ani paraqiti shumë piktura të begatisë, të cilat Allahu ia mundësoi njeriut. Në secilin rast paraqiteshin grumbull begatishë “të njësuara” simetrikisht në këtë mënyrë të cilën do ta paraqesim në dy ndarje për të dhënë shembull:

a) “Allahu ua bëri shtëpitë tuaja vendbanim dhe nga lëkurët e kafshëve ju mundësoi të keni shtëpi (tenda) që lehtë i bartni kur udhëtoni, e edhe kur vendoseni, ndërsa nga leshi (i dhenve), nga

qimet (e deveve) dhe fjetet (e dhive) petka e shtroja që t'i shfrytëzoni për një kohë.” (Nahl, 80).

“Allahu nga ajo që krijoi, ju bëri edhe hije, e në kodra vendstrehime, edhe petka që ju mbrojnë prej të nxehtit dhe petka që ju mbrojnë në luftë. Ashtu Allahu plotëson të mirat (ni'metet) e Tij ndaj jush, në mënyrë që të dorëzoheni (besoni).” (Nahl, 81).

b) “Ju edhe në kafshët keni mësim (përvojë). Ne ju furnizojmë me atë që kanë në barqet e tyre - ndërmjet ushqimit të përpunuar dhe gjakut: qumësht të pastër dhe të shijshëm për ata që e pijnë.” (Nahl, 66).

“E nga frytet e hurmës (palmave) dhe të rrushit (hardhive) nxirrni prej tyre pije dehëse dhe rrizk të shëndetshëm. S'ka dyshim se në të ka fakte për një popull që mendon (logjikon).” (Nahl, 67).

“Zoti yt e frymëzoi bletën: Ndërto shtëpi nëpër kodra, nëpër drunj dhe nëpër ato që i ngritin (njerëzit). Pastaj ha nga të gjitha (llojet e) frutave dhe ec rrugës së Zotit tënd. Nga barqet e tyre del lëng, ngjyra e të cilit është e ndryshme dhe në të cilin ka shërim për njerëzit. Edhe në këtë ka dëshmi për atë popull që mendon thellë.” (Nahl, 68-69).

Në këto dy kontekste vërehet se kafshët janë të përmendura në mënyrë të barabartë. Tani të shohim se prej cilave pikëpamje janë ekspozuar veç e veç në secilin kontekst dhe pse është ekspozuar kjo pikëpamje këtu e pse ajo tjetra atje:

a) Versioni i parë vizaton pikturën me shtëpi, vendstrehime, hije dhe petka; të gjitha ose kanë karakter dëfryes ose karakter mbrojtës, ose hijedhënës ose mbulues.

Meqë ky është “unjësim vizatimor” prej kafshëve, u paraqit aspekti i cili përputhet me këtë unjësim. Kur’ani paraqiti lëkurët të cilat shfrytëzohen për shtëpi (tenda) të cilat barten lehtë kur udhëtohet. Pastaj lesi (i dhenve), qimet (e deveve) dhe fijet (e dhive) të cilat shfrytëzohen për petka dhe shtrojë. E gjithë pamja është pamje shtëpishë, petkash dhe hijesh.

b) Versioni i dytë pasqyron një pamje të nxjerrjes së pijeve: vera e cila fitohet nga frutat dhe mjalti i cili fitohet nga bletët. Meqë ky është unjësim vizatimor, prej kafshëve u paraqit aspekti i cili përputhet me pijet, u paraqit qumështi për ata që e pijnë.

Përpikëria e harmonizimit nuk u ndal në unjësimin e pamjes së përgjithshme por vazhdoi edhe në hollësitë e detajeve: Ja, vera fitohet nga frutat, të cilët përngja forma nuk i ngjajnë verës; dhe ja, mjalti fitohet nga nektari i luleve, të cilat përngja forma dhe natyra nuk i ngjajnë mjaltit, dhe ja qumështi, nxirret ndërmjet ushqimit të përpunuar dhe gjakut, të cilët përngja forma dhe natyra nuk i ngjajnë qumështit. Megjithatë, që të gjitha këto është e pamundur të prodhohen prej gjërave tjera. Mandej i gjithë procesi është proces bujqësor e gjedhor në të cilin ka jetë.

Pra kjo është ajo forcë krijuese e cila i unjëson detajet, i përpikëron ilustrimet dhe e harmonizon shfaqjen. Shembuj të ngjashëm me këto prekshmëri të përpikta të cilat i përshkojnë hollësitë e detajeve kemi shumë në Kur’an, por ne do të mjaftojmë me këta shembuj duke ua shtuar edhe shembullin vijues i cili ka disa karakteristika të veçanta:

4 - “Ata që të zotohen ty, në të vërtetë ata i zotohen Allahut, se dora e Allahut është mbi duart e tyre. E kush e thyen (zotimin), ai e thyen vetëm në dëm të vetin, e kush e zbaton atë për të cilën i

është zotuar Allahut, Ai do t'i japë atij shpërblim të madh.” (Fet'h, 10).

Këtu piktura është pikturë zotimi me duar, e për ta harmonizuar tërë ambientin e bëri “dorën e Allahut mbi duart e tyre”. Kur’ani u shërbye me këtë trupëzim në sferën e indiferimit absolut dhe abstraktizimit total.

Dijetarët e belagës (retorikës-stilistikës) këtë lloj harmonizimi e quajnë “konsolidim i të krahasueshëmve” dhe i japin rëndësi aspektit gjuhësor, sepse ata nuk u përpoqën ta hulumtojnë aspektin ilustrativ. Ne do ta përdorim të njëjtën shprehje “konsolidim i të krahasueshëmve” dhe do ta vëmë në spikamë aspektin e harmonizimit artistik në atë pikturë, që të ruhet “unjësimi vizatimor”, ambienti skenik dhe simetria (përputhshmëria) e përgjithshme.

Por, Kur’ani nuk shërbehet vetëm me këto “prekshmëri subtile” në ilustrim por edhe me “prekshmëritë dimensionale” (e ne këtu shprehemi me gjuhën ilustrative sepse në realitet jemi në fushë të ilustrimit para se të jemi në fushë të interpretimit). Këto prekshmëri dimensionale ndonjëherë përfshijnë qiellin dhe tokën në njëthurje, e ndonjëherë skenat e natyrës dhe të jetës në një kontekst. Përkundër kësaj, pergamenti i vizatimit ka hapësirë për t’i pranuar të gjitha këto në bazë të “unjësimit të madh” në vend të “unjësimit të vogël”.

1 - Për shembull: “Vallë a nuk e shikojnë deven se si është krijuar; edhe qiellin se si është ngritur; edhe malet se si janë vendosur; edhe tokën se si është shtruar.” (Gâshije, 17-20).

Ky peizazh përfshinë qiellin, tokën, kodrat dhe devet në një shfaqje; kufijtë e së cilës janë këto hapësira të gjera të jetës dhe natyrës. Këtu vërehet ajo gjerësi kolosale e cila sjell në ndjenjë një

huti dhe befasi. Detajet e pikturës janë të shpërndara mes vijës horizontale në qiellin e ngritur dhe tokën e shtrirë dhe vijës vertikale mes maleve të vendosura dhe deveve të larta e të mëdha.

Këto janë hollësi të cilat i përvjedh syri i ilustruesit krijues si përnga forma ashtu edhe përnga pesha.

Ajo që mund të vërehet këtu me syrin e ilustruesit është edhe ajo se; një peizazh natyror që për bazë i ka qiellin dhe tokën, nuk mund të vërehet nga sendet e ngurta pos maleve, e as prej sendeve të gjalla pos deveve ose diç që është në madhësi të deveve. Kurse deveja është kafshë e përshtatshme sepse ajo është shoqëruese e shkretëtirave të rrafshta të cilat kufizohen me qiellin dhe malet!

2 - Po i të njëjtit synim - me ndryshime në vendet e prekshmërive - është edhe ajeti: “Ne në qiell kemi krijuar galaktika yjesh dhe e kemi zbukuruar atë, për ata që e shikojnë me vëmendje, dhe e kemi ruajtur nga çdo djall i mallkuar. Përveç atij që vjedh (përgjon) çka dëgjohet, po edhe atë e kap ylli i zjarrtë dhe i dukshëm. E tokën e kemi shtrirë dhe në të kemi ngritur kodra dhe kemi mbirë në të çdolloj (bime) në masa proporcionale. Dhe Ne ua bëjmë në të jetesën edhe atyre për të cilët ju nuk jeni furnizues (nuk i mbani).” (Hixhr, 16-20).

Në qiell ka “galaktika yjesh” impozante dhe yje të zjarrra të cilat i përmbysin të papërlshmit. E në tokën e shtrirë ka male të larta dhe bimë “në masë proporcionale” (e nuk tha “bimë” të mrekullueshme)! Në tokë ka gjithashtu “jetesa” të cilat janë të përmendura në shumës, ato aludojnë në numër të madh dhe asosh që nuk furnizohen dhe mbahen nga njerëzit. Pra, ai shprehet kështu në këtë mënyrë denoncuese dhe përcmuese... E gjithë kjo është përplot skena të cilat i unjësoi madhështia konkrete (shqisore) dhe abstrakte (imagjorative).

3 - Ndonjëherë zgjerohet pëlhura e vizatimit dhe zgjatet hapësira e saj. Gjithashtu paraqiten kontaktet të cilat në përfundim bëhen më precize ashtu që i përfshijnë edhe detajet:

Si shembull: “S’ka dyshim se vetëm Allahu e di kur do të ndodhë kijameti. Ai e zbret shiun. Ai e di se çka ka në mitra (të shtatzëneve), askush nuk e di se çka do t’i ndodhë të nesërmen dhe askush nuk e di se në ç’vend do të vdesë. Allahu është më i dijshti, më i njohuri.” (Llukmân, 34).

Kjo është një pëlhurë e gjerë që përshtatet me kohën dhe vendin, me të tashmen reale dhe ardhmërinë e parashikueshme, me fshehtësitë e paarritshme, dhe në ndërmendjet e emocionit dhe në kërcimet e imagjinatës qëndron kijameti me largësi të paperceptuar; shiu me burim të largët; ajo që është strukur në mitër e panjohur për syrin si për nga emri ashtu edhe për nga realiteti i tij; furnizimi (rrizku) për të nesërmen i cili është afër sipas kohës por i fshehur për dijen; dhe vendi i vdekjes (varrosjes) i cili është larg paramendimit.

* * *

Ajo është një pëlhurë vizatimore me gjerësi të kohës dhe vendit. Mirëpo prekshmëritë dimensionale pasi që arriten në të gjitha poret dhe trokasin në këndet e saj (pëlhurës), dhe t’i bashkojë ato në sheshin e sekretit të paarritshëm, do të qëndrojnë bashkërisht para një sporteli të vogël e të mbyllur. Sikur prej tij të hapej një vrimë sa vrima e gjilpërës, do të barazohej e të bashkohej e afërta pas saj me të largëtën dhe do të shpaloseshin ato shumë të vonshmet dhe ato të çastit.

Më tej ngrihemi në një hapësirë tjetër nga hapësirat e harmonizimit artistik sipas ilustrimit kur’anor.

Deri më tash harmonizimi bëhej në pikturë apo skenë. Ai ishte më i suksesshmi dhe më i ploti sa u përket detajeve dhe ambientit të përgjithshëm. Mirëpo krijimtaria e mrekullueshme nuk ndalet këtu. Ajo në disa momente pikturën e përkufizon në përshkrim kurse skenën në ndriçim, ashtu që përshkrimi dhe ndriçimi ndërliiden me pikturën dhe skenën që pastaj të lidhet përreth ritmi muzikor i cili i përshtatet gjithë kësaj, në mënyrë që ta arrijë atë që e shpreh ky shembull:

1 - “Pasha mëngjesin (paraditën). Dhe natën kur e shtrinë errësirën! Zoti yt nuk të ka braktisur as nuk të ka përbuzur. Por, vërtet bota tjetër (ahireti) është më e mirë për ty se sa e para (dunjaja). E Zoti yt do të të japë ty, e ti do të kënaqesh. A nuk të gjeti ty jetim e të strehoi. Dhe të gjeti të paudhëzuar e të udhëzoi. Dhe të gjeti të varfër e të pavarësoi (nga të tjerët me pasuri). E jetimin mos e nënçmo. As lypësin mos e refuzo. E dhuntitë e Zotit tënd shprehi!” (Duhâ, 1-11).

Këto shprehje nxorën në pah një ambient të përkëdheljes së ëmbël dhe mëshirës së butë, kënaqësisë së plotë dhe ngushëllimit të dhembshëm. “Zoti yt nuk të ka braktisur as nuk të ka përbuzur. Por, vërtet bota tjetër është më e mirë për ty se sa e para. E Zoti yt do të të japë ty e ti do të kënaqesh”. Pastaj: “A nuk të gjeti ty jetim e të strehoi. Dhe të gjeti të paudhëzuar e të udhëzoi. Dhe të gjeti të varfër e të pavarësoi”. Kjo pra është përkëdhelje, është mëshirë, është kënaqësi dhe është ngushëllim. Të gjitha këto derdhen përmes vargjeve të shprehjes së ëmbël me fjalë të buta dhe përmes muzikës joshëse të shprehjes me lëvizje të shkallëzuar, me hapa të ngadalësuar, me tingull të ulët dhe me ritëm të dhimbshëm. E Kur’ani dëshiroi ta përshkruajë këtë përkëdhelje të ëmbël, këtë mëshirë të butë, këtë kënaqësi të plotë dhe këtë ngushëllim të dhembshëm. Përshkrimin e filloi nga mëngjesi i ndritshëm dhe nata kur shtrinë errësirën. Këto janë dy peizazhet më të bukura të

natës dhe të ditës dhe dy kohët më të përshtatshme për soditje. Ato i ndërthuri me fjalë cilësuese të përshtatshme. “Natë e bukur” është ajo kur fillon të shtrihet errësira e jo nata e trishtueshme me errësirën skëterrë të saj. Nata kur fillon të shtrihet errësira është e butë dhe e pastër. E mbulojnë disa re përkëdhelëse, ngushëlluese dhe të dhembshme, mu si ambienti i jetimit dhe të varfërit. Pastaj shpaloset dhe shkëlqen atëherë kur pason mëngjesi i ndritshëm me fjalët: “Zoti yt nuk të ka braktisur as nuk të ka përbuzur. Por, vërtet bota tjetër është më e mirë për ty se sa e para. E Zoti yt do të të japë ty e ti do të kënaqesh”. Kështu përputhen ngjyrat e pikturës me ato të përshkrimit për t’u plotësuar harmonizimi dhe akordimi.

2 - Tash dëgjo një muzikë tjetër, shiko një përshkrim tjetër të një pikturë e cila krahasohet me këtë pikturë:

“Pasha vrapuesit e shpejtë (kuajt) që hingëllojnë! E që qesin xixa nga thundrat e tyre. Dhe i vërsulen (armikut) në mëngjes. Dhe në atë rast ngrenë pluhur. Dhe ashtu hedhen në mesin e grumbullit (të armikut). Vërtet, njeriu është përbuzës ndaj Zotit të vet. Edhe vet është dëshmues i asaj (përbuzjeje). Dhe ai është shumë lakmues i pasurisë. A nuk e di ai se do të nxirret çka ka në varreza? Dhe të dalë në shesh (e tubuar) ajo që ishte në gjokse. E atë ditë, pa dyshim, Zoti i tyre është i njohur hollësisht për (çështjen) e tyre.” (Adijat, 1-11).

Këtu muzikaliteti është shumë i ngjashëm me muzikalitetin e ajeteve të sures Naziât të cilën e kaluam. Bile ky është më i ashpër dhe më tronditës. Në të ka vrazhdësi, thërrmim dhe plasaritje. Ai i përngjan ambientit të buçitjes së pluhurosur të cilën e krijojnë varrezat e shkapërderdhura dhe gjokset që nxjerrin prej tyre në shesh atë që kanë punuar dhe ambientit të refuzimit dhe tërheqjes së fortë. E kur Kur’ani dëshiroi që gjithë kësaj t’i japë një

përshkrim të përshtatshëm nga ambienti i buçitjes së pluhurosur, zgjodhi kuajt e shpejtë që hingëllojnë, e që nga thundrat e tyre xixat xixëllojnë, që vërsulen herët në mëngjes dhe që në atë rast çojnë pluhur. Në këtë mënyrë përshkrimi u bë pjesë e pikturës dhe piktura pjesë e përshkrimit me përpikmërinë e harmonizimit dhe bukurinë e zgjedhjes.

Këto janë dy përshkrime të cilët çdonjëri prej tyre ka ngjyrë të veçantë ose dy ngjyra të përafërta. Vetë piktura në brendinë e saj ka një ngjyrë ose dy ngjyra rë përafërta, por përshkrimi mund të ketë më shumë se një ngjyrë, kur edhe pikturën që e ka me vete e ka të tillë, siç është rasti me suren El-Lejl:

“Pasha natën që e mbulon terri. Pasha ditën kur ajo shkrepëtinë! Pasha Atë që krijoi mashkullin dhe femrën. Vërtet, veprimi juaj është i llojlojtë. E, sa i përket atij që jep dhe ruhet. Dhe vërteton (atë) më të bukurën. Ne do t’ia lehtësojmë të lehtën (rrugën e kënaqësisë). Kurse atij që është koprrac dhe e ndien veten të pavarur (nga Zotit) dhe që përgënjeshtroi atë më të bukurën. Ne do t’ia lehtësojmë të vështirën (rrugën e ndëshkimit). E pasuria e tij nuk do t’i bëjë dobi kur do të hedhet (në varr). E jona është vetëm të udhëzojmë. Dhe vetëm e Jona është bota tjetër si dhe kjo. Unë ua kam tërhequr vërejtjen për zjarrin që këndellet. Në te nuk hedhet pos ai më i prishuri. I cili përgënjeshtroi dhe u tërhoq (nga besimi). E larg tij do të jetë më i druajturi. Ai që jep pasurinë për t’u pastruar e jo për ta shpërblyer ndokë që i ka bërë mirë më parë. Por vetëm për ta fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të lartit. Ai me siguri do të jetë i kënaqur.” (El-Lejl, 1-21).

Këtu kemi një pikturë që pasqyron të bardhën dhe të zezën. Në te ka të atillë që “japin dhe ruhen” dhe të atillë që janë “dorështrenguar dhe e ndiejnë veten të pavarur”. Në te ka të atillë që ia përgatisin vetes të lehtën dhe të atillë që ia përgatisin vetes të

vështirën. Në te është edhe i prishuri që do të hedhet në zjarr të këndellur dhe i druajturi që do të jetë i kënaqur dhe i sigurt.

Në përshkrimin gjithashtu të bardhë dhe të zi kësaj here: “Nata që e mbulon terri (e jo nata që e shtrinë errësirën). Në te është edhe dita kur ndriçon e cila plotësisht i qëndron përballë natës kur “e mbulon terri”. Këtu janë: mashkulli dhe femra të përballshëm përngja lloji dhe krijimi... Ky edhe është përshkrim i përshtatshëm për pikturën të cilës i bashkangjitet.

Ndërsa muzika që e shoqëron atë është më e vrazhdë dhe më e lartë se muzika në suren Duhâ, mirëpo ajo nuk është e ashpër e as ekstreme sepse këtu ambienti më shumë është rrëfyes dhe proklamues se sa kërcënues dhe qortues.

Edhe kjo, pa dyshim është një madhështi e harmonizimit.

* * *

Më pas do të ngjitemi në një hapësirë tjetër prej hapësirave të harmonizimit artistik në Kur'an.

Kur ilustrimi kur'anor përfundon me harmonizimin e ngjyrave dhe detajeve në këtë pikturë apo në atë skenë, dhe kur i bashkangjitet atij muzika plotësuese në ambient, nuk përfundon edhe me harmonizimin e realizimit. Ekziston edhe një hap pas gjithë kësaj i cili është i domosdoshëm për harmonizimin, i domosdoshëm për stimulimin e skenës dhe për përkryerjen artistike në te. Ai është intervali i caktuar për mbetjen e skenës së shfaqur në shqisat e imagjinatës. Harmonizimi kur'anor e vëren këtë dhe e realizon në formën më të lartë.

Disa skena kalojnë shpejtë dhe grabitshëm, përpak e të grabiten sytë nga shpejtësia që e kanë, dhe pothuajse vetë imagjinata nuk mund t'i përcjellë. Disa skena zgjaten e zgjaten saqë në disa çaste njeriut i duket se ato nuk përfundojnë. Disa nga këto skena të gjata janë përplot lëvizje dhe aksione e disa të tjera të palëviz-shme që nuk shfaqen gjatë. Të gjitha këto realizohen duke e patur parasysh një qëllim të veçantë në skenë i cili përputhet me qëllimin e përgjithshëm të Kur'anit. Me të plotësohet harmonizimi në realizimin e atyre skenave në mënyrën më të plotë.

Shkurtësitë (thurjet e shkurta) kanë metoda të ndryshme por edhe gjatësitë (thurjet e gjata) kanë metoda të llojllojshme. Çdonjëra prej tyre e realizon qëllimin (synimin) dhe i përshtatet ambientit të skenës. Ky është një hap tjetër në këtë hapësirë të re. Tani të kalojmë në shembujt ngaqë ata janë të vetmit që kanë mision dhe porosi.

1 - Kur'ani dëshiron t'ua ilustrojë njerëzve shkurtësinë e jetës së dunjasë e cila i mashtron në krahasim me jetën e ahiretit.

Ai këtë shkurtësi në këtë pikturë e pasqyron në këtë mënyrë:

“E ti (Muhammed), krahasoju atyre shembullin e jetës së kësaj bote me ujin që e lëshojmë Ne nga qielli, e me te përzihet bima në tokë, e (pas pak) ajo bëhet bar i thatë (byk) që e shpërndajnë erërat.” (Kehf, 45). Me këtë përfundon shiriti i tërë jetës përmes këtyre fjalive të shkurtra dhe në këto tri skena të njëpasnjëshme.

“Ujin që e lëshojmë Ne nga qielli”; “Me të përzihet bima në tokë”; “E (pas pak) ajo bëhet bar i thatë (byk) që e shpërndajnë erërat”.

Vallë, a ka jetë më të shkurtë?!

Megjithatë Kur'ani i paraqiti të gjitha etapat e zhvillimit të bimës pa mos munguar asgjë - përveç etapave të dorës së dytë - e paraqiti ujin me të cilin ushqehet, pastaj ai përzihet me tokën dhe mbinë, pastaj paraqiti përpjekjen e tyre dhe në fund tharjen dhe shpërndarjen e tyre. E çka mbeti prej jetës bimore pos etapave dytësore?

Në këto shprehje kur'anore janë bashkuar të gjitha elementet e realitetit, përpikërisë dhe bukurisë. Realiteti në paraqitjen e stadeve bimore. Aty nuk mungoi asgjë për ta realizuar qëllimin fetar. Përpikëria, sepse ajo e realizoi porosinë e pikturës plotësisht. Bukuria ngase shpejtësia e saj grabitçare e vuri në aksion imagjinatën.

Në këtë rast u shfrytëzua simetria gjuhësore në shkurtimin e shfaqjes së skenës, ashtu siç u shfrytëzuan mjetet e shfaqjes artistike për këtë synim. Ky “kontinuitet” të cilin e përfaqëson “fe-ja” (në tekstin origjinal sh.p.) në përcjelljen e etapave përputhet me mënyrën e shfaqjes së shpejtë. Pastaj ky ujë i zbritur (shiu) në këtë ajet nuk përzihet me tokën e të mbijnë bimët e tokës në mënyrë direkte. Ky edhe është realiteti, por realitet i cili shfaqet në mënyrë të posaçme dhe e realizon shpejtësinë e duhur.

2 - Ngjashëm me këtë tekst, në domethënie dhe drejtim kemi edhe një tekst tejtër, por ai ndryshon prej tij në një hallkë me të cilën realizon një qëllim tjetër krahas synimit të mëparshëm:

“Dijeni se jeta në këtë botë nuk është tjetër vetëm se lojë, dëfrim, stolisje dhe mburrje ndërmjet jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe fëmijëve! Kjo i shëmbëllen bimës e cila pas shiut rritet dhe i entuziazmon bujqit jobesimtarë, e pastaj ajo thahet dhe e sheh të zverdhur, mandej bëhet e thyer (e llomitur).” (Hadîd, 20).

Kjo pikturë e ekspozuar është unike për afërsisht me pikturën e parë sa i përket jetës së shkurtë. Ndoshta edhe kjo u përhitet disave se aty ka përsëritje totale. Në realitet, aty ka ndryshime të hollësishme (subtile). Kur'ani e zgjati shfaqjen e shiritit të jetës në dunja - siç e shohin mosbesimtarët - duke i thënë lojë, dëfrim, stolisje, mburrje ndërmjet tyre dhe përpjekje për shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, me qëllim që t'u thotë: E gjithë kjo që ju entuziazmoheni me të dhe që mundoheni t'ia zgjatni afatin, ajo në realitet është e shkurtë dhe kalimtare, mu ashtu si shiu që i bien bimës dhe i entuziazmon mosbesimtarët, e ajo pastaj thahet dhe e sheh të zverdhur, mandej bëhet e llomitur.

Këto pra janë detajet e pikturave të përsëritura në Kur'an. Në çdo përsëritje kemi një pikturë e cila ndryshon pak a shumë. Ajo mohon supozimin e përsëritjes pa ndonjë qëllim tjetër pos përsëritjes. Ndonëse të përsëriturit e ka luajtur rolin e vet në fillim të da'ves (thirrjes islame), megjithatë ai shtrihet sipas bukurisë artistike me ndryshime të hollësishme dhe të ndieshme.

3 - Në dy shembujt e mëparshëm shkurtësia u bë me heqjen e etapave sekondare. Këtu kemi një shembull tjetër në të cilin paraqitet shkurtësia e jetës në të njëjtën mënyrë por me një shkurtim edhe më të madh. Ai i kap dy skajet e jetës dhe i bashkon në një dremitje të rrufeshme dhe në të njëjtën kohë e përfytyron distan-cën e gjatësisë mes dy skajeve:

“Juve ju preokupoi grumbullimi (i pasurisë dhe fëmijëve). Deri atëherë kur t'i vizitoni varrezat (të bëheni banorë të tyre).” (Tekâthur, 1-2).

Kjo pikturë nga aspekti i përfytyrimit të shkurtësisë së jetës fillon me grumbullimin e pasurisë dhe të fëmijëve dhe përfundon me varrezat. Kjo është periudha më e shkurtë që mund të

përfytyrohet jeta si në fjalë ashtu edhe në imagjinatë. Por ajo nga një aspekt misterioz (i padukshëm e i fshehtë) shfaq vazhdimësinë e dëfrimit (preokupimit) aq sa zgjatë jeta që nga fillimi e deri në mbarim, kurse fjala “hatta” (në tekstin origjinal sh.p.) ndihmoi në shfaqjen e gjatësisë. Ajo ia përfytyroi shpirtit se ata njerëz iu mbështetën dëfrimit një kohë të gjatë. Kjo pra është prej çudirave (madhështive) të imagjinimit. Qëllimi i shkurtimit të jetës dhe qëllimi i dëfrimit në te, që të dy ishin në synimin kur'anor dhe që të dy u realizuan në këtë pasus të shkurtë.

4 - Në të njëjtin drejtim, por me një synim tjetër, shfaqet ky ajet:

“Si e mohoni Allahun, e dihet se ju ishit të vdekur e Ai ju ngjalli, mandej ju bën të vdekur e pastaj ju ringjall, e pastaj tek Ai do të ktheheni?” (Bekare, 28).

Në katër pasuse të shkurtra të një paragrafi u paraqit rrëfimi për krijimin para të shfaqurit të tij për një etapë dhe deri pas përfundimit të saj për një etapë: Vdekja e cila ishte para jetës është jetë, dhe vdekja me të cilën përfundon jeta është jetë pas vdekjes.

Vdekja e cila ishte para jetës ishte e përhershme pa fillim (ezel), jeta e cila vijoi pas saj ishte e përkufizuar me fillim dhe mbarim (emed) ndërsa vdekja e cila pason pas jetës është e përhershme dhe pa mbarim (ebed)... Të gjitha përmbliidhen në ca fjalë që të shfaqet vetia e shpejtësisë, por ajo zgjatet në imagjinatë kur ekspozohet. Ajo ka për qëllim këtë konkluzë: Të gjitha këto etapa të gjata janë të shkurtra në dorën e “Fuqisë së madhe”.

Kur'ani e ilustron fuqinë e Të Fuqishmit i cili i thotë diçkaje: “Bëhu, dhe ajo bëhet”, ndërsa shpejtësia ia shton ndriçimin fuqisë, sidomos kur këto periudha të gjata janë përfshirë sa një kapsitje

(vezullimë). E si pra e mohoni Allahun, kur Ai i ka në duar çështjet tuaja para dhe mbrapa, “e pastaj tek Ai do të ktheheni”.

Dhe si plotësim i kësaj shpejtësie vjen ajeti vijues:

“Ai (Allahu) është që për ju krijoi gjithë atë që ka në tokë, pastaj vullnetin e Vet ia drejtoi qiellit dhe i përsosi ata shtatë qiej.” (Bekare, 29).

Kështu pra, sa një kapsallitje syri “për ju krijoi gjithë atë që ka në tokë” dhe po për aq “vullnetin e Vet ia drejtoi qiellit dhe i përsosi ata shtatë qiej”. Në disa vende tjera krijimi i asaj që është në tokë ose i diçkaje që është krijuar në tokë, merr kohë me ajete të tëra atëherë kur synohet sqarimi dhe zgjatja.

5 - Me kaq do ta lëmë shpjegimin e shkurtësisë me etapat e saj të rezyмуara ose të bashkangjitura. Kurse tash do të japim shembull tjetër ku shkurtësia vjen nga ngjyrosjet e brushës së shpejtë me ngjyrosje të vrullshme (furishme). Kjo brushë madhështore e cila pak ngjyros këtu e pak atje, e pastaj mbështillet e gjithë pëlhura e pikturuar sikur të mos ishte shfaqur asnjëherë. Sa merr drejtim imagjinata për ta shikuar, kur qe, ajo e humb prej syve dhe nuk e takon.

“E kush i përshkruan shok Allahut, ai është sikur të bie nga qielli e ta rrëmbejë shpendi ose e hedh era në ndonjë vend të largët (e të panjohur).” (Haxh, 31).

Shiko: Ai bie nga qielli, shiko: Atë e rrëmbeu shpendi, shiko: Atë e hedh era në ndonjë vend të largët e të panjohur, shiko: Skena u mbyll dhe ata që ishin në te u zhdukën!

E pse kjo shpejtësi e rrëmbyeshme? - Që të mos ketë iluzione askush se ata që i përshkruajnë Allahut shok sipas natyrës (së sjelljeve) apo mënyrës së jetesës, apo pohimit me gojë, sado që të arrijnë pozitë, fuqi, pasuri e fëmijë, ai vjen për një çast nga një botë e panjohur (bota para lindjes sh.p.) dhe shkon për një çast në një botë të panjohur (botën pas vdekjes sh.p.).

Tani do të kalojmë në skenat e gjata:

1 - Ne e pamë rrëfimin për ujin i cili bie nga qielli e me te përzihet bima e tokës e pastaj bëhet bar i thatë (byk) që e shpërndajnë erërat. Atje u shfaq në çaste të rrufeshme e tani të shohim se si një pjesë e tij shfaqet ngadalë dhe qetë.

“Allahu është Ai që i çon erërat, e ato lëkundin retë dhe Ai i shtrinë lart si të dojë e i bënë ato edhe të ndara në pjesë, dhe përmes tyre e sheh se si bie shi, e kur ia lëshon atë kujt të dojë prej robërve të Vet, qe ata gëzohen.” (Rrûm, 48).

Kështu pra, pjesa e parë është unjësime të veçantës me arritjen e ujit në tokë që përfshinë këto paragrafe dhe shfaqet në këto etapa. Erërat lëkunden e me to lëkunden edhe mjegullat në qiell - ashtu siç dëshiron Allahu - e më pas grumbullohen, që mandej të dalë prej tyre shiu e të zbresë nga qielli, që të gëzohen ata që ishin të dëshpëruar para se t’u bie.

Të shohim se si paraqitet pjesa e dytë pasi që të arrijë uji:

“A nuk e sheh se Allahu lëshon ujë nga qielli dhe atë e shpërndanë në tokë nëpër burime, mandej me te mbijnë bimë të llojeve e të ngjyrave të ndryshme, pastaj ato thahen dhe i sheh të zverdhura, e më vonë të llomitura.” (Zumer, 21).

Kështu në mënyrë suksesive shprehet “pastaj”, “mandej” dhe në mënyrë të ngadalshme dhe graduale. Këtu uji zbret por nuk përzihet në tokë e as me bimët e tokës por shpërndahet nëpër burime. “Mandej me të mbijnë bimë”. Në të njëjtën kohë ka hapësirë për t’i përkujtuar ngjyrat e bimëve të llojllojshme. “Mandej ato thahen dhe i sheh të zverdhura”. Në ato çaste përsëri ka hapësirë për ta parë dhe për ta soditur. “Pastaj ato i bën të llomitura”. Këtu shprehet me shprehjen “ato i bënë”! kurse më parë thuhej “ajo bëhet bar i thatë”. “Mandej bëhet e llomitur” sikur të ishte bërë nga vetvetja dhe sikur të ishte pa shkaktues ose bërës! Këtu e bëri të llomitur dhe mbeti në atë formë e atje më parë kemi “që e shpërndajnë erërat” dhe mbetet pa ndonjë gjurmë.

Këtu ajeti ka për qëllim t’i shfaqë dhe t’i ekspozojë dhuntitë hyjnore. Shfaqja ishte e ngadalësuar, pikturat ishin të vëna, skenat ishin të plotësuara dhe ato si të tilla ishin më të përshtatshme për situatën, andaj edhe të fascionon gjatë gjithë këtij intervali të gjatë!

2 - Kemi edhe një pikturë tjetër të bimës me të cilën krahasohen Muhammedi dhe ata që ishin me të:

“Përshkrimi i cilësive të tyre është në Tevrat dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhil. Ata janë si një farë e mbjellë ku mbin filizi i vet, e ai trashet, përforcohet dhe qëndron në trungun e vet, ajo e mahnit mbjellësin. (Allahu i shumoi) për t’ua shtuar me ta mllëfin jobesimtarëve.” (Fet’h, 29).

Ç’po sheh në këtë bimë? - Ajo nuk po bëhet krejt e thatë dhe as nuk po e shpërndajnë erërat aspak. Ajo të duket se është e përforcuar në vendin e saj, e thellosur në rrënjët e saj dhe e përhershme në pozitën e saj. Koha e shfaqjes këtu është e përhershme, spektakli është i palëkundshëm saqë edhe syri nëse largohet prej tij, ai nuk largohet nga syri. Ky pra edhe është qëllimi

i synuar, ndërsa kjo vendosje stabile është rrugë prej rrugëve të gjatësisë.

Nga hollësitë subtile në këtë pikturë është se pamja e përgjithshme shtrihet në formë të zgjatimit siç thamë edhe më parë, mirëpo detajet e para të saj plotësohen në një shpejtësi të njëpasnjëshme (suksesive). “Ata janë një farë e mbjellë ku mbin filizi i vet” e “ai trashet” e “përforcohet” dhe “qëndron në trungun e vet”. Trashja (zhvillimi) dhe qëndrimi (pingul) u arritën për një afat të shkurtë e më pastaj u plotësuan dhe u stabilizuan. Qëllimi i shpejtimit të parë është si vendosja e fundit gjatë ilustrimit të gjendjes së muslimanëve që njëherë arrihet vitalizimi (zhvillimi) i tyre e më pas stabilizohet pozita e tyre përgjithmonë.

3 - Jeta (në shembujt e mëparshëm) tretej sa një dremetje e syrit që nga fillimi i saj e deri në fund. Tani të shohim se si u zgjat ajo këtu në shfaqjet e zgjatimit.

Vetëm një etapë prej etapave të jetës në veçanti në mesin e jetëve të shumta, përfshinë këtë interval dhe këtë hapësirë:

“Vërtet, Ne e krijuam njeriun me prejardhje prej baltës. Pastaj atë (prejardhjen) e bëmë pikë uji në një vend të sigurt. Më pas atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngjizur e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra dhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartësuar është Allahu, Krijuesi më i mirë.” (Mu’minûn, 12-14).

Etapat e foshnjës në barkun e nënës nga jeta njerëzore e jo nga jetat e të gjitha gjallesave përfshijnë këtë zbrazëtiirë dhe shfaqen me këto zbërthime duke i përkujtuar të gjitha hapat e zhvillimit, ngase ajeti është i ekspozuar për këshillë dhe vërejtje, dhe për të ndikuar

në ndërgjegje e për të proklamuar përpikërinë e diturisë hyjnore. Pra, në këso rastesh pa dyshim është mirë të bëhet zgjatimi.

4 - Nga skenat në të cilat zgjatet shfaqja ndonjëherë janë skenat e ndëshkimit në Ditën e kijametit. Pas trupëzimit të skenës e cila pothuajse duket se është e pranishme dhe sintetizimit të detajeve të saj e të cilat duken sikur të jenë të dëshmuara, zgjatet shfaqja e saj që ta ngacmojë ndjenjën, ta zgjojë imagjinatën dhe ta futë frikën dhe presionin në thellësinë e shpirtit dhe brendësinë e ndërgjegjes.

Për ta zgjatur shfaqjen në këtë rast, përdoren metoda të ndryshme, e ne do t'i ekspozojmë disa shembuj, ndërsa skenat e kijametit janë më të llojllojshmet në Kur'an.⁹

a) Ndonjëherë zgjatimi bëhet me fjalë përfytyruese për përsëritje. Shembull: "Është e vërtetë se ata që i mohuan argumentet Tona do t'i hedhim në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurët e tyre Ne ua ndërrojmë me lëkura të tjera që ta shijojnë dënimin." (Nisaë, 56).

Këtu imagjinata bëhet duke e inskenuar pamjen tmerruese dhe duke e përsëritur aksionin e trishtueshëm. Sa herë që i shtohet trishtimi dhe tmerri, shtohet dëshira për përsëritje. Kjo, ngase tmerri e tërheq për vete shpirtin dhe e lidhë ate sa herë që të tentojë të ikë!

b) Ndonjëherë zgjatimi bëhet me thirrjen siç është rasti me detajizimin pas rezymimit duke i ekspozuar detajet në tërësi.

Shembull:

⁹ Shih më gjerësisht librin Skenat e kijametit në Kur'an.

“Ata të cilët e grumbulluan arin dhe argjendin dhe nuk e dhanë në rrugë të Allahut, sihariqoi për një dënim të dhembshëm. Atë ditë kur ajo (pasuria e grumbulluar) fërgohet në prushin e xhehennemit, e me të (ashtu të skuqur) lyhen ballet, anët dhe shpinat e tyre (do t’u thuhet): Kjo është ajo që grumbulluat për veten tuaj, pra shijone atë që e grumbulluat.” (Tevbe, 34-35).

Ajeti së pari e përgjithësoi dënimin kur tha: “sihariqoi për një dënim të dhembshëm” dhe e ndërpreu fjalinë që të qetësohet shikuesi, ta përmbajë veten dhe të përgatitet për detajizim, e pastaj fillon ta prezentojë çështjen detalisht.

E së dyti, kur e filloi detajizimin pas përgjithësimit veprimi filloi që nga etapa e parë në mënyrë graduale, atëherë ari dhe argjendi u shndërruan në një grumbull e jo të veçuar, duke aluduar në copat e tyre të shumta. Këtu zgjatimi bëhet troç “Atë ditë kur ajo fërgohet” - e jo ato dyja fërgohen - dhe ja tani do ta shohim atë që fërgohet derisa të skuqet. Tani ajo u skuq ashtu që të fillojë procesi i tmerrshëm: lyerja e balleve me zharvën e prushit, e pasi e kryen lyerjen e ballit me zharavën e prushit atëherë iu kthyen anëve të trupit. Ja edhe anët e trupit po lyhen. Me anët e përfunduan lyerjen e tash iu kthyen shpinave. Ja edhe shpinave po lyhen.... Mos u ngut, se shfaqja ende s’është kryer. Aty do të shohim edhe shqetësime edhe qortime në momentin kur do të dalin sipas përfytyrimit që ta vuajnë dënimin në një kolektiv tjetër ku pret rendi i gjatë. Aty u thuhet: “Kjo është ajo që e grumbulluat për veten tuaj, pra shijoni atë që e grumbulluat”.

c) Ndonjëherë zgjatimi bëhet duke i detajizuar lëvizjet, duke i numëruar ato dhe me anë të përsëritjes të cilat i imagjinojnë fjalët bashkërisht:

“Këta janë dy kundërshtarë që janë zënë rreth Zotit të tyre; e atyre që nuk besuan, iu qepen rroba prej zjarri e u hedhet uji i valë mbi kokat e tyre. Me atë u shkrihet krejtë ajo që kanë në barqet e tyre e edhe lëkurët. Për ata janë edhe kamxhikët e hekurt. Sa herë që përpiqen të dalin prej tij nga vuajtjet e padurueshme, kthehen me dhunë në të përsëri (u thuhet): vuane dënimin me djegie!” (Haxhixh, 19-22).

Kjo është skenë e vrazhdë dhe e buçitshme, përplot lëvizje të përsëritshme. Aty janë rrobat prej zjarri të cilat prehen dhe qepen. Aty është edhe uji valë i cili u hedhet mbi koka, i cili shkrinë atë që kanë në barqe dhe lëkura. Aty janë edhe kamxhikët prej hekuri të cilët edhe më shumë i shtojnë dhimbjet e dënimit. Aq sa edhe u kapërcehet çdo forcë durimi dhe tentojnë, “ata që nuk besuan” të dalin nga zjarri, uji valë dhe rrahjet shpirtëdjegëse, të dalin nga këto “vuajtje të padurueshme”, por ata kthehen përsëri dhunshëm: “Vuane dënimin me djegie”. Imagjinata mbetet duke e përsëritur këtë pikturë që nga episoda e parë e deri te e fundit dhe derisa të mbërrijë në episodën e daljes e pastaj kthyerjes së dhunshme që të fillojë shfaqja e njëjtë përsëri!

d) Ndonjëherë zgjatimi bëhet përmes ndaljes së aksionit në skenë dhe zhveshjes së tij nga çdo gjë që parafytyrohet në të lëvizja. Dhe ja ky është “zullumqari” i cili Ditën e kijametit po rrin, sikur të ishte i vetëm në skenën e teatrit. Ai fillon të pendohet dhe e përsërit këtë disa herë saqë kërkon t’i thuhet “Mjaft o njeri, s’ka dobi” Edhe pse koha të cilën e shfrytëzon është relativisht e shkurtë, përsëri të duket se ajo është shumë e gjatë “Atë ditë zullumqari do t’i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: Ah, sikur unë ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit. O i mjeri unë, ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi që e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej saj, e djalli është ai që e humb njeriun dhe e lë të vetmuar.” (Furkân, 27-29).

Ky pendim i gjatë dhe përkujtim i të kaluarës i shoqëruar me melodinë e gjatë e të zvarritur, dhe me muzikën e valëzuar dhe të ngadalësuar, ta përfytyron zgjatimin edhe pse fjalët relativisht janë të pakta. Zgjatja e rastit të pendimit përputhet me ndjeshmërinë intuitive të kërkuar.

I ngjashëm me rastin e pendimit është edhe rasti i pranimit. Ja, një grupi prej mizorëve-kriminelëve u shtrohet pyetja: “Ç’ju solli juve në Sekar (xhehennem)?”. Ata përgjigjen: “Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënin namaz). As nuk kemi qenë (prej atyre) që ushqenin të varfërit. Por jemi lëshuar (në biseda të kota) me bjerraditësit (badihavxhinjtë). Dhe kemi qenë që e përgënjeshtrojmë Ditën e fesë (gykimit). Derisa na erdhi e sigurta (vdekja).” (Muddeththir, 42-47). Do të mjaftonte sikur të thonin: Ishim mohues ose përgënjeshtgues, por në këtë pozitë është më e përshtatshme të bëhet pranimi i mëkatit!

e) Nganjëherë marrin pjesë të gjitha mënyrat e mëparshme për zgjatjen e shfaqjes së skenës. Ajo bëhet përmes lidhmërisë së fjalëve dhe cekjes së detajeve. E në disa akte të shfaqjes ndërpritet shfaqja e skenës si me rastin e këtij shembulli të veçantë: “E kur të fryhet njëherë në sùr. E të bëhen toka e kodrat e të copëtohen përnjëherë. Atë ditë do të ndodhë ajo që duhej të ndodhë (kijameti). E qielli çahet, ngaqë ai atë ditë është i rraskapitur. Engjëjt qëndrojnë në skajet e tij, e atë ditë, tetë (engjëj) e bartin arshin e Zotit tënd. Atë ditë do të ekspozoheni, duke mos mbetur i fshehur asnjë sekret i juaj”. “Kujt t’i jepet libri nga e djathta e tij, ai do të thotë: Qe, lexoni librin tim! Unë kam qenë i bindur se do ta jap llogarinë time. Ai atëherë është në një jetë të kënaqshme. Në një kopsht të lartë (të mrekullueshëm), frutat e të cilit janë të ulët (afër duarve). (U thuhet atyre): Hani e pini dhe ju bëfshin mirë për atë që keni punuar në ditët e kaluara!”. “E kujt t’i jepet libri nga e majta e tij, ai do të thotë: O i mjeri unë, të mos më jepej fare libri

im. Dhe të mos dija fare për llogarinë time. Ah, sikur të kishte qenë ajo (vdekja) mbarim i amshueshëm. Pasuria ime nuk më solli dobi. M'u zhduk edhe mbretëria ime (vullneti i lirë). (U thuhet Zebanive): Kapeni atë dhe lidhjani prangat. Pastaj në xhehennem fërgojeni. Mandej, lidhne atë me një zinxhir të gjatë shtatëdhjetë kute. Pasi ai ka qenë që nuk besoi Allahun e Madhëruar. Ai nuk nxiste për t'i ushqyer të varfërit. Prandaj ai sot nuk ka këtu ndonjë mik. As ushqim tjetër përpos qelbësirës, të cilën nuk do ta hajë kush, pos mëkatarëve.” (Hâkka, 13-37).

Në këtë shfaqje kemi zgjatim të detajeve, zgjatje të shprehjeve dhe zgjatje të melodive, por edhe ndërprerje në disa seri. Dhe si sintetizim i gjithë kësaj atmosfere, vjen zinxhiri i cili është “i gjatë shtatëdhjetë kute” për ta spikatur njërën prej metodave të zgjatimit me anë të imagjinatës!

5 - Prej metodave të zgjatimit të synuar janë edhe rastet e krahimit të dy pikturave përballë njëra-tjetrës. Njëra në jetën e kësaj bote e tjetra në Ditën e kijametit, dhe ate në këtë mënyrë:

“Libri i të mirëve gjendet në Il-lijjûnë! E kush të mësoi ty se çka është Il-lijjûnë? Është një libër i qëndisur qartë, të cilin e dëshmojnë të afërtit e Zotit (engjëjt). E s'ka dyshim se vepërmirët janë në përjetime kënaqësie. Të mbështetur në kolltukë vështrojnë. Në fytyrat e tyre do ta njohësh freskinë e begative. U jepet të pijnë pije në enë të mbyllura. Pije që në fund i vjen era misk! E për ta fituar këtë le të garojnë garuesit (ata që i lakmojnë ato). Shija e tij është prej Tesnimit. (Ai është) kua prej të cilit do të pijnë të afërtit e Zotit”.

“Vërtet, mëkatarët qesheshin me ata që besuan. Dhe kur kalonin pranë tyre, ia bënin me sy njëri-tjetrit. E kur ktheheshin te familjet e veta, ktheheshin tallshëm (e argëtueshëm). E kur i

shihnin (besimtarët) thonin: S'ka dyshim se këta janë të humbur. Por ata nuk janë dërguar për kujdestarë të tyre”.

E sot në Ditën e gjykimit, ata që besuan do të tallen me jobesimtarët.” (Mutaffifinë 18-34).

Ky zgjatim shqyrton dy skena: Skenën e begatisë së madhe me të cilën do të dëfrehen të afërtit e Zotit, dhe skenën e talljes të cilën e përjetojnë kriminelët (mëkatarët). Dhe sa herë që të zgjaten këto dy skena, e sidomos skena e fundit, befasia bëhet edhe më e vrullshme, atëherë kur thuhet:

“E sot (në Ditën e gjykimit) ata që besuan do të tallen me jobesimtarët”. Ky pra, edhe është qëllimi.

6 - Zgjatja e rasteve të cilat shfaqen si shembuj për imanin ndikon vrullshëm në ndërgjegjen e njeriut dhe i fton shikuesit që të marrin pjesë me besimtarët në adhurimin dhe virtytet e tyre të ekspozuara për spektatorët. Raste të tilla në Kur'an kemi shumë por ne do ta zgjedhim këtë shembull:

“Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës (shkurtimit dhe zgjatjes së tyre), ka argumente të qarta për ata që kanë mend. Për ata që Allahun e përmendin kur janë në këmbë, ulur dhe shtrirë. Dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Zoti ynë këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit! Zoti ynë, atë që Ti e futë në zjarr, atë e ke poshtëruar, për mizorët nuk ka ndihmëtarë! Zoti ynë, ne dëguam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): Besoni në Zotin tuaj! E ne besuam! Zoti ynë, na i fal mëkatet tona dhe pas vdekjes na bashko me të mirët! Zoti ynë, na e jep atë që nëpërmjet Të të dërguarve T'u na e premtove dhe në Ditën e

kijametit mos na turpëro; vërtet Ti je Ai që nuk e shkel premtimin.” (Âli Imrân, 190-194).

“Zoti i tyre iu përgjigj lutjes së tyre (e tha): Unë nuk ia humb mundin (punën) asnjërit që mundohet prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni njëri nga tjetri (andaj edhe njëjtë do të shpërbleheni), por ata që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe emigruan, u maltretuan vetëm pse ishin në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, atyre patjetër do t’ua mbuloj të metat e tyre dhe do t’i vë në xhennete në të cilat burojnë lumenj. Ai është shpërblim nga ana e Allahut, se shpërblimi më i mirë është te Allahu.” (Âli Imrân, 195).

E cilit nuk i ngjallet shpirti gjatë shikimit të kësaj skene të gjatë e stabile, të mbushur me përkulje dhe nënshtrim, përplot ndikim të thellë. Gjatë këtij kompensimi të madh i cili në mënyrë të hollësishme i shfaq sakrificat e besimtarëve dhe këtij shpërblimi të madh që i pret në Ditën e Fesë (gjykimit) ata, e cilit nuk i shkon mendja t’u bashkangjitet “mentarëve”. Të lutet me lutjet e tyre dhe të përkulet mu si përkuljet e tyre, e pastaj t’i përgjigjet Zoti i tij bashkë me ta, dhe ta arrijë atë që e arritën ata?

Si kjo pikturë e gjallë njerëzore ka shumë, kudo që mëton Kur’ani të ndikojë me shëmbëllimë në intuitë dhe ndërgjegje.

* * *

Kështu pra soditësit në Kur’an përmes horizonteve të tij i shpalosen harmonizimet dhe akordimet e tij. Prej tyre: vargjet e thurura bukur, rrëfimet e rrëfyera rrjedhshëm, domethëniet e ndërlidhura mirë, thurjet e zinxhiruara, fjalët e shprehura, shprehjet e ilustruara, ilustrimet e personifikuara, përfytyrimet e trupëzuara,

muzika ritmike, akordimet e detajeve, harmonizimi i përshkrimeve, përputhshmëria e melodive, mjeshtria e inskenimit.

Pra, me anë të këtyre tipareve arrihet kreativiteti dhe realizohen elokuenca dhe stilistika.

Rrëfimi në Kur'an

Rrëfimi në Kur'an nuk është një vepër artistike, e pavarur në tematikën, mënyrën e shprehjes dhe interpretimin e ngjarjeve të tij, ashtu siç është rasti me rrëfimin e lirë artistik i cili synon ta realizojë vetëm aspektin artistik. Rrëfimi është njëra prej metodave të shumta të Kur'anit e cila mëton ta realizojë qëllimin e saj themelor. Kur'ani para së gjithash është libër i misionit fetar, ndërsa rrëfimi është njëra prej metodave të tij për proklamimin e këtij misioni (thirrjeje) dhe vendosjen e tij. Rasti i tij është identik me rastin e skenave të kijametit, pikturave të mjerimit (ndëshkimit) dhe lumturisë (kënaqësisë), si dhe rastin e fakteve të cilat i pasqyrojnë për ringjalljen dhe fuqinë e Allahut. Ai është identik edhe me çështjet e shariatit të cilat i detajizon dhe me shembujt të cilët i sjell, por edhe me të gjitha tematikat të cilat i shqyrton.

Rrëfimi kur'anor, sa i përket tematikës, mënyrës së shtrirjes dhe interpretimit të ngjarjeve të tij, u është nënshtruar në mënyrë direkte qëllimeve fetare. Gjurmët e këtij nënshtrimi shfaqen në simptome të veçanta të cilat do t'i paraqesim më vonë. Megjithatë, ky nënshtrim i plotë ndaj qëllimit fetar dhe realizimi i tij me anë të këtij qëllimi, në mënyrë të plotë nuk e pengon shfaqjen e tipareve artistike gjatë paraqitjes së tij e sidomos veçorisë më të madhe të Kur'anit në të shprehur, ilustrimit.

Ne kemi vërejtur më parë se shprehja kur'anore e sintetizon qëllimin fetar me atë artistik kur ekspozon diç nga pikturat dhe skenat. Bile kemi vërejtur se ajo bukurinë artistike e shndërron në mjet synues për ndikim intuitiv. Andaj edhe i referohet sensit të intuitës fetare me gjuhën e bukur artistike. Ndërsa arti dhe feja janë dy gjëra të lindura (ngulitura) në thellësi të shpirtit dhe të ndjenjës, që ta arrijnë ndikimin fetar. Ai arrihet atëherë kur arti ngrihet në këtë shkallë të lartë, shkallën e të shprehurit për besimin (akidenë) dhe atëherë kur pastrohet shpirti që ta pranojë misionin e bukurisë i cili në besim ka arritur përsosurinë e plotë.

Ne në kapitullin “Ilustrimi artistik” cekëm dy shembuj të rrëfimit në të cilët brusha magjepsëse e bëri të veten duke i ekspozuar mahnitshëm. Ne në atë rast premtuam se do ta shkoqisim temën për rrëfimin, e tani do t'i rrekemi këtij shqyrtimi.¹⁰

Qëllimet e rrëfimit

Rrëfimi në Kur'an është thurur për t'i realizuar ekskluzivisht qëllimet fetare, ashtu siç thamë edhe më parë. Unë kam shqyrtuar një numër të mjaftueshëm të këtyre qëllimeve të cilat është shumë vështirë të përkufizohen, ngase rrëfimi përafërsisht shtrihet në të gjitha qëllimet kur'anore. Vërtetimi i shpalljes dhe misionit, vërtetimi i njëshmërisë (vahdanijsë) së Allahut, uniteti i feve në bazë, qortimet dhe përgëzimet, fenomenet e fuqisë së Allahut, pasojat e të mirës dhe të keqes, du-rimit dhe mosdurimit,

¹⁰ Ky shqyrtim përkundër gjatësisë së tij, trajtohet i shkurtë në sajë të studimit të plotë që e pata përgatitur për “Rrëfimi në Kur'an”. Besoj se ky studim i plotë do ta shohë dritën insha All-llah si libër në një hallkë prej serisë “Biblioteka e Kur'anit”.

mirënjohjes dhe mosmirënjohjes,...e shumë të tjera që rrëfimi i shqyrtoi si qëllime fetare dhe synime morale të cilat ishin elemente të tij dhe mënyrë për ta arritur.

Nëse këtu i ekspozojmë qëllimet e rrëfimit kur'anor, do t'i konfirmojmë qëllimet më të rëndësishme dhe më të qarta e do ta lëmë anash gjithëpërfshirjen e tyre.

1 - Njëri prej qëllimeve të rrëfimit është konfirmimi i shpalljes dhe misionit. Muhammedi alejhisselam nuk ka qenë njohës i shkrimit dhe leximit, e as që është e njohur se ai është ulur para priftërinjve (klerikëve) çifutë apo të krishterë. Më vonë atij i shpallen këto rrëfime të Kur'anit. Disa prej tyre kanë ardhur në mënyrë të qartë siç është rasti me rrëfimin për Ibrahimin, Jusufin, Musain dhe Isain.

Pra, cekja e tyre në Kur'an është marrë si argument mbi shpalljen që shpallet... Kur'ani e thekson këtë qëllim tekstualisht dhe atë në fillim të disa rrëfimeve ose në fund të tyre.

Në fillim të sures Jûsuf vjen ky ajet: “Ne e zbritëm Kur'anin arabisht, ashtu që ta kuptoni. Ne me të shpallur të këtij Kur'ani po të rrëfejmë ty (Muhammed) më të bukurin rrëfim, edhe pse para tij ishe nga të painformuarit.” (Jûsuf, 2-3).

E në suren Kasas para se të paraqitet rrëfimi për Musain, erdhi ky ajet: “Këto janë ajetet e librit të plotkuptueshëm, që po t'i lexojmë ty nga lajmi rreth Musait e faraonit, e që është e vërtetë për një popull që beson.” (Kasas, 2-3). E pas përfundimit të tij vjen: “E ti nuk ishe në anën perëndimore (të vendit ku Allahu i foli Musait) kur Ne Musait ia besuam shpalljen, e as nuk ishe dëshmitar i kësaj (ngjarjeje). Por Ne krijuam gjenerata dhe u kanë kaluar kohëve të gjata. Dhe nuk ke banuar në mesin e banorëve të

Medjenit e t'ua lexosh këtyre argumentet Tona, por Ne t'i kemi dërguar ty (lajmet e këtyre ndodhive). Dhe ti nuk ke qenë pranë Turit kur Ne e thirrëm (Musain), por (tregimi ynë) është mëshirë nga Zoti yt, për t'ia tërhequr vërejtjen një populli që para teje nuk i kishte ardhur ndonjë këshillues (Pejgamber)”, dhe ashtu ata të marrin mësim.” (Kasas, 44-45).

E në suren Âli Imrân në fillim të paraqitjes së rrëfimit të Merjemes zbriti ky ajet: “Këto janë nga lajmet e panjohura (sekrete) që po t'i shpallim ty. Ti nuk ishe i pranishëm kur i hedhnin shortet se kush prej tyre do të bëhet kujdestar i Merjemes, nuk ishe pranë tyre as kur ata ziheshin mes vete.” (Âli Imrân, 44).

Kurse në suren Sâd para ekspozimit të rrëfimit për Ademin erdhi ky ajet: “Thuaj: Ky (Kur'an) është një kumtesë e madhe! Ju prej tij po shmangeni. Unë nuk kam pasur kurrfarë dije për elitën e lartë (engjëjt) kur ata polemizonin (rreth Ademit). Mua nuk më shpallet tjetër vetëm se, unë nuk jam tjetër pos një tërheqës i hapët i vërejtjes! Kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë po krijoj një njeri nga balta...” (Sâd, 67-71).

Ndërsa në suren Hûd pas rrëfimit për Nuhin erdhi ky ajet: “Këto janë disa nga lajmet e panjohura (sekrete), që po t'i shpallim ty, e që para këtij (Kur'anit) nuk i ke ditur as ti as populli yt.” (Hûd, 49).

2 - Prej qëllimeve të rrëfimit ishte edhe proklamimi se i tërë dini (feja) është prej Allahut që nga koha e Nuhit deri te koha e Muhammedit, dhe se besimtarët të gjithë janë një “Ummet” (popull), dhe se Allahu Një, është Zot i të gjithëve. Shpeshherë janë cekur rrëfimet e disa pejgamberëve në një pikturë të ekspozuar në mënyrë të veçantë për ta konsoliduar këtë të vërtetë. Meqë ky është qëllimi kryesor në misionin (da'ven islamike) dhe në

sendërtimin e botëkuptimit islam, andaj edhe u përsëritën ngjarjet e këtyre rrëfimeve në atë mënyrë, me disa dallime në të shprehur, për ta përforcuar këtë të vërtetë dhe konsolidimin e saj në logjikë.

Për këtë do të japim shembull nga ajo që erdhi në suren Enbija:

“Ne i patëm dhënë Musait e Harunit, Furkânin,¹¹ (Tevratin) që ishte dritë e këshillë për të devotshmit. Të cilët ia kanë frikën Zotit të tyre edhe pse nuk e shohin, edhe ata të cilët ia kanë drojën kijametit. Edhe ky (Kur’ani) është këshillë, është i bekuar që Ne e shpallëm. A ju po e refuzoni?”.

“Ne i dhamë Ibrahimit herët të mbarën, sepse Ne e kemi njohur mirë atë. Kur ai babait dhe popullit të vet u tha: Ç’janë këta idhuj që i adhuron? Ata thanë: I gjetëm të parët tanë që po i adhuronin.” (Enbija, 48-53), deri te fjala e Allahut: “Ata deshën t’i kurdisin atij (Ibrahimit) kurthë, por Ne ata i bëmë më të dështuarit. E Ne i shpëtua atë dhe Lutin në atë tokë që e kemi bekuar për njerëz. Dhe ia falëm atij Is’hakun e si dhuratë edhe Jakubin. Dhe që të gjithë i bëmë të mirë (pejgamberë). Dhe ata i bëmë shëmbëlltyra që udhëzonin sipas urdhrit Tonë, i orientuam në punë të mira, në faljen e namazit, në dhënien e zeqatit, dhe ata ishin adhures Tanë të singertë.” (Enbija, 70-73).

“Dhe Ne Lutit i dhamë të jetë pejgamber dhe i dijshtëm, andaj edhe e shpëtua prej atij fshati që bënte punë të ndyra. Ata ishin popull i dëmshëm dhe i prishur. Atë (Lutin) e shpëtua dhe e vëmë nën mëshirën Tonë, vërtet ai ishte prej më të mirëve”.

¹¹ Në vetë cilësimin e Tevratit se ai është Furkân, ndarës i të vërtetës nga e pavërteta, kuptojmë afërsinë mes këtyre dy feve, bile edhe në cilësinë e librit, sepse edhe Kur’ani njihet me emrin Furkân.

“(Përkujto) Edhe Nuhin kur më parë - e pat thirrur (Zotin) e Ne ia pranuan atij (edhe lutjen) e ate dhe familjen e tij i shpëtuam nga ai tmerr i madh. Ne e mbrojtëm atë prej atij populli që përgënjeshtrohte argumentet tona. Vërtet, ata ishin popull i keq, prandaj i përmbytëm të gjithë ata”.

“(Përkujto) Davudin e Sulejmanin kur pleqëronin për çështjen e bimës (mbjelljes), të cilën delet e atij populli e kishin kullotur natën, e Ne ishim përcjellës të gjykitimit të tyre. E Sulejmanit Ne ia mësuam atë (përgjigjen e saktë), po secilit (prej tyre) u patëm dhënë urtësi e dije. Ne bëmë që kodrat dhe shpezët të madhërojnë (bëjnë tesbih) së bashku me Davudin. Ne kemi mundësi (ta bëjmë këtë) dhe e bëmë. Ne ia mësuam atij (Davudit) punimin e petkave (të hekurta) për ju, që t’ju mbrojnë në rast lufte. A jeni pra ju mirënjohës për këtë?”. “Ndërsa Sulejmanit (ia nënshtroam) erën e fortë që sipas dëshirës së tij ecte me të deri te toka të cilën e kemi bekuar Ne. Ne jemi të gjithëdijsëm për çdo gjë. Edhe disa nga djajtë (ia nënshtroam) që zhyteshin (në thellësi të ujit) dhe bënë edhe punë të tjera për të (për Sulejmanin), por Ne ia ruanim ata (të mos shmangeshin)”.

“(Përkujto) Edhe Ejubin kur iu drejtua Zotit të vet me lutjen: Më gjeti belaja, e Ti je më mëshirues ndër mëshiruesit. Ne iu përgjigjëm atij nga mëshira Jonë, ia hoqëm ato vështirësi që i kishte, i dhamë familjen e tij dhe aq sa ishin ata, dhe i bëmë përkujtim për të devotshmit”.

“(Përkujto) Edhe Ismailin, Idrisin dhe Dhulkiflin, që të gjithë ishin të durueshëm. Ata i përfshimë në mëshirën Tonë, se ishin vërtet prej të mirëve”.

“(Përkujto) Edhe atë të peshkut (Junusin) kur doli i hidhëruar (prej popullit) dhe mendoi se nuk do t’i vijë më puna ngushtë, por

në errësirë ai tha se: Nuk ka zot pos Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtësi vetes! Ne iu përgjigjëm atij, e shpëtuan nga tmerri. Kështu Ne i shpëtojmë besimtarët”.

“(Përkujto) Edhe Zekeriain kur e luti Zotin e vet: Zoti im, mos më lë të vetmuar se Ti je më i miri trashëgues (pas çdokujt). Ne e pranuan lutjen e tij, ia dhuruan atij Jahjanë dhe ia përmirësuan bashkëshorten atij. Ata përpiqeshin për punë të mira, Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj nesh”.

“(Përkujto) Edhe atë që e ruajti nderin e saj, e Ne e frymëzuam me shpirt (barrë) nga ana Jonë, dhe atë dhe të birin e saj i bëmë mrekulli për njerëzit”.

“Kjo fe është e juaja dhe është e vetmja fe (e shpallur) kurse Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua...” (Enbija, 76-92). Ja pra, mu ky është qëllimi kryesor dhe themelor nga ky ekspozim i gjatë, por ka edhe qëllime të tjera të cilat do të ekspozohen brenda tij.

3 - Nga qëllimet e rrëfimit gjithashtu është proklamimi se e tërë feja në bazë është unike - krahas asaj se ajo si e tërë është prej një Zoti - dhe duke e pas këtë parasysh, shumë prej rrëfimeve për pejgamberët cekeshin bashkërisht, me të cilët përsëritej baza e besimit (akideja) themelor, e ai është besimi në Allahun Një, mu ashtu siç erdhi në suren A’rafë:

“Ne e patëm dërguar Nuhin te populli i vet, e ai tha: O populli im, adhurone Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij...” (A’rafë, 59).

“Edhe te (populli) Ad-i (dërguam) vëllain e tyre Hudin, e ai tha: O populli im, adhurone Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij...” (A’rafë, 65).

“Edhe te (populli) Themud-i (dërguam) vëllain e tyre Salihun, e ai u tha: O populli im, adhuronë Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij...” (A’rafë, 73).

“Edhe te (populli) Medjen-i (dërguam) vëllain e tyre Shuajbin, e ai u tha: O populli im, adhuronë Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij...” (A’rafë, 85)

Pra, ky unifikim fjalësh rrjedh nga baza e besimit në të cilin u inkorporuan të gjithë pejgamberët e të gjitha feve (sherateve - në aspektin juridik sh.p.), te të cilët të gjitha rrëfimet e tyre kthehen në këtë komponentë për ta konfirmuar këtë qëllim të veçantë.

4 - Nga qëllimet e rrëfimit është edhe proklamimi se metodat e pejgamberëve në “da’ve” ishin unike, dhe pritja-pranimi i popujve të tyre ndaj thirrjes së tyre ishte e ngjashme - krahas asaj se feja është e ardhur prej një Zoti dhe se ajo është e ngritur në një bazë - që si rezultat i kësaj ishte cekja e rrëfimeve të shumta të pejgamberëve në formë të përbashkët në të cilën përsëritet e njëjta mënyrë e “da’ves” siç është rasti me suren Hûd:

“Ne e patëm dërguar edhe Nuhin te populli i vet (me porosi të njëjtë si Muhammedin që t’u thotë): Unë ua tërheq vërejtjen haptazi, që të mos adhuronë tjetërkë pos Allahut, sepse unë kam frikë për dënimin tuaj në ditën e pikëllueshme. Paria që nuk besoi dhe populli i tij thanë: Ne nuk të shohim ndryshe vetëm si njeri, sikurse edhe ne, nuk po shohim se të pasoi kush, përveç atyre që janë më të poshtër (më të ulët) e më mendjelehtit nga mesi ynë, dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne. Përkundrazi, ne ju konsiderojmë gënjeshtarë!”... derisa të thotë Nuh: “O populli im, unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë pasuri, shpërblimi im është vetëm tek Allahu”... e derisa të thotë populli: “O Nuh, ti polemizove me ne dhe e zgjate polemikën tonë. Urdhëro, e nëse

flet të vërtetën, sille pra, të na gjejë ajo me çka na kërcënohesh!...” (Hûd, 25-32)

“Edhe te (populli) Ad-i (dërguam) vëllain e tyre Hudin e ai tha: O populli im, adhurone Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij, ju vetëm po hutoheni me trillime. O populli im, unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim. Shpërblimi im është vetëm prej Atij që më krijoi. A nuk po kuptoni?”... derisa të thotë: “Ata thanë: “O Hud, ti nuk na solle ndonjë argument (fakt bindës, mrekulli), e ne nuk i braktisim zotat tanë për fjalën tënde dhe ne nuk të besojmë ty. Ne nuk themi tjetër vetëm se dikush prej zotave tanë të ka goditur me çmendje! Ai tha: Unë dëshmitar e kam Allahun, e ju dëshmoni se unë jam larg nga ajo çka ju i shoqëroni (larg adhurimit) pos Tij. Ju pra të gjithë përpiquni kundër meje e mos më jepni afat.” (Hûd, 50-55).

“Edhe te (populli) Themud-i (dërguam) vëllain e tyre Salihun, e ai tha: O populli im, adhurone Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij, Ai së pari ju krijoi nga dheu dhe ju bëri banues të tij, andaj kërkonti falje prej Tij, dhe shprehni pendim te Ai. S’ka dyshim, Zoti im është afër (me mëshirë), dhe u përgjigjet (lutjeve)! Ata thanë: O Salih, ti ishe shpresa jonë para kësaj. Si mund të na ndalosh ta adhurojmë atë që e adhuruan prindërit tanë? Vërtet, ne jemi shumë të dyshimtë e në dilemë në atë që na thërret ti...” (Hûd, 61-62).

5 - Prej qëllimeve të rrëfimit ishte edhe proklamimi i bazës (trungut) së përbashkët mes fesë së Muhammedit dhe fesë së Ibrahimit në mënyrë të veçantë, e pastaj me fetë (në aspektin legjislativ sh.p.) e Beni Israilëve (bijve të Israilit) në aspekt të përgjithshëm. Gjithashtu publikimi se kjo lidhje (pikëtakim) është me karakter më të fortë se sa lidhja e përgjithshme mes të gjitha feve (qielle). Indikacionet për këtë pohim u përsëritën në rrëfimet për Ibrahimin, Musain dhe Isain:

“Vërtet, kjo (këshillë) gjendej edhe në broshurat e para: Në broshurat e Ibrahimit dhe të Musait.” (A’la, 19). “Apo nuk është informuar për atë që është në fletushkat e Musait dhe të Ibrahimit që gjithnjë i plotësoi obligimet. (Që në to shkruan)” Se askush nuk bart barrën (mëkatin) e tjetrit.” (Nexhm, 36). “Njerëzit më me meritë për t’u thirrur në Ibrahimin ishin ata që e ndoqën atë (besimin e tij) dhe ky peygamber me ata që besuan atë (shpalljen e tij).” (Âli Imrân, 68). “Në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, edhe ky (Kur’ani) ju quajti muslimanë.” (Haxh, 78). “Ne vazhduam gjurmët e tyre (peygamberëve) me Isain, birin e Merjemesë, vërtetues i Tevratit që e kishin më parë. Atij ia dhamë Inxhilin që është udhëzim i drejtë dhe dritë, që është vërtetues: i Tevratit që kishin pranë, që ishte udhëzues e këshillues për të devotshmit”, dhe vijon deri në ajetin ku thotë: “Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur’anin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre.” (Mâide, 46-48).

6 - Prej qëllimeve të rrëfimit është edhe proklamimi se Allahu u ndihmon përfundimisht peygamberëve dhe i shpartallon gënjeshtarët. Këtë, si përforsim për Muhammedin dhe ndikim psikik në kokat e atyre që i thërret në besim (iman):

“Të gjitha këto që t’i rrëfyem ty nga lajmet e peygamberëve, janë që ta përforcojnë zemrën tënde, dhe në to të ka ardhur e vërteta e këshilla si dhe përkujtimi për besimtarët.” (Hûd, 12). Dhe si rezultat i këtij qëllimi cekeshin rrëfimet e peygamberëve bashkërisht dhe të përfunduara me humbjen e atyre që i përgënjeshtruan. Për këtë arsye përsëriten shfaqjet e rrëfimeve siç edhe erdhi në suren Ankebût:

“Ne e dërguam Nuhin te populli i vet, e ai kaloi ndër ata një mijë pa pesëdhjetë vjet, e ata meqë ishin horra (zullumqarë) i

përfshiu vërshimi (tufani). Ndërsa atë vetë dhe të tjerët që ishin në anije i shpëtuan dhe Ne atë (ngjarje) e bëmë argument për tërë botën”.

“Edhe Ibrahim (e dërguam) kur ai popullit të vet i tha: Adhurone Allahun dhe kini frikë prej Tij, se kjo, nëse e kuptoni, është shumë më e mirë për ju”... ashtu vijon deri kur thotë: “Po përgjigjja e popullit të tij nuk ishte tjetër vetëm të thonë: mbyteni atë (Ibrahimin) ose djegje! Mirëpo, Allahu e shpëtoi atë prej zjarrit. Për një popull që beson, këtu vërtet ka fakte bindëse...” (Ankebût, 16-24).

“Edhe Lut (e dërguam) kur ai popullit të vet i tha: Ju bëni aq punë të shëmtuar sa askush para jush nga tërë bota nuk e ka bërë”... Ashtu vijon deri kur të thotë: “Ne mbi banorët e këtij qyteti do të lëshojmë një dënim nga qielli për shkak se ata bëjnë punë të liga. E nga ai vend, Ne kemi lënë gjurmë të qartë për një popull që mendon.” (Ankebût, 28, 34, 35).

“E në Medjen (dërguam) vëllain e tyre Shuajbin dhe ai u tha: “O populli im, adhurone Allahun dhe kini frikë ditën e fundit, e mos e teproni si shkatërrues në tokë! Por ata e përgënjeshtroan, andaj i përfshiu tërmeti dhe gdhinë të shtangur (të mbytur e të ftohur) në shtëpitë e tyre”.

“(I shkatërruam) Edhe Adin dhe Themudin, e vendbanimet e tyre janë të qarta për ju. Djalli ua pat zbukuruar veprat e tyre duke i shmangur nga e vërteta, edhe pse e shihnin atë”.

“Edhe Karunin, faraonin dhe Hamanin. Atyre Musai u solli fakte por ata treguan mendjemadhësi, ndaj nuk mundën t'i shpëtojnë dënimit”.

“Secilin prej tyre e kemi dënuar për shkak të mëkatit të vet: disa prej tyre Ne i goditëm me furtunë plot rërë; disa i shkatërruam me krismë nga qielli, e disa të tjerë i sharruam në tokë e disa i përmbytëm në ujë. Allahu nuk u bëri atyre ndonjë të padrejtë, por ata vetes së tyre vet i bënë zullum.” (Ankebût, 36-40).

Ja pra, ky është përfundimi i njëjte për të gjithë ata që përgënjeshtroan.

7 - Dhe prej qëllimeve të rrëfimit është vërtetimi (realizimi) i përgëzimit dhe qortimit, duke e ekspozuar shembullin që ka ngjarë nga ky vërtetim, ashtu siç erdhi në suren Hixhr:

“Njoftoi robërit e Mi se vërtet Unë jam Ai që fal shumë dhe jam mëshirues i madh. Po (njoftoi) se edhe dënimi Im është dënim i dhembshëm”. E si vërtetim për cilësinë e parë dhe të dytë rrëfimet erdhën në këtë mënyrë: “E (njoftoi) edhe për mysafirët e Ibrahimit. Kur ata hynë te ai dhe i thanë: Selâmâ - Paqja qoftë mbi ju, e ai (Ibrahimi) tha: Ne po frikësohemi prej jush! Ata i thanë: Mos u frikëso, ne po të marrim myzhde për një djalë të zgjuar!...” (Hixhr, 49-53). Në këtë rrëfim shfaqet “mëshira”.

E më pastaj:

“E kur i erdhën familjes së Lutit të dërguarit. Ai (Luti) tha: Ju jeni njerëz të panjohur! Ata i thanë: Jo, (nuk kemi qëllim të keq ndaj teje), të kemi ardhur ty me atë (dënim) që ata dyshonin. Të kemi sjellë të vërtetën, e ne jemi të drejtë (për atë që themi). Ti ec me familjen tënde pasi të kalojë një pjesë e natës dhe rri pas tyre (që të mos frikësohen), dhe asnjëri prej jush të mos kthejë mbrapa (për të shikuar), dhe shkoni andej nga urdhëroheni. E Ne i kumtuam atij (Lutit) atë çështje se zhdukja e tyre deri në më të mbramin, do të jetë në mëngjes”. Në këtë rrëfim vërehet

“mëshira” në anën e Lutit kurse “dënimi i dhembshëm” në anën e popullit të tij të shkatërruar.

Pastaj: “Edhe populli i “Hixhres” i përgënjeshtroi të dërguarit. Ne u patëm parashtruar atyre argumentet (mrekullitë) Tona, por ata i kundërshtonin ato. Ata ndërtonin shtëpi në kodra shkëmbore për të qenë të sigurt. Por ata në mëngjes i goditi gjëmimi i tmerrshëm e shkatërrues. Dhe nuk u ndihmoi atyre asgjë ajo që vepruan.” (Hixhr, 80-84). E në këtë rrëfim shihet “dënimi i dhembshëm” që u realizua ndaj përgënjeshtresve.

Pra në këtë mënyrë vërtetohen dhe realizohen paralajmërimet, e në këto rrëfime të ngjara dhe në këtë formë të renditura shpaloset e vërteta e tyre.

8 - Nga qëllimet e rrëfimit është edhe proklamimi i dhuntive të Allahut pejgamberëve dhe të zgjedhurve të vet, siç është rasti me rrëfimet për Sulejmanin, Davudin, Ejubin, Ibrahimin, Merjemenë, Isain, Zekerianin, Junusin dhe Musain. Disa rrëfime të atyre pejgamberëve që i cekëm në shumë raste e shfaqin dhuntinë. Bile shfaqja e saj do të jetë qëllim i tij i parë, e të gjitha të tjerat në këtë rast marrin formën e ekspozimit.

9 - Prej qëllimeve të rrëfimit gjithashtu është vërejtja bijve të Ademit në lajthitjen e shejtanit dhe shpalljen e armiqësisë së përhershme mes tij dhe mes tyre që nga babai i tyre Ademi. Por shpallja e kësaj armiqësie përmes rrëfimit është më impresionuese dhe më spektakulare, dhe më e përshtatshme për vërejtjen kërcënuese nga çdo shushurimë e shpirtit që dëshiron të bëjë keq, që buron prej këtij armiku që nuk ua dëshiron të mirën njerëzve!

Meqë kjo është temë e përhershme, edhe rrëfimi i Ademit u përsërit në shumë raste.

10 - Rrëfimi ka edhe qëllime tjera të llojllojshme, e prej tyre:

Proklamimi i fuqisë së Allahut për gjërat që për ne janë të jashtëzakonshme: Si rrëfimi për krijimin e Ademit, rrëfimi për lindjen e Isait, rrëfimi i Ibrahimit dhe shpendit i cili iu kthye atij pasi që në çdo kodër shpërndau nga një pjesë të shpendit dhe si rrëfimi i “atij që kaloi pranë një fshati që ishte rrënuar në kulmet e tij” të cilin e ngjalli Allahu pas njëqind vjet të vdekjes së tij.

Pastaj proklamimi se çfarë përfundimi ka e mira dhe puna e prishur, siç është rasti me rrëfimin e bijve të Ademit, pronarit të dy kopshteve, rrëfimet e Beni Israilëve pas tradhtisë (mëkatit) të tyre, rrëfimi për pendën Me'reb dhe rrëfimi për të zotët e hendeqeve (as'habul uhdud).

Dhe gjithashtu proklamimi i dallimit mes urtësisë njerëzore e cila shikon afër dhe shkurt dhe urtësisë hyjnore e cila shikon larg dhe gjatë, si rasti me rrëfimin e Musait me “një rob prej robërve Tanë, të cilit i kemi dhuruar mëshirë nga ana Jonë dhe i kemi mësuar me një dituri të posaçme nga Ne”, të cilin do ta shqyrtojmë detajisht në një rast tjetër.

Kështu pra mund të shkohet deri në fund të këtyre qëllimeve për të cilat edhe u pasqyruan këto rrëfime, të cilat transferoheshin sipas kuptimit dhe porosisë së qëllimeve.

Pasojat e nënshtrimit të rrëfimit ndaj qëllimit fetar

Siç thamë edhe më parë, rrëfimi në Kur'an i është nënshtruar drejtpërdrejt qëllimit fetar. Ky nënshtrim apo varësi la gjurmë të dukshme në mënyrën e prezentimit të rrëfimit, madje edhe në tematikën e tij. Ne këtu do t'i spikasim pasojat më të dukshme:

a) Prej pasojave të para të këtij nënshtrimi është që rrëfimi të ceket - në shumicën e rasteve - i përsëritur në vende të ndryshme. Megjithatë, kjo përsëritje, në të shumtën e rasteve, nuk e përfshinë tërë rrëfimin, por ajo është përsëritje e disa episodeve të tij të cilat janë vetëm indikacione sipërfaqësore për qëllimin ku synon, ndërsa trangu i rrëfimit në përgjithësi nuk përsëritet pos rrallëherë, ose për raste ekskluzive të shprehjes ashtu siç kemi dhënë shembull kur folëm për qëllimet e rrëfimit.

Kur njeriu i lexon këto episode të përsëritura duke e vërejtur kontekstin për të cilin edhe janë cekur, do t'i gjenë ato episode plotësisht të përputhura me kontekstin në fjalë, gjithashtu edhe në zgjedhjen e episodës e cila shfaqet aty apo diku tjetër, dhe në mënyrën e ekspozimit po ashtu. Duhet që gjithmonë ta kemi ndërmend se Kur'ani është libër i misionit (thirrjes) fetar dhe se harmonizimi mes pjesës së rrëfimit e cila shfaqet dhe kontekstit në të cilin shfaqet është qëllimi i mësipërm. Edhe pse ky gjithmonë është i pranishëm, atij asnjëherë nuk i mungon tipari artistik.

Ekziston një formë e cila ndodh të jetë rregull i vendosur përkitazi me shfaqjen e episodeve të përsëritura të një rrëfimi. Kjo mund të vërehet kur të lexohen ajetet sipas rendit të zbritjes së

tyre¹² ku shumica e rrëfimeve fillojnë me përshkrime të përcipta, e më pas ato zgjaten pak nga pak që më vonë të shfaqen episode të mëdha të cilat sipas tërësitë së tyre formojnë trupin e rrëfimit. Përshkrimet e shkurtra vazhdojnë të paraqiten brenda këtyre pjesëve të mëdha në raste të nevojshme derisa rrëfimi t'i plotësojë pjesët e tij. Atëherë edhe këto përshkrime kthehen dhe mbetet gjithë ajo që shfaqet rreth rrëfimit.

Ne si shembull rreth këtij rendi (sistemi) do ta sjellim rrëfimin për Musain, ngase ai është rrëfimi më i përsëritur në Kur'an. Nga ky këndvështrim rrëfimi për Musain jep një pasqyrim të plotë për përsëritjen e tij.

Ky rrëfim është cekur në afër tridhjetë vende në Kur'an. Këtu do t'i cekim vendet më kryesore e do t'i lëmë anash disa vende ku është përmendur emri pa ndonjë qëllim. Si erdhi ky rrëfim në këto vende? - Ai zhvillohet nëpër këto etapa:

1 - Në suren A'la (sureja e tetë sipas zbritjes), kemi përshkrim të përciptë: "Vërtet, kjo (këshillë) gjendej edhe në broshurat e para: Në broshurat e Ibrahimit dhe të Musait". Dhe një përshkrim të ngjashëm me te gjithashtu e kemi edhe në suren Nexhm (sureja e 23-të sipas zbritjes).

2 - Edhe në suren Fexhr (sureja e 10-të) kemi përshkrim të faraonit pa mos e përmendur Musain, por me popullin e Adit dhe Themudit: "...dhe me faraonin, i fortifikuar me tenda (ushtarake). Të cilët e tepruan me krime në tokë. Dhe në të shtuan shkatërrimin. E Allahu kundër tyre lëshoi lloj-lloj dënimesh."

¹² Çështja e renditjes së ajeteve sipas zbritjes së tyre nuk është çështje e prerë dhe unanime mes dijetarëve. Çështja e tyre është diskutabile dhe merret sipas avancimit të mendimeve dhe saktësisë së tyre.

(Fexhr, 10-13). Dhe një përshkrim i afërt me të në suren Buruxh (sureja e 27-të).

3 - E në suren A'rafë (sureja e 39-të) fillon detajizimi i parë i rrëfimit në ekspozitën e rrëfimeve të përbashkëta me Nuhin, Hudin, Lutin dhe Shuajbin, në të cilat u unanimizua forma e “da’ves” (thirrjes), forma e përgënjeshtërimit dhe dënimit të cilën e morën përgënjeshtresit. Këtu rrëfimi filloi me misionin e Musait dhe Harunit drejtuar faraonit dhe parisë së tij: “Mandej e dërguam Musain me mrekulli të argumentuara te faraoni dhe paria e tij...” (A'rafë, 103). Pastaj përmendi mrekullinë e shkopit dhe të dorës së ndiçuar; tubimin e fallxhorëve dhe garat mes tyre dhe Musait; fitores së tij ndaj tyre dhe besimi (dorëzimi) i tyre atij dhe torturimi i Beni Israilëve nga faraoni pas atij rasti; mandej ceku belanë që iu vu atyre në qafë për shkak të mohimit përmes karkalecave, rriqërave, bretkosave dhe gjakun që ia lëshoi faraonit dhe parisë së tij; kërkimin e ndihmës që e bënte te Musai; largimin e belasë prej tyre; torturimin e Beni Israilëve nga faraoni për të dytën herë; dalja e tyre nga Egjipti; pas daljes nga Egjipti kërkimin që ia bënë Beni Israilët Musait që t'u bëjë një zot ashtu siç egjiptasit kanë zota; përkujtimin që ua bëri Musai ndaj Zotit të tyre; takimi i Musait me Zotin e tij që pas tridhjetë netësh u shtuan edhe për dhjetë; kërkimin që e bëri ta shohë Zotin e tij; thërrmimi i kodrës, alivanosja e Musait dhe këndellja, kthimi i tij te populli i tij të cilët i gjeti me vësh të ndërtuar dhe të marrur për zot; hidhërimi i tij ndaj vëllait, Harunit; zgjedhja e shtatëdhjetë burrave nga ana e tij prej tyre për takim me Zotin; dridhja e tyre dhe alivanosja që i zuri me gjithë kodrën kur kërkuan ta shohin Allahun sheshazi; pastaj ardhja në vete dhe kërkimi i mëshirës me anë të lutjeve që i bënë; dhe

kthimi i përgjigjes se mëshira u takon besimtarëve që e pasojnë pejgamberin e pashkolluar...¹³

4 - Pastaj ceken dy përshkrime të misionit, përgënjeshtrimi dhe shkatërrimi i përgënjeshtguesve në rrëfime të përbashkëta, njëri në suren Furkân (e 42-ta sipas zbritjes) dhe tjetri në suren Merjem (e 44-ta).

5 - Kurse në suren Tâhâ (45) fillon një detajizim tjetër ku fillon me një seri më të hershme se ajo e misionit (pejgamberllëkut) e cila u cek në A'rafë. Aty kemi të bëjmë me pamjen e Musait dhe zjarrin në një pjesë të kodrës Tûr: “A të ka ardhur ty (njohuria) për ndodhinë e Musait? Kur ai e pa një zjarr, e i tha familjes së vet: Rrini ku jini, se kam vërejtur një zjarr, e unë ndoshta do t’u sjell ndonjë gacë prej tij ose do të gjejë te zjarri ndonjë udhërrëfyes. E kur shkoi te ai (zjarri), u thirr: O Musa, vërtet Unë jam Zoti yt, zbathi mbathëset tuaja, se je në luginën e shenjtë Tûvâ. Unë të zgjodha ty (për pejgamber), prandaj dëgjo mirë se ç’po të shpallet!...”. (Tâhâ, 9-13) dhe pasi e ngarkoi të shkojë te faraoni, ai kërkoi prej Zotit të tij ta dërgojë me të vëllain e tij Harunin i cili do ta përforcojë dhe do ta ndihmojë. Allahu ia përkujtoi dhuntinë që ia dha atij me rastin e lindjes dhe kthimit të tij nënës së vet - me fjalë të shkurtra - e pastaj zhvillohet rrëfimi siç u zhvillua në suren A'rafë (duke mos e përdorur ajetin e karkalecave, rriqërave, bretkosave dhe gjakut, pastaj ajetin e premtimit të faraonit të Beni Israilëve dhe tradhtinë e tij, dhe duke e shtuar një episodë të re e ajo është, se Samirijju është ai i cili e ndërtoi viçin duke e shpjeguar detajisht rrëfimin për ndërtimin e tij, e pastaj sipërfaqësisht e

¹³ Të gjithë pejgamberët kanë qenë të pashkolluar. Ata nuk morën mësim nga njerëzit ngase ishin bartës të mësimave hyjnore të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ua komunikuam njerëzve (sh.p.).

përmend “takimin” (miadin) e Musait e nuk e përmend aspak “takimin” (mikatin) e të shtatëdhjetëve.

6 - Në suren Shuaraë (47) rrëfimi fillon prej serisë së misionit dhe i vazhdon hapat e njëjtë në episodin e daljes nga Egjipti, por ajo këtu i shton dy shënime: I pari: Përmendja se Musai mbyti një njeri prej egjiptasve dhe frika e tij se mos po dënohet për te, pastaj përkujtimi i faraonit atij se ai u rrit te ata prej kur ishte foshnje dhe krimin që e bëri. I dyti: Përmendja e çarjes së detit që u bë si dy kodra të mëdha. Edhe në të parin edhe në të dytin do ta gjejmë dialogun mes Musait dhe faraonit dhe vërtetimin e Musait për ekzistencën e Zotit me cilësitë e tij dhe dialogun me magjis-tarët gjithashtu.

7 - Pastaj në suren Neml (48) përmend serinë e përgënjeshtërimit dhe dënimit, sipërfaqësisht së bashku me rrëfimet tjera.

8 - Kurse në suren Kasas (49) rrëfimi që nga fillimi i serisë së parë fillon me lindjen e Musait në momentin e shtypjes së popullit të tij. Pastaj vendosjen e tij në arkë dhe hedhjen e tij në det. Ai cek edhe marrjen e Musait si foshnje nga deti nga ana e familjes së faraonit; mospranimin e tij të gjirit prej asnjërës nga gratë; porosinë e nënës së tij motrës së vet që ta gjurmojë atë dhe njohja e saj për gjendjen e tij; propozimin e motrës së vet familjes së faraonit për një gjidhënëse për fëmijën, e ajo në realitet ishte nëna e tij, pastaj përmend rritjen e tij; mbytjen e egjiptasit nga ana e tij; orvatjen që e bëri që ta mbyse edhe tjetrin; kërcënimi i këtij tjetrit se do ta zbulojë fshehtësinë e mbytjes së të parit; pastaj këshillën e një njeriu që ia dha Musait për të ikë e i cili erdhi nga skaji i qytetit duke nxituar: kalimin e tij në tokën e Medjenit dhe takimi i tij me dy bijat e plakut të moshuar; dhënia ujë kafshëve të tyre dhe fascinimi i njëres prej vajzave me te; pastaj cek nxitjen e saj babait

të vet që ta marrin në shërbim dhe të bëhet punëtor i tyre; martesën e Musait me bijën e tij sipas kontratës së paraparë dhe ndarjen e tij nga plaku dhe kthimin me familjen e tij, pastaj cek hetimin e tij të zjarrit (te i cili rrëfimi fillon në suren Tâhâ); mandej zhvillohet rrëfimi si në suren Tâhâ përpos një shtojce, e ajo është tallja e faraonit kur tha; “O Haman, m’i pjek (tullat) nga dheu e më ndërto një kullë të lartë, ndoshta do të arrijë ta shoh Zotin e Musait!” (Kasas, 38). Ndërsa rrëfimi përfundon te episodi i përmbysjes së faraonit në det meqë Musai del matanë.

9 - Në suren Israë (50) kemi një shënim të shpejtë për përmbysjen e faraonit dhe fuqizimin e Beni Israilëve.

10 - Në suren Jûnus (51) kemi një ekspozim të shkurtë ndërmjet rrëfimeve të përbashkëta për ta proklamuar pasojën e përgënjeshtimit. Në te u cek episodi i magjistarëve në mënyrë të përmbledhur, kalimi i detit duke ikur prej Beni Israilëve dhe ndjekja e tyre prej faraonit; Por në episodin e përmbysjes e shton edhe këtë thënie: “Derisa e përfshiu atë përmbysja, e ai tha: Besova se nuk ka zot tjetër pos Atij që i besuan Beni Israilët e edhe unë jam nga të dorëzuarit (muslimanët).” (Jûnus, 90). E atij iu dha kjo përgjigje: “Ti tani beson, ndërsa më parë kundërshtove dhe ishe njëri prej shkatërrimtarëve! Sot po të shpëtojmë ty (po të nxjerrim prej detit) me trupin tënd (të vdekur) që të shërbesh si argument për ata që vijnë pas teje.” (Jûnus, 91). Kjo shtesë nuk përmendet pos në këtë vend.

11 - Pastaj në suren Hûd (52) ceket një shënim i shpejt për shkatërrimin pas përgënjeshtimit në përbërje (kontekst) të rrëfimeve të përbashkëta.

12 - Kurse në suren Gâfir ose Mu'min (60) prezentohet episodi i dialogut mes faraonit dhe Musait. Por në këtë rast kemi një shtesë

gjatë debatit të faraonit: “Më lini mua ta mbys Musain, e ai le ta thërrasë Zotin e vet.” (Gâfir, 26), dhe një tjetër me rastin e paraqitjes së një njeriu besimtar nga familja e faraonit i cili e fshehte besimin e tij, e që e mbron Musain dhe i këshillon të mos e mbysin se ndoshta është në rrugë të drejtë. Kjo është një shtesë e cila nuk ceket jashta këtij vendi.

13 - Edhe në suren Fussilet (61) kemi një shënim të përciptë. Po ashtu edhe në suren Zuhruf (63) kemi dy shënime të shkurtra rreth rrëfimit për Musain. Por në këtë rast shtohet shënimi se faraoni ka thënë: “O populli im, a nuk është i imi pushteti i Egjiptit (Misirit) dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin nën pallatin tim, e nuk po shihni? Pra, unë jam më i mirë se ky qyqar që mezi flet!”.Edhe kjo është një shtojcë e cila nuk ceket pos në këtë sure.

14 - Në suren Dhârijât (67) kemi një shënim tepër të shkurtër për dërgimin e Musait te faraoni me një fuqi (mrekulli) të haptë e pastaj përgënjeshtrimi nga ana e faraonit dhe shpartallimi i tij.

15 - Ndërsa në suren Kehf (69) prezentohet episodi i takimit të Musait me një rob prej robërve të Allahut të cilit i është dhënë prej Tij një mëshirë (dhuntë) dhe u mësua me një dituri. Musai kërkoi prej tij që ta shoqërojë e të përfitojë dituri. Ai e informoi se nuk mund të durojë për të mësuar prej tij. Musai i premtoi se do të bëjë durim. Pastaj atë nuk e mbajti durimi ngase njeriu filloi të bëjë vepra çfarë Musai nuk ua dinte thelbin po as përfundimin. Njeriu i dijshtëm ia shpjegoi fshehtësinë e atyre sjelljeve dhe u ndanë. Kjo seri përmendet vetëm një herë.

16 - Në suret Ibrahim dhe Enbija (72), (73), kemi dy shënime të shkurtra që në të dytin ka rëndësi vlerësimi i Tevratit se ai është Furkân siç u theksua edhe më parë në këtë kapitull.

17 - Kurse në suren Bekare (87) del një detajizim tjetër me rastin e përkujtimit të Beni Israilëve për begatitë e Allahut që ua dha dhe pranimin e këtyre begative me përçmim dhe refuzim. (Në këtë rast përsëriten disa seri të kaluara rreth rrëfimit për Musain). Prej atyre begative rrëshira dhe shkurtëza, por ata shfaqin mosmirënjohje duke kërkuar ushqime të llojllojshme në vend të rrëshirës dhe shkurtëzave. Pastaj rasti i lopës për të cilën Allahu i urdhëroi ta therin, e ata filluan ta zvarrisin urdhrin duke pyetur për cilësitë e saj. Ata aq e tepruan saqë përfunduan të gjitha cilësimet e ata filluan të arsyetohen se nuk mund ta gjejnë, “mirëpo e therën atë, e përpak e lanë pa e kryer punën.” (Bekare, 71). Kjo, siç po e shihni, është një seri e re e cila nuk është përmendur më parë askund.

18 - E në suren Nisaë (92) kemi shënim për kërkimin e tyre që Allahun ta shohin sheshazi, si argument për problemet dhe padëgjueshmëritë e tyre.

19 - Në suren Mâide (112) theksohet episodi i qëndrimit të tyre para dyerve të tokës së shenjtë “Palestinës” dhe e refuzimit të hyrjes në te: “Ata thanë: O Musa, aty është një popull i fuqishëm (dhunues), prandaj ne nuk do të hymë kurrë derisa ata të mos dalin nga ajo (të na lirojnë pa luftë). Nëse dalin ata nga ajo, ne do të hymë!”, kështu vijon deri te thënia: “Ata thanë: O Musa, ne kurrë nuk hymë në të derisa ata janë aty, shkoni pra ti dhe Zoti yt luftoni e ne po rrimë këtu! Musai tha: Zoti im, unë nuk kam në dorë pas vetes sime dhe as vëllait tim, ndana pra neve prej popullit të prishur. (Allahu) tha: Ajo (tokë) është e ndaluar (haram) për ta dyzet vjet. Do të sillen nëpër tokë (të hutuar). Ti mos u brengos për popullin e shfrenuar.” (Mâide, 22, 24-26). Kështu Beni Israilët aty përshkruhen të hutuar e pas saj nuk vjen ndonjë shënim për Musain, ndërsa për Beni Israilët nuk përmendet gjë pos përçarjes

së tyre mes vete dhe armiqësisë ndaj Mesihut (Isait) dhe muslimanëve.

Ky rrëfim është prej më të përsëriturve në Kur'an. Ne në këto pasqyrime i pamë edhe llojet e përsëritjeve, dhe se përsëritja, përpos në gjashtë raste, ka karakter indikativ dhe këshillues sa i përket rrëfimit, të cilët i rezultoi konteksti i rastit ku bëhet fjalë. Ndërsa seritë kryesore përafërsisht nuk janë përsëritur. E nëse është përsëritur ndonjë seri, ajo vjen me një të dhënë të re gjatë përsëritjes.

Ky rrëfim është model për rrëfimet tjera, dhe nën prizmin e tij kuptojmë se nuk ka në rrëfimet kur'anore ndonjë përsëritje komplete dhe absolute, gjë që u shtiret disave që e lexojnë Kur'anin pa vëmendje të plotë dhe përpikëri.

* * *

b) Prej pasojave të nënshtrimit të rrëfimit në Kur'an ndaj qëllimit fetar - përveç përsëritjes - është që rrëfimi të shfaqet me atë masë që majfton ta kryejë qëllimin e tij në atë episodë ku përshtatet me te. Ndonjëherë rrëfimi shfaqet nga fillimi, ndonjëherë nga mesi e ndonjëherë nga fundi ndonjëherë shfaqet i plotë e ndonjëherë mjafton me disa seri të tij ndonjëherë zgjedh pak aty e pak këtu në atë mënyrë që ta nxjerrë porosinë ku edhe mëton. Kjo ngase qëllimi historik nuk është prej qëllimeve kryesore të Kur'anit siç është rasti me qëllimin fetar. Andaj edhe rrëfimi dhe qëllimi i parë i tij është qëllimi fetar dhe atë në këtë mënyrë:

1 - Disa rrëfime i gjejmë se si shfaqen që nga episodi i parë: episodi i lindjes së protagonistit të tij, sepse në lindjen e tij ka porosi të dalluar. Për këtë si shembull kemi:

Rrëfimi për Ademin që nga “krijimi i tij”. Në të shfaqet fenomeni i fuqisë së Allahut, përsosurisë së diturisë së Tij dhe begatimit të Tij ndaj Ademit dhe bijve të tij. Edhe në ngjarjen me Iblisin ka qëllime fetare për të cilat sinjalizuar më parë.

Pastaj lindja e Isait, birit të Merjemesë e cila shfaqet me detaje të plota, ngase lindja e tij është dëshmia (mrekullia) më e madhe e jetës së tij. Dhe rreth kësaj lindjeje të jashtëzakonshme u zhvillua e tërë polemika, dhe prej saj degëzohen të gjitha çështjet (kontestet) e Krishterimit para dhe pas Islamit.

Edhe rrëfimi për Merjemen, e cila u përkushtua në shërbim të Allahut duke qenë në barkun e nënës, marrja e saj nën kujdesin e Zekeraiat, mandej furnizimi i saj që nga lindja e saj me rrizk të mirë nga ana e Allahut ashtu që: “Sa herë që Zekeraiat hynte në mihrabin (dhomën) e saj, gjente te ajo ushqim e thoshte: “Oj Merjeme, prej nga ty ky ushqim? Ajo i thoshte: Ai është nga Allahu, se Allahu atë që do pa masë e furnizon!” (Merjem, 37). Më pas seritë e saj shtrihen njëra pas tjetrës derisa të vijë episodi i lindjes së Isait. Ajo është periudha e dytë e rëndësishme e jetës së saj.

Rrëfimi për Musain; të cilit lindja i ngjau në kohën e shtypjes (torturimit) ndaj Beni Israilëve dhe therjen e fëmijëve meshkuj të tyre, pastaj shpëtimi i tij prej kësaj masakre, dhe atë duke qenë në mesin e familjes së faraonit. Kjo është një vlerë e posaçme në vërtetimin e kujdesit të Allahut ndaj tij dhe përgatitjen e tij në një mënyrë të veçantë për misionin të cilin do ta marrë përsipër. Më tej, i cek nga jeta e tij episodet të cilat kanë të njëjtin kuptim.

Po edhe Ismailit dhe Is’hakut u shfaqet episodi i lindjes së tyre ngase në lindjen e tyre ka urtësi. I pari prej tyre, furnizimi i Ibrahimit me të në pleqëri - dhe vendosja e tij përkundër dëshirës së Ibrahimit - skaj shtëpisë së shenjtë, bejtul haram, dhe i dyti, për

të cilin u përgëzua kur gruaja e tij ishte e shtyrë në moshë, e ai veç i kishte kaluar vjetët e rëndomta të pleqërisë.

Në Kur'an gjithashtu ceket lindja e Jahjasë, birit të Zekeriait dhe atë pasi që i ishin dobësuar eshtrat dhe i ishte zbardhur koka nga thinjat.

2 - Disa rrëfime tjera pjesërisht fillojnë të shfaqen prej ndonjë episodi më të vonshëm:

Ja rrëfimi i Jusufit fillon nga fëmijëria e tij. Në këtë episodë e sheh ëndrrën e cila ia dëfton jetën e tij në përgjithësi, e cila do të ndikojë në tërë ardhmërinë e tij. Ai sheh njëmbëdhjetë yje, diellin dhe hënën, që të gjithë i bien në sexhde. Babai i tij e kupton brendinë e saj andaj edhe e afron afër vetes, por vëllezërit nga ky shkak edhe e xhelozonin. Më pas rrëfimi vazhdon sipas rrugës së tij të vizatuar nga ajo ëndërr.

Rrëfimi për Ibrahimin fillon kur ai është djalosht i cili shikon në qiell dhe e sheh një yll. Atë e kujton si zot të tij. E kur u humb tha: Unë nuk i dua ata që humben. Pastaj shikon edhe një herë dhe e sheh hënën. Edhe atë e kujton si zot të tij. E kur u humb, tha: Unë nuk i dua ato që humben. Pastaj shikon edhe një herë dhe e sheh diellin. Atë e fascinon madhësia e tij dhe e kujton si zot! Por edhe dielli humbet (perëndon) dhe ia ndërron mendimin. Më në fund mbështetet në Zotin e tij i cili nuk shihet, pastaj e thërret babain dhe popullin e tij t'i besojnë këtij Zoti, e ata nuk i përgjigjen thirrjes. Ai atëherë ua rrënon dhe copëton idhujt e tyre pa e hetuar, për të cilin edhe thanë: “Kemi dëgjuar për një djalosht që i përqueshte ato, të cilit i thonin Ibrahim.” (Enbija, 60). Atëherë ata ia mësynë ta djegin por Allahu e shpëtoi prej tyre: “Por Ne i thamë: “O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin.” (Enbija, 69).

Rrëfimi i Davudit fillon në prag të rinisë së vet. Fillon në episodin kur ai zihet me Xhalutin i cili ishte kalorës i fuqishëm dhe i njohur, të cilin Davudi e mund sepse Allahu e ndihmon. Pra prej këtu fillon rrëfimi i tij. Ndoshta edhe Sulejmani (i biri i Davudit) ishte në vjetët e tij kur ai u ul me të për të gjykuar për çështjen e të mbjellurave: “të cilat delet e atij populli i kishin kullotur natën, e Ne ishim përcjellës të gjykimit të tyre.” (Enbija, 78). Ky pleqërim i hershëm i Sulejmanit ishte dëshmi për atë që Allahu e përgatiti për ta marrë në dorë mbretërinë e madhe.

3 - Pastaj gjejmë disa rrëfime të cilat nuk shfaqen pos në seri krejtësisht të vonshme:

Shembull: Nuhi, Hudi, Salihu, Luti, Shuajbi dhe shumë të tjerë të cilëve nuk u prezantohet rrëfimi pos me episodin e risales (misionit). Ajo është seria e vetme e cila shfaqet nga jeta e tyre ngase është seria më e rëndësishme e jetës së tyre, por edhe urtësia e shfaqjes së struktur në te.

E gjithë kjo që folëm ishte rreth fillimit të rrëfimit, ndërsa sa i përket zgjatjes së rrëfimit dhe shkurtimit të tij edhe ato gjithashtu i nënshtrohen dhe varen sipas këshillave dhe urtësive në episodet e rrëfimit. Tani do të japim shembuj për këtë dukuri si vijon:

1 - Një rrëfim siç është rasti me rrëfimin e Musait. Ai përfshihet me të gjitha ngjarjet dhe detalet e tij, që nga lindja e tij - bile para lindjes së tij - deri te qëndrimi i tij me popullin e tij para tokës së shenjtë të cilëve edhe iu caktua bredhja lart e poshtë dyzet vjet si dënim i merituar. Pra në çdo episodë prej këtyre episodeve të rrëfimit ekziston një synim fetar që dallohet dhe i cili ka lidhshmëri të ngushtë me qëllimet më të larta të Kur'anit dhe të botëkuptimit origjinal islamik.

I ngjashëm me të është edhe rrëfimi për Isain - me pak rezymim në episodet e tij të mesme - në to përmendet lindja e tij detajisht, ceken mrekullitë e tij plotësisht; aty ceket edhe rasti i tij me Havarijunët kur kërkuan sofrën dhe ua zbriti atyre; pastaj episodi i përgënjeshtimit të tij dhe orvatja për kryqëzimin e tij, të cilin e ngriti Fuqiploti dhe e shpëtoi; përçarja e popullit të tij pas ngritjes së tij; dhe në fund shtohet edhe ilustrimi i qëndrimit të tij Ditën e kijametit kur e pyet Allahu se a i ka thënë popullit të tij: “Merrmëni mua dhe nënën time si dy zota veç Allahut.” (Mâide, 116). E ai e shfaqëson veten nga ato fjalë të Zotit dhe tregon se ai i ka thirrur t’i besojnë një Allahu të vetëm dhe se çështjen e tyre e lë në duar të Allahut, nëse do i mëshiron e nëse do i ndëshkon.

Qysh kur fillon rrëfimi i Jusufit ai vazhdon të rrëfëhet detajisht derisa të përfundojë: Ajo që i ndodh me vëllezërit e tij; ajo që i ndodh në Egjipt pas blerjes dhe rritjes së tij; ngashënjimi i gruas së zotëriut (ministrit) dhe lakmimi i saj pas tij; burgosja e tij; komentimi i tij që ua bëri ëndrrave të dy shërbëtorëve të mbretit; pastaj komentimi i tij i ëndrrës së mbretit; dalja e tij nga burgu; marrja e tij e detyrës si përgjegjës i depove të tokës (ministër i financave dhe furnizimit!); ardhja e vëllait të tij dhe kthimi i vëllezërve të babait të tij pa vëllain; ndërsa përkryerja e rrëfimit arrihet me ardhjen e babait dhe të familjes së tij. I gjithë ky rrëfim i shpjeguar detajisht dhe hollësisht është bërë ngase këtu detajizimi i rrëfimit është qëllimi kryesor, së pari: për konfirmimin e shpalljes dhe misionit siç treguam edhe më parë, dhe së dyti: këto detajizime kanë vlerën e tyre fetare gjatë rrëfimit.

Rrëfimi për Ibrahimin nuk shfaqet nga fillimi i jetës së tij, por shfaqet në disa seri të përdërdhura: episodi i imanit të tij (ardhjes në besim) i cili u përmend; polemizimi i babait dhe popullit të tij; rrënimi i idhujve; izolimi i tij nga babai dhe populli i tij; dhurimi i Allahut atij Ismailin dhe Is’hakun; ëndrra e tij duke e thënë djalin e

tij dhe sakrifikimi i tij, ndërtimi i Qabes dhe leja (urdhri) njerëzve për ta bërë haxhxin, kërkimi i tij nga Zoti që t'i sjell dëshmi bindëse për ringjalljen e të vdekurve, e jo për të besuar se ai veç më ka besuar, por për t'iu qetësuar zemra. Atë Allahu e urdhëroi të marrë katër shpezë e pastaj t'i copëtojë. Mandej t'i shpërndajë nëpër kodra pjesët e tyre. E pastaj t'i thërrasë e ata i erdhën përnjëherë.

Nga rrëfimi për Sulejmanin gjithashtu shfaqen seri të gjata: Gjykimi i tij për të mbjellat, mbretëria e tij; mashtrimi (sprovimi) i tij me kuajt e bukur luftarakë; nënshtrimi i xhinëve dhe erërave atij; pastaj sprovimi tjetër i tij për të cilin Kur'ani nuk e cek shkakun; rasti i tij me thneglën, pupëzën dhe me Belkisen; vdekja e tij duke qenë mbështetur në shkopin e tij, kurse djajtë nuk dinë asgjë Pra të gjitha këto lajme kanë kuptime për qëllime të caktuara.

2 - Kemi rrëfime të cilat detajizohen mesatarisht:

Rrëfimi për Nuhin në të cilin përmenden detaje të shpalljes dhe thirrjes së tij për popullin e vet; madhështimi i tyre ndaj thirrjes së tij; episodi i ndërtimit të anijes; episodi i tufanit (vërshimit) me ujë; përmbytja e djalit të tij; lutja e tij ta shpëtojë të birin; mospërgjigjja e Allahut lutjes së tij sepse i biri nuk është prej familjes së tij edhe pse është i biri i tij dhe se: "Ai ishte punëkeq." (Hûd, 46).

Rrëfimi për Ademin shpjegohet detajisht në krijimin e tij; gabimin e tij; lëshuarjen e tij (në tokë); pendimin e tij; dhe pranimin e lutjes nga ana e Allahut.

Rrëfimi për Merjemen zgjatet me rastin e lindjes së saj dhe lindjes së Isait.

Rrëfimi për Davudin shpjegohet në një gjatësi normale por nuk arrinë detajizimin e rrëfimit për Sulejmanin, por ai shqyrton shumë prej episodeve të tij.

3 - Kemi rrëfime edhe të shkurta:

Rrëfimet për Hudin, Salihun, Lutin, Shuajbin, përkundër përsëritjes së tyre janë të shkurta ngase ato shfaqen vetëm në episodin e shpalljes në të cilat shqyrtohet vetëm çështja e “risales” (shpalljes) dhe e dialogut me popujt e tyre, përgënjeshtrimi i tyre dhe në fund shkatërrimi i tyre total.

Rrëfimi për Ismailin ceket me lindjen e tij; rastin e sakrifikimit të tij kur ishte në pyetje therja e tij; në rastin e ndërtimit të Qabesë me babain e tij; të gjitha ceken me një formë të shkurtuar pjesërisht nëpër të gjitha seritë.

Rrëfimi për Jakubin përmendet në kontekst të rrëfimit për Jusufin dhe ate vetëm një herë: “Kur Jakubit iu afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: Çka do të adhuron pas meje? Ata thanë: “Do ta adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e prindërve tuaj.” (Bekare, 133). Kjo seri u veçua për shkak të rëndësisë së saj në proklamimin e “tevhidit” (monoteizmit) për të cilin porosi Jakubi.

4 - Ekzistojnë edhe disa rrëfime të cilat janë tejet të shkurta.

Rrëfimi për Zekeria in me rastin e lindjes së Jahjasë dhe me rastin e përkujdesjes së tij ndaj Merjemesë. Rrëfimi për Ejubin përmendet kur e kaplon sëmundja; pastaj kërkimi i ndihmës që ia bëri Allahut; shërimi i tij dhe kthimi i familjes përsëri te ai. Rrëfimi për Junusin ceket me rastin kur ai kapërdihet nga një peshk i madh; hedhja e tij në një vend të shkretë, dhe misioni i tij ndaj popullit të vet dhe besimi i tyre ndaj tij.

5 - Rrëfimet të cilat sinjalizojnë emrat e tyre por nuk përmendin asgjë për ta, pos një përshkrimi të përciptë, si rrëfimet për Idrisin, Eljesanë, Dhulkiflin dhe disa të tjerëve të cilëve nuk u përmendet gjë pos emrit të tyre në rast të ekspozimit të shënimit (regjistrimit) të pejgamberëve.

6 - Kurse rrëfimet tjera të shpërndara, si rrëfimi i “zotave të hendeqeve” (as’habul uhdud); banorëve të shpellës; dy bijve të Ademit; pronarit të dy kopshteve; pronarëve të xhennetit; pendës Me’reb dhe ai i cili kaloi pranë një fshati që ishte rrënuar që nga themelet e tij. Këto janë rrëfime ekskluzivisht këshilluese. Ato prezentohen atëherë sa të arrihet qëllimi i këshillës. Disa prej tyre i kemi ekspozuar më parë e disa prej tyre do t’i ekspozojmë në të ardhmen. Ne këtu do të mjaftojmë me këtë sqarim. Pra ne e kemi për qëllim të bëjmë me dije se rrëfimi kur’anor shfaqet në atë masë sa të jetë në pajtim me qëllimin e tij fetar. Mendoj se atë që e synuam edhe e arritëm.

* * *

c). Prej gjurmëve të nënshtërimit të rrëfimit ndaj qëllimit fetar është edhe ngërthimi i orientimeve (kaheve) fetare me kontekstin e rrëfimit si në fillim të tij po ashtu edhe në mbarim, por edhe në brendinë e tij. Sa u përket orientimeve të cilat ceken në fillim të rrëfimit apo më mirë të themi para tij, ne kemi theksuar dy shembuj më parë: I pari: Vënia në dije se udhëzimet e rrëfimeve argumentojnë shpalljen e tyre, siç është rasti me rrëfimin për Jusufin dhe rrëfimin për Ademin. I dyti: Ardhja e rrëfimeve si dëshmuar të paralajmërimeve. Për shembull: “Njoftoi robërit e Mi, se vërtet unë jam Ai që fal shumë dhe mëshirues i madh. Po (njoftoi) se edhe dënim i madh është dënim i dhembshëm.” (Hixhr, 49-50). Pastaj vazhdon që t’i nxjerrë në pah rrëfimet të cilat dëshmojnë për rahmetin dhe ato që dëshmojnë për dënimin.

Ato që ceken pas rrëfimit, edhe për to kemi theksuar dy shembuj më parë: I pari: Vënia në dije se udhëzimet e rrëfimeve argumentojnë shpalljen e tyre, siç është rasti pas rrëfimit për Nuhin në suren Hûd. I dyti: Vënia në dije se dënimi i Allahut është i drejtë dhe se Ai nuk e dënon një popull vetëm pas tërheqjes së vërejtjeve si ai i cili u cek në suren Ankebût pas rrëfimeve të përbashkëta të pejgamberëve: “Secilin prej tyre e kemi dënuar për shkak të mëkatit të vet; disa prej tyre Ne i goditëm me furtunë plot rërë, disa i shkatërruam me krisma nga qielli, kurse disa të tjerë i sharruam në tokë e disa i përmbytëm në ujë. Allahu nuk u bëri atyre ndonjë të padrejtë, por ata vetvetes i bënë padrejtë.” (Ankebût, 40).

Ai cili i përcjell me vëmendje rrëfimet kur’anore pas çdo rrëfimi gjenë një koment fetar i cili përshtatet me urtësinë e tij. Ndërsa sa u përket orientimeve fetare në brendinë e rrëfimit, ne do t’i sjellim disa shembuj këtu:

1 - “...Ose (nuk je i njohur) me shembullin e atij që kaloi pranë një fshati që ishte rrënuar në kulmet e tij, e ai tha: Si e ngjall Allahu pas shkatërrimit të tij? E Allahu e bëri të vdekur atë (pyetësin-Uzejrin) njëqind vjet, pastaj e ringjalli dhe i tha: Sa qëndrove (i vdekur)? Ai tha: Një ditë ose një pjesë të ditës! Ai (Allahu) tha: Jo, por ke qenë i vdekur njëqind vjet, shiko ushqimin dhe pijen tënde se si nuk është prishur, e shiko edhe gomarin tënd (si i janë shkapërderdhur eshtrat). E për të bërë ty argument, për njerëzit (bëmë këtë sprovë), shiko se si i kombinojmë eshtrat e pastaj i veshim me mish. E kur iu bë e qartë atij tha: U binda se me të vërtetë Allahu ka mundësi për çdo send!” (Bekare, 259). Kështu brenda kontekstit të fjalës sjell pasusin: “E për të bërë ty argument për njerëzit (bëmë këtë sprovë)”, e në mbarim të saj: “Tha: U binda se me të vërtetë Allahu ka mundësi për çdo send”.

2 - Në rrëfimin e Sulejmanit me Belkisen, pupëza thotë: “Në të vërtetë unë gjeta një grua që po i sundonte ata (popullin e Sebe-it), dhe asaj i është dhënë çdo send, e ajo kishte edhe një fron të madh. Madje e takova atë dhe popullin e saj se e adhurojnë diellin e jo Allahun, por djalli ua kishte hijeshuar atë veprim të tyre dhe i kishte shmangur prej rrugës së drejtë, andaj ata nuk gjejnë udhëzim. (I kishte shmangur) Që të mos e adhurojnë Allahun që nxjerr në shesh të fshehtë në qiej dhe në tokë, dhe që e di atë që e fshehni dhe atë që e publikoni, Allahu është Një, nuk ka zot tjetër pos Tij, Zot i arshit të madh.” (Neml, 23-26). Gjithë këtë e thotë pupëza në brendi të rrëfimit që të udhëzohen Ademijjunët (njerëzit) përmes fjalëve të saj ashtu siç është udhëzuar ajo!

3 - Në rrëfimin e Jusufit me dy shërbëtorët e mbretit. Njëherë ai ua komenton ëndrrat e pastaj u thotë: “Kjo është nga ajo që ma mësoi Zoti im (nuk është fall as parashikim). Unë e kam braktisur fenë e një populli që nuk beson Allahun as botën tjetër, e ata ishin jobesimtarë. Unë e ndoqa fenë e prindërve të mi: Ibrahimit, Is’hakut, Jakubit. Neve nuk na takon që t’i përshkruajmë kurrnjë send shok Allahut. Ky (besim i drejtë) është dhuratë e madhe nga Allahu ndaj nesh dhe ndaj njerëzve, por shumica e njerëzve nuk ia dinë vlerën.” (Jûsuf, 37-38). Kështu pra nuk zhvillohet konteksti i rrëfimit, e të mos gjenden në brendinë e tij këto orientime fetare pa marrë parasysh brendinë e kuptimit në rrëfim i cili gjithmonë mëton në to përmes ngjarjeve që zhvillohen pa i cekur orientimet.

Lexuesi i rrëfimeve në Kur’an i gjen këto orientime të skalitura në brendinë e tyre, ose në këtë mënyrë ose në ndonjë mënyrë të ngjashme. Me rëndësi është se ai i gjen me shumicë dhe bollëk, të cilat dëshmojnë qëllimin kryesor në kontekst të rrëfimit, e ai është qëllimi fetar para çdo qëllimi tjetër.

Feja dhe arti në rrëfim

Ne kemi thënë se nënshtrimi i rrëfimit ndaj qëllimit fetar nuk i ka penguar veçoritë artistike të shfaqen gjatë ekspozimit të tij. E tash themi: Në të vërtetë, nga pasojat e këtij nënshtrimi erdhi deri te shfaqja e veçorive artistike të cilat konsiderohen në opusin (kapitalin) artistik të rrëfimit në botën e artit të lirë. Kjo konkluzë është garanci më e sigurt për atë që e thamë në fillim të këtij kapitulli, se Kur'ani “bukurinë artistike e shndërron në mjet synues për ndikim intuitiv, andaj edhe i referohet sensit të intuitës fetare me gjuhën e bukurisë artistike”.

Në qëllimet do t'i ekspozojmë këto veçori artistike të cilat i quajmë: “dukuri të harmonizimit artistik në rrëfim”.

* * *

a) Nga qëllimet e rrëfimit në Kur'an kemi vërtetimin e njëshmërisë së Zotit, njëshmërisë së fesë, njëshmërisë së pejgamberëve, njëshmërisë së metodave të da'ves (thirrjes islame) dhe njëshmërisë së pasojave të cilat do t'i përjetojnë përgënjeshtresit ashtu siç edhe squarum në fillim të këtij kapitulli.

Prej varësisë së rrëfimit nga këto qëllime u krijua edhe shfaqja e shiritit të pejgamberëve lajmëtarë dhe të dërguar, të cilët ftuan për besim në një fe; dhe njerëzisë përgënjeshtreuse ndaj kësaj feje të vetme të vërtetë dhe ate disa herë, aq sa edhe ishin qëllimet e nduarnduarta. Kjo dukuri shkaktoi përsëritjen në disa vende; por ajo, nga ana tjetër, në mënyrë permanente krijoi edhe bukurinë artistike. Kjo, nga arsyeja se ky shirit ia përfytyron medituesit sikur të ishte vetëm një pejgamber dhe sikur të ishte një popull gjatë tërë asaj kohe. Çdo pejgamber thërret duke e thënë fjalën e tij të urtë

dhe të qetë, e në anën tjetër atë e përgënjeshtrojnë ajo njerëzi lajthitëse. Pastaj vjen tjetri dhe e thotë të njëjtën fjalë dhe e pret të njëjtën përgjigje, por edhe të tjerët kështu me radhë...

“Ne e patëm dërguar Nuhin te populli i vet, e ai i tha: O populli im, adhurone Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një ditë të madhe! Paria nga populli i tij tha: Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur! (Nuh) tha: O populli im, unë nuk kam kurrfarë humbje, por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve!. Unë ua kumtoj juve shpalljen e Zotit tim, ju këshilloj dhe unë e di nga Zoti im atë që ju nuk e dini! A mos u habitët që shpallja ju erdhi nga Zoti juaj përmes (gjuhës së) një njeriu nga mesi juaj, për t’ua tërhequr vërejtjen që të ruheni dhe ashtu të shpëtoni!. Po, ata e përgënjeshtrojnë atë (Nuhin), e Ne e shpëtuam atë dhe ata që ishin me të në anije, ndërsa ata që i përgënjeshtrojnë faktet Tona i fundosëm. Vërtet, ata ishin popull i verbër”.

“Edhe te (populli) Ad-i (dërguam) vëllain e tyre Hudin, e ai tha: O populli im, adhurone Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij, a nuk po frikësoheni?! Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: Ne po të shohim mendjelehtë dhe të konsiderojmë vërtet rrenacak! Tha (Hudi) O populli im, nuk jam mendjelehtë (nuk kam të meta mendore), por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve. (Jam dërguar) që t’ua komunikoj shpalljen e Zotit tim dhe unë jam këshillues besnik për ju. A mos ju erdhi çudi që ju erdhi shpallja nga Zoti juaj përmes një njeriu nga mesi juaj, e për t’ua tërhequr vërejtjen. Përkujtoni kur Ai ju bëri sundues pas popullit të Nuhit dhe ua shtoi fuqinë fizike. Përkujtoni të mirat e Allahut që të gjeni shpëtim. Ata thanë: A na erdhe (të na frikësosh) që ta adhurojmë vetëm Allahun e ta braktisim atë që e adhuronin prindërit tanë? Nëse je i vërtetë (siç thua), sillna atë që na e premtonte (kërcënosh). (Hudi) tha: Juve ju gjeti dënimi dhe përbuzja nga

Zoti juaj. A më polemizoni mua për emra (të idhujve) që i emëruat ju dhe prindërit tuaj, e që për ta Allahu nuk shpalli kurrfarë argumenti? Pritni pra (dënimin), edhe unë së bashku me ju jam duke pritur. Ne me mëshirën tonë e shpëtuam atë dhe ata që ishin me të, dhe i shkulëm nga rrënja ata që i përgënjeshtroan argumentet Tona dhe nuk ishin besimtarë”.

“Edhe te (populli) Themud (e dërguam) vëllain e tyre, Salihun, e ai u tha: O populli im, besone Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Qe, ju erdhi argumenti nga Zoti juaj. Ja, kjo devja është mrekulli për ju. Line këtë të lirë të hajë në tokën e Allahut dhe kurrsesi mos e merrni me të keq, e t’ju arrijë dënimi i dhembshëm. Përkujtoni kur Ai ju bëri sundues pas Adit, ju vendosi në tokë, e ju në rrafshin e saj ndërtoni pallate kurse në kodrina ngreni shtëpi, përkujtoni të mirat e Allahut e mos u bëni shkatërrues në tokë. Krerët kryelartë nga populli i tij u thanë atyre që ishin më të dobët e që kishin besuar: A e dini se me të vërtetë Salihu është i dërguar nga Zoti i tij? Ata thanë: Vërtet ne jemi besimtarë të asaj me çka është dërguar. Ata kryelartit thanë: Ne jemi mohues (jobesimtarë) të asaj që ju e besuat. Ata e therën deven dhe me kryelartësi shkelën Ligjin e Zotit të tyre dhe thanë: O Salih, sille atë me çka na u kërcënove, nëse je prej të dërguarve. Atëherë ata përjetuan tërmetin dhe u gdhinë në shtëpitë e tyre si kufoma të ngrira...” (A'rafë, 59-78).

Pra, sa herë që përsëriten këto pasqyime, kemi rastin t'i parafytyrojmë ata të cilët u kundërvunë çdoherë para çdo pejgamberi, të cilën gjë Kur'ani e ekspozon në mënyrë të vazhdueshme derisa të vie te kundërvimi i mosbesimtarëve kurejshitë ndaj Muhammedit. Ai duke i përsëritur të njëjtat fjalë që i thanë pejgamberët tjerë, e ata duke reaguar me atë kundërvim të përhershëm. Pa dyshim, nëse përjetohet (vërehet me vëmendje) ky pasqyrim, do të shohim se në te ka bukuri artistike.

b) Prej pasojave të nënshtrimit të rrëfimit ndaj qëllimit fetar është edhe ekspozimi i serive të tij të cilat i rezultojnë këto qëllime. Nga kjo mënyrë e ekspozimit lindi ajo që ishte shumë afër të shndërrohet në rregull të përgjithshme. Kjo, ngase seria e fundit e cila paraqitet (sipas rendit kohor të sureve), përputhet me qëllimin më të dukshëm fetar për shkak të të cilit edhe u thur rrëfimi. Në të njëjtën kohë ky përfundim përputhet me bazat artistike dhe duket sikur të ishte përfundim artistik në vete e jo për qëllimin fetar jashtë tij.

Ne kemi vërejtur në rrëfimin për Musain më parë se rrëfimi i fundit që flet për te gjendet në suren Mâide dhe episodi i cili shfaqet në te është episodi i hutimit (bredhjes). Ja pra, ata ishin Bijtë e Israilit të cilëve Allahu ua lëshoi dhuntinë e tij rrëke dhe i përshkoi me mëshirën e Tij. Dhe ja ata në fund nuk e ruajnë këtë dhunti e as nuk hyjnë në tokën e shenjtë. Musai dha mund të madh që t'i bindë, por kot. Atëherë Allahu i provoi me bredhje duke i lënë të hutuar pa udhëzues dhe ndihmës derisa të kalojë afati i caktuar.

Ky pra është qëllim ekskluzivisht fetar. Megjithatë, a ta merr mendja se ka përfundim më të bukur artistik se sa kjo skenë e hutimit pas atij mudi të madh dhe pas asaj pavendosurie marramendëse? Pa mëdyshje, skena e hutimit dhe bredhjes është skena më e përshatshme artistike nëse rrëfimi është i liruar nga të gjitha kufizimet.

Tani le ta ndjekim këtë dukuri në rrëfimet tjera.

1 - Rrëfimi për Ibrahimin përmendet në më shumë se njëzet vende. Vendi i fundit ku ceket është sureja Haxhxxh (sipas zbritjes), në të cilën shfaqet kjo episodë “Përkujto kur Ne e udhëzuam Ibrahimin për në vendin e shtëpisë (Qabes): Të mos më përshkruaj Mua shok, pastroje shtëpinë time për ata që e vizitojnë (bëjnë tavaf), që qëndrojnë në këmbë duke u falur, përkulur dhe që bëjnë sexhde. Dhe thirr ndër njerëz për haxhxxh, se do të të vijnë ty këmbësorë dhe kalorës me deve të rraskapitur që vijnë prej rrugëve të largëta.” (Haxhxxh, 26-27).

Këtu nga pikëpamja fetare, kemi një lidhje mes ritualeve të haxhxxhit në Islam dhe ritualeve të tij në fenë e Ibrahimit. Ky pra është qëllimi i synuar siç thamë më parë. Në të njëjtën sure në përfundim të saj është cekur përmendja e fundit e Ibrahimit kur thotë: “Në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur’an) ju quajti muslimanë.” (Haxhxxh, 78). Por le të ndalemi në pikëpamjen ekskluzivisht artistike dhe të pyesim: A ka mund të ketë skenë më mallëngjyese me të cilën do të përmbylej rrëfimi për te se sa ajo skenë kur ai i thërret njerëzit për haxhxxh, kurse vet ishte ndërtues i shtëpisë dhe i cili e la birin e tij Ismailin aty para se ta ndërtojë? Ajo pra është përmbyllja më mallëngjyese artistike edhe pse këtë nuk e synoi qëllimi fetar.

2 - Rrëfimi për Isain ceket kryesisht në tetë vende ndërsa episodi i fundit i tij është shfaqur në suren Mâide (112) në këtë mënyrë: “Dhe kur Allahu tha: O Isa, bir i Merjemesë, a ti njerëzve u the: Më besoni mua dhe nënën time si dy zota pos Allahut? (Isai) tha: Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua të them atë që s’është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, Ti do ta dije, Ti e di se çka në mua e unë nuk e di çka në Ty. Ti je më i dijsmë i

të fshehtave! Unë nuk u kam thënë tjetër atyre, pos asaj që Ti më urdhërove; ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, dhe sa isha ndër ta kam qenë përcjellës i tyre, e pasi që më more mua, Ti ishe roja (dhe dëshmues) i tyre. Ti je dëshmitar për çdo send! Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robërit Tu, e nëse u fal atyre, Ti je i Gjithëfuqishmi, i Urti.” (Mâide, 116-118).

Për një rrëfim si rrëfimi i Isait, kjo përmbyllje në të njëjtën kohë është edhe fetare edhe artistike. Lindja e tij është e çuditshme dhe e pazakontë. Nga kjo lindje shpërthyen dyshimet e zotimit (konsiderimit të tij për Zot) të tij dhe mu nga kjo pikë e nyjësuar u trazuan problemet. E ja ai vetë, në çastin e fundit para Krijuesit të tij, pranon adhureshmërinë e tij, dëshmon për atë se çka i ka thënë popullit të tij, kurse çështjen e tyre e lë në kompetenca të Allahut fuqiplotë dhe të urtë.

Arti synon këtë përmbyllje kur rrëfimi zhvillohet sipas rrjedhës së tij në Kur'an.

3 - Rrëfimi për Ademin gjithmonë përmbyllet me zbritjen e tij (në tokë). Nëse diçka shtohet, shtohet kërkimfalja e Ademit për mëkatën e tij dhe pranimin prej Zotit. Pastaj nuk kemi kurrfarë lajmesh nga ajo se çka i ndodhi pas zbritjes në tokë (siç tregon Tevrati për shembull), ngase qëllimi fetar kryhet me largimin e Ademit nga xhenneti si dënim për pranimin e konsultimit nga ana e armikut të tij të vjetër dhe për harresën e urdhrit të Zotit të tij bujar.

Ndërsa sa i përket artit, në të gjendet e gjithë ajo që e kërkon artisti. Largimi nga xhenneti dhe zbritja e tij në tokë; lënia e rrëfimit hapur pas zbritjes së tij për kujtesën që ajo ta përcjell dhe imagjinojë Ademin e ngratë dhe të shoqen e tij në tokë, të hutuar duke mos i njohur skajet e saj. Ata as që ishin mësuar që të

ambientohen në te e as që kishin përvojë t'i adaptohen jetës së saj, e shumë gjëra të tjera të cilat i ndien imagjinata duke i inskenuar dhe hipotetizuar, që bukuria e tyre artistike e nxjerr çdo plotësim për rrëfimin pas kësaj përmbylljeje.

4 - Rrëfimi për Sulejmanin ceket në tre vende. Sureja e fundit në të cilën përmendet është sureja Enbija (73), e cila e regjistron këtë skenë: “(Përkujto) Davudin dhe Sulejmanin, kur pleqëronin për çështjen e bimës (mbjelljes) të cilën delet e atij populli e kishin kullotur natën, e Ne ishim përcjellës të gjykit të tyre. E Sulejmanit Ne ia mësuam atë (përgjigjen e saktë) po secilit (prej tyre) u patëm dhënë urtësi e dije. Ne bëmë që kodrat dhe shpezët ta madhërojnë (ta bëjnë tesbih) së bashku me Davudin. Ne kemi mundësi (ta bëjmë këtë) dhe e bëmë. Ne ia mësuam atij (Davudit) punimin e petkave (të hekurta) për ju, që t’ju mbrojnë në raste lufte. A jeni pra ju mirënjohës për këtë? Ndërsa Sulejmanit (ia nënshtruam) erën e fortë që sipas dëshirës së tij ecte me të deri te toka të cilën e kemi bekuar Ne. Ne jemi të gjithëdijsëm për çdo gjë. Edhe disa nga djajtë (ia nënshtruam) që zhyteshin (në thellësi të ujit) dhe bënë edhe punë tjera për të (Sulejmanin), por Ne i ruanim ata (të mos shmangeshin).” (Enbija, 78-82).

Edhe këtu kemi qëllimin fetar siç është rasti me qëllimet e shumë rrëfimeve për Sulejmanin. Në shikim të parë këtu duket se përmbyllja artistike nuk përputhet me qëllimin fetar, dhe se pamja e Sulejmanit të mbështetur në shkopin e tij pas vdekjes, duket se është përmbyllja artistike e kërkuar.

Kjo skenë pa dyshim përshtatet për një gjë të tillë, por skena e gjykit (pleqërimit) dhe urtësisë në këtë rast ka vlerën e vet artistike në jetën e Sulejmanit. Ai është “Sulejmani i urtë” siç quhet por edhe “Sulejmani mbret”. Në këtë pleqërim të hershëm kemi dëshmi për dhuntinë e urtësisë dhe parapërgatitje për mbretërinë e

madhe. Madje ajo është metodë prej metodave të shfaqjes që rrëfimi i heroit të përfundojë me një skenë nga skenat e fëmijërisë ose djalërisë së tij, e cila ka lidhje të fortë me thelbin e rrëfimit që nga fillimi e deri në fund.

5 - Madje edhe rrëfimet e përbashkëta mes disa pejgamberëve - që qëllimet e tyre fetare janë të ditura - shfaqja e tij e fundit është harmonizuar me përmbylljen artistike me disa fjalë: “Po edhe nëse të përgënjeshtrojnë ty, para tyre pat përgënjeshtruar edhe populli i Nuhit, Adit dhe Themudit. Edhe populli i Ibrahimit edhe populli i Lutit. Po edhe banorët e Medjenit. Qe përgënjeshtruar edhe Musai; e Unë jobesimtarëve u pata dhënë afat, më pastaj u dhashë dënim, e çfarë ishte ai dënim Imi? (Ua ndryshova gjendjen në të keq).” (Haxhixh, 42-44). Ky është një përfundim konkret, pastaj përfundim fetar e njëkohësisht edhe përfundim artistik.

6 - Ndërsa sa i përket rrëfimit për Jusufin, në përmbyllje të tij në formë të veçantë ekziston përputhshmëria me rrëfimin në fillim të tij. Ky rrëfim fillon me ëndrrën e Jusufit dhe mbaron me realizimin e po asaj ëndrre duke iu përlënë prindërit dhe vëllezërit e tij, dhe më në fund skena ku Jusufi i largon duart nga çdo gjë dhe i drejtohet Zotit të tij me këtë lutje të sinqertë dhe penduese: “Pasi iu plotësua dëshira, Jusufi tha: Zoti im, ‘Ti më ke dhënë mua pushtet,ma mësove komentimin e ëndrrave; o Krijues i qiejve dhe i tokës, ‘Ti je kujdestar Imi në dunja e në Ahiret, më bën të vdes musliman dhe më bashko me të mirët!’” (Jûsuf, 101). Pas kësaj nuk u shtua asnjë pasus siç ndodhi në Tevrat, ngase qëllimi fetar u realizua me çka u realizua edhe përmbyllja më e bukur artistike.

* * *

c) Nga synimet e qëllimeve fetare të rrëfimit është që ai të përshtatet me mesin në të cilin shfaqet. Kjo përshtatje krijoi një lloj të harmonizimit artistik për të cilin diskutuam në një kapitull të veçantë ku i përmendëm të gjitha llojet e ilustrimit në Kur'an.

Ndërsa sa i përket pamjes së tij në kontekst të rrëfimit, ne përmendëm një model të tij më parë kur bëmë fjalë për qëllimet e rrëfimit. Për këtë si shembull: “Njoftoi robërit e Mi, se vërtet Unë jam ai që fal shumë dhe mëshirues i madh, por (njoftoi) se edhe dënimi Im është dënim i dhembshëm.” (Hixhr, 49-50), e që pas kësaj vijojnë rrëfimet që i vërtetojnë këto njoftime.

Tani do të cekim disa modele të tjera në të cilat qëllimi fetar përputhet plotësisht me harmonizimin artistik:

1 - Në suren A'rafë rrëfimi për Ademin u paraqit në këtë mënyrë:

“Ne ju krijuam pastaj ju dhamë formën, e mandej engjëjve u thamë: Bëni sexhde për Ademin. Ata i bënë sexhde pos Iblisit. Ai nuk qe prej atyre që bënë sexhde. (Allahu) tha: Çka të pengoi ty të bësh sexhde, kur Unë të urdhërova? Ai (Iblisi) tha: Unë jam më i vlefshëm se ai, më krijove mua nga zjarri, e ate e krijove nga balta! (Allahu) tha: Zbrit nga ai (xhenneti), nuk të takon të bësh kryelartësi në të, dil jasht, s'ka dyshim se ti je i poshtëruar. (Iblisi) tha: Më afatizo deri në ditën kur ringjallen (njerëzit)! (Allahu) tha: Ti je i afatizuar! (Iblisi) tha: Për shkak se më humbe mua, unë do t'ju ulem atyre (do t'u zë pus) në rrugën tënde të drejtë. Mandej do t'u sillem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjeshe që të falënderohen (të besojnë)! (Allahu) tha: Dil nga ai (xhenneti) i urrejtur, i dëbuar. Kush prej tyre vjen pas teje, Unë kam për ta mbushur xhehennemin me të

gjithë ju. (Ne i thamë) O Adem, ti dhe bashkëshortja jote zini vend në xhennet, hani çka të doni, e mos iu afroni kësaj peme sepse do të bëheni prej zullumqarëve (të vetvetes suaj). Shejtani i nxiti ata të dy (i mashtroi) që t'ua zbulojë atyre pjesët e turpshme që u ishin të mbuluara dhe tha: Zoti juaj nuk ua ndaloi juve atë pemë vetëm që të mos bëheni engjëj, ose të mos bëheni prej të përjetshëmve. Dhe iu përbetua atyre (duke u thënë) se: Unë jam këshillues për ju. Atëherë me mashtrim i zbriti (në nivel të palakmueshëm). E kur e shijuan pemën, u zbulua vendturpi i tyre dhe filluan ta mbulojnë atë (duke vënë gjeth mbi gjeth), nga gjethet e (pemëve të) xhennetit. Zoti i tyre i thirri (duke u thënë): A nuk ua ndalova atë pemë dhe a nuk ju thashë se shejtani është armik i haptë për ju?! Ata të dy thanë: Zoti ynë, ne i bëmë padrejtë (e dëmtuam) vetvetes sonë, e në qoftë se nuk na mbulon (mëkatin) dhe nuk na mëshiron, ne mesiguri jemi prej të shkatërruarve! (Allahu) tha: Zbritni, jeni armik i njëri-tjetrit. Në tokë ju e keni vendqëndrimin (vendbanimin) dhe përjetimin deri në një kohë. Tha: Në të (në tokë) do të jetoni (do të gjallëroni), në të do të vdisni (do të varroseni), dhe prej saj do të nxirreni (do të ringjallen).” (A’rafë, 11-25).

Pas këtij rrëfimi konteksti i fjalisë vazhdon duke i thirrur bijtë e Ademit që t’i ruhen djallit: “O bijtë e Ademit, të mos ju mashtrojë kurrsesi shejtani sikurse i nxori prindërit tuaj nga xhenneti.” (A’rafë, 27). Pastaj ata udhëzohen që të dëfrehen në kufijtë e lejuar; të mos e ndalojnë atë që Allahu e bëri të lejuar; dhe t’i dëgjojnë e respektojnë pejgamberët të cilët u vinin nga ana e Allahut: “Ne i kemi bërë dajhtë miq të atyre që nuk besojnë.” (A’rafë, 27).

Pastaj transferohet në Ditën e kijametit ku e ekspozon qëndrimin e besimtarëve të cilët ndoqën udhëzimin e Allahut dhe qëndrimin e jobesimtarëve të cilët ndoqën dredhitë e djallit. Më në fund kryhet ekspozimi me hyrjen e të parëve në xhennet dhe

hyrjen e të dytëve në xhennem. Ata i thërrasin burrat e A'rafit ashtu siç përmendëm në kapitullin “Ilustrimi atistik”: “Vazhdoni në xhennet, as nuk ka frikë për ju, as nuk keni për t’u brengosur.” (A’rafë, 49). Atyre do t’u kumtohet edhe nga paria e lartë (engjëjt më të zgjedhur): “Ky është xhenneti, u është dhënë juve për atë që vepruat.” (A’rafë, 43).

Sikur ky të ishte “kthim i mërgimtarëve dhe kthim i të humburve” nga vendbanimi i lumtur. Sikur ata e merituan kthimin dhe e trashëguan xhennetin për shkak se ata nuk e dëgjuan shejtanin, pasi që dëgjimi i tij është shkak për daljen e tyre nga xhenneti.

Këtu pra, në këtë “kthim” kemi harmonizimin e shfaqjes me atë “dalje” për të cilën u bë fjalë në kapitullin “Harmonizimi artistik”, që pa dyshim trajtohet prej niveleve të shkallës më të lartë.

Si ky harmonizim kemi gjurmë edhe në rrëfimet tjera. Ne këtu do të ndalemi me sjelljen e këtij shembulli, që sipas tij të udhëzohen lexuesit në të gjitha rrëfimet e Kur’anit.

Veçoritë artistike të rrëfimit

Pas gjithë kësaj, tani do t'i ekspozojmë veçoritë e përgjithshme artistike të cilat u realizua qëllimi fetar i rrëfimit nëpërmjet bukurisë artistike. Kjo, ngase kjo bukuria artistike cekjen e tij në shpirt e bën më të lehtë kurse në intuitë e futë më thellë. Studimi sipas kësaj metode, spikat katër fenomene artistike të cilat zënë vend të merituar në studimet artistike të rrëfimit të lirë në botën e arteve.

* * *

a) Prej veçorive të para artistike është llojllojshmëria e mënyrës së shfaqjes.

Ne në rrëfimet kur'anore vërejtëm katër metoda të ndryshme të fillimit të shfaqjes së rrëfimit. Ato janë si vijojnë:

1) Ndonjëherë para fillimit të rrëfimit, Kur'ani bën një hyrje të rezymuar e pastaj i cekë detajet prej fillimit e deri në mbarim të tij. Për shembull, mënyra e rrëfimit të “banorëve të shpellës”. Ai fillon kështu: “A mos mendove ti se ata të vendosurit e shpellës dhe Rekimit ishin nga mrekullitë Tona më të çuditshme? Kur djelmoshat u strehuan në shpellë e thanë: O Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë! Ne u vumë mbulojë mbi veshët e tyre (i vumë në gjumë) në shpellë për disa vjet me radhë. Pastaj ata i zgjuam (prej gjumit) për të parë se cili prej atyre dy grupeve është më preciz në llogaritjen e kohës se sa gjatë qëndruan.” (Kehf, 9-12).

Ky është një rezymim i rrëfimit. Pastaj vijojnë detajet e konsultimit të tyre para se të hyjnë në shpellë, gjendja e tyre pasi që

të hyjnë, fjetja e tyre; pastaj zgjimi i tyre, dërgimi i njërit prej tyre që t'u blejë ushqim, zbulimi i tij në qytet, pastaj kthimi i tij dhe vdekja e tyre, ndërtimi i faltores, mospajtimi i popullit për çështjen e tyre, etj. Pra, ky rezymim sikur të ishte ndonjë hyrje e domosdoshme për detajet e një rrëfimi.

2 - Ndonjëherë cek pasojat e rrëfimit dhe urtësinë e tij, e pastaj fillon rrëfimi prej ngjarjeve të para dhe vazhdon duke i detajizuar hap pas hapi. Shembull për këtë e kemi rrëfimin për Musain në suren Kasas. Ai fillon kështu: “Këto janë ajetet e Librit të plotkuptueshëm, që po t’i lexojmë ty nga lajmi rreth Musait e faraonit, e që është vërtet për një popull që beson. Me të vërtetë faraoni ka ngritur kokën lart në tokë, e popullin e saj (tokës) e ka grupëzuar dhe një grup prej tyre e shtyp ashtu që djemtë e tyre ua mbyt, e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai është prej më shkatërrimtarëve. E Ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues. Dhe atyre t’u japim pushtet në tokë, e faraonit, Hamanit dhe ushtrisë së këtyre dyve t’ua tregojmë atë që i ruheshin (ia kishin frikën).” (Kasas, 2-6).

Pastaj vazhdon duke e detajizuar rrëfimin për Musain: lindjen e tij; zhvillimin; gjimarrjen; rritjen; vrasjen që ia bëri egjiptasit dhe daljen e tij... ashtu siç i detajizua edhe më parë. Sikur kjo hyrje e ndriçon qëllimin e rrëfimit që ishte një parathënie e domosdoshme për ta njohur mënyrën se si realizohet qëllimi i planifikuar dhe i studiuar.

I ngjashëm, sa i përket kësaj mënyre, është edhe rrëfimi për Jusufin. Ai fillon me ëndrrën të cilën ia rrëfen Jusufi babait të tij kurse i ati e lajmëron se atij do t’i ngjajë diç madhështore. “(Përkujto) Kur Jusufi babait të vet i tha: O babai im, unë pashë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje dhe diellin e hënë, i pashë duke më

bërë mua sexhde! Ai (Jakubi) tha: O biri im, mos ua trego ëndrrën tënde vëllezërve t'u se po të bëjnë ndonjë dredhi, s'ka dyshim se djalli për njeriun është armik i haptë. Ja kështu Zoti yt të zgjodhi ty, të mëson interpretimin e ëndrrave, plotëson dhuntinë e Tij ndaj teje dhe familjes së Jakubit, sikurse e pat plotësuar atë më parë ndaj prindërve tu, Ibrahimit dhe Is'hakut. Vërtet, Zoti yt është më i dijshtëmi, më i urti!" (Jûsuf, 4-6).

Më pas vazhdon rrëfimi sikur ai të ishte interpretues i ëndrrës dhe atë që e pritte Jakubi të ndodhë pas saj. E kur u realizua (ëndrra) përfundoi edhe rrëfimi e nuk u vazhdua, ashtu siç e vazhdoi Tevrat, edhe pas këtij përfundimi të përpiktë artistik.

3 - Ndonjëherë e cek rrëfimin menjëherë pa ndonjë hyrje apo rezymim. Edhe pse rrëfimi fillon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe befas, ai mjafton. Shembull për këtë e kemi rrëfimin për Merjemen me rastin e lindjes së Isait. Befasitë e saj janë të njohura. Ato do t'i paraqesim detajisht në një rast tjetër. Gjithashtu edhe rrëfimi për Sulejmanin, pupëzën dhe Belkisen që do të paraqiten më vonë.

4 - Ndonjëherë e përfytyron rrëfimin sikur të ishte dramë. Aty do t'i përmend vetëm ato fjalë të cilat japin shenjë për fillimin e shfaqjes, e pastaj e lë rrëfimin të flasë për vete përmes protagonistëve të tij. Si shembull kemi skenën të cilën e shfaqëm nga rrëfimi për Ibrahimin dhe Ismailin në kapitullin "Ilustrimi artistik": "Edhe kur Ibrahimit dhe Ismaili duke i ngritur themelet e shtëpisë". Ky është sinjali për fillimin e ngjarjes kurse pjesa tjetër i është lënë Ibrahimit dhe Ismailit: "Zoti ynë pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di." (Bekare, 127). Kështu vazhdon deri në fund të skenës së gjatë që për një rast të tillë ka shumë shembuj të ngjashëm në Kur'an.

* * *

b) Veçoria e dytë artistike është llojllojshmëria e mënyrës së befasisë.

1 - Ndonjëherë e fsheh sekretin e befasisë edhe për protagonistin por edhe për publikun, në mënyrë që t'ua zbulojë atë që të dy palëve për një moment. Shembull e kemi rrëfimin për Musain me personin e devotshëm dhe dijetar në suren Kehf. Ky rrëfim zhvillohet kështu:

“(Përkujto) Kur Musai djaloshit që e shoqëronte i tha: Nuk do të ndalem së ecuri derisa ta arrijë vendtakimin e dy deteve, ose do të udhëtoj një kohë të gjatë. Kur e arritën ata të dy vendtakimin e atyre deteve, e harruan peshkun e tyre, e ai (peshku) mori rrugën e vet si fole (strofull) në det. Pasi ata e kaluan atë vend, ai (Musai) i tha djaloshit: Na jep drekën tonë (ushqimin), meqë nga ky udhëtim jemi lodhur. Ai (djaloshi) tha: A sheh!? Kur u strehuam te shkëmbi, unë e harrova peshkun, dhe përveç djallit nuk më bëri kush ta harroj që të ta përkujtoj ty atë, dhe ai në mënyrë të çuditshme mori rrugën e tij për në det! Ai (Musai) tha: Ai është (vendi) që ne po e kërkojmë! Dhe u kthyen që të dy rrugës së tyre prej nga kishin ardhur. Dhe e gjetën një nga robërit Tanë, të cilit i kemi dhuruar mëshirë nga ana Jonë dhe e kemi mësuar me një dituri të posaçme nga Ne. Atij (Hidrit-njeriut të mirë e të dijsëm) Musai i tha: A pranon të vijë me ty që të më mësosh nga ajo që je i mësuar (i dhuruar) ti: dituri të drejtë e të vërtetë? Ai (Hidri) tha: Sigurisht, ti nuk do të mund të keshë durim me mua! Si do të durosh për atë që nuk je i njoftuar? (Musai) Tha: Në dashtë Allahu, do të shohësh se do të jem i durueshëm dhe nuk do të kundërshtoj ty për asgjë! Ai tha: Nëse më shoqëron ti mua, atëherë mos më pyet për asgjë, derisa unë vet të të tregoj për atë”.

“E ata të dy shkuan (duke ecur) deri kur hipën në anije. Ai (i dijshtë) e shqeu atë. Ai (Musai) tha: A e shqeve që t'i fundosësh

udhëtarët e saj, vërtet bëre një punë të hatashme? Tha: A nuk të thashë se nuk do të mund të kesh durim me mua? (Musai) tha: Mos më qorto sepse harrova dhe mos më mundo me vështirësi në këtë shoqërim timin (lehtësoma punën)!”.

“Vazhduan të shkojnë deri kur takuan një djalë të ri, e ai (i dijsmë) e mbyti atë. (Musai) Tha: A e mbyte njeriun e pastër, pa e mbyt ai askë?! Vërtet ke bëre një punë të shëmtuar! Ai (i dijsmë) tha: A nuk të thashë se vërtet ti nuk do të mund të kesh durim me mua? (Musai) Tha: Nëse pas kësaj të pyes (të kundërshtoj) për ndonjë gjë, atëherë mos më lejo të të shoqëroj. Tashmë ndaj meje ke arsyetim (të mos më shoqërosh)!”.

“Vazhduan të udhëtojnë derisa arritën te banorët e një qyteti prej të cilëve kërkuan t’u japin ushqim, po ata nuk deshën t’i pranojnë si mysafirë (e as t’i ushqejnë), e ata të dy gjetën aty një mur që gati po rrëzohej, e ai e drejtoi atë (murin). (Musai) Tha: Sikur të kishe dashur do t’u merrje shpërblim për këtë! Ai (i dijsmë) tha: Tash është koha e ndarjes sonë, e unë do të tregoj për domethënien e asaj për të cilën nuk munde të kesh durim!” (Kehf, 60-78).

Deri në këtë vend ne jemi para befasive të njëpasnjëshme të cilave nuk ua dimë sekretin. Gjendja ynë ndaj këtyre befasive është identike me gjendjen e protagonistit të rrëfimit, Musait. Madje ne nuk e dimë se kush është ai që sillet me këto sjellje të çuditshme po as Kur’ani nuk na informon për emrin e tij, si plotësim i kësaj atmosfere enigmatike e cila na përshkon. E çfarë vlere ka emri i tij? Ai ka për qëllim që ta përfaqësojë urtësinë e sekretit më të lartë (atij hyjnor) te i cili nuk vlejnë rezultatet (konkluzat) e atypëratyshme në bazë të premisave (dukurive paraprake) sensible. Ajo (urtësia hyjnore) synon në qëllime shumë të larta që nuk mund t’i perceptojë syri i rëndomtë dhe i kufizuar. Moscejka e emrit të tij

përputhet me këtë personalitet figurativ të cilin e përfaqëson. Në këtë rast fuqitë e panjohura dominojnë mbi rrëfimin që nga fillimi i tij. Ja Musai dëshiron ta takojë këtë njeri të premtuar. Ai merr rrugën e tij por djaloshi e harron ushqimin të shkëmbi. Kjo i përngjanë sikur e harroi me qëllim që të kthehet e ta gjejnë këtë person aty. Takimi i tyre do të distancohej sikur ta vazhdonin drejtimin e tyre dhe të mos i kishte kthyer caktimi i Zotit të shkëmbi edhe një herë. E gjithë atmosfera është e mbyllur dhe e panjohur, gjithashtu edhe emri i njeriut është misterioz dhe i panjohur.

Pastaj sekreti fillon të shpaloset duke ia bërë me dije publikut në të njëjtin çast kur ia bën me dije edhe Musait:

“Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e disa të varfërve që punojnë në det, e unë desha ta bëj atë me të meta, ngase para tyre ishte një sundues që grabiste çdo anije (të aftë - pa të meta). Sa i përket djaloshit, dy prindërit e tij ishin besimtarë, e u frikësua se ai do t'i shpie ata të dy në humbje e në mosbesim. Dëshëm që Zoti i tyre t'u japë në vend të tij një më të mirë se ai dhe më të afërt në respekt e në mëshirë (ndaj prindërve). Sa i përket murit, ai ishte i dy djelmoshave jetima të atij qyteti, e nën të ata kishin një thesar ari dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata dy (jetimat) ta arrijnë pjekurinë e vet dhe ta nxjerrin ata vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshirë e Zotit tënd (ndaj tyre). Dhe unë nuk e bëra tërë atë sipas bindjes sime (por sipas udhëzimit të Zotit). Ky pra është sqarim i asaj për të cilën nuk munde të kesh durim.” (Kehf, 79-82).

Në këtë hutesë të sekretit të zbuluar humbet gjurma e njeriut dijetar. Mendjeve të hutuara pasi të rivetëdijësohen u shkon ndërmend të pyesin: Kush ishte ky? - Kurse ato nuk marrin përgjigje. Ai shkoi në drejtim të panjohur, ashtu siç erdhi nga

drejtimi i panjohur. Ky rrëfim shëmbëllon urtësinë e madhe, kurse kjo urtësi nuk e zbulon veten pos me masë, ashtu që pastaj mbetet enigmatike përgjithmonë.

Edhe kjo gjithashtu është hapësirë prej hapësirave të harmonizimit. Ajo zuri vend në kapitullin “Harmonizimi artistik” e tani lexuesi le ta transferojë në këto hapësira.

2 - Ndonjëherë sekretin ua zbulon spektatorëve kurse protagonistët e rrëfimit i lë të verbër. Ata sillen lirisht e në anën tjetër nuk dinë asgjë për sekretin. Kurse ata (spektatorët) i shohin sjelljet e tyre haptazi. Mesiguri kjo është kështu si prezentim i talljes në të cilin do të marrin pjesë spektatorët që nga momenti i parë dhe të cilëve do t’u jepet mundësia të tallen me gjestet e aktorëve!

Një gjë të tillë ne e pamë me rastin e rrëfimit për pronarët e kopshtit: “Kur u betuan se do ta vjelin atë herët në agim. E nuk thanë (kur u betuan) Në dashtë Allahu! E sa qenë ata fjetur, atë (kopshtin) e goditi një bela nga Zoti yt. Dhe ai gdhiu si të ishte i vjelur.” (Kalem, 17-20).

Në ndërkohë kur ne e dimë se çka ndodh, pronarët e kopshtit nuk e dinë: “Ata në mëngjes thërritnin njëri-tjetrin. Ngrahuni herët te prodhimet tuaja nëse doni t’i vilni! Dhe ata vajtën duke pëshpëritur në mes vete (të mos i dëgjojnë kush). Të mos lejojnë të afrohet sot në të asnjë i varfër. Dhe vazhduan herët me atë qëllim të përcaktuar të tyre.” (Kalem, 21-25).

Ne shikuesit tallemi me ta derisa ata thirrnin njëri-tjetrin dhe pëshpëritnin. Në anën tjetër, kopshti është shëmtuar si të ishte i vjelur, derisa më në fund u zbulua sekreti pasi që ne u ngopëm me shpotitje dhe tallje: “E kur e panë atë, thanë: “S’ka dyshim, ne jemi

në humbje. Bile ne kemi mbetur edhe pa të!” (Kalem, 26). Ky është ndëshkimi që u takon atyre që u ndalojnë (nga të mirat e Allahut) të ngratëve!

Edhe ky është një lloj i harmonizimit i cili u bashkangjitet të tjerëve.

3 - Ndonjëherë spektatorëve ua zbulon një pjesë të sekretit i cili është i pazbuluar për protagonistin dhe një pjesë tjetër e cila është misterioze edhe për shikuesit edhe për protagonistin, dhe atë brenda një rrëfimi. Shembull për këtë e kemi rrëfimin për fronin e Belkises i cili iu soll (Sulejmanit) sa një dremetje syri. Ne u kuptuam se ai erdhi në duart e Sulejmanit ndërkohë kur Belkisa nuk e dinte këtë. E kur erdhi ajo, iu tha: “A është i këtillë froni yt? E ajo tha: Si të ishte vetë ai?!” (Neml, 42). Kjo është një befasi për Belkisen të cilën ne e kemi ditur më herët. Mirëpo befasia e pa-llatit të lëmuar nga qelqi mbeti e fshehur për ne dhe për të derisa kur u befasuam së bashku me Belkisen atëherë kur “Asaj iu tha: Hyn në pallat, e kur e pa atë mendoi se është një ujë i madh dhe i përvoli këmbët. Ai tha: Ky është një pallat i lëmuar prej qelqi!”. (Neml, 44) Këtë tregim ne do ta shtjellojmë më vonë detajisht.

4 - Ndonjëherë në rrëfim nuk ka ndonjë fshehtësi. Por me befasinë ndeshen protagonistin dhe publiku dhe në të njëjtën kohë gjithashtu e kuptojmë fshehtësinë e saj po në atë moment. Shembull i kemi befasitë e rrëfimit për Merjemen atëherë kur vetmohet dhe ndahet nga familja e saj. Aty befasohet me takimin e shpirtit besnik, Xhibrilit në formë të njeriut. Andaj edhe i thotë: “Unë i mbështetem Të Gjithëmëshirshmit për mbrojtje nga ti, nëse je që i frikësohesh Atij (më le të lirë)!”. (Merjem, 18). Vërtet, ne kuptuam para saj për një çast se ai është “shpirti”, por situata nuk zgjati shumë, dhe ai e lajmëroi: “Ai (Xhibrili) tha: Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër!”

(Merjem, 19). Ne u befasuam bashkë me te edhe kur dhembja e lindjes e mbështeti atë te një trup i hurmës: “Ajo tha: Ah sa mirë ka qenë për mua të kisha vdekur para kësaj e të isha e harruar që motil. E prej së poshtmi atë e thirri (Xhibrili): Mos u brengos, Zoti yt bëri pranë teje një përrockë (uji)...” (Merjem, 23).

c) Veçoria e tretë në shfaqjen e rrëfimit është: Ekzistimi i disa zbrazëtirave (pushimeve) mes një skene dhe skenës tjetër, të cilat i krijojnë ndarjet e skenave dhe përpjesëtimet e akteve me qëllim që të bëjnë mes çdo dy skenave apo dy serive një zbrazëtirë të cilën e plotëson imagjinata e shikuesit duke u dëfryer me ngritjen e urës mes skenës së kaluar dhe skenës së ardhshme.

Kjo metodë përafërsisht ushtrohet në të gjitha rrëfimet kur'anore. Ajo mund të vërehet edhe në ato rrëfime që i kemi paraqitur më parë. Ndërsa sa i përket këtij rasti, ne do të sjellim shembull nga rrëfimi i Jusufit: ky rrëfim është ndarë në njëzet e tetë skena. Le t'i shfaqim disa prej tyre:

Vëllezërit e Jusufit ia mësyen “depove të tokës” në vitet e thatësirës për të kërkuar grurë. Jusufi kërkoi prej tyre ta sjellin vëllain tjetër (i vëllai i Jusufit prej babës dhe nënës), e ata e sollën përkundër mosdashjes së babait të tyre. Mandej Jusufi e vuri tasin e mbretit në barrën e tij dhe e mori peng në emër të asaj se ai është vjedhës ashtu që Jusufin ta ndalë te ai...

Mandej, ja ata, vëllezërit e tij ndahen mënjandë që të kontrollohen për rastin e tyre. Jusufi refuzoi ta marrë ndonjërin prej tyre në vend të tij: “E kur e humbën shpresën prej tij, u veçuan për t’u kontrolluar. Më i madhi prej tyre tha” A nuk e dini që babai juaj ka marrë prej jush besën në Allahun, e më parë çfarë padrejtësishë kemi bërë ndaj Jusufit?. Unë pra nuk ndahem kurrë prej kësaj toke (Egjiptit) deri që të më lejojë babai im, ose të

vendosë Allahu (mirë) për mua, e Ai është gjykatës më i drejtë. Ju kthehuni te babai juaj dhe thuani: O babai ynë, djali yt vodhi, ne dëshmojmë vetëm për atë që dijmë, e për të fshehtën ne nuk ishim roje! Ti dërgo e pyeti (banorët në) qytetin ku ishim ne, po ashtu edhe ata me karvanin me të cilin kemi ardhur. Ne jemi të drejtë (për atë që e themi).” (Jûsuf, 80-82).

Në këtë moment lëshohet perdja që të takohemi me ta, jo në Egjipt e as në rrugë gjatë udhëtimit por para babait të tyre. Ata ia përcjellin porositë e vëllait të tyre, por pa i dëgjuar ne. Perdja hapet përsëri, kur ja ne, e gjejmë babain e tyre duke u thënë: “Ai (Jakubi) tha: Jo, çështjen e ka kurdisur epshi juaj, (mua nuk më ka mbetur tjetër) durimi i mirë, është shpresë që Allahu do t’mi sjell të gjithë: Ai është më i dijsi, më i urti.” (Jûsuf, 83). Perdja lëshohet përsëri.

Tani do të shohim një skenë tjetër mes Jakubit dhe bijve të tij. Atë do ta shohim se si i janë zbardhur sytë nga dëshpërimi. Malli për Jusufin është i pranishëm përherë. Bijtë e tij ia shohin për të madhe për gjithë këtë brengë. Atëherë ai: “Ua ktheu shpinën e tha: O mjerë unë për Jusufin, nga pikëllimi iu zbardhën të dy sytë, por i përmbajtur (nga pikëllimi). Ata thanë: Për All-llahun, ti vazhdimisht e përkujton Jusufin derisa do të sëmuresh rëndë, ose do të shkatërrohesh. Ai (Jakubi) tha: Unë hidhërimin dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut, e unë e di për Allahun atë që ju nuk e dini. O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni (në Egjipt) për Jusufin dhe vëllain e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut, sepse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në Allahun.” (Jûsuf, 83-87). Këtu përsëri mbyllet perdja. Ata marrin rrugën e ne nuk dimë asgjë, por kur ngrihet perdja i gjejmë para Jusufit në Egjipt: “E kur hyjnë te ai (Jusufi), thanë: O ti zotëri, neve dhe familjen tonë na ka goditur një skamje e vështirë, e kemi ardhur me një mall të vjetër, e ti pra na mbush masën (barrën) dhe

na dhuro, Allahu i shpërblen ata që dhurojnë.” (Jûsuf, 88). E kështu pra vazhdon me radhë.

Edhe rrëfimet për banorët e shpellës, Merjemen dhe Sulejmanin zhvillohen sipas të njëjtit kontekst. Ato do t’i ekspozojmë detajisht në temën e ardhshme.

Ilustrimi në rrëfim

Këtë titull e kemi veçuar si përfundim për veçorinë e katërt. Kjo veçori është prej veçorive më të dalluara artistike të rrëfimit dhe më të lidhurave ngusht me titullin e këtij libri “Ilustrimi artistik në Kur’an”. Ne kemi thënë më herët se: Shprehja kur’anore e interpreton rrëfimin me brushën e ilustrimit mahnitës me të cilin i përfshinë të gjitha skenat dhe të gjitha aktet të cilat i pasqyron. Andaj rrëfimi shndërrohet në ndodhi që ka ngjarë dhe skenë ku ka lëvizje, e jo rrëfim që tregohet e as ndodhi që ka kaluar.

Tash themi: Ky ilustrim në skenat e rrëfimit është ngjyra-ngjyra: Një ngjyrë paraqitet në fuqinë e shfaqjes dhe gjallërimin e saj, një tjetër paraqitet në sensibilizimin e emocioneve dhe reagimeve; një tjetër paraqitet në përshkrimin e protagonistëve. Kjo nuk don të thotë se këto ngjyra janë të ndara por ndonjëra prej tyre dallohet në disa raste dhe dominon mbi të tjerat, andaj edhe cilësohet me emrin e saj. Në të vërtetë, të gjitha këto gjurmë artistike paraqiten në të gjitha skenat e tregimeve. Këtë mund ta sqarojë shembulli e kurrsesi mendimi i shkruar:

Që më parë e ekspozuam rrëfimin për pronarët e kopshtit, skenën e Ibrahimit dhe Ismailit para Qabes, skenën e Nuhit dhe të birit të tij gjatë vërshimit...

Të gjithë këto janë shembuj për fuqinë e shfaqjes dhe gjallërimit, saqë lexuesit do t’i shkonte mendja se skena është e pranishme, ndihet dhe shihet, siç edhe sqaruam më parë. Ndërsa këtu do të shtojmë një shembull të ri.

Ja, ne jemi ata që jemi dëshmitarë të “banorëve të shpellës” kur ata konsultoheshin për hallin e tyre pasi u udhëzuan në rrugë të Allahut në mes të popullit mushrik (idhujtar):

“Ne po ta rrëfejmë saktë çështjen e tyre. Ata ishin disa djelmossa, kishin besuar Zotin e tyre, e Ne edhe më tepër ua shtuam bindjen. Edhe i forcuam zemrat e tyre (i bëmë të qëndrueshëm) saqë kur u ngritën thanë: Zoti ynë është Zot i qiejve dhe i tokës, nuk adhurojmë ndonjë zot tjetër pos Tij, sepse atëherë do të thoshim diç shumë mizore! Ky, populli ynë, ka besuar zota të tjerë pos Atij, pse pra nuk sjellin ndonjë argument të qartë për ata! A ka më mizor se ai që shpif gënjeshtër ndaj Allahut? Derisa jeni izoluar prej tyre dhe prej asaj që adhurojnë ata, pos Allahut, atëherë strehohuni në shpellë, e Zoti juaj ju dhuron nga mëshira e Tij dhe ua lehtëson në çështjen tuaj atë që është në dobinë tuaj.” (Kehf, 16).

Këtu mbaron skena dhe bie perdja. E kur të ngrihet perdja, përsëri do t’i gjejmë se ata veç e kanë zbatuar atë që u pajtuan mes vete. Ja tani ata i shohim në shpellë. Ja ata i shohim me sytë e vërtetë. Shprehja nuk mund t’i lë vend dyshimit se ne nuk i shohim të bindur:

“Dhe ti e shihje diellin kur lindte, bartej prej shpellës së tyre nga ana e djathtë, e kur perëndonte largohej nga ata nga ana e majtë, e ata ishin në një vend të gjerë të saj.” (Kehf, 17). E si mos të themi se e gjithë kjo është gjallërim i skenës! Pa dyshim teatri bashkëkohor me të gjitha mjetet e ndriçimit është i paafët ta inskenojë këtë lëvizje të valëzuar. Lëvizjen e diellit kur “ai bartej” nga shpella me rastin e lindjes së tij dhe nuk e ndriçonte (vetë fjala e ilustron kuptimin e saj), dhe largohej nga ata kur perëndonte dhe nuk u binte atyre. Ndoshta kinematografia me një angazhim të

madh do të mund ta incizojë këtë lëvizje të çuditshme të cilën fjalët e kanë incizuar me një lehtësi të papërshkrueshme...

Më pas të shohim kur “ata ishin në një vend të gjerë të saj”. Këtu fjalët edhe njëherë krijojnë mrekulli. Ato nxjerrin në pah formën e shtrirjes dhe lëvizjes së tyre sikur ata shtangen dhe lëvizin pandërprerë “do të mendojë se ata janë të zgjuar, ndërsa ata ishin fjetur, e Ne i rrotullonim herë në krahun e djathtë e herë në të majtën. Qeni i tyre i kishte shtrirë këmbët e para pranë hyrjes. Sikur të kishe hasur në ta, do të ishte kthyer duke ikur dhe do të ishte mbushur frikë prej tyre.” (Kehf, 18). Në këtë mënyrë shkrepen fjalët me ilustrim dhe lëvizje në gjithë këtë lehtësi.

Befasisht fillon të gjallërojë jeta. Të shikojmë e të dëgjojmë:

“Ashtu (sikur i vumë në gjumë) i zgjuam ata që të pyesin njëri-tjetrin (se sa kanë fjetur). Njëri prej tyre foli e tha: Sa keni ndenjur? Ata thanë: Kemi ndenjur një ditë ose një pjesë të ditës! Disa thanë: Zoti juaj e di më së miri se sa keni ndenjur, prandaj dërgoni njërin prej jush me këtë argjend (monedhë argjendi) në qytet, e të zgjedh ushqim më të mirë, e t’ua sjell atë juve dhe le të ketë shumë kujdes e të mos i japë të kuptojë askujt për ju. Nëse ata (të qytetit) kuptojnë për ju, do t’ju mbysin me gurë, ose do t’ju kthejnë në fenë e tyre, atëherë kurrë nuk keni për të shpëtuar.” (Kehf, 19-20).

Kjo është skena e tretë - ose mbarimi i skenës së dytë - ata veç më janë zgjuar. Pyetja e parë që iu parashtrua atyre ishte: Sa keni ndenjur? - Përgjigjja jepet: Kemi ndenjur një ditë apo një pjesë të ditës, kurse ne e dimë shumë mirë se ata kanë ndenjur shumë, shumë më gjatë. Neve na u bë i njohur rrëfimi shkurtimisht para se të detajizohet. Megjithatë, ata janë të urtë dhe shpejtojnë për t’u vërtetuar. Madje ata janë besimtarë. Andaj le të jetë manifestimi i besimit të tyre të thonë:

“Zoti juaj e di më së miri se sa keni ndenjur”. Mirëpo ata kanë drojë se vallë kush po e përhap çështjen e tyre. Ata të dërguarin e tyre e porosisin që të sillet me kujdes e mos t’i japë askujt të kuptojë për ta. Ata nuk dëshirojnë që populli ta dijë vendstrehimin e tyre ngase mund t’i gurëzojnë (mbysin) ose t’i kthejnë në fenë e tyre. Derisa ne e dimë se ata nuk ka kush që t’i gurëzojë ose t’i largojë nga feja e tyre, por le ta përcjellim këtë të dërguar në skenën e tretë:

E ku është kjo skenë? Këtu kemi zbrazëtirë të lënë për imagjinim. Ne nuk shohim pos asaj se çështja e tyre është zbuluar dhe njerëzit i kanë hasur ata, edhe pse njerëzit kësaj radhe ishin besimtarë e jo pabesimtarë.

“Dhe ashtu (sikurse i zgjuam nga gjumi) i zbuluam (t’i shohin njerëzit), e të kuptojnë se premtimi i Allahut (për ringjallje) është i sigurt.” (Kehf, 21).

Ja këtu zbulohet qëllimi fetar i rrëfimit, mirëpo edhe aspekti artistik veç është plotësuar. Tash imagjinata le të parafytyrojë se ç’ndodhi kur shkoi i dërguari i tyre dhe kur u zbulua çështja e tij?

Këtu kemi përsëri një zbrazëtirë tjetër. Aty si duket kanë vdekur por jo, ata vërtet kanë vdekur, ndërsa populli jasht shpellës zihej me fjalë e konsultohet për hallin e tij se cilës fe i ka takuar?

“Mu atëherë kur ata (populli) ziheshin me fjalë për çështjen e tyre, ata thanë: Ndërtoni atyre një ndërtesë (të jetë e shenjë). Zoti i tyre di më së miri për ta. E ata që ishin me shumicë thanë: Do të ndërtojmë gjithqysh në hyrjen e tyre një xhami.” (Kehf, 21).

Këtu kemi zbrazëtirën e tretë. Imagjinata le ta përfytyrojë se çfarë xhamie ndërtoan për ta. Kurse njerëzit, pasi përfundoi çështja

e tyre, ja ata - si është traditë te njerëzit, - i përcjellin lajmet e tyre. Ata polemizonin për numrin e tyre dhe vitet të cilat i kaluan aty:

“Ata (që besonin për këtë) do të thonë: Ishin tre, i katërti ishte qeni i tyre, e disa thonë: ishin pesë, e qeni ishte i gjashti i tyre. Duke bërë supozime për atë që se kanë parë, po edhe thanë: Ishin shtatë e qeni i tyre ishte i teti!” (Kehf, 22).

Ja, kështu popullin e përfshiu misteri pasi që u plotësua urtësia fetare nga ringjallja e tyre. Andaj ata udhëzohen që këtë sekret le t’ia mbështesin Atij që është misterioz (i papashëm): “Thuaj” Zoti im di më së miri për numrin e tyre, përveç një pakice nuk di kush për ta, e ti (Muhammed) mos polemizo për numrin e tyre vetëm në mënyrë globale, dhe askë mos e pyet për të.” (Kehf, 22).

Pas kësaj piqen kushtet për t’i bërë udhëzimet fetare të njohura. Ne tash jemi pas përfundimit të rrëfimit për ringjalljen, fuqinë hyjnore dhe të ruajturit e sekretit. Andaj këtu thotë: “Dhe mos thuaj kurrsesi për ndonjë çështje: Unë këtë do ta bëjë nesër! Vetëm (nëse ia shton): Në dashtë Allahu! E kur të harrosh përmende Zotin tënd dhe thuaj: Shpresohet se Zoti im do të më japë udhëzim edhe më të afërt prej këtij (që ua dha banorëve të shpellës).” (Kehf, 23-24). Për këtë udhëzim përmendet një rast i veçantë me Muhammedin alejhisselam, por neve nuk na intereson ta detajizojmë këtë shkak. Kjo për ne është një dukuri e përgjithshme që ka nevojë për udhëzim fetar gjatë rrëfimeve pas tyre dhe në çastet e përshtatshme emocionale. Këtu pa dyshim e kemi rastin më të përshtatshëm. Në fund kemi një lajm të sigurt për kohën e qëndrimit të tyre në shpellë. Kjo edhe është e nevojshme për rrëfimin ndërsa sa i përket numrit të tyre, ai do të mbetet i panjohur: “Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind e nëntë vjet.” (Kehf, 25). Ky ajet jep edhe një rast të volitshëm për udhëzimin fetar: “Thuaj: Allahu e di më së miri sa kanë ndenjur,

Atij i takon fshehtësia e qiejve dhe e tokës. Sa (i çuditshëm) është të pamurit e Tij dhe të dëgjuarit! Pos Tij, ata njerëzit, nuk kanë ndihmëtarë. Në vendimin e Tij nuk mund t'i përzihet askush. Lexo çka të është shpallur ty nga Libri i Zotit tënd! Nuk ka kush që mund t'i ndryshojë fjalët e Tij, dhe pos Tij nuk mund të gjesh strehim.” (Kehf, 26-27).

Ne arritëm që t'i vëmë në spikamë të gjitha veçoritë e rrëfimit të cilat u ekspozuan këtu. Megjithatë, pa dyshim “fuqia e shfaqjes dhe gjallërimi i saj” është elementi më i dallueshëm në të gjitha skenat e rrëfimit, dhe se kjo ngjyrë është ajo që i përshtatet më tepër dhe dominon mbi ngjyrat tjera.

Tash shkojmë në ngjyrën e dytë prej ngjyrave të ilustrimit në rrëfim: ilustrimi i emocioneve dhe reagimeve dhe dallueshmëria e tyre.

Ne më parë e kemi ekspozuar rrëfimin për pronarin e dy kopshteve dhe shokut të cilin e polemizonte dhe rrëfimin e Musait me atë njeriun “një nga robërit Tanë, të cilit i kemi dhuruar mëshirë nga ana Jonë”. Që të dy rrëfimet i përshkruajnë emocione të ndryshme dhe i dallojnë përskaaj përshkrimit të protagonistëve dhe gjallërimit të skenave. Por ne këtu do t'ua bashkangjesim një rrëfim tjetër duke e ekspozuar detajisht. Fjala është për rrëfimin për Merjemen me rastin e lindjes së Isait.

“E përmendju në këtë libër (tregimin për) Merjemen kur ajo u largua prej familjes së saj në një vend në lindje. Ajo, vuri një perde ndaj tyre...” (Merjem, 16-17).

Dhe ajo e vetme dhe e mënjanuar, e qetë me vetminë e saj. Në ndërgjegjen e saj dominon ajo që dominon mbi një vashë kur e kapin ethet! Ja tani ajo befasohet vullshëm dhe fillon t'i përçojë

kujtimet e saj për të ardhmen e largët. Për shkak të gjendjes në të cilën ishte, ja se ç'i ndodhë: "...Ne ia dërguam asaj Xhibrilin, e ai iu paraqit asaj njeri në tërësi. Ajo tha: Unë i mbështetem Të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse je që i frikësohesh Atij (e të më lëshë të lirë)!" (Merjem, 17-18) Kjo është klithje e virgjërshës së gjorë të cilën e befason një njeri në vetminë e saj. Ajo mundohet t'ia tregojë takvallëkun (frikërespektin) në shpirtin e tij: "Nëse je që i frikësohesh Atij". Ne edhe pse e dinim se ai është "shpirti besnik" ajo nuk e dinte, pos se ai është njeri. Në këtë çast imagjinata e përfytyron atë vajzë të pastër e të pafajshme me virtyte të familjes së ndershme. Ajo u edukua me edukatë fetare "nën kujdesin e Zekeriasë", pasi që nëna e saj ia kushtoi thjesht shërbimit të Zotit derisa ajo ishte në barkun e saj...

Kjo është drithma e parë:

"Ai (Xhibrili) tha: Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër (pejgamber)." (Merjem, 19). Tani le ta përfytyrojmë imagjinata vëllimin e trembjes së trupit nga ky njeri i panjohur (për të cilin ende nuk është e sigurt e ai vërtet është i dërguar nga ana e Zotit të saj, ndoshta ato janë mashtrime të ndonjë dëmprurësi i cili dëshiron ta shfrytëzojë pastërtinë e saj). Ai ia kumton ato fjalë të cilat lëndojnë nderin e vajzës së turpshme kur i thotë se dëshiron t'i dhurojë një djalë kur ata dy janë të vetmit të vetmuar.

E kjo është drithma e dytë.

Pastaj vjen guximi femëror duke e mbrojtur nderin e saj "Ajo tha: si do të kem unë djalë, kur mua nuk më ka prekur njeri (nuk jam e martuar), e as nuk kam qenë e pamoralshme?" (Merjem, 20). Ajo i drejtohet kështu haptazi, me fjalë çelë sepse ajo dhe njeriu janë në vetmi. Qëllimi i befasisë së tij ndaj saj tani u shpalos. Ajo

ende nuk e di sesi do t'i dhurojë fëmijë. Shqetësimin e situatës nuk mundën ta lehtësojnë as fjalët që ia tha asaj: “Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd”. Ky mund të jetë mashtrim i ndonjë dëmprurësi siç thamë. Këtu turpi dhe trembja kurrsesi të hiqen andaj fjala e hapur këtu është e përshtatshme:

“Ai (Xhibrili) tha: Ja, kështu ka thënë Zoti yt; ajo për Mua është lehtë, e për ta bërë atë (djalën e krijuar pa baba) argument për njerëzit dhe mëshirë nga ana e Jonë. Kjo është çështje e kryer.” (Merjem, 21).

E më pas çka?

Këtu do të gjejmë zbrazëtirë në mes të rrëfimit, një zbrazëtirë të madhe artistike që ia lë imagjinatës ta përfytyrojë. Mandej rrëfimi vazhdon në rrugën e tij që ta shohim këtë virgjëreshë të gjorë në një skenë edhe më të lemeritshme:

“Ajo e barti atë (Isain), andaj (me të në bark) u izolua në një vend të largët... Dhembja (e lindjes) e mbështeti atë te një trung i hurmës. Ajo tha: Ah e mjera unë, më mirë të kisha vdekur para kësaj e të isha e harruar që moti!” (Merjem, 22-23).

Ja pra, kjo është drithma e tretë.

Edhe pse në rastin e parë ajo i doli ballë vetes së saj në vetmi me nder, edukatë dhe moral, ajo tash është në prag të daljes përballë popullit me skandalin më të madh. Më pas ajo u përballon dhembjeve trupore përkaj dhembjeve shpirtërore. Ajo tani ballafaqohet me dhimbjen prerëse të trupit e cila i erdhi (për lindje) dhe e mbështeti për trungun e hurmës. Ashtu e vetmuar dhe e veçuar ankohet me pazakonshmërinë e virgjëreshës kur t'i vjen dhimbja (e lindjes). Ajo për asgjë nuk di, atë s'ka askush që ta

ndihmojë. Atëherë ajo klith dhembshëm: “Ah e mjera unë, më mirë të kisha vdekur para kësaj e të isha e harruar që moti”. Ne pothuajse i shohim dhembjet në fytyrën e saj, e ndjejmë shqetësimin e ndërgjegjes së saj dhe i përjetojmë vendet e dhembjes te ajo.

“E prej së poshtmi atë e thirri (fëmija): Mos u brengos, Zoti yt bëri pranë teje një përrockë (uji). E ti shkunde trupin e hurmës se do të bijnë ty hurma të freskëta. Ti pra ha, pi e qetësohu dhe nëse e sheh ndonjë prej njerëzve thuaj: Unë kam vendosur heshtje për hir Të Gjithëmëshirshmit, andaj asnjë njeriu sot nuk i flas!” (Merjem, 24-26).

Kjo është drithma e katërt dhe befasia më e papritur. Pothuajse neve - e jo Merjemen - na lëshuan këmbët nga shqetësimi i drithmave dhe çudive: fëmija i cili sapo lindet e thërret prej së poshtmi?! Ia zbut vështirësitë asaj dhe ia tregon ushqimin. A nuk është kjo habia më e madhe!

Jemi të sigurt se ajo mbeti e shtangur nga habia një kohë të gjatë, por edhe e hutuar para se ta zgjasë dorën e saj në trungun e hurmës për ta shkundur e për t'i ra asaj hurmat e freskëta. Kjo iu parashtrua që së paku ajo të vërtetohet dhe zemra t'i shërohet për ballafaqimet që do t'i ketë me familjen e saj. Këtu kemi edhe një zbrazëti e cila i lihet imagjinatës që ajo ta ngrisë një urë e të kalojë në anën tjetër...

“Dhe duke e bartur n'gryk, shko i me të te të afërmit e vet!”.

Tani le të qetësohet Merjemeja, le t'i transferojë drithmat e saj shpirtërore te dikush tjetër. “Ata i thanë: Oj Merjeme, ke bërë një punë shumë të keqe! Oj motra e Harunit, babai yt nuk ishte njeri i

prishur e as nëna jote nuk ka qenë e pamoralshme!” (Merjem, 27-28).

Drithmën e lëshojnë gjuhët e popullit përmes talljes dhe ironisë që ia bëjnë “motrës së Harunit”! Përkujtimi që i bëhet asaj në këtë vëllezëri tregon distancën kohore (mes saj dhe Harunit), se kësi rasti në këtë shtëpi nuk ka ndodhur kurrë më parë: “Babai yt nuk ishte njeri i prishur, e as nëna jote nuk ka qenë e pamoralshme!”.

“Atëherë ajo u dha shenjë nga ai (Isai)”. (Merjem, 29). Siç duket, ajo ishte e sigurt se mrekullia edhe kësaj radhe do të përsëritet. Ndërsa ata, çka do të themi për ta pos çudisë e cila do t’i kaplojë dhe nënçmimit i cili do t’i shqetësojë shpirtrat e tyre derisa shohin virgjëreshën se si u kundërvihet me fëmijë. Pastaj ajo e merr veten dhe u sinjalizon atyre që ta pyesin për sekretin e saj? Ata thanë: “Si t’i flasim atij që është foshnje në djep?” (Merjem, 29).

Por ja, tani do të dalë në pah mrekullia e pritur: “Tha: Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë (më ka caktuar të më japë) librin e më ka bërë Pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (falje) e zeqat derisa të jem gjallë. Më ka bërë të mirësjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë e as të padëgjueshëm. Selami (shpëtimi prej Allahut) është me mua ditën kur u linda, ditën kur të vdes, dhe ditën kur të dal i gjallë!” (Merjem, 30-33)

Sikur ne të mos e dinim më parë se ç’do të ndodhë, do të na dridheshin këmbët nga lemeria ose do të na ngallmoheshin gjymtyrët nga hutia apo do të na ngriheshin gojët e hapura nga çudia. Mirëpo ne e dinim, andaj prej impresionimit le të shpërthejnë lotët prej syve tanë. Në ato momente bie perdja,

ndërsa sytë lotojnë për këtë fitore. Në ato çaste dëgjojmë në formë kumtuese në rastin më të volitshëm për bindje dhe pranim:

“Kjo është (fjalë) e vërtetë rreth Isait, birit të Merjemes në të cilin ata shkaktojnë dyshime. Nuk i takoi (nuk ka nevojë) Allahut të ketë ndonjë fëmijë, i pastër është Ai, kur dëshiron një gjë Ai vetëm thotë: Bëhu! Ajo menjëherë bëhet. (Isai i tha popullit të vet) Dhe se Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, pra adhurone Atë, kjo është rrugë (fe) e drejtë.” (Merjem, 34-36).

Këtu u shpalos qëllimi fetar e u shpaluan edhe skenat e rrëfimit. Mirëpo ajo në të cilën fare s’dyshohet është çështja se fuqia e shfaqjes së emocioneve dhe reagimeve këtu është dominante dhe se kjo ngjyrë edhe i përshtatet asaj dhe është me te më shumë se ngjyrat tjera.

Përshkrimi i protagonistëve në rrëfim

Kësaj here do të flasim për ngjyrën e tretë prej ngjyrave të ilustrimit në rrëfim. Atë ne do ta veçojmë prej tyre edhe pse ajo është një prej tyre. Fjala është për përshkrimin e protagonistëve dhe zbulimin e tyre.

Qysh herët ne e ekspozuam rrëfimin për pronarin e dy kopshteve dhe shokun e tij si dhe rrëfimin për Musain dhe mësuesin e tij. Në të dy rrëfimet ka dy forma shëmbëlluese. Shembuj të kësaj ngjyre të ilustrimit janë rrëfimet e tërë Kur'anit. Kjo është ajo veçori dalluese e këtyre rrëfimeve. Ajo është veçori ekskluzivisht artistike dhe vetvetiu është qëllim i rrëfimeve artistike në veçanti. Te të gjitha rrëfimet kur'anore tipar kryesor i tyre është misioni (thirrja) fetare i cili gjatë zhvillimit përfshinë edhe këtë veçori. Në këtë mënyrë edhe ajo shfaqet në të gjitha rrëfimet. Ajo pikturon disa “lloje njerëzore” nga protagonistët të cilët i kapërcejnë kufijtë e personalitetit spekulativ në personalitet shembullor. Tani do t'i ekspozojmë disa rrëfime në mënyrë të përgjithshme e disa të tjera në mënyrë të veçantë.

1 - Ta marrim Musain: Ai është shembull i liderit flijues me prirje patriotike:

Ja, ai u rrit në pallatin e faraonit, para syve dhe veshëve të tij. Ai u bë djalë i fortë: “Dhe hyri në qytet në një kohë të pahetuar prej banorëve të tij, dhe në te i gjeti dy veta që po ziheshin, njëri prej ithtarëve të tij e tjetri prej armiqve të tij, e ai i anës së tij i kërkoj ndihmë kundër armikut dhe Musai i ra grusht dhe ai vdiq”. Mu këtu vërehet qartë reagimi fanatik:

Shumë shpejt e lëshon kjo shtyrje fanatike dhe i bie ndërmend se çfarë pasojash ka ky fanatizëm “Ai (Musai) tha: Kjo është prej veprave të djallit, e s’ka dyshim se ai është armik i haptë që shpie në humbje. Ai tha: Zoti im, unë e ngarkova veten e Ti më fal mua! Dhe Ai ia fali, se Ai është që fal shumë, është mëshirues. Ai tha: Zoti im, betohem në ato të mira që m’i dhurove mua se kurrë nuk do të vihem në ndihmë të kriminelëve”.

“Dhe (Musai) agoi i frikësuar në qytet e duke pritur (se çka po i ngjanë)”. Kjo është një shprehje ilustruese e një figure të njohur: Figura e të frikësuarit i cili sodit çdo anë dhe parapret t’i vijë e keqja nga çdo lëvizje. Ajo gjithashtu është cilësi e fanatikëve.

Megjithatë edhe pse ai premtoi se nuk do t’u vihet në ndihmë kriminelëve, të shohim se ç’do të veprojë. Ai duke shikuar: “Kur qe, ai i cili i kishte kërkuar ndihmë dje, e thirri sërish (në ndihmë)”, kundër një njeriu tjetër “e Musai i tha: Vërtet, ti qënke ngatërrestar i njohur!”. Por ja ai ia mësyu edhe këtij tjetrit siç ia mësyu atij të djeshmit. Kështu flijimi patriotik e bëri që të harrojë kërkim-faljen, pendimin, frikën dhe pasigurinë sikur të mos ia përkujtonte ai të cilit ia mësyu për krimin e tij. Atëherë i kujtohet dhe tërhiqet frikësueshëm:

“E kur deshi ta rrëmbejë atë që ishte armik i të dyve, ai tha: A do të më mbytish mua siç e mbyte dje njeriun, ti nuk do tjetër vetëm se të bëhesh arrogant në tokë, e nuk dëshiron të jeshë nga përmirësuesit.” (Kasas, 15-19). Atëherë i vie një njeri nga skaji i qytetit duke u ngutur dhe e këshillon që të largohet. Ai pastaj, siç e dimë, largohet nga qyteti.

Le ta lëmë anësh këtë protagonist këtu e të kalojmë në periudhën e dytë të jetës së tij dhe ate pas dhjetë vjetësh. Ndoshta

ai tani është qetësuar dhe është bërë njeri me natyrë të qetë dhe shpirt të butë.

Kurrsesi! Ja si tani ftohet nga ana e djathtë e luginës: Hedhe shkopin tënd! - Ai e hodhi, kur qe ai sikur të ishte gjarpër i shpejtë. Sa e pa ai u tërhoq me shpejtësi duke mos vështruar mbrapa po as të ndalet. Ai vërtet është i njëjti djalosh temperament edhe pse tanimë ishte bërë burrë. Sigurisht edhe tjetri pas tij do të frikohej por edhe pse ndoshta do të largohej, ai përsëri do të ndalej që ta rikujtojë këtë mrekulli të madhe.

Pastaj le t'ia lëmë në disponim edhe një afat tjetër që të shohim se çka do të bëjë koha me nervat e tij.

Ai i fitoi magjistarët, i shpëtoi Beni Israilët, me ta kaloi detin dhe më në fund shkoj ta takojë Zotin e tij në kodrën Tûr. Në të vërtetë ai është pejgamber por ja ai Zotit të tij i shtron një pyetje të çuditshme. “Ai tha: Zoti im, më mundëso pamjen tënde e të shikoj! Ai (Zoti) i tha: Ti nuk ke mundësi të më shohësh, por shiko kodrën, e nëse ajo qëndron në vendin e vet, ti do të më shohësh Mua”. Më pas ndodhi ajo që nuk mund ta durojnë asçfarë nervash njerëzore “Kur u drejtua kah kodra, një pjesë e dritës nga Zoti i tij e bëri atë (kodrën) thërrmi. Musait i ra të fikët. Kur erdhi në vete tha: “E lartë është madhëria Jote! Pendohem te Ti (për atë që kërkova), dhe unë jam i pari i besimtarëve.” (A’rafë, 143). Kështu temperamenti kthehet në shpejtësi dhe reagon.

Dhe ja ai tani kthehet dhe popullin e tij e gjenë se si ata morën për zot një viç, kurse në duart e tij mban levhat të cilat ia shpalli Allahu atij. Ai aspak nuk priti dhe mendoi: “I hodhi levhat dhe e zuri për koke (flokë) vëllain e vet duke e tërhequr nga vetja.” (A’rafë, 150). Ai kështu vazhdoi i revoltuar duke ia shkundur flokët dhe mjekrën të vëllait, e duke mos ia vurë veshin fjalëve të tij: “Ai

(vëllai, Haruni) tha: O bir i nënës sime, mos më kap as për mjekre as për flokë, se unë u frikësova se do të thuash i përçave Beni Israilët dhe nuk e ke respektuar porosinë time.” (Tâhâ, 94).

E kur merr vesh se Samiriju është ai që e bëri atë vepër, i drejtohet atij i hidhëruar dhe e pyet duke e ironizuar, madje edhe nëse e ka kuptuar sekretin e viçit. “Ai (Musai) tha: Prandaj largohu sepse sa të jeshë gjallë ke për të thënë: (këdo që e sheh) Mos m’u afro! E ty të pret edhe një moment (dënim) që nuk ke për t’i ikur. E ti shiko zotin tënd që e adhurove bindshëm, e tani atë do ta djegim e do ta bëjmë shkrumb dhe hirin e tij do ta shpërndajmë nëpër det.” (Tâhâ, 97). Kështu i drejtohet me urrejtje të haptë dhe me sjellje acaruese (kërcënuese).

Ta lëmë edhe disa vjet tjera.

Tashmë populli i tij bredhte rrugëve i hutuar; mendojmë se atëherë kur u nda prej tyre ishte i shtyrë në moshë, ai takoi njeriun nga i cili kërkoi ta shoqëronte që ta mësojë (ai njeri) nga ajo dituri që i kishte dhënë Allahu atij. Siç e dimë, ai nuk arriti të bëjë durim disa herë, derisa ai njeriu ta informojë për sekretin e asaj që vepronte, andaj edhe u ndanë...! Ky vërtet është protagonist i pandryshueshëm e i dallueshëm dhe shembull i qartë njerëzor në çdo etapë prej etapave të rrëfimit në përgjithësi.

2 - I kundërt me personalitetin e Musait është personaliteti i Ibrahimit. Ibrahimit është shembull i qetësisë, tolerancës dhe butësisë:

“Vërtet, Ibrahimit ishte shumë i butë, shumë i dhembshëm dhe i kthyeshëm.” (Hûd, 75).

Ja ku e kemi Ibrahimin në rininë e tij, vetmohet duke medituuar dhe duke e kërkuar Zotin e tij:

“E kur atë e mbuloi nata, ai e pa një yll e tha: Ky është zoti im! E kur u zhduk ai (perëndoi) tha: Unë nuk i dua ata që humben. Kur e pa hënën të posalindur tha: Ky është zoti im! E kur perëndoi ajo tha: Nëse zoti im nuk më udhëzon, unë do të jem prej njerëzve të humbur! Kur e pa diellin të lindur, tha: Ky është zoti im, ky është i madh! E kur ai perëndoi, tha: O populli im, unë jam i pastër nga ajo që ju ia shoqëroni! Unë me veten time i drejtohem Atij që krijoi qiejt dhe tokën, larg besimeve të tjera; unë nuk jam prej atyre që i përshkruajnë shok! Po atë (Ibrahimin) e polemizoi populli i tij e ai tha: A polemizoni me mua rreth Allahut e Ai më udhëzoi? Unë nuk u frikohem atyre që ju ia bëni shok, vetëm nëse Zoti im do ndonjë send (të më godas, ai më godet). Me dijen e tij Zoti im ka përfshirë çdo send, e nuk e merrni me mend?” (En’am, 76-80).

Sapo arriti në këtë bindje, ai filloi me të mirë dhe me ngrohtësi ta udhëzojë babain e tij. Ai zgjodhi fjalët më të dashura dhe më tërheqëse: “O babai im, pse e adhuron atë, që as nuk dëgjon, as nuk sheh, e as nuk ke asgjë prej tij. O babai im, mua më është dhënë nga dituria çka ty nuk të është dhënë, andaj më dëgjo se unë të udhëzoj në rrugë të drejtë. O babai im, mos adhuro djallin, sepse djalli është kundërshtar I Mëshiruesit. O babai im, unë kam frikë se do të të godasë ndonjë dënim prej Të Gjithëmëshirshmit e do të jesh shok i djallit!” (Merjem, 42-45).

Por ja, babai i tij mohon fjalën e tij, i kthehet me fjalë të vrazhda dhe i kërcënohet ashpër: “Ai (babai) tha: A ti Ibrahim i refuzon zotat e mi? Nëse nuk ndalesh (së fryeri ndaj zotave të mi), unë do të gurëzoj ty, ndaj largohu prej meje për një kohë të gjatë.” (Merjem, 46).

Kjo vrazhdësi e babait nuk e largoi Ibrahimin nga sjellja e tij e matur, as nga natyra e tij e butë e as nuk e bëri që ai të heq dorë nga babai i tij.

“Ai (Ibrahimi) tha: Qofsh i lirë prej meje! Unë do ta lus Zotin tim që të të falë ty, ngaqë ti (baba) ishe i kujdesshëm ndaj meje. Unë po largohem prej jush dhe prej asaj që e adhuroni ju pos Allahut, dhe do ta lus Zotin tim e shpresoj se me lutjet drejtuar Zotit tim nuk do të jem i humbur.” (Merjem, 47-48).

Ja tani Ibrahimi merr dhe ua copëton idhujt atyre - kjo mund të jetë e vetmja vepër e ashpër që e bëri ai - por e gjithë ajo që e shtyri ta bëjë këtë është një mëshirë shumë e madhe; se ndoshta populli i tij do të besojë kur t'i shohin zotat e tyre të copëtuar dhe ta kuptojnë se ata janë aq të pafuqishëm saqë nuk mundën ta pengojnë as vetë shkatërrimin e tyre. Në të vërtetë, ata pothuajse erdhën në besim. “Ata u ndalën e filluan të mendojnë, e dikush tha: Vërtet, ju jeni mu ata të gabuarit (sepse adhuroni gjëra të kota).” (Enbija, 64). Mirëpo ata përsëri u kthyen dhe ia mësynë ta ndjekin Ibrahimin, atëherë “Ne i thamë: O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin.” (Enbija, 69).

Ai u largua nga ata për një kohë të gjatë dhe u vetmua me grupin i cili besoi së bashku me te. Prej tyre edhe djali i vëllait të tij, Luti.

Në pleqëri, gjegjësisht në moshë shumë të shtyrë, Zoti ia dhuroi Ismailin, mirëpo atij i ngjanë ajo që e detyron ta largojë të birin dhe nënën e tij (Kur’ani nuk e shoshit këtë rast që ka ndodhur). Atë e mbizotëroi natyra e atij që i dorëzohet caktimit të Zotit mbi atë që e dirigjon dashuria atërore. Atë e frymëzon besimi në Zotin e tij dhe e lë përkaj shtëpisë së Tij. Në atë vend ai thërret me thirrje të të përlushmit dhe të kthyesmit:

“Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, e pranë shtëpisë tënde të shenjtë. Zoti ynë (i vendosa aty) që të falin namazin, pra bëje që zemrat e disa njerëzve të mallëngjehen për ata, dhe, për të falënderuar me mirënjohje, furnizoi ata me fruta.” (Ibrahim, 37).

Megjithatë ende pa u rritur mirë ky fëmijë, ai sheh në ëndërr se është duke e therë. Atë e mbizotëron besimi i tij i thellë fetar mbi dashurinë e madhe atërore. Ai ia mësynë që ta respektojë këtë sinjal sikur mos ta shoqëronte Zoti i tij dhe t'i falte një kurban madhështor.

Në këtë mënyrë ndriçohen ngjarjet në rrëfim dhe diskutimet për një personalitet me tipare të dalluara e veçori të qarta: “Vërtet Ibrahim i ishte shumë i butë, shumë i dhembshëm dhe i kthyesëm”.

3 - Ndërsa Jusufi, ai është shembull i njeriut inteligjent dhe me gjykim të shëndoshë.

Ai gati se u provua kur gruaja e ministrit i bëri lajka që t'i afrohet, por ai e refuzoi. Në fund ai e mundi epshin dhe mbizotëroi në një situatë kur vullneti e tërhiqte vrullshëm nga ajo vepër.

Këtu zbulohet “gruaja” në gjendjen e saj më të pavolitshme, në rastin kur atë e dirigjon epshi i saj: “Dhe, që të dy ata nxituan kah dera, e ajo ia grisi këmishën e tij nga mbrapa”. Mirëpo aty ndodh një befasi e tmerrshme. “Dhe pranë derës, ata të dy e takuan burrin e saj”. Këtu gruan e udhëheq pasioni përsëri; përgjigjen e merr të gatshme - ajo e akuzon djaloshin: “Ç’farë mund të jetë ndëshkimi i atij që tenton të keqen në familjen tënde?”. Mirëpo ajo si grua e dashuronte andaj edhe frikohej për te që të mos pësojë ndonjë

përfundim të keq dhe jep shenjë për një dënim mbrojtës: “Përpos të burgoset ose dënim të dhembshëm!”.

Dikë tjetër pos Jusufit në këtë rast do ta kishin lëshuar këmbët, por Jusufi mendjeshëndoshë ia pret drejtë: “Ajo mu vërsul mual!”. Dhe dëshmon me këmishën e tij të grisur nga mbrapa. Ai e takon atë që i rri krah dëshmisë së tij prej të afërmeve të gruas. “Një dëshmitar nga familja e saj tha: Nëse këmisha e tij është grisur përpara, ajo ka thënë të drejtën, kurse ai gënjen. E nëse këmisha e tij është grisur nga prapa, atëherë gënjen ajo kurse ai thotë të drejtën”... Jusufi pra doli i pastër dhe i pafajshëm.

Gratë e qytetit e përhapën këtë ngjarje, siç është traditë te gratë e çdo vendi dhe të çdo kohe ngase zgjoi interesim të madh dhe vend për diskutim te to. Vetia e “gruas” del në shesh edhe njëherë te e shoqja e ministrit. Ajo i thërret gratë në gosti, ndërkohë kur ato ishin të preokupuara me ngrënien e ushqimit, kur thikat i kishin në duar - Egjipti që atë kohë ishte vend i civilizuar, dhe populli i tij hante në enë dhe përdorte thikat - u doli përpara Jusufi e ato mbetën gojëhapur dhe të shtangura. I lënduan duart e tyre dhe morën plagë të rënda. “Kur e panë ate, ato u tronditën dhe i prenë duart e tyre dhe thanë: Allahut i qofshim falë! Ky nuk është njeri, ky është vetëm ndonjë engjëll i lartë!...” (Jûsuf, 23-31). Ato janë gra, dhe ajo është grua. Ajo di se si t’ua mbyll gojën grave!

“Mandej, meqë u vërtetuan argumentet (e pastërtisë së Jusufit) atyre (ministrit dhe rrethit të tij) u lindi ideja që atë për një kohë ta burgosin.” (Jûsuf, 35). Nuk mund të ndalen fjalët derisa gratë janë në qytet.

Ja tani ua komenton ëndrrat dy shërbëtorëve të mbretit në burg. Kur ja, për njërin kuptoi se ai do të shpëtojë dhe do t’i kthehet në shërbim zotëriut të tij. Jusufi mendjeshëndoshë dhe

inteligjent nuk harroi ta porosisë atë ta përmend çështjen e tij te zotëriu (mbreti) i vet.

“E atij për të cilin besonte se është i shpëtuar i tha: Më përkujto mua te zotëriu yt.” (Jûsuf, 42).

Por ai që e pi ujin e harron të eturin “E për këtë mbeti në burg disa vjet.” (Jûsuf, 42), derisa mbreti ta shohë ëndrrën e vet dhe të mos munden komentuesit t’ia komentojnë. Atëherë atij “Që e piu ujin” (d.m.th. që u lirua nga burgu sh.p.) iu kujtua Jusufi. Ai erdhi te Jusufi që t’ia komentojë ëndrrën. Ai e merr komentën prej tij kurse mbreti kërkon ta shohë.

Këtu del në pah njeriu mendjeshëndoshë dhe inteligjent. Ai në burg hyri i dëmtuar (i pafajshëm). Rreth tij ka fjalë. Ai nuk dëshiron që pasi të dalë nga burgu të kthehet përsëri në te siç hyri herën e parë. Ai e shfrytëzoi rastin e volitshëm për të marrë garanci dhe të dalë në shesh pafajësia e tij: “Ai tha: Ktheu te zotëriu yt dhe pyete ç’është puna e atyre që i prenë duart e tyre? Vërtet, Zoti im e di shumë mirë dredhinë e tyre.” (Jûsuf, 50). Mbreti i pyet ato dhe ato përgjigjen drejt. Do të shohim se edhe gruaja e ministrit e çfajëson gjithashtu. Siç duket, ajo veç i kishte marrur vjetët e veta sepse nisemi nga ajo se ajo e bëri veprën e saj kur i kishte të dyzetat ose mbi to. Ajo ishte vepër e një gruaje e cila e kishte plotësuar periudhën e saj të fundit; e kur ne ia shtojmë vjetëve të saj edhe ca vjet, ajo do t’i ketë pasur pesëdhjetë vjet apo afër të pesëdhjetve. Andaj edhe nuk ka dëm nëse e zbulon të kaluarën e varrosur: “Gruaja e ministrit tha: Tash doli në shesh e vërteta, unë iu vërsula atij në dashuri, ai është nga të drejtit.” (Jûsuf, 51).

Kur e pa mirënjohjen e mbretit ndaj tij, qetësimin dhe kënaqësinë e tij për komentimin që ia bëri dhe kur dëgjoi fjalët e

tij: “Tash ti te ne ke pozitë dhe je i besueshëm.” (Jûsuf, 54), nuk e lëshoi mundësinë e të ikë por tha: “Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik, i dijshtëm.” (Jûsuf, 55). Kërkesa e tij pranohet në kushtet më të volitshme.

Qëndrimi i Jusufit gjatë viteve të begatshme dhe ato të thatësisë si ministër, dëshmon për shkathtësinë dhe mprehtësinë që e kishte në administratë dhe ekonomi. Ai e ushtronte funksionin e ministrit për financa dhe furnizim pesëmbëdhjetë vjet, jo vetëm për furnizimin e Egjiptit por edhe për furnizimin e vendeve të afërta fqinje të cilat i shkatërroi thatësia dhe të cilat kërkonin ndihmë shtatë vjet me radhë. E kur i erdhën vëllezërit e tij ai i njohu, kurse ata e kishin harruar. Ai ua kushtëzoi ndihmën me sjelljen e vëllait të tij prej nëne si çmim për marrjen e kafshatës (grurit). Kur i erdhën me vëllain e tij, ai ia behu ta ndalë atë: “E vuri tasin (gotën) në barrën e vëllait të vet, e pastaj një thirrës thirri: O ju devexhinj, ju jeni vjedhës.” (Jûsuf, 70). Kur ata e mohuan vjedhjen dhe kërkuan që të bëhet kontrollimi i tyre, ai kërkoi dëmshpërblim për atë te i cili do të gjendet tasi. Këtu do të vërehet mendjempreh-tësia e tij. Ai filloi me kontrollimin e barrave të tyre para barrës së vëllait e më pas nxori tasin nga barra e të vëllait. Ai e la të kthehen pa te. Pastaj ata i erdhën përsëri me barrat e tyre. Kësaj here ai ua zbuloi veten pasi që ua dha këtë mësim (sprövë) dhe pasi që i detyroi të ngarkohen me atë vështirësi.

Të gjitha këto sjellje nëse burojnë prej dikujt, ato mund të burojnë vetëm nga njeriu mendjemprehtë.

4 - Ne do të dëshironim që personalitetin e Ademit dhe atë të Iblisit t'i ekspozojmë në këtë shtrirje detajore, por do të mjaftojmë me një ekspozim të përgjithshëm të tyre ngase kemi një rrëfim tjetër të cilin do ta ekspozojmë detajisht.

Personaliteti (karakteri) i Ademit në rrëfimet kur'anore është shembull për “njeriun” i cili posedon të gjitha karakteristikat (potencialet) dhe tiparet e tij. Nga karakteristikat dhe tiparet më të dukshme është dobësia më e madhe njerëzore e cila përfshinë të gjitha pikëpamjet e dobësive tjera. Dobësia përballë dëshirës për amshim. Iblisi ngacmoi mu këtë vend të dobët e Ademi iu dorëzua ftesës së tij së bashku me të shoqen Havën. “Atë e ngacmoi djalli duke i thënë: O Adem, a do të të tregoj për pemën e pavdekshmërisë dhe të sundimit të pazhdukshëm!” (Tâhâ, 120). Njeriu i kësaj bote e lakmon gjithmonë amshueshmërinë. E kur nuk e arriti atë që ia premtoi djalli, ai vazhdoi dhe do të vazhdojë ta arrijë atë në mënyra të ndryshme, qoftë me fëmijë (pasardhës), qoftë në kujtesë, qoftë në imagjinatë. Nëse të gjitha këto (e ne jemi të bindur sh.p.) nuk do t'i sjellin dobi, do t'i sjell dobi feja e cila ia garanton ringjalljen edhe njëherë dhe i garanton një lloj amshimi gjithashtu!

Ndërsa personaliteti i Iblisit është personalitet i djallit dhe kjo mjafton...!

5 - Tani do ta ekspozojmë një rrëfim prej rrëfimeve ku më vrullshëm shfaqen tiparet e protagonistit që deri më tani nuk i kemi parë dhe më të shtrirat në artin e pastër gjithashtu, përkrah kryerjes së plotë të funksionit fetar.

Ky është rrëfimi i Sulejmanit me Belkisen (mbretëreshën e Sebesë). Që të dy janë protagonistë të qartë në te: Aty shfaqet personaliteti i “burrit” dhe personaliteti i “gruas”. Mandej personaliteti i “mbretit pejgamber dhe i “mbretëreshës”. Të shohim se si shfaqen të gjitha ato karakteristika.

“Dhe vështroi shpezët e tha: “Ç’është që nuk e shoh pupuzën? Jo, ajo nuk qenka këtu! Unë do ta dënoj me një dënim të ashpër

ose do ta ther ose do të më sjell ndonjë argument të fortë.” (Neml. 20-21).

Kjo është skena e parë. Aty shfaqet “mbreti korrekt” dhe “pejgamberi i drejtë”. Ai është mbret i cili sodit dhe kontrollon barinjtë e tij (ata që i ka nën përkujdesin e tij). Ai hidhërohet prej atij që e prish rendin dhe mungon pa marrë leje. Por ai nuk është mbret zullumqar nëse ai i cili mungon ka arsyetim dhe në te ka bazë të shëndoshë, përndryshe pasojës nuk mund t’i ikë, do ta dënojë me një dënim të ashpër ose do ta therë.

“Ajo nuk zgjati shumë e tha: Unë e kuptova atë që ti nuk je i njohur dhe të erdha nga Sebei me një lajm të sigurt. Në të vërtetë unë gjeta një grua që po i sundonte ata (popullin e Sebeit) dhe asaj i ishte dhënë çdo rend, ajo kishte edhe një fron të madh. Madje vëreja se ajo dhe populli i saj e adhurojnë diellin e jo Allahun, por djalli ua kishte hijeshuar atë veprim të tyre dhe i kishte shmangur prej rrugës së drejtë, andaj ata nuk gjejnë udhëzim (i kishte shmangur) për të mos e adhuruar Allahun që nxjerr në shesh (e di) të fshehtë në qiej e në tokë, dhe që e di atë që fshehni dhe atë që e publikoni. Allahu është një, nuk ka zot tjetër pos Tij, Zot i arshit të madh.” (Neml, 22-26).

Kjo është skena e dytë - kthimi i atij që nuk ishte i pranishëm, ajo e dinte korrektësinë dhe forcën e tij të madhe. Ajo fillon bisedën e saj me një befasi që e kishte përgatitur për mbretin me të cilën do ta arsyetonte mungesën e saj. Nisma e bisedës së saj garantonte që mbreti ta drejtojë vëmendjen nga ajo: “Unë kuptova atë që ti nuk je i njohur dhe të erdha nga Sebei me një lajm të sigurt”. Cili mbret nuk do të dëgjonte kur një e vogël (pupëza) prej tufës (ithtarëve) së tij i thotë: “Unë kuptova atë që ti nuk je i njohur (me te)”. Kur ja, ajo që mungonte e paraqet lajmin në mënyrë të përpiktë. Ajo tani edhe e ndien në vete tërheqjen e

vëmendjes së mbretit dhe interesimin e tij për lajmin që ia sjell. Pastaj fillon ta zgjasë bisedën por edhe të filozofojë. Ajo e kundërshton orientimin e atij populli: “(Djalli i kishte shmangur) Për të mos e adhuroar Allahun që nxjerr në shesh (e di) të fshehtën në qiej e në tokë”. Ajo flet për të fshehtën (të strukturën) me një theks të veçantë ngase ajo me natyrshmërinë që ka është e detyruar që të hulumtojë me sqepin e saj ushqimin e strukur në tokë. Pra, ky sinjalizim i saj është gjëja më e përshtatshme për natyrën që e posedon! Ajo deri në këtë çast ende është në pozitë të mëkatarit. Mbreti ende nuk iu përgjigj. Atëherë ajo jep shenjë se këtu ka Zot, e ai është: “Zot i arshit të madh”. Që t’ia zbusë mbretit këtë madhështi njerëzore para kësaj madhështie hyjnore!

“Ai (Sulejmani) tha: Do të shohim se a e thua të vërtetën apo je nga gënjeshtarët! Shko me këtë letrën time e hedhja atyre, largohu nga ata pak dhe përgjo se çka bisedojnë!”.

Kjo është skena e fundit e pjesës së dytë. Në të shihet mbreti korrekt dhe i drejtë. Lajmi i madh nuk e zbuti “mbretin”. Ky arsyetim nuk e shpëtoi rastin e ushtarit i cili e prishi rendin. Rasti është i përshtatshëm për shqyrtim siç edhe vepron “Pejgamberi i drejtë” dhe “shtetari i mençur”.

Mandej, ja ne shikuesit nuk e dimë se ç’ka në atë shkresë. Asgjë prej saj nuk u publikua para se t’i bie në dorë mbretëreshës! E kur arriti, ajo është e cila e publikoi. Këtu fillon skena e tretë:

“Ajo (Belkisja) tha: O ju pari, mua më ka arritur një letër madhështore! (e lexova), kjo është prej Sulejmanit (mandej e hapi kur qe në të) me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit (Bismil-lahir-rrahmanir-rrahim)! (Në vazhdim shkruan) Të mos mbaheni më të mëdhej kundër meje, por të më vini të dorëzuar (besimtarë)!”.

Dhe ajo që e ka cilësinë e “mbretëreshës” nuk dëshiron që ta detyrojë parinë e popullit të saj t’i dorëzohen vendimit të saj para se t’i shfaqin ata dëshirat dhe animin e tyre. Ajo e mbyll letrën dhe u drejtohet këshilltarëve të saj të rinj:

“Ajo tha: Ajo pari më sugjeroi në këtë çështje timen, se unë nuk do të vendos asgjë derisa edhe ju të jepni pëlqim!”.

Siç është zakoni i ushtarakëve në çdo kohë dhe në çdo vend që ata doemos ta tregojnë gatishmërinë e tyre në çdo moment, përndryshe ata e përçmojnë detyrën e tyre, duke ia lënë çështjen udhëheqjes së lartë, ashtu siç referon rendi dhe sistemi: “Ata (paria) thanë: Ne jemi të fuqishëm dhe jemi luftëtarë të rreptë, por puna qëndron te ti, e ti mendo se çka do të na udhëzosh.” (Neml, 27-33).

Tash mu në këtë rast shfaqet “gruaja” prapa “mbretëreshës”... Gruaja e cila e urren luftën dhe shkatërrimin dhe e cila e avancon armën e dredhisë dhe butësisë ndaj armës dhe vrazhdësisë dhe e cila përnga struktura e saj është e gatuar që të ballafaqohet me “burrin” pa armiqësi dhe konflikt!

“Ajo tha: Kur pushtuesit e pushtojnë ndonjë vend, e rrënojnë atë ndërsa parinë më të zgjedhur të atij vendi e nënshtrojnë. Kështu ata veprojnë! Po unë do t’u dërgoj atyre një dhuratë (të madhe), e do të shoh se çka do të na sjellin të dërguarit (me dhuratë)!” (Neml, 35).

Këtu bie perdja që të hapet te Sulejmani:

“E kur i erdhi ajo Sulejmanit, ai tha: A me pasuri më ndihmoni mua? E ajo që ma ka dhënë Allahu është shumë më e dobishme nga ajo që ua ka dhënë juve! Por ju krenoheni me dhuratat tuaja!

Kthehuni te ata (i tha kryesuesit të të deleguarve), se për Zotin ne do t'u vijmë atyre me një ushtri të cilës ata nuk do të mund t'i bëjnë ballë, dhe do t'i dëbojmë prej aty të nënshtruar e të poshtëruar!" (Neml, 36-37).

Tashmë të deleguarit e kthyen dhuratën e tyre e ne t'i lëmë të kthehen në atë rrugë të gjatë.

Pa dyshim peygamberi Sulejman është mbret kurse "mbreti" nga përvoja e tij e di se kjo kthesë e tij e vrazhdë do të përfundojë me një mbretëreshë e cila nuk do armiqësi - siç edhe duket nga dhurata e saj atij - dhe se ajo, sipas të gjitha gjasave, do t'i përgjigjet thirrjes së tij, bile e sigurt dhe pa kurrfarë hamendjeje. Sulejmani është burrë. Burri e di sipas natyrës së tij se "gruan" e trishton fuqia mbimendore. Dhe ja, ai dëshiron që ta sjell fronin e mbretëreshës para se të vijnë "të dorëzuar" dhe t'ia përgatisë pallatin prej qelqi (edhe pse rrëfimi pallatin e lë sekret - madje edhe për ne shikuesit - që të na befasojë me të së bashku me Belkisen në skenën e fundit).

"Ai (Sulejmani) tha: O ju pari, cili prej jush do të ma sjell fronin e saj para se të më vijnë ata të dorëzuar? Njëri prej xhinëve të vrazhdë (ifrit) tha: Unë do ta sjell atë ty, para se të ngrihesh nga vendi yt, unë për të kam fuqi dhe jam i sigurt!".

Dhe ja një njeri nga besimtarët - i cili kishte dituri nga libri - fuqia e tij e tejkalon fuqinë e atij ifriti!

"E ai i cili kishte dituri nga libri tha: Unë do ta sjell atë ty sa çel e mbyll sytë".

Këtu kemi një pushim sa mbyllen sytë e pastaj çelen: "E kur e pa atë (fron) të vendosur pranë tij (Sulejmani), tha: Kjo është nga

dhuntia e Zotit tim që të më sprovtojë mua a do ta falënderoj, apo mos do ta përbuzë. E kush falënderon, ai falënderon për të mirën e vet, e kush përbuz, Zoti im (s'ka nevojë), është i panevojë e bujar!”.

Në shpirtin e Sulejmanit tashmë është zgjuar “pejgamberi” para dhuntisë së Allahut e cila realizohet përmes duarve të një robi prej robërve të Allahut. Me këtë rast Sulejmani kthehet dhe falënderohet për dhuntinë, me të cilën realizohet qëllimi fetar i rrëfimit.

Më pas, ja në Sulejmanin zgjohej përsëri ai “burrë”.

“Ai (Sulejmani) tha: Ndryshojani asaj fronin që të provojmë se a po e njeh apo është prej atyre që nuk dinë ta njohin.” (Neml, 38-41).

E tash, këtu përgatitet teatri që ta pret mbretëreshën. Ne tani le ta mbajmë veten kur e shoshit pritësi i saj:

“E kur erdhi ajo, ai i tha: A është i këtillë froni yt? Ajo tha: Si të ishte vetë ai?!” E pastaj çka ka? Mbretëreshës - si duket - ende nuk iu servua kjo befasi: “Pse atë (Belkisën) e kishte penguar (nga besimi i drejtë) ajo që adhuronte, pos Allahut, dhe ishte nga një popull jobesimtar.” (Neml, 43).

Me këtë rast plotësohet befasia e dytë për mbretëreshën dhe për ne bashkërisht:

“Asaj iu tha: Hyn në pallat, e kur e pa atë, mendoi se është një ujë i madh dhe i përvoli këmbët. Ai (Sulejmani) tha: Ky është një pallat i lëmuar prej qelqi! Ajo tha: Zoti im, unë i kam bërë krim

vetes, e tash i dorëzohem (pranoj besimin) së bashku me Sulejmanin Allahut, Zotit të gjithësisë.” (Neml, 44).

Ja pra, kështu mbretëresha u bë “grua” e vërtetë: e cila i frikohet luftës dhe shkatërrimit dhe e cila përdorë mashtrimin dhe butësinë në vend të kundërshtimit të haptë dhe vrazhdësisë. Ajo nuk dorëzohet në çastet e para. Befasia e parë kaloi e ajo megjithatë nuk u dorëzua, por kur e trishtoi befasia e dytë ajo hodhi armën, u dorëzua duke qenë e kënaqur pas vërejtjeve serioze që iu drejtuan natyrës së femrës dhe hamendjes së amshueshme në shpirtin e Havës!

Këtu lëshohet perdja. Rrëfimi më nuk ka kurrfarë shtese nga aspekti fetar po as nga ai artistik, vetëm nëse dikush orvatet të ngërthejë një aspekt ekskluzivisht artistik i cili nuk do të mund të ndërlidhej me qëllimin fetar e as t’i qëndrojë përballë. Rrëfimi në Kur’an është vetëm rrëfim fetar ku orientimi i vetëm i tij është feja. Ai i shpalon këto reagime shpirtërore, i përshkruan këto “lloje njerëzore”. Ai dëshiron t’i ekspozojë dhe t’i harmonizojë vetëm në këtë mënyrë.

Me këtë sqarim po e përmbyllim kapitullin e rrëfimit në Kur’an. E kush të dojë, pos këtij kapitulli kemi sqarime edhe më të gjera.¹⁴

¹⁴ Aludon në librin e tij i cili temë shqyrtimi e ka vetëm rrëfimin në Kur’an. (sh.p.)

Llojet njerëzore

Gjatë interpretimit të qëllimeve të ndryshme fetare, Kur'ani pikturoi dhjetëra “lloje njerëzore” jashtë rrëfimeve. Ai pikturoi lehtë, me lehtësi dhe shkurt. Ato nuk janë pos një apo dy fjali të cilat pikturojnë “llojin njerëzor” që përmes ngjyrosjeve të brushës bëhet i personifikueshëm, shndërrohet në krijesë të gjallë me tipare të përvetshme!

Ndonjëherë këto lloje janë pasqyrë e tërë llojit njerëzor, e ndonjëherë janë pasqyrë e disa individëve të përsëritshëm. Në të dy rastet ato janë lloje origjinale, të cilat njeriu do t'i hasë në çdo shoqëri dhe në çdo kohë.

Këto ajete erdhën për raste të posaçme, për të pikturuar lloje të karaktereve praktike. Mirëpo mrekullia artistike e ilustrimit bëri që këto lloje t'i kapërcejnë kohët dhe vendet e t'i tejkalojnë shekujt dhe gjeneratat. Ne këtu do të ekspozojmë disa nga këto lloje në formë të kapsallisjes - sipas metodës së ekspozimit të tyre në Kur'an, - disa prej tyre i kemi cekur në kapitullin e “Ilustrimit artistik” ku në realitet vendi i tyre ishte atje, atje ku shkëlqenin prekjet e brushës krijuese gjatë ilustrimit, por cekja e tyre në llojet rrëfimore është bërë me shkas, andaj edhe i ilustruam që t'i transferojmë prej atje këtu.

1 - Llojet njerëzore të cilat pikturojnë tërë llojin njerëzor:

“E kur njeriun e përfshinë dëmi, ai Na lutë goftë shtrirë, ulur ose në këmbë, e kur Ne ia largojmë të keqen atij, ai vazhdon sikur të mos Na ishte lutur fare për dëmin që e pat përfshirë.” (Jûnus, 12).

Në këtë lloj të shkurtë pikëtakohen të gjitha karakteristikat e realitetit shpirtëror dhe të harmonizimit artistik. Njeriu me të vërtetë është i tillë: Kur e përfshinë ndonjë e keqe dhe i ndërpritet forca për t'u ballafaquar me jetën, tërhiqet mbropa, i kujtohet fuqia absolute, dhe atëherë tërhiqet te ajo. Nëse i hiqet e keqja dhe i largohen pengesat e jetës, ia beh forca gjallëruese e qenies së tij, marrin vrullin kërkesat e jetës në bazë të tij dhe u përgjigjet “lutjeve të saj të pranueshme” dhe “vazhdon” sikur të mos kishte më parë asgjë!

Ndërsa harmonizimi artistik i saj shfaqet në atë shtrirje të fjalëve në formën e lutjes kur e përfshinë dëmi: “Ai Na lutë qoftë shtrirë, ulur ose në këmbë” pastaj te ai kalim i shpejtë, pra kur i largohet dëmi: “Vazhdon, sikur të mos Na ishte lutur fare për dëmin që e pat goditur”. Këto dy pasqyrime i ngjajnë plotësisht ndërprerjes së rrymës nga përcimi kur ndeshet me ndonjë pengesë të fortë. Kjo ndërprerje mund të zgjasë pak apo shumë, por kur mënjanohet ajo pengesë e fortë, rryma lëshohet në përcim vrullshëm dhe “vazhdon” sikur fare të mos ishte ndërprerë më parë.

Ky lloj ilustrohet shumëherë në Kur'an, por ai ilustrohet në aspekte të ndryshme, takohet në pikën fundamentale, e pastaj vazhdon në forma të llojlojshme, siç është rasti me ajetin:

“E kur begatojmë njeriun (me të mira), ai prapësohet dhe largohet i mashtruar, e kur e kap e keqja, ai humb shpresën.” (Israë, 83), ose “Po nëse Ne ia japim njeriut ndonjë begati nga ana e jonë, e pastaj e marrim ate prej tij, ai do të jetë shumë i dëshpëruar dhe përbuzës. E nëse pas të keqes që e pat kapluar atë, Ne i dhuruam të mira, ai do të thotë: Kaluan të këqijat prej meje! Vërtet, ai është i shfrenuar dhe mendjemadh”, (Hûd, 9-10), ose fjala e Tij: “Është e vërtetë se njeriu është i prirur të jetë i

padurueshëm. Se kur e kaplon ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi. Ndërkaq, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac.” (Me'arixh,19-21). Si këto ajete kemi shumë në brendi të Kur'anit.

Ja kështu dhe në këtë mënyrë ilustruhet ky lloj i përsëritshëm në këndet e shumta të shpirtit njerëzor dhe nga përveshjet kontraverse të jetës së tij. Të gjitha këto në fund takohen në të vërtetën e madhe shpirtërore; njeriu me fuqinë e tij - përkaj dukurive dhe llojeve të saj të shumta - ai prore vërsulet para, krenar me fuqinë që e posedon dhe mbështetës në gjallërinë e tij - me të gjitha mundësitë e mbështetjes derisa ta ndërprejë ndonjë pengesë - përkaj llojeve të ndryshme të pengesave - atëherë shikon mbrapa me vizione kundërtëse!

2 - Llojet e përvetshme njerëzore. Prej tyre e kemi atë krijesë me besim të dobët, e cila kapet për besimin e saj derisa ia sheh të mirat, e kur i ndodh ndonjë e padëshirueshme, hamendet dhe tërhiqet prej tij. Për shembull: “Ka nga njerëzit që e adhurojnë Allahun me mëdyshje (luhatshëm), nëse i godet ndonjë e mirë ata qetësohen me të, por nese i godet ndonjë e pakëndshme, ata e tregojnë fytyrën e tyre të vërtetë (mëparshme), ata e kanë humbur këtë dhe jetën tjetër.” (Haxh, 11). Ngjashëm me këtë shembull pos që në te ka pak diskutim: “Ka disa njerëz që thonë: Ne i kemi besuar Allahut, e kur lëndohet (në rrugë) të Allahut ai sprovimin e njerëzve e trajton njëjtë me dënimin e Allahut, e nëse vjen ndonjë fitore prej Zotit tënd, ata do të thonë: Ne kemi qenë me ju!” (Ankebût, 10).

3 - Prej njerëzve ka që krenohen me të vërtetën kur vjen prej duarve të tyre, e kur të vërtetën e sjell dikush tjetër, ngrihen kundër tij dhe ia mohojnë atë: “E kur u erdhi atyre prej Allahut Libri (Kur'ani), që është vërtetues i atij që e kishin pranë (Tevratin) - që para se t'u vinte e kërkonin ndihmën e tij (luteshin që të vijë)

kundër mosbesimtarëve, - e mohuan atë (Muhammedin) që e njihnin kur u erdhi!” (Bekare, 89).

Të ngjashëm me ta janë ata të cilët nuk njohin asgjë pos interesit të tyre dhe të cilët nuk nxitojnë pas hakut (të drejtës), pos kur shohin se në te ka levërdi. Kjo është strategjia e tyre, e ky është parimi: “E kur thirren që ndërmjet tyre të gjykojë Allahu dhe I dërguari i Tij, një grup i tyre nuk iu përgjigjën asaj. Po nëse është që e drejta u takon atyre (në atë gjykim), ata i shkojnë atij të bindur e me respekt...!” (Nûrë, 48-49).

4 - Ka prej njerëzve që ikin prej hakut, urrejnë që t'i dalin para ngase në shpirtin e tyre janë bërë bashkë arroganca dhe ligështia. Arroganca e cila refuzon hakun dhe ligështia e cila nuk mund të ballafaqohet me te: “Bëjnë polemikë me ty për të vërtetën pasi që e kishin të qartë (se ti vepron me lejen e Zotit), sikur me qenë se shtyheshin në vdekje të sigurt!” (Enfâl, 6).

5 - Disa ikën nga haku përmes këtij pasqyrimi në vete: “Po çka kishin ata që largoheshin prej këshillës (Kur’anit)? Sikur të ishin gomarë të trembur (të egër), që ikën prej luanit.” (Muddeththir, 49-51). Kjo skenë është e mbushur përplot lëvizje nxitëse për tallje.

6 - Sa prej llojeve njerëzore i shohim për çdo ditë dhe lexojmë: “E kur t'i shohish ata, trupat e tyre të mahnisin, e kur të flasin, fjalës së tyre ia vë veshin. Po ata janë si trungujt e zgavruar dhe të mbështetur.” (Munâfikûnë, 4). Vërtet, kjo është një skenë e shkëlqyeshme dhe tallje e përshtatshme.

7 - Pastaj ata që nuk bëjnë asnjë punë: “Dëshirojnë të jenë të lavdëruar për atë që se kanë punuar!” (Âli Imrân, 188). Ata vërtet janë shumë, në çdo kohë dhe në çdo vend!

8 - Sa ka prej atyre që hanë prej të gjitha sofrave e paraqiten se janë miq të të gjitha palëve dhe se ata janë të domosdoshëm për çdo palë: “Ata janë që presin se ç’po ju ndodh juve. Nëse me ndihmën e Allahut ngadhënjëni, ata thonë: “A nuk ishim me ju?”. E nëse jobesimtarëve u takon ndonjë fitim, ata thonë: A nuk mbizotëruam ne mbi ju (ju ndihmuam) dhe penguam prej jush besimtarët!” (Nisaë, 141).

9 - Lloji i arrogancës së çuditshme zbulohet në dy tekste të cilat u përmendën në ilustrimin artistik: “Edhe sikur Ne t’u hapim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lartë në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë). Ata gjithqysh do të thonin: Neve na janë ndalë sytë (të pamurit). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur.” (Hixhr, 14-15). “Edhe sikur ta zbritnim ty një libër të shkruar në letër, e ta preknin atë me duart e tyre, ata që mohuan do të thoshin: Kjo nuk është tjetër përveç një magji e qartël!” (En’am, 7).

10 - Llojin e atij i cili frikohet por nuk turpërohet: “E sikur t’i shihje ata kur janë ndalur pranë zjarrit e thonë: Ah sikur të ktheheshim (në dynja) të mos gënjejmë faktet e Zotit tonë e të bëhemi nga besimtarët! Jo, (s’është ashtu) po atyre u doli në shesh ajo që e mbanin fshehtë më parë, prandaj edhe sikur të ktheheshin ata do të përsëritnin atë që e kishin të ndaluar, e s’ka dyshim se ata janë gënjeshtarë.” (En’am, 27-28).

11 - Llojin e munafikut (hipokritit) të dobët, i cili nuk ka guxim që t’i shkojë pas mendimit të shëndoshë e as t’i dorëzohet të vërtetës. I vetmi preokupim i tij është që të mos ballafaqohet me argumentin: “E kur u zbret ndonjë sure (kaptinë), (që zbulon turpin e tyre), ata shikojnë njëri-tjetrin (e thonë mes vete): A ju pa ndokush ju, e pastaj largohen.” (Tevbe, 127). Pothuajse ti je duke i parë tani se si ata largohen duke shushuritur!

12 - Lloji i preokupimit të dobët, vendosjes së sakatosur, hujit të tërheqjes (nga begatia) dhe arsyetimit të rrejshëm: “Sikur të ishte fitim i afërt dhe udhëtim mesatar, ata (hipokritët) do të vinin pas teje, por për ta ishte largësi e vështirë. Ata do të betoheshin në Allahun: Sikur të kishim pasur mundësi, do të dilnim me ju. E shkatërrojnë veten e tyre; Allahu e di se ata janë rrenacakë.” (Tevbe, 42).

13 - Prej njerëzve ka të tillë në të cilët takohen tradhtia dhe pakujdesi. Ata e kujtojnë veten të shkathët për dredhi por ata e kanë mbushur ndjenjën e tyre plot pakujdesi. Ata me punën që e punojnë mendojnë se e kanë dëmtuar dikë tjetër e në të vërtetë ata e kanë dëmtuar vetëm vetveten: “Ka disa njerëz që thonë: Ne i kemi besuar Allahut dhe jetës tjetër (ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë Allahun dhe ata që besuan, por në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetërkë, pos vetes, por ata nuk e hetojnë.” (Bekare, 8-9).

14 - A thua nuk e ke hasur këtë kategori njerëzish - që do t'i përmendim - në çdo vend - që mbahen me kundërshti, kreshpërim dhe pakujdesi (neglijencë): “E kur u thuhet atyre: Mos e prishni rendin në tokë! Ata thonë: Ne jemi vetëm përmirësues (paqësues)! Vini re, ata në të vërtetë janë shkatërrues, por nuk e kuptojnë.” (Bekare, 11-12).

15 - Lloji i cili dëshiron të mbijetojë me çdo kusht, që dëshiron vetëm jetë, sido që të jetë, lakmon pas saj sa që në funksion të saj do t'i pranojë ato kushte që nuk do t'i pranonin as nuhatorët: “Është e sigurt se njerëzit më lakmues për të jetuar, ti ke për t'i gjetur ata (hebrenjtë).” (Bekare, 96). Kur'ani kështu shprehet me këtë refuzim, përçmim, dhe minimizim të veprës së tyre.

16 - Lloji i konservatorëve në të vjetrën (të kaluarën) sikur të ishin ata disa ngurtësira: “E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): Pranoni atë që Allahu e shpalli! Ata thonë: Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë! Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar asgjë dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t’i pasonin)?!” (Bekare, 170).

17 - Lloji i shoqërisë së përçarë e cila nuk bashkohet në një mendim e as nuk i përmbahet ndonjë kontrate: “Sa herë që ata kanë dhënë ndonjë premtim, një grup prej tyre e shkelin atë!” (Bekare, 100).

18 - Lloji i atyre të cilët polemizojnë me të drejtë dhe pa të drejtë në atë që e dinë dhe atë që nuk e dinë. A nuk i ngushtohet gjoksi njeriut prej tyre kudo që t’i takojë?:

“Jo, ju jeni ata që polemizuat edhe për atë që e dinit (për Isain), e përse polemizoni për atë që s’keni kurrfarë dije (për Ibrahimin)?!” (Âli Imrân, 66), ose ajeti: “Ka disa prej njerëzve që bëjnë polemikë rreth çështjes së Allahut duke mos pasur kurrfarë dije, kurrfarë udhëzimi dhe kurrfarë libri të besueshëm. Ai që e shtrembëron qafën (në shenjë mendjemadhësie), e përpiqet t’i shmang njerëzit nga rruga e Allahut!” (Haxh, 8-9). Në përshkrimin e fundit Kur’ani ilustron pikturë konkrete që ta glorifikojë thelluesin në polemika i cili ngrefos qafën dhe “kacagjelohe!”

19 - Lloji i atyre të cilët zhagiten (tërhiqen) nga angazhimi (dhënia) dhe flijimi në çastet kyç e të ngushta. Nëse ata që përpiqen i godet ndonjë dëm, këta falënderohen në vete për largpamësinë dhe mendjemprehtësinë e tyre, e nëse i godet e mira (realizohet fitorja) si rezultat i xhihadit të tyre, këta të tjerët pendohen dhe lakmojnë sikur të ishin angazhuar edhe ata:

“Ka prej jush që zvarriten (nuk dalin në luftë). E nëse ju godet juve ndonjë e papritur thonë: Zoti më furnizoi (mbivlerësoi) që nuk ishim të pranishëm bashkë me ta. Po nëse ju gjenë juve ndonjë e mirë nga Allahu, ai (munafiku) mesiguri do të thoshte - sikur të mos kishte ekzistuar mes jush dhe mes tij ndonjë njoftësi - për fat, të kisha qenë së bashku me ta e të kisha arritur një fitim të madh.” (Nisaë, 72-73).

20 - Lloji i një grupi njerëzish ku brendia e tyre ndryshon nga pamja e tyre e jashtme, saqë duken sikur të jenë dy persona të vendosur në një person: “Ka nga njerëzit fjala e të cilëve për jetën në këtë botë të mahnit dhe bëjnë dëshmi Allahun për atë (të mirën) që kanë në zemër, por ata në të vërtetë janë kundërshtarët më të rreptë”. “E posa të largohen, ata në tokë angazhohen të bëjnë shkatërtime në te, t’i shkatërrojnë të mbjellat dhe gjallesat, e Allahu nuk e do çrregullimin (fesatin).” (Bekare, 204-205).

21 - Lloji i atyre që nuk e njohin Zotin e tyre pos në çastin e vdekjes dhe pendohen: “Nuk është pendimi (i pranueshëm) për ata që vazhdimisht bëjnë punë të këqija dhe vetëm atëherë kur t’i vie vdekja ndonjërit prej tyre thotë: Unë tash u pendova!” (Nisaë, 18).

22 - Lloji i të marrëve të konservuar të cilët dëgjojnë por sikur të mos kishin dëgjuar: “Prej tyre ka të tillë që vijnë të të dëgjojnë ty, por kur largohen prej teje, u drejtohen atyre që kanë dije e u thonë: Çka tha ai (Muhammedi) më parë?!” (Muhammed, 16).

Megjithatë, tek njerëzimi ka edhe të mirë dhe mirësi. Kur’ani nuk i injoron llojet e të mirëve, guximtarëve, të ndershëmve, durimtarëve dhe të angazhuarve.

23 - Prej tyre kemi: “Ata (shokët e Pejgamberit) që njerëzit u thanë: Njerëzit (idhujtarët) janë tubuar që t’ju sulmojnë, pra kini

frikë prej tyre! Ajo vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: Neve na mjafton që e kemi Allahun, Ai është mbrojtësi më i mirë.” (Âli Imrân, 173).

24 - Pastaj kemi: “Të varfërit që janë angazhuar në rrugë të Allahut dhe nuk kanë mundësi të udhëtojnë nëpër tokë (për të fituar). Meqë ata nuk lypin, ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur. Ata i njeh nga vetë pamja e tyre (të rraskapitur), por nuk kërkojnë e as nuk i bezdisin njerëzit.” (Bekare, 273).

25 - Prej tyre gjithashtu ka: “Besimtarë të vërtetë, të cilëve kur përmendet Allahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre.” (Enfâl, 2).

26 - “Dhe robërit e Zotit të cilët ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: Paqe!” (Furkân, 63).

27 - Dhe ata që: “Për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, bonjakëve dhe të zënëve rob. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim.” (Insân, 8-9).

28 - Dhe lloji i “Durimtarëve të cilët kur i godet ndonjë gjë e pakëndshme thonë: Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehem!” (Bekare, 156).

29 - Dhe ata të cilët: “I duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepet atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të.” (Hashr, 9).

30 - Dhe lloji i atyre: “Që e frenojnë mllëfin, që ua falin (të keqen) njerëzve.” (Âli Imrân, 134). Shembujt e tyre janë të shumtë në shoqëri.

Këto janë disa lloje të njerëzve të cilat i konfirmuan në këtë mënyrë, pra të shpërndara e jo të renditura, ashtu të shpërndara në grumbullin e shoqërisë së çdo kohe dhe çdo vendi. Shprehja kur'anore ato i ilustroi qartë dhe në mënyrë të përshkrueshme. Ato syrit të këtij njerëzimi të përngjashëm mes vete nuk i shpëtojnë gjatë të gjitha kohëve.

Logjika intuitive

Islami si fe u ballafaqua me përgënjeshtime ashtu siç u ballafaqua çdo mision dhe polemizoi për misionin e tij me të gjithë ata që u futën për ta polemizuar ate. Meqë Kur'ani është libër i këtij misioni, ai përmban shumë polemika. A thua si i polemizoi ata? Cilat metoda i përdori dhe cilat argumente i zgjodhi?

Para se t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve duhet që ta vrojtojmë qëllimin parësor për të cilin zbriti Kur'ani.

Kur'ani u zbrit që të themelojë një besim solid (të qëndrueshëm) - besimin e njëshmërisë (monoteizmit) - në mesin e një populli që Allahut i shoqëronte zota të tjerë. Çudia më tronditëse për ta do të ishte sikur dikush t'u thoshte: Allahu është Një: “A mendon ai t'i bëjë zotat një Zot? Vërtet, kjo është një gjë shumë e çuditshme! Paria vazhdoi duke i thënë njëri-tjetrit: Vazhdoni të jeni të qëndrueshëm në adhurimin e zotave tuaj, sepse kjo është një gjë e kurdisur”. “Nuk keni dëgjuar diçka të këtillë në popullin (fenë) e fundit, kjo nuk është tjetër pos një trillim!” (Sâd, 5-7).

Ne sot këtë çështje e vështrojmë me një sy tjetër. Sot qeshemi me këtë primitivizëm fëmijëror të kësaj thënije. Megjithatë doemos duhet të shikojmë në këtë çështje sipas pozitës së asokohshme kur Tevhidi (njëshmëria, monoteizmi) u prit me gjithë atë çudi në atë kohë.

Kjo nuk do të thotë se me të gjithë ata që u ballafaqua Kur'ani, ishin arabë primitivë e politeistë. Në mesin e tyre kishte edhe ithtarë të librave (hebrenj e të krishterë) të cilët nuk dëshironin të paraqitet një fe e re dhe t'ua zhdukë rrënjët fesë së tyre, t'i zbresë

një njeriu që nuk ishte nga mesi i tyre edhe po qe se kjo fe do të ishte unike me fenë e tyre në bazë. “E që para se t’u vinte (Muhammedi), e kërkonin ndihmën e tij kundër mosbesimtarëve”. (Bekare, 89)

Ne doemos duhet ta dimë gjithashtu se ky unitet ka qenë në bazat e fesë e jo në besimet e ithtarëve të çdonjërës së asaj kohe. Ja, ata, hebrenjtë thonin: “Uzejri është djali i Allahut”, ndërsa të krishterët thonin: “Mesihu është djali i Allahut.” (Tevbe, 30). Pastaj të dy palët thonin: “Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij.” (Mâide, 18), ose thonin: “Neve nuk do të na djeg zjarri vetëm për pak ditë të numëruara.” (Âli Imrân, 24), ashtu siç tregon Kur’ani për ta në të gjitha rastet.

Pra, në krahasim me të dy palët, në mënyrë të barabartë, në fakt, detyra e Islamit ishte themelimi i një besimi të ri që sipas kësaj apo asaj, detyra parësore e Kur’anit do të ishte themelimi i kësaj akideje të qëndrueshme, akidesë së Tevhidit (besimit të njëshmërisë) në këtë program të ri.

Themi, një besim solid - edhe pse neve sot na duket çështje e padiskutueshme dhe e garantuar, - nuk ka qenë lehtë për këtë njerëzi e cila që nga lindja e saj u ndesh me të gjitha fuqitë në këtë nënqiell, me të gjitha rrethet e panjohura të cilat ia veshën jetës së tyre mijëra dukuri mbinatyrore, mijëra efekte spirituale, që të zhveshet përkaj vendosjes së të gjitha këtyre fenomeneve thellë në ndërgjegjen e tyre e të nxitojë drejt besimit në një Zot dhe t’i mbizotërojnë të gjitha këto fuqi.

E vërteta është se Islami nuk ishte feja e parë e cila thirrte në monoteizëm, por që të gjitha fetë hasën në të njëjtën rezistencë për shkak të thirrjes në Tevhid siç hasi edhe Islami. Meqë Tevhidi në të cilin ftonte Islami ishte Tevhid plotësisht i pastër, i zhveshur nga

gjithçka jashtë tij, i ndijshëm më tepër se çdo tevhid para tij, andaj edhe ishte shumë më radikal se të gjitha fetë tjera tevhidore dhe më kundërshtues ndaj gjithë asaj që zuri vend në mendjen e njerëzve siç është rasti me trupëzimin dhe ngjashmërinë (e Zotit me krijesat).

Atëherë pra, detyrë e Kur'anit ishte ta konstituojë këtë besim të veçantë e të pastër, e vendqëndrim i përhershëm i kësaj akideje (besimi) është ndërgjegjja dhe intuita - vendqëndrim i çdo besimi e jo vetëm i atij fetar. Rruga më e afërt deri te ndërgjegjja është instinkti, kurse rruga më afër intuitës është sensi, që në këtë hapësirë logjika nuk është asgjë pos një dritare prej shumë dritareve, e cila për çdo rast nuk don të thotë se është dritarja më e gjerë, më e qëndrueshmja e as më e afërta për ta arritur synimin.

Disa njerëz ia rritën vlerën logjikës sot, meqë njerëzit u mahnitën me ndikimin e logjikës si në teknologji, industri dhe zbulimet shkencore. E disa fetarë të thjeshtë e naivë i fascinojnë këto shpikje dhe u besojnë atyre. Ata përpiqen që ta konsolidojnë fenë duke i aprovuar mendimet e tyre të mbështetura në logjikë apo në eksperimentet shkencore!

Ata njerëz, sipas bindjes sime, logjikën e ngrenë në ato hapësira që janë mbi hapësirat e saj të pranueshme. Logjika njerëzore është krijuar që të padishmes (xhahilijetit) t'i japë hisen e vet dhe t'i bëjë një llogari që gjithmonë të mos thërret në atë konkluzë thjesht vetëm si shenjtëri fetare, por thërret në zgjerimin e hapësirave shpirtërore dhe i hap dritaret e diturisë. “E logjikshmja” në botën e mendimit dhe “konkretja” në eksperimentet e shkencës, nuk janë e tërë “gnostika-njohuria” në botën e individit. Logjika njerëzore, ku nuk kemi për qëllim vetëm kujtesën, nuk është asgjë tjetër pos një frëngji prej frëngjive të shumta të individit. Njeriu nuk do t'i mbyllte këto dritarëza vetëm

atëherë kur në shpirtin e tij ndien ngushtësi, kur në potencialet e tij ekziston bllokim që me to nuk lejohet të gjykojë për këto çështje të mëdha. Ta lëmë mendjen që t'i krijojë çështjet e jetës së përditshme praktike ose t'i shtjellojë çështjet që janë kyç në këtë jetë, ndërsa akideja (besimi) është në shtresën më të lartë të jetës. Atë nuk mund ta arrijë kush pos ai i cili ndjek rrugën e padiskutueshmërisë (aksiomatizmit) dhe udhëzohet sipas udhëzimeve të syrit të zemrës, ia hap ndjenjën dhe zemrën që ta pranojë kumbimin dhe ndriçimin (hyjnor).

Numri më i madh i besimtarëve të çdo feje dhe besimi në këtë botë kanë besuar, dhe ende besojnë, me dorëzim total dhe me sytë e zemrës. Dijetarët e apologetikës islame shekuj të tërë kanë kaluar duke zbuluar e përsëritur diskutime mendore rreth çështjeve të 'Tevhidit, megjithatë nuk arritën asgjë prej asaj që e arriti dialektika kur'anore vetëm për disa vjet. Le ta shikojmë tani këtë intelekt aksiomatik dhe lehtë të pranueshëm.

Kur'ani gjithmonë ka tentuar ta ngacmojë aksiomën, ta zgjojë ndjenjën, që prej tyre të përcillet drejtpërdrejt në syrin e zemrës e pastaj të kalojë në intuitë. Lëndë e tij kanë qenë dëshmitë shqisore, ngjarjet konkrete, dëshmitë analitike dhe lëvizjet e ilustruara. Gjithashtu lëndë e tij kanë qenë edhe të vërtetat e përhershme aksiomatike të cilave u përgjigjet syri i zemrës së ndriçuar dhe i kupton natyrshmëria e padevijuar.

Ndërsa, sa i përket metodës së Kur'anit, ai përdor metodën e përgjithshme: metodën e ilustrimit dhe analizimit me anë të përfytyrimit dhe trupëzimit, sipas asaj që e shtjelluam në të gjithë kapitujt e mëparshëm. (Ne natyrisht, këtu termin "trupëzim" e përdorim sipas kuptimit të tij artistik e jo sipas kuptimit fetar, ngase Islami është fe e zhveshjes (nga çdo trupëzim) dhe mënjanimit të "njëshmërisë" nga çdo veti njerëzore).

Kjo pra ishte dialektika intuitive me të cilën edhe debatoi Kur'ani dhe avancoi, e më në fund edhe betejën e fitoi.

Në këtë dialektikë u inkuadruan fjalët shprehëse, shprehjet ilustruese, ilustrimet e personifikueshme, skenat artikulluese dhe rrëfimet e shumta për të cilat kemi diskutuar deri tash. E gjithë ajo që është ekspozuar prej skenave të kijametit dhe pamjeve të lumturisë e ndëshkimit, rangohet në shkallën e kësaj dialektike e cila ngacmon ndjenjën, zgjon imagjinatën, që pastaj ta ngacmojë syrin e zemrës, ta zgjojë intuitën e që ta përgatisë individin për pranim dhe dorëzim.

Madje Kur'ani ndoqi metoda, jo të pikturave shpirtërore dhe emocionale, jo të rrëfimeve të shumta, jo të skenave të kijametit, jo edhe të pamjeve të lumturisë dhe mjerimit..., ai ndoqi metodë krejtësisht tjetër, metodën e debatit ilustrues në dialektikën intuitive për të cilën edhe e ndamë këtë kapitull të ri.

Është krejtësisht e natyrshme se ajo që na intereson në këtë punim, nuk është vetë metoda e debatimit, por metoda e të shprehurit me te. Metoda ilustruese të cilën e ndjek është ajo që e bën element prej elementeve të punimit tonë, sepse aspekti artistik si i mëvetësishëm është temë jona e vetme në këtë libër.

Problemi kryesor me të cilin u ballafaqua Islami, siç thamë edhe më parë, ishte problemi i Tevhidit me një kolektivitet i cili e mohonte këtë Tevhid në mënyrën më të paskrupullt dhe e konsideronte si një prej çudirave më të mëdha.

Të shohim tani se si Kur'ani u përgjigjej me fakte për këtë çështje të ndërlikuar.

Ai, Kur'ani këtë çështje e shtjelloi në mënyrë të lehtë dhe të rëndomtë duke iu drejtuar aksiomës dhe intuitës pa ndonjë komplikim gjuhësor apo polemikë mendore:

“A mos morën ata zota prej toke që mund t’i ringjallin (të vdekurit)? Sikur të kishte në to (në qiëj e në tokë) zota pos Allahut, ato të dyja do të shkatërroheshin. Larg asaj që i përshkruajnë është Allahu, Zoti i arshit. Ai nuk pyetet se çka punon, por ata (njerëzit) pyeten. A përvetësuan ata zota të tjerë pos Tij! Thuaj: Sillne argumentin tuaj? Ky është (Kur’ani) argument për këta që tani janë me mua dhe për ata që ishin para meje, por shumica e tyre nuk e dinë të vërtetën, andaj edhe nuk vështrojnë.” (Enbija, 21-24). Pastaj ajeti: “Allahu nuk ka marrë për vete kurrfarë fëmijë (as nga engjëjt as nga njerëzit), nuk ka me Te asnjë zot tjetër, sepse (sikur të kishte zot tjetër), atëherë secili zot do të veçohej me atë që e ka krijuar dhe do të dominonin njëri mbi tjetrin.” (Mu'minûn, 91).

Kështu pra me këtë aksiomë të zakonshme e cila në qiell dhe në tokë nuk shihet parregullsi por shihet sistem të përpiktë, jep të kuptojmë se Projektuesi është Një, i fuqishëm, i dijshtëm dhe i urtë.

Pastaj ja kjo pamje të cilën e imagjinojmë - sikur të kishte shumë zota - “atëherë secili zot do të veçohej me atë që e ka krijuar”. Kjo vërtet është pamje qesharake, që çdo grup krijesash ta konsiderojë ndonjërin prej tyre zot, e pastaj çdo zot t’i marrë kri-jesat e tij e të shkojë..., po ku të shkojë? - Nuk e dimë! Megjithatë ne e imagjinojmë këtë pikturë dhe qeshemi nga ideja e shumësisë së zotave nëse ky është rezultat i saj!

E pastaj çdo të bëjnë ata, zotat tjerë? - Kjo është tokë ai është qiell, cilin do ta avancojnë, këtë apo atë?!!

“Thuaj: Më thuani për ata që pos Allahut i adhuron, më tregoni se çka krijuan ata në tokë dhe a kanë pjesëmarrje (në krijimin) e qiejve? Nëse e thoni të vërtetën, më sillni ndonjë libër para këtij ose ndonjë gjurmë të mbetur prej diturisë”. (Ahkâf, 4)

Këto janë pikturat e krijimit dhe fenomenet e fuqisë të cilat shqisat i shohin, aksiomat i arrijnë dhe sytë e zemrave i përjetojnë: “Thuaj: (O I dërguar): Falënderimi i qoftë Allahut, e shpëtimi qoftë ndaj robërve të Tij që Ai i zgjodhi (pejgamberët)! A më i mirë (për ta besuar) është Allahu, apo ata që ia bëjnë shok? Ai që krijoi qiejt e tokën, që për ju lëshoi shiun nga qielli, e Ne me të bëmë të lulëzojnë kopshte të bukura, e për ju ka qenë e pamundshme t’i bëni të mbijnë bimët në to; A mos ka ndonjë zot tjetër pos Allahut? Jo, por shumica e tyre nuk dinë! A është Ai që i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur ai e thërret, duke ia larguar të keqen e juve ju bën mbizotërues të tokës. A ka zot tjetër pos Allahut? Jo, por ju shumë pak përkujtoni. Ai që ju orienton në errësirat e tokës e të detit, dhe Ai që pranë mëshirës së tij (shiut) si myzhde i lëshon erërat. Vallë, a ka tjetër zot pos Allahut? E lartë është madhëria e Tij nga ajo që ata i përshkruajnë shok. Ai që e fillon krijimin (e njeriut) e pastaj e përsërit atë (e ringjall pas vdekjes) dhe Ai që ju furnizon nga qielli e toka. A mos ka zot tjetër pos Allahut? Thuaj: Sillni argumentet tuaja, nëse jeni të sinqertë!” (Neml, 59-64).

Kështu pra, dynden (marrin pjesë) skenat e tokës dhe të qiellit me të gjitha evoluimet që u ndodhin çdo ditë dhe me të gjitha ndjenjat natyrore të cilat njeriun në raste të vështirësive specifike e strukin në Fuqinë Absolute... Ato marrin pjesë kur i referojnë ndjenjës dhe imagjinatës, kur e ngacmojnë syrin e zemrës dhe intuitën që t’ua përqëndrojnë fortë akidenë e Tevhidit (besimin e njëshmërisë) në shpirtrat e tyre. Shembuj të tillë ka shumë në Kur’an, që përsëriten (duke qenë të llojllojshëm). Ata përsërisin

pamjen e kijametit, skenat e lumturisë dhe mjerimit (begatisë dhe ndëshkimit). Që të gjitha këto janë dialektikë (logjikë) intuitive që bën pjesë në këtë lëmi.

Problemi i dytë ishte problemi i ringjalljes dhe ditës së ahiretit me një grup njerëzish të cilët thonin:

“Nuk ka tjetër, pos jetës sonë të kësaj bote, vdesim, lindim dhe nuk do të ngjallemi!” (Mu’minûn, 37). Ky grup çështjen e ringjalljes e sheh shumë më të jashtëzakonshme (të çuditshme) sesa që e sheh çështjen e njëshmërisë së Allahut. Ata, njerëzit të cilët e thanë këtë fjalë, i konsiderojnë si të marrë! Këtë nuk mund ta thotë kush, vetëm të marrët!

“Dhe ata që nuk besuan thanë: A doni t’ju tregojmë për një njeri që do t’ju informojë juve se si, pasi që (të vdisni) e të jeni shkapërderdhur plotësisht, ju do të krijoheni rishtazi? A është duke shpifur gënjeshtër ndaj Allahut, apo e ka zënë çmendia?” (Sebeë, 7-8). Deri në këtë masë të injorimit e kanë marrë çështjen e ringjalljes. A thua si polemizoi me ta në këtë çështje të çuditshme?!

Kur’ani ua paraqiti pamjet e dukshme të krijimit dhe të fshehtat, ua thjeshtëzoi zanafillën e jetës në tokë përgjithësisht kurse të njeriut veçanërisht, që të shohin se Ai i cili e pikënisoi krijimin ka mundësi edhe ta përsërisë.

“A mos u lodhëm Ne me krijimin e parë? Jo, por ata janë në hutë rreth një krijimi të ri.” (Huxhurât, 15).

Me metodën e njohur ilustruese Kur’ani mori që t’ua shtrojë skenat e jetës në tokë dhe në njeriun:

“Qoftë mallkuar njeriu, sa mohues i fortë është ai! Po prej çkafi e krijoi Ai atë? Atë e krijoi prej një pike uji dhe e përgatiti. Pastaj atij ia lehtësoi rrugën. Mandej ate e bëri të vdesë dhe i bëri varr (të varroset). Pastaj kur të dojë Ai e ringjall atë. Jo! Ai nuk e zbatoi atë që e urdhëroi Ai. Njeriu le ta shikojë ushqimin e vet. Ne lëshuam shi të mjaftueshëm. Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës. Dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra. Edhe rrush e perime; edhe ullinj e hurma; edhe kopshte të den-dura; edhe pemë e kullosa. Si mjete gjallërimi për ju dhe për bagëtinë tuaj.” (Abese, 17-32).

“Nga faktet (e fuqisë) e Tij është edhe ajo, se Ai ju krijoi: prej dheu, e mandej ju (u zhvilluat) në njerëz që veproni të shpërndarë. Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë) ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe ndërmjet jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë. Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz. Nga argumentet e Tij është edhe gjumi juaj natën, edhe përpjekja juaj për të fituar nga të mirat e Tij. Në këtë ka argumente për popullin që dëgjon. Nga argumentet e Tij është edhe ajo që ua dëfton vetëtimën edhe si frikë edhe si shpresë, dhe nga qielli lëshon shiun e me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj. Në këtë ka argumente për një popull që di të mendojë.” (Rrûm, 20-24).

Kështu pra, çdoherë atyre u parashtrohen skena të zakonshme, ose që janë të njohura. Ato shqisat i vëzhgojnë në çdo çast, aksiomat e tyre i ngulmojnë në çdo shikim të cilat në mënyrë direkte janë të lidhura me jetën dhe gjallërinë e tyre. Ato ngacmojnë ndjenjat dhe intuitën e tyre, futen ngadalë në shpirttrat e tyre. Kur’ani i orienton nga këto skena duke ua ekspozuar sikur të ishin skena të reja (në realitet skenat e natyrës gjithmonë janë të

reja për atë i cili i shikon me ndjenjë të fortë dhe sy vrojtues), pa mos rezultuar kjo polemikë mendore e cila më shumë mbështetet në shkathhtësi se sa në vetë realitetin.

Kur'ani hapëron dhe i kapërcen të gjitha sferat e mendjes dhe të gjitha sferat e shqisave që të lidhet drejtpërdrejt me misteriozitetin e akidesë (besimit). Me këtë rast, qenia e tij lidhet direkt me të panjohurën. Ai gjen në misteriozitetin dhe largësinë e tij nga ndjenja dhe mendja një kënaqësi dhe dëfrim të përbashkët. Megjithatë Kur'ani edhe në këtë rast zgjedh metodën e ilustrimit dhe përfytyrimit:

“A nuk e di për Allahun se Atij i lutet kush është në qiej e në tokë madje edhe shpezët krahëhapura. Të gjithë e dinë dhe janë të udhëzuar për lutjen ndaj Tij dhe për madhërimin ndaj Tij.” (Nûr, 41).

“Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiej e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e adhuron (nuk i bën tesbih) duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre (pse nuk është në gjuhën tuaj). Ai është i butë dhe falë shumë.” (Israë, 44).

“Ndërsa ata (engjëjt) që e mbajnë Arshin dhe ata që janë përreth tij, e lartësojnë me falënderim Zotin e tyre, i besojnë Atij dhe i luten Atij t'i falë ata që besuan (duke thënë): “Zoti ynë, Ti me mëshirën dhe diturinë Tënde ke përfshirë çdo send, andaj fali ata që u penduan dhe ndoqën rrugën tënde, dhe ruaji ata nga dënimi i xhehennemit! Zoti ynë, futi në xhenetet e Adnit ata të cilëve u ke premtuar, ata dhe kush ishte i mirë, prej etërve të tyre, grave të tyre dhe pasardhësve të tyre. Vërtet, Ti je ngadhënjyesi, i urti! Dhe i mbron ata prej të këqijave, pse atë që Ti e mbron atë ditë prej të

këqijave, Ti e ke mëshiruar, e ai është shpëtim i madh.” (Gâfir, 7-9).

Kështu pra ndikon ilustrimi në shpirt, me atë trishtim që e ndien para të panjohurës dhe me atë kënaqësi që e ndien kur shpirti bredh në atë botë misterioze, atje ku: Engjëjt që e mbajnë Arshin dhe ata që janë përreth tij e lartësojnë me falënderim Zotin e tyre... dhe i luten Atij t'i falë ata, dhe atje ku: Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to.

Ndonjëherë gajbi (sekreti) nuk është kështu larg, ai mund të jetë konkret (i prekshëm), por ai në realitet është i panjohur. Ai gjithashtu ngacmon intuitën, vërteton fuqinë e gjithësisë dhe e pasuron shpirtin me iman:

“S’ka dyshim se Allahut nuk mund t’i fshehet asgjë në tokë e as në qiell. Ai është që ju krijon (formon) formën juve në mitra ashtu si të dojë.” (Al Imrân 5-6).

Ky është fakt për diturinë e cila përshkon çdo misteriozitet, dhe çdo fakt intuitiv praktik të cilin mendja nuk mund ta kuptojë dhe ta ndriçojë.

Tani do të sjellim një shembull të ngjashëm me të por me një hapësirë më të gjerë dhe me një ilustrim më fascinaues.

“Çelësat e fshehtësisë janë vetëm te Ai, ate (fshehtësinë) nuk e di kush pos Atij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det. Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s’ka kokërr në thellësi të tokës, s’ka të njomë dhe s’ka të thatë që nuk është (shënuar) në librin e qartë (Lehvi Mahfûdh)”: (Enâm 59).

Në këto pak fjalë, kemi shprehje të fortë e hutuese për gjithëpërfshirjen e dijes së Zotit. Për ta shprehur e vërë në spikamë këtë dije, janë zgjedhur fjalët më të bukura shprehëse dhe shprehjet ilustruese. Nuk mund të thuhet se është shprehje e thjeshtë për domethënien e diturisë së përpiktë dhe të përfshirë, se nëse thuhet: Ai di për çdo gjeth që bie e për çdo kokërr në thellësi të tokës, për çdo të njomë e çdo të thatë. Kjo në të vërtetë është pikturë e çuditshme imagjinative. Në këtë rast imagjinata sillet nëpër të gjitha hapësirat e dunjasë edhe ato të panjohurat që t'i përcjell ato gjethe të rëna dhe ato kokrra të fshehura që bëjnë pjesë në gjërat misterioze ku fshehja e tyre është në dije të Allahut. Pastaj i kthehet shpirtit dhe e përmbush përplot madhëri të Allahut dhe përlulshmëri ndaj Tij: Me to Kur'ani shpirtin e orienton nga Allahu i cili i përshkon me diturinë e Tij të gjitha këto mistere dhe hapësira.

Kjo është pra logjika intuitive dhe polemika ilustruese. Po ku është pra në të ajo polemikë mendore për të cilën dijetarët e apologjetikës (Ilmul-Kelâm) mbetën duke e filluar e përsëritur disa shekuj me radhë. Ne do të sjellim këtu vetëm një shembull të polemikës mendore nga e cila u distancua Kur'ani kur tha:

“Ju dhe ajo që e adhuruat ju pos Allahut do të jeni lëndë e xhehennemit dhe keni për të hyrë në te.” (Enbija, 98).

I atillë është ky ajet, por, të tilla janë edhe të gjitha ajetet e ngjashme me të në kuptim.

Kur'ani i përshkruan idhujtarët arabë duke kërkuar hapësirë për të bërë polemikë mendore dhe nënçmuese, duke menduar se me te do ta ngushtojnë Muhammedin dhe ithtarët e librave. Ata thanë: E si është puna e Isaut, të birit të Merjemesë? Ata janë një

grup prej popullit të tij që janë duke e hyjnizuar Isaun. A hyjnë edhe ata në xhehennem?

E Kur'ani u dha përgjigje të urtë kur tha: “Ata nuk ta thanë atë vetëm si polemikë, por ata janë njerëz ngatërrestarë.” (Zuhruf, 58). Këtë që e thonë idhujtarët është shembull i logjikës (dialektikës) mendore. Vërtet, Ai është i arsyeshëm nga aspekti i rregullave të logjikës formale, por ku rangohet sipas logjikës së shëndoshë dhe sipas të vërtetës së natyrshme e të rëndomtë?

Nuk do të arrinte të bëjë gjë logjika mendore sikur Kur'ani ta trasonte, jo pse në te nuk ka të vërteta që mund të argumentohen sipas kësaj logjike por sepse akidenë nuk mund ta formojë kjo polemikë. Ajo gjithmonë është në hapësira më të larta se sa këto hapësira. Akidenë (besimin) aspak nuk do ta nënçmonte sikur aktiviteti i mendjes në saje të saj të jetë i kufizuar. Në të vërtetë, mendja nuk është asgjë pos një fuqi e vogël dhe e kufizuar e cila lidhet për përditshmëritë ku ajo përsëri nuk është faktor i ndryshimeve në përditshmëri.

Kur'ani e ngacmoi intuitën dhe e trasoi në të metodën e ilustrimit. Ai e arriti qëllimin me anë të lëndës dhe metodës së tij, e bashkoi (unifikoi) qëllimin fetar dhe atë artistik me anë të metodës më të afërt dhe më të lartë.

Metodologjia e Kur'anit

Ne mund të sjellim një përfundim nga të gjitha temat e mëparshme se Kur'ani ka metodologji unike në të shprehurit të cilën e përdor për t'i realizuar të gjitha qëllimet në mënyrë të barabartë, madje edhe qëllimet e argumentimit dhe të polemikës. Kjo pra është metodologji e ilustrimit analitik përmes përfytyrimit dhe trupëzimit.

Le të shikojmë tani strukturën e kësaj metodologjie nga aspekti artistik i saj, ngase ajo është njëra prej metodave realizuese (kjo pra është lëmia e studimit tonë në këtë libër). Qëllimet fetare për të cilat u zbrit Kur'ani që t'i realizojë ato, temat hyjnore dhe ligdhënëse të cilat i shtjellojnë të gjitha këto, janë lëmi të cilat nuk janë temë studimi këtu. Nëse disa prej tyre erdhën të ekspozuara në brendinë e kapitujve të kaluar, ato erdhën vetëm të shohim se si i shtjelloi Kur'ani dhe çfarë metode aplikoi për t'i shprehur ato.

Disa njerëz kur i analizojnë këto tema dhe kuptojnë se sa ato janë të përpikta, fascinuese, relevante, elastike, përshkuese dhe gjithëpërfshirëse, i trajtojnë si veçori më të mëdha të Kur'anit. Ata mendojnë se metodologjia e shprehjes kur'anore bën pjesë në të dhe se e tërë mrekullia kur'anore është strukur në të. Disa të tjerë bëjnë dallimin mes domethënies dhe mënyrës së realizimit (interpretimit), ata flasin kur është në pyetje mrekullia kur'anore e në veçanti për çdonjërin prej tyre.

E ne mund ta bëjmë këtë shtojcë e të themi: Metodologjia të cilën e trasoi Kur'ani në të shprehur është ajo e cila i ndriçoi këto qëllime dhe këto tema. Andaj edhe ajo mjafton për këto qëllime dhe këto tema.

Kjo nuk mund të na shpie në ato tema shterpe rreth fjalës dhe domethënies së saj. Këto tema u shkoqitën nga kritikët arabë që kur Xhahidhi iu rrek kësaj teme dhe supozoi se domethëniet përfaqësojnë thelbin e metodologjisë. Atë e pasoi Ibni Kutejbe, Kudame, Ebu Hilal El Askeri e të tjerë në të njëjtën vijë të temës, disa duke e përkrahur e disa duke e kundërshtuar. Ne llogarisim se Abdulkahiri arriti në një mendim të prerë e të shëndoshë kur në librin e tij Delailul Ixhaz erdhi në përfundim se vetëm fjalën në vete nuk mund ta paramendojë i mençuri që rreth saj të zhvillohet studimi vetëm nga aspekti i saj si fjalë, por se studimi zhvillohet nga aspekti i synimit të saj. Gjithashtu nuk mund të paramendojë i mençuri se vetëm domethënia në vete meriton të zhvillohet studimi rreth saj, ngase ajo shpreh atë që është në brendi të fjalës, por nga aspekti se ajo është përfaqësuese në fjalë dhe se domethënia përcaktohet sipas përkufizimit të saj në kontekstin e fjalisë ku vepron. Andaj, edhe nuk mund të jenë të ndryshme dy struktura fjalish e që pastaj të unjësohet domethënia në mënyrë të plotë.

Abdulkahiri këtë çështje nuk e shtjelloi me këtë shtjellim të shkurtë por ai për të shkroi një libër të cilin ne nuk mundemi ta përcjellim këtu e as nuk mund të bëjmë përcjelljen e disa pasuseve të tij, siç i transmetuam në fillim të këtij libri me atë stil të ndërlikuar të cilin e hasëm atje. Ne do t'i përcjellim vetëm domethëniet shkurtimisht. Atij vërtet i takojnë meritat për shtjellimin e kësaj çështjeje. Sikur të sillte një definicion për ta shprehur në mënyrë të prerë atë, do ta arrinte piedestalin në kritikën artistike. Ne do të shpreheshim në vend të tij kështu: Pa dyshim metodologjia e realizimit (interpretimit) është vendimtare në ilustrimin e domethë-nies dhe kudo që dy metoda ndryshojnë njëra prej tjetrës në të shprehurit e një domethënieje, do të ndryshojnë edhe pamjet e kësaj domethënieje në shpirt dhe mendje. Në këtë mënyrë lidhen domethëniet dhe mënyrat e

realizimit me një lidhje që nuk ka nevojë më të diskutohet rreth të tjerave dhe domethëniesve të tyre për çdonjërin në veçanti. Një domethënie nuk mund të shfaqet pos në një figurë të vetme. E kur të ndryshojë figura, ndryshon edhe domethënia sipas masës së saj. Ndoshta kuptimi mendor i përgjithshëm nuk ndikon në qenien e fjalës mirëpo figura në shpirt dhe mendje ndryshon. Ajo ashtu edhe është e rregulluar në art - ngase shprehja në art ka funksion të ndikimit ashtu që kur të ndryshojë forma e ndikimit prej saj, domethënia e transferuar ndryshon pa dyshim!

Ne po përfundojmë me këtë sqarim dhe kalojmë në vlerën e metodologjisë ilustruese në Kur'an. Kjo metodologji është ajo e cila domethëniesve, qëllimeve dhe temave kur'anore ua dha këtë pamje të cilën e shohim. Përmes pamjes ajo arriti vlerën e saj të lartë ngase kjo metodologji në këto pamje është krejtësisht ndryshe nga çdo pamje tjetër siç e pamë edhe më herët.

Ne dëshirojmë që këtë çështje ta ndriçojmë përmes modeleve, edhe pse ato gjenden aty-këtu në brendi të librit, gjithashtu edhe sqarimi i tyre aq sa do të mjaftonte të dallohet veçoria e metodologjisë kur'anore në të. Megjithatë ne këtu jemi para ekspozimit të fundit të rezymuar e në anën tjetër kemi edhe mjaft modele që na shërbejnë për këtë temë.

Tipari i parë i shprehjes kur'anore është trasimi i metodës së ilustrimit të domethëniesve mendore, gjendjeve shpirtërore dhe shfaqja e tyre në pikturat konkrete, nxjerrja e metodës së ilustrimit të skenave natyrore, ngjarjeve të kaluara, rrëfimeve të treguara, shembujve të rrëfyer, skenave të kijametit, pamjeve të begatisë dhe ndëshkimit si dhe llojeve njerëzore. Thuhet se të gjitha ato të ishin të pranishme e të përshkrueshme me parafytyrimin sensibil të cilin e përmbush me lëvizje imagjinate.

Çka e mbivlerësoi këtë metodë mbi metodat tjera të cilat i transmetojnë domethëniet dhe gjendjet shpirtërore në figurën e tyre mendore dhe abstrakte dhe i transmetojnë ngjarjet dhe rrëfimet në lajme të shfaqura, gjithashtu i shprehin skenat dhe spektaklet në formë gjuhësore e jo si ilustrim imagjativ?

Për ta proklamuar këtë mbivlerësim mjafton që të ilustrohen të gjitha këto domethënie në figurë abstrakte dhe të ilustrohen më pastaj në formën tjetër ilustrative.

Vërtet, domethëniet në metodologjinë e parë i referohen mendjes dhe vetëdijes. Ato arrijnë në mendje dhe vetëdije të zhveshura nga hijet e tyre të bukura. Kur'ani në metodologjinë e vet të dytë i referohet sensit dhe intuitës, dhe arrin në shpirt përmes shumë dritareve: përmes shqisave me anë të imagjinatës, përmes ndjenjës me anë të shqisave, përmes intuitës aktive me anë të oshëtimit (ehos) dhe ndriçimeve. Kështu pra, mendja është vetëm një dritare prej dritareve të saj të shumta në shpirt e jo dritarja e saj e vetme.

Kjo metodologji, pa dyshim zotëron vlerën e interpretimit të da'ves në çdo besim. Megjithatë ne këtu e studiojmë vetëm në pikëpamje ekskluzivisht artistike. E ajo në këtë pikëpamje ka një rëndësi të madhe e të veçantë. Funksioni i parë i artit është t'i ngacmojë reflekset intuitive, ta përhapë oreksin artistik me anë të këtij ngacmimi, shpalosjen e jetës misterioze me anë të këtyre refleksioneve, ushqimin e imagjinatës me piktura që t'i realizojë të gjitha këto. Të gjitha këto i përmban metodologjia e ilustrimit dhe e përshkrimit në artin e bukur. Këtu do t'ua ekspozojmë disa shembuj jashtë atyre që i kemi ekspozuar më parë:

1 - Domethënia e ikjes së fortë (largimit të madh) nga thirrja në besim. Ajo na shfaqet në pamjen e saj abstrakte përmes ikjes së

tyre çuditëse nga thirrja në besim. Mendja në vetmi dëshiron ta kuptojë domethënien e ikjes kur është e qetë dhe e lirë.

Kur, ja, Kur'ani na e shfaqë këtë pikturë të çuditshme: “Po çka kishin ata që largoheshin prej këshillës (Kur'anit)? Ata ishin si gomarë të trembur (të egër) që ikin prej luanit (ose prej gjahtarit).” (El-Muddeththir, 49-51). Këtu mendjes i shoqërohet shqisa e shikimit, diapazoni i imagjinatës, refleksioni i talljes dhe ndjenja e bukurisë: Tallja nga ata të cilët ikin sikur kur ik gomari i egër nga luani, jo për asgjë vetëm pse ata thirren në besim. Bukuria e cila vizatohet në lëvizjet e pikturës është atëherë kur e përjeton (percepton) imagjinata brenda kornizave të natyrës kur dëbohen këta gomarë të egër duke i ndjekur luanët e tërbuar!

Shprehja këtu ka rreth saj hije e cila ia shton hapësirën-nëse lejohet të themi kështu.

2 - Domethënia e paaftësisë së zotave të cilët i adhurojnë idhujtarët përpos Allahut mund të interpretohet përmes disa shprehjeve mendore e abstrakte, sikur të thuhet: Vërtet, ata që adhuron pos Allahut janë më të dobët se krijimi i sendit më të thjeshtë. Këtu domethënia arrinë në mendje abstrakte dhe hutuese:

Megjithatë, shprehja ilustrative e pasqyron në këtë mënyrë:

“Vërtet, ata që po i adhuron në vend të Allahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të, e po ashtu, nëse miza ua rrëmben ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj. I dobët është edhe lutësi (kër-kuesi) edhe i luturi (i kërkuari)!” (Haxhxxh, 73).

Kështu e shfaq këtë domethënie dhe e ndriçon përmes këtyre figurave aktive dhe të njëpasnjëshme:

“Nuk mund të krijojnë asnjë mizë” kjo është shkalla e parë, “Edhe nëse tubohen të gjithë për të”, kjo është e dyta. “Nëse miza ua rrëmben ndonjë send, ata nuk mund ta shpëtojnë atë prej saj”, kjo është e treta... A nuk është e gjithë kjo ilustrim i dobësisë së ploghshtë dhe shkallëzimit i ilustrimit të tij me çka nxit në shpirt talljen therëse dhe nënçmimin ironik?!

Megjithatë, a nuk është kjo teprim? A thua stilistika e saj shkon në ekstremitet?

Kurrsesi! Kjo është e vërtetë reale dhe e rëndomtë.

Ata Zota! “Nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të”. Miza është e vogël dhe përçmuese, megjithatë mrekullia e krijimit të saj është e barabartë me mrekullinë e krijimit të deves dhe elefantit. Aty qëndron mrekullia e jetës në tërësi në të cilën marrin pjesë viganët dhe të imtit. Pra, mrekullia nuk qëndron në konstruksionin e saj (fjala është për krijimin e kolosëve prej gjallesave), por në një qenie të vogël si pluhuri.

Shpikja artistike në këtë rast qëndron në ekspozimin e këtij realiteti në një pikturë ku vijëzohen hijet e dobësisë në krijimin e sendit më të vogël. Kurse bukuria artistike në këtë rast qëndron në ato hije të cilat shtohen prej komponenteve të pikturës, prej lëvizjes imagjinuese të përpjekjes për krijim, në tubimin e gjithë masës për të, e pastaj edhe të përpjekjes për të fluturuar pas mizës për ta shpëtuar atë që e rrembeu, ku ata, por edhe pasardhësit e tyre, janë të paafte për ta bërë këtë shpëtim.

3 - Kur’ani interpreton rastin e largimit të miqve nga miqtë e tyre ditën kur do të dalin para tmerrit të kijametit me anë të kësaj shprehjeje abstrakte e distancuese. Këtu të sinqertit (në veprimin e

tyre të shëmtuar) injorohen mes vete, shokët grinden mes vete e më në fund pasuesit largohen nga të pasuarit kur dëshmuan tmerrin në ditën e fesë. Ky interpretim arrinë të bëhet prej më të përpiktëve të cilët shprehen. Prapëseprapë shtrohet pyetja: ku e ka vendin kjo shprehje mendore në këtë ekspozim përplot gjallëri.

“E të gjithë njerëzit (sheshazi) i paraqiten Allahut. Ata të dobët (masa e nënshtruar) u thonë parisë (udhëheqësve): “Ne ishim pasuesit tuaj andaj a mund të na lehtësoni diç nga dënimi i Allahut? Ata (paria) thonë: “Sikur të na kishte udhëzuar Allahu, ne do t’ju udhëzonim juve. Për ne tash është njësoj, u pikëlluam thellë ose duruam, për ne nuk ka ikje (shpëtim). E pasi të kryhet çështja (të hynë ata të xhennetit në te dhe të xhehennemit në te, xhehennemlinjve) djalli (u mban ligjëratën e shëmtuar dhe) u thotë: “Vërtet, Allahu ju pat premtuar premtim të vërtetë, e unë ju pata premtuar dhe, ja, nuk e zbatova premtimin ndaj jush. Po unë nuk pata kurrfarë pushteti ndaj jush (që t’ju detyroj), përpos që ju thirra (në rrugë të gabuar), e ju m’u përgjigjët: atëherë pra, mos më qortoni mua po qortone veten. Unë nuk mund t’ju shpëtoj juve, e as ju nuk mund të më shpëtoni mua. Unë mohoj shoqërimin tuaj që ma bëtë mua më parë (më adhuroat në vend të Zotit).” “S’ka dyshim, jobesimtarët kanë dënim të dhembshëm.” (Ibrâhîm, 21-22).

Të dobët janë ata të cilët u ishin nënshtruar të fortëve dhe të cilët ende janë të dobët, mendjelehtë dhe shpirtdorëzuar. Ata u strehuan në pushtetin e mendjemëdhejve në këtë botë, andaj edhe e kërkojnë shpëtimin prej tyre nga ky rast. Ata i qortojnë të dobët pse u mashtruan pas tyre në jetë duke u përmbajtur në këtë rast me natyrën e tyre të nënçmuar dhe dobësinë e tyre të njohur.

Ata të cilët u madhështuan, atyre u ra poshtë mendjemadhësia dhe u ballafaquan me fatin e tyre. Atyre ua ngushtojnë shpirtin

edhe më të dobët të cilëve nuk u mjafton ajo që e shohin prej poshtërimit dhe ndëshkimit. Prej tyre kërkojnë që t'i shpëtojnë atëherë kur ata nuk kanë në dorë as shpëtimin e vetvetes ose ua përkujtojnë krimin e mashtrimit të tyre atëherë kur nuk bën dobi përkujtimi. Ata nuk kanë çka t'u thonë në këtë mërzë e ngushtësi pos fjalëve: “Sikur të na kishte udhëzuar Allahu, ne do t’ju udhëzonim juve.”

Djalli, përkundër të gjitha tipareve të personalitetit të tij si mashtrues, tradhtues, nënçmues, mendjemadh, kurthbërës e djallëzor, pranon para ithtarëve të tij-por vetëm tash-se Allahu u ka premtuar premtim të vërtetë, dhe se ai (djalli) u premtoi por i tradhtoi pastaj i dhimbsen dhe i ngushëllon duke i tërhequr duart e tij prej udhëheqjes së tyre. “Po unë nuk pata kurrfarë pushteti ndaj jush (që t’ju detyroj) përpos që ju thirra (në rrugë të gabuar) e ju mu përgjigjët: Atëherë pra, mos më qortoni mua por qortone veten.” Jo, jo, madje ai edhe në këtë rast e tregon mendjemadhësinë e tij duke thënë “Unë e mohoj shoqërimin tuaj që ma bëtë mua më parë”.

Vërtet dhe pa dyshim ai është shejtani!

Kjo vërtet është një shpikje në ilustrimin e këtij rasti specifik, në të cilin largohet i pasuari nga pasuesit e vet dhe e mohon lidhshmërinë e pasuesit nga i pasuari ku asnjëri prej tyre nuk ka gjë në dorë për tërheqje apo bashkim, por kjo është natyrë e çdo grupi të cilit i zbulohen turpshmëritë para një tmerri të papërshtueshëm.

Në këtë rast shejtani është shumë logjik me veten dhe me figurën të cilën ia përshkruan Kur’ani: Përndryshe, ai nuk mund të jetë shejtani pa këto mashtrime, kreshpërimë dhe injorime!

Në këtë mënyrë në shpirt arrijnë të gjitha ato oshëtimat dhe ato hije prapa shprehjes së ilustruar e të përshkruar. A thua vallë ku e ka vendin shprehja mendore krahas këtij ilustrimi artistik?!

4 - Gjithashtu thuhet se punët e atyre që nuk besuan nuk mund të llogariten e të maten: Ata mashtrohen kur mendojnë se janë diçka, ata janë në humbje të përhershme, s'ka kush që mund t'i nxjerrë prej saj e as t'i udhëzojë diku tjetër. Kështu domethënia përçohet në mendje dhe pushon aty.

Megjithatë ajo gjallëron dhe lëviz, ajo trazon ndjenjën dhe imagjinatën kur realizohet në këtë formë ilustrative:

“E veprat e atyre që nuk besuan janë si valët (nga rrezet e diellit) në një rrafshinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t'i afrohet nuk gjen asgjë, por aty e gjen Allahun dhe Ai do t'ia japë llogarinë e tij. Allahu është i shpejtë në llogaritje.” (Nûr, 39). “Ose (veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë të cilin e mbulojnë valë mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën saqë nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit Allahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë.” (Nûr, 40).

Këtu kemi figura magjepsëse artistike. Në to është strukur shpirti i rrëfimit dhe në to gjendet imagjinata e fuqishme...Më pas, ato janë të nevojshme për një brushë shpikëse nëse dëshirohet ilustrimi i tyre me anë të ngjyrave, ose për një objektiv të përpiktë nëse dëshirohet ilustrimi i tyre me anë të lëvizjeve.

Madje, a thua ka brushë ose objektiv të cilët do të mund t'i ndriçojnë këto errësira: “Në det të thellë të cilin e mbulojnë valë mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën saqë nuk do ta shohë ai as dorën e vet?” Ose ilustrimi i të etshmit që vrapon pas valëve “derisa kur t'u afrohet atyre nuk gjen asgjë”.

Por aty do të hasë në një bafasi të çuditshme, - të cilit as që i ka shkuar mendja, - “aty e gjen Allahun” i cili me një shpejtësi rrëmbyese e merr “dhe ia jep llogarinë e vet”.

Nëse e cekëm qëllimin fetar për të cilin edhe u vizatua kjo pikturë, le ta cekim së bashku me të edhe senzacionin mahnitës në këtë ilustrim të bukur e të gjallë.

5 - Nga ky kënd është edhe ilustrimi i domethënies së humbjes (lajthitjes) pas udhëzimit dhe humbjes së tërë atij mundi përnjëherë, në këto piktura të njëpasnjëshme.

“Të tillët janë që e ndërruan të vërtetën (besimin) me të pavërtetën (mosbesimin), pra tregtia e tyre nuk pati fitim dhe ata nuk ishin të vetëdijshëm (në punën e tyre). Shembulli i tyre (në hipokrizi) është si shembulli i atij që ndez një zjarr dhe, posa ta shndritë ai vendin përreth tij, Allahu ua shuan dritën e tyre dhe i lë në errësirë që mos të shohin. (Mbesin në errësirë) të shurdhër, memecë dhe të verbër, andaj ata nuk kthehen (nga ajo rrugë e tyre e keqe).” (El Bekare, 16-18).

“Ose (shembulli i tyre është) si ndonjë shi i rreptë prej së larti me errësirë, me bubullimë e me vetëtimë, e prej frikës së vdekjes nga rrufeja, ata i vënë gishtat në veshët e tyre. Po Allahu është rrethues i mosbesimtarëve (atij nuk mund t’i shpëtojë askush). Vetëtimia gati ua merr të pamurit dhe sa herë që ajo u bënë dritë atyre ata ecin në te, e kur u errësohet mbesin aty. E sikur të donte Allahu do t’ua merrte të dëgjuarit (me krismën e bubullimës) dhe të pamurit (me shkëndijën e vetëtimës). Vërtet, Allahu është i plotfuqishëm për çdo gjë.” (El Bekare, 19-20).

Këtu gjendet një grumbull i pikturave të njëpasnjëshme në shiritin e kamerës: Ja ata e ndezin zjarrin e ai u bëri dritë. Kur

papritmas Allahu ua merr dritën e tij dhe i mbulon me errësirë. Ose ja kjo shtërngatë: shi i rreptë nga qielli me errësirë, bubullimë e vetëtimë. Ja ata janë të trembur, presin në çdo çast t'i djej zjarri i vetë-timës. Aty u shtohet frika e vdekjes. Marrin dhe i vënë gishtat në veshët e tyre. Edhe pse gishtat në veshë nuk mund ta ndalin klithmën, ato aktivizohen instinktivisht në këto çaste. Ja tani shkëndija e vetëtimës ua merr të pamurit por për një çast ua ndriçon rrugën e ata hapërojnë përmes dritës së saj një hap. Por vetëm sa një dremetje dhe menjëherë ndërpritet e mbeten të shtangur dhe nuk dinë si të hapërojnë...

Sikur objektivi i kamerës të regjistronte një skenë të tillë me të gjitha lëvizjet dhe përcjelljet që i posedon, do të ishte e realizuar mrekullueshëm dhe një punë e rrallë. E si është e mundshme ta parafytyrojmë këtu rastin kur këtë spektakël e regjistrojnë fjalët duke mos u munguar asnjë lëvizje që do ta zinte objektivi i kamerës? Jo, bile këtu i mundësohet emocionit të përjetojë një sensacion më spektakular, duke e aktivizuar imagjinatën ajo i vizaton disa piktura e disa tjera i fshinë, pastaj krijon lëvizje dhe i përcjell ato, ajo vizaton edhe hijet dhe i inskenon, të gjitha shpirti i ndien, ndërgjegjja reagon, zemrës i shtohen të rrahurat, nën ndikimin e kujt? - vetëm nën ndikimin e fjalëve!

Si fjalë plotësuese e metodologjisë ilustrative të Kur'anit është që ne ta përcjellim këtu gjithë atë që është e shpërndarë në vende të ndryshme të librit për jetën të cilën e ndriçon shprehja në ilustrim. Ajo është njëra prej karakteristikave të dallueshme në te, e cila e përcakton llojin e ilustrimit dhe shkallën e tij.

Pa dyshim domethëniet mendore dhe gjendjet emocionale jo që janë transferuar vetëm në piktura, por atyre iu zgjodhën piktura

të gjalla, u dimensionuan me motive të gjalla dhe u zhvilluan në një mes të gjallë.¹⁵

Tmerri i Çastit të Madh ilustrohet përmes braktisjes së gjidhënësive nga foshnjat e tyre, dështimin e barrës së grave shtatzëna dhe kolovitjes së të dehurve që në të vërtetë nuk janë të dehur. E gjithë kjo matet sipas ndikimit të tmerrit në shpirtrat e atyre njerëzve e nuk matet sipas fjalëve dhe përshkrimeve abstrakte.

Pastaj ilustrimi i njeriut i cili ik nga vëllai, nëna, babai, por edhe nga të afërmit e tij që e mbronin ngase:

“Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet.” (Abese, 37).

Këtu ilustrimi matet sipas ndikimit të tij në shpirt e jo me kriteret tjera përshkruese.

Nëse marrin pjesë edhe sendet e ngurrta në ilustrimin e këtij tmerr, zhveshet jeta nga ai ose përndryshe marrin pjesë edhe gjallesat:

“Atë ditë kur toka e kodrat të dridhen, e kodrat bëhen rërë rrëshqitëse.” (Muzemmil, 14).

Ato bëhen të gjalla, dridhen sikur të ishin njerëz.

Ose ajeti:

¹⁵ Për veçimin e kësaj veçorie kur'anore në mënyrë indikative meriton respekt për udhëzimin që na e bëri profesori Abbas Akkad, edhe pse diçka u cek brenda librit gjatë spikatjes së shembujve të ndryshëm.

“Nëse ju mohoni, si do të mbroheni në një ditë që femijët do t’i bëjë pleq? Atë ditë qielli do të çahet.” (Muzemmil, 17-18). Qielli i çarë përskaaj tij edhe fëmijët e thinjur....

Tmerri i tufanit (përmbytjes me ujë) ilustruhet në natyrë ku përskaaj tij pikturohen babai dhe i biri. I pari shpëton hipur në anije i shoqëruar me farefisn (ithtarët e tij) e të dytin e përmbytë tufani ngase: “Nuk ka të mbrojtur nga dënimi i Allahut, pos atë që Ai e ka mëshiruar.” (Hûd, 43). Tmerri këtu thuhetse gati është edhe më i madh se ai në natyrë “Ajo lundron me ta nëpër valë si kodra”. Vala në skenë nuk është asgjë tjetër pos një ambient i tmerrit shpirtëror i cili ndanë birin nga babai dhe ndal lidhjen të cilën nuk mund ta ndërpresin as lemeritjet e ndryshme!

Dhimbjet e ndëshkimit të fortë në ahiret shfaqen përmes klithjeve njerëzore të cilat lëshojnë hijet e tyre përmes shprehjes: “Dhe ata thërrasin: O Malik (engjëll i mbikëqyrjes së zjarrit) le të na marrë shpirtin Zoti yt! Ai thotë “Ju do të jeni aty përgjithmonë.” (Zuhruf 77). “Dhe ata do të klithin aty.” (Fâtir, 37).

Shpimet nënçmuese në atë ditë nuk përshkruhen me fjalë por ndriçohen në një mes njerëzor të gjallë: “E sikur t’i kishe parë ata kur të ndalen para Zotit të tyre e u thuhet atyre: “A nuk është kjo ringjallja e vërtetë”? Ata thonë: “Po për Zotin tonë! Thotë “Shijone pra dënimin për atë që e mohuat.” (En’amë, 39-40).

Klithjet e pendimit i nxjerr gjuha e njeriut i cili u pendua por meqë i kalon koha e pendimit: “Atë ditë zullumqari do t’i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit! O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik.” (Furkân, 27-28).

Rjedhën e besimit e shohim nëpërmjet qenies njerëzore në rrëfimin për Ibrahimin: “E kur atë e mbuloi nata, ai pa një yll e tha: Ky është zoti im! E kur u zhduk ai (perëndoi), tha: Unë nuk i dua ata që humben.” (En’amë, 76).

Sensi për xhihad shfaqet në ilustrimin e qëndrimit mes besimtarëve dhe mohuesve. “Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armikut, sepse nëse ndjeni dhembje edhe ata ndiejnë dhembje sikurse ju, e ju shpresoni nga Allahu çka ata nuk shpresojnë.” (Nisae, 104).

Ky është një ilustrim që e bën dallimin mes realitetit të pjesëmarrësve në luftë. Një dallim i prerë vetëm me disa fjalë. Ai i matë këto dallime me emocionet e dy palëve dhe fatin që i pret të dyja.

Ne nuk do t’i kthehemi ekspozimit të atyre pikturave që veç i kemi ekspozuar në kapitujt e ndryshëm: Pa dyshim do të na mjaftojnë këta shembuj për ta proklamuar llojin e ilustrimit kur’anor dhe për ta sqaruar domethënien e jetës në këtë ilustrim. Jetën e cila i përçon mbresat prej ndjenjës në thellësi të shpirtit, ngase ajo transferohet prej një qenieje të gjallë në një mes të gjallë. Ajo përpëlitet në thellësinë e ndërgjegjes përmes shprehjes dhe ilustrimit.

Ja edhe tipari i tretë në shprehjen kur’anore:

S’do mend, kjo brushë shpikëse nuk ka send të ngurtë që e preku e që nuk i dha frymë dhe jetë, nuk ka send të zakonshëm që e prezentoj e që nuk u duk i freskët dhe i ri. Kjo pra është fuqi mbi fuqitë dhe mrekulli magjepsëse si çdo mrekulli e jetës!

Agimi (mëngjesi) është skenë e zakonshme dhe e përsëritur por ai në shprehjen kur'anore është jetë e re: "Pasha natën që shkon." (F'exhr, 4).

Ajo shpejton kah dita në një garë kolosale, "Ai e mbulon ditën me natën, që më të shpejtë e kërkon atë (mbulimin e dritës së dritës!" (A'rafë, 54).

Hija është një fenomen që e dëshmojmë dhe e njohim mirëpo në shprehjen kur'anore ajo është shpirt që është i ndijshëm dhe i lëvizshëm: "Dhe në hijen prej tymi të zi, as e freskët e as e këndshme." (Vâkia, 43-44).

Muret janë një ndërtim i ngurtë si shkëmbi. Mirëpo në shprehjen kur'anore janë të ndieshëm dhe kanë dëshirë: "E ata të dy gjetën aty një mur që donte të rrëzohej e ai e drejtoi ate." (Kehf, 77).

Shpendi është një qenie e gjallë, megjithatë ai është i zakonshëm dhe nuk tërheq vëmendjen e njerëzve. Mirëpo në shprehjen kur'anore ai krijon skenë spektakulare që impresionon intuitën dhe shpirtin: "A nuk i panë ata shpezët përmbi ta krahëhapur dhe kur krahët i palojnë, ato nuk i mban kush në ajër pos Fuqiplotit." (Mulk, 19).

Toka, qielli, dielli, hëna, kodrat, luginat, shtëpitë e ndërtuara, gjurmët e zhdukura, bimët, shtazët, drurët, degët... të gjitha këto janë gjallesa ose dëshmi që u drejtohen të gjallëve. Kështu pra (në Kur'an), në mesin e sendeve dhe trupave të ngurtë, nuk ka asgjë të vdekur e të ngurtë!

Kjo është metodologjia e Kur'anit dhe ky është stili i tij. Ky është art që përmes domethënies dhe qëllimeve qëndron i

pavarur, kurse arti në pedestalin e tij më të lartë, është prezentues i këtyre domethënieve dhe qëllimeve.

Përmbajtja

Fjala e përkthyesit	3
Përkushtim	5
Kur'anin e kam gjetur	6
Kur'ani magjepsës	11
Burimi i magjepsjes nga Kur'ani	18
Si është kuptuar Kur'ani	27
Ilustrimi artistik.....	40
Përfytyrimi konkret (ndijimor) dhe trupëzimi	82
Harmonizimi artistik	99
Rrëfimi në Kur'an	162
Qëllimet e rrëfimit.....	163
Pasojat e nënshtrimit të rrëfimit ndaj qëllimit fetar	177
Feja dhe arti në rrëfim.....	195
Veçoritë artistike të rrëfimit.....	206
Ilustrimi në rrëfim	217
Përshkrimi i protagonistëve në rrëfim.....	228
Llojet njerëzore	245
Logjika intuitive.....	255
Metodologjia e Kur'anit.....	268